

Enkeleida MILO

Eueda DAUTAJ

Violeta MEÇAJ

LIBËR PËR MËSUESIN

MATEMATIKA 6

Për klasën e 6-të të arsimit 9-vjeçar

BOTIME



BOTIME



Redaktor letrar: Arlon Liko
Paraqitja grafike: Elvis BEJTJA
Shtypi: Shtypshkronja Pegi, Lundër, Tiranë

© Botime Pegi, prill 2018

Të gjitha të drejtat për këtë botim në gjuhën shqipe janë tërësisht të zotëruara nga Botime Pegi shpk. Ndalohet çdo riprodhim, fotokopjim, përshtatje, shfrytëzim ose çdo formë tjetër qarkullimi tregtar, pjesërisht ose tërësisht, pa miratimin paraprak nga botuesi.

Botime Pegi: tel: +355/ 042 468 833; cel: +355/ 069 40 075 02;
e-mail: botimepegi@botimepegi.al; web: www.botimepegi.al
Spektori i shpërndarjes: cel: +355/ 069 20 267 73; 069 60 778 14;
e-mail: marketing@botimepegi.al
Shtypshkronja Pegi: cel: +355/ 069 40 075 01;
e-mail: shtypshkronjapegi@yahoo.com

SHKOLLA: _____

Planifikimi i kurrikulës për klasën VI

Fusha: Matematikë

LËNDA: MATEMATIKË

MËSUESI: _____

Planifikimi përmban: planin vjetor; planet tremujore; formati i planifikimit të orës së mësimi

Viti shkollor _____

PLANI MËSIMOR VJETOR KLASA VI¹

FUSHA: MATEMATIKË

LËNDA: MATEMATIKË

Tematikat	Shpërndarja e përmbajtjes lëndore për realizimin e kompetencave		
	Shtator – Dhjetor 55 orë	Janar – Mars 48 orë	Prill – Qershor 37 orë
Numri + Algjebra dhe Funksioni	Numri dhe vendvlera (sistemi numerik, vendvlera, numrat e thjeshtë, krahasimi i numrave; përfaqësimi dhe rrumbullakimi, vargjet numerike) Thyesat dhe numrat dhjetorë (thyesat e barabarta, thyesat dhe numrat dhjetorë, mbledhja me çiftim, numrat e përzierë, raportit dhe përpjesëtimi, përqindja) Veprime me mend (Strategji të veprimeve me mend për mbledhjen, zbritjen, shumëzimin dhe pjesëtimin, dyfishi dhe gjysma) (55 orë)	Mbledhja dhe zbritja (numrat treshifrorë, mbledhja dhe zbritja e parave, numrat negativë) Shumëzimi dhe pjesëtimi (Shumëzimi i numrave dy-, tre- dhe katërshifrorë, pjesëtimi i numrave treshifrorë me numra dyshifrorë, pjesëtimi me mbetje, vetitë e shumëzimit dhe të pjesëtimin) (25 orë)	
Matja			Njësitë e gjatësisë, të masës dhe të vëllimit (njësitë e matjes, këmbimi i njësive, mjete të shkallëzuara) Koha (njësitë e kohës, këmbimi i njësive, sistemi 24-orësh, koha zonale) 19 orë

¹ Plan i vjetor është hartuar sipas tekstit të Oksfordit për matematikën VI dhe përmban të gjitha njohuritë e parashikuara në program për 140 orë. Orët e tematikës “Numri” janë të integruara edhe në tematikë të tjera si *Gjeometria* dhe *Statistika*. Ndajja e orëve në periudha tremujore varion dhe mund të ndryshojë në varësi të datës së fillimit dhe të mbarimit të shkollës apo të ditëve festive të pushimit. Në planet tremujore janë planifikuar të detajuara të gjitha orët. Mësuesit ndihen të lirë të bëjnë ndryshimet e tyre hap pas hapi në varësi të specifikave të shkollës së tyre.

Gjeometria		Figurat dhe trupat gjeometrikë (klasifikimi i shumëkëndëshave, vetitë e trupave, hapja e trupave, ndërtimi i këndeve dhe këndet e një trekëndëshi) Pozicioni dhe zhvendosja (koordinatat, simetria dhe rrotullimi) 23 orë	Sipërfaqja dhe perimetri (sipërfaqja dhe perimetri i figurave drejtkëndëshe, sipërfaqja e figurave të parregullta, sipërfaqja e figurave të përbëra) (9orë)
Statistika dhe Probabiliteti			Grumbullimi, organizimi, interpretimi dhe përpunimi i të dhënave (mbledhja e të dhënave nëpërmjet anketave të thjeshta nga mjedise të njohura për nxënësin, paraqitja e të dhënave në tabela statistikore e diagrame me shtylla, interpretimi i tyre) Probabiliteti (kuptimi për probabilitetin, përdorimi i shprehjeve: ka mundësi, nuk ka mundësi, mbase) (9 orë)

PLANIFIKIMI TREMUJOR (SHTATOR – DHJETOR)

FUSHA: MATEMATIKA

LËNDA: MATEMATIKA

Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit: Shpreh mendimin e vet për një temë të caktuar me gojë ose me shkrim, si dhe në formë të tjera të komunikimit. Kompetenca e të menduarit: Zgjidh një problem matematikor dhe arsyeton përzgjedhjen e teknikave përkatëse. Përzgjedh dhe demonstroi strategji të ndryshme për zgjidhjen e një problemi matematikor duke paraqitur rezultate të njëjtë. Kompetenca e të nxënës: Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, udhëzues, fjalorë, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzojnë për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën. Shfrytëzojnë të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve numerike, simboleve, formulave në matematikë, duke i sqaruar nëpërmjet formave të ndryshme të të shprehurit. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin: Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët (pavarësisht statusit të tyre social, etnik etj.) për realizimin e një aktiviteti të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klase/shkolle apo jashtë saj). Kompetenca qytetare: Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, shkollë etj. dhe mban qëndrim aktiv ndaj personave, të cilët nuk i respektojnë ato, duke shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bën pjesë.	Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave kyçe Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit: Shpreh mendimin e vet për një temë të caktuar me gojë ose me shkrim, si dhe në formë të tjera të komunikimit. Kompetenca e të menduarit: Zgjidh një problem matematikor dhe arsyeton përzgjedhjen e teknikave përkatëse. Përzgjedh dhe demonstroi strategji të ndryshme për zgjidhjen e një problemi matematikor duke paraqitur rezultate të njëjtë. Kompetenca e të nxënës: Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, udhëzues, fjalorë, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzojnë për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën. Shfrytëzojnë të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve numerike, simboleve, formulave në matematikë, duke i sqaruar nëpërmjet formave të ndryshme të të shprehurit. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin: Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët (pavarësisht statusit të tyre social, etnik etj.) për realizimin e një aktiviteti të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klase/shkolle apo jashtë saj). Kompetenca qytetare: Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, shkollë etj. dhe mban qëndrim aktiv ndaj personave, të cilët nuk i respektojnë ato, duke shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bën pjesë.
Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave matematikore Zgjidhja probleme: Përdor simbole dhe fakte për zgjidhjen probleme që lidhen me numra natyrorë, dhjetorë dhe thyesorë. Përzgjedh dhe zbaton teknika të përshtatshme për zgjidhjen e problemeve. Arsyetimi dhe vërtetimi matematik: Klasifikon numrat natyrorë, dhjetorë dhe thyesorë. Të menduarit dhe komunikimi matematik: Demonstroi zbatimin e numrave natyrorë, të plotë dhe thyesorë; Komunikon të menduarin e tij matematik (nëpërmjet të lexuarit, të shkruarit, diskutimit, të dëgjuarit, të pyeturit) duke përdorur: gjuhën e përditshme, fjalorin fillestar matematik, paraqitje të ndryshme. Mendon matematikën si pjesë e kulturës njerëzore. Lidhja konceptuale: Bën lidhje ndërmjet koncepteve e procedurave matematikore. Integron njohuritë e shprehurit matematike me situata ose dukuritë e marra nga kontekste të tjera (jeta e përditshme, lëndët e tjera, sportet etj.). Integron/lidh koncepte të ndryshme matematike në mënyrë që të zgjidhë problema të ndryshme. Përdorimi i teknologjisë në matematikë: Përdor makina llogaritëse për verifikimin dhe zgjidhjen e problemeve matematikore.	

Nr.	Kapitulli	Temat mësimore	Situata e parashikuar e të nxëniet	Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve	Vlerësimi	Burimet
1.	Numri dhe vendvlera (17 orë)	Diskutojmë së bashku	<i>Mbushja e klasës me qigra</i>	Metoda ndërvepruese, bashkëvepruese, gjithëpërfshirëse; Puna në grup dhe puna individuale; Hetimi dhe zbulimi; Zbatime praktike brenda dhe jashtë klase Metoda integrale Bashkëbisedim Teknika që zhvillojnë mendimin	Vlerësim diagnostikues - intervistë me një listë treguesish; - vetëvlerësim me listë kontrolli; Vlerësim për të nxënë (vlerësim formues) - vlerësimi i përgjigjeve me gojë; - vlerësimi i punës në grup; - vlerësim mes nxënësish; - vlerësim i aktivitetit gjatë debateve në klasë;	Teksti i matematikës për klasën VI; teksti i mësuesit për klasën VI; materiale nga interneti; materiale nga enciklopedi; tekst nga fusha të tjera; slide/ materiale të krijuara nga mësuesit; modele të detyrave
2.		Sistemi numerik – Zbulojmë	<i>Sisteme të tjera numerike</i>			
3.		Sistemi numerik – Eksplorojmë	<i>Jashtëtokësorët</i>			
4.		Vendvlera – Zbulojmë	<i>Loja me etiketat e shifrave</i>			
5.		Vendvlera – Eksplorojmë	<i>Përdorimi i makinës llogaritëse</i>			
6.		Vetitë e numrave – Zbulojmë	<i>Sita e Eratostenit</i>			
7.		Vetitë e numrave – Eksplorojmë				
8.		Krahasimi i numrave – Zbulojmë	<i>Zari kubik me shifrat 0–6</i>			
9.		Krahasimi i numrave – Eksplorojmë	<i>Sipërfaqet e disa shteteve të Evropës</i>			
10.		Përafrimi dhe rrumbullakimi – Zbulojmë	<i>Etiketat me shifrat 0–9</i>			
11.		Përafrimi dhe rrumbullakimi – Eksplorojmë				
12.		Vargjet numerike – Zbulojmë				
13.		Vargjet numerike – Eksplorojmë	<i>Loja “Kalo rrethin” dhe “Krijoi grupin”</i>			
14.		Numri dhe vendvlera – Përmbledhim				
15.		Numri dhe vendvlera – Përforcim	<i>Loja – Gjej numrin tim</i>			
16.		<i>Vetëvlerësim</i>	Libri i mësuesit (Veprimtari vlerësuese)			
17.		Projekt (1)				
18.	Thyesat dhe numrat dhjetorë (18 orë)	Diskutojmë së bashku	<i>Në dyqanin e veshjeve</i>	Bashkëbisedim Teknika që zhvillojnë mendimin		
19.		Thyesat e barabarta – Zbulojmë	<i>Ndarja e çokollatës</i>			
20.		Thyesat e barabarta – Eksplorojmë				
21.		Thyesat dhe numrat dhjetorë – Zbulojmë				
22.		Thyesat dhe numrat dhjetorë –	<i>Lojërat Olimpike</i>			

	Eksplorojmë		kritik dhe krijues	nga nxënësit;
23.	Mbledhja me çiftim – Zbulojmë	<i>Etiketat me shifrat 0-9</i>		vlerësim i detyrave të shtëpisë;
24.	Mbledhja me çiftim – Eksplorojmë			vetëvlerësim;
25.	Projekt (2)		Prezantime në forma të ndryshme,	makina llogaritëse;
26.	Numrat e përzier dhe thyesat më të mëdha se 1 – Zbulojmë	<i>Loja me karrige dhe çokollata</i>	përfshirë TIK	etiketa numrash etj.
27.	Numrat e përzierë dhe thyesat më të mëdha se 1 – Eksplorojmë	<i>Situata me pica, kekë, pite etj.</i>		
28.	Raporti dhe përpjesëtimi – Zbulojmë	<i>Kutiitë e bojës sipas ngjyrave</i>	Projekte kurrikulare	
29.	Raporti dhe përpjesëtimi – Eksplorojmë		Konkurse	
30.	Përqindja – Zbulojmë	<i>Pikët e një testi</i>		
31.	Përqindja – Eksplorojmë			
32.	Thyesat dhe numrat dhjetorë – Përmbledhim	<i>Në dyqan veshjesh</i>		
33.	Thyesat dhe numrat dhjetorë – Përforcim	<i>Etiketat me numra</i>		
34.	TEST			Vlerësimi i të nxëniet (vlerësimi përmbledhës)
35.	Projekt (3)			
36.	Diskutojmë së bashku			
37.	Strategjitë e kryerjes me mend të mbledhjes dhe të zbritjes – Zbulojmë	<i>Loja, cilët mund të jenë dy numra, Stacionet e autobusit</i>		test për një grup temash të caktuara;
38.	Strategjitë e kryerjes me mend të mbledhjes dhe të zbritjes – Eksplorojmë	<i>Etiketat me shifrat 1,2,3,4,5</i>		test në përfundim të një kohe të caktuar;
39.	Strategjitë e kryerjes me mend të shumëzimit dhe pjesëtimit– Zbulojmë			Vlerësim i portofolit
40.	Strategjitë e kryerjes me mend të shumëzimit dhe të pjesëtimit –			

[illegible]

PLANIFIKIMI TREMUJOR (JANAR – MARS)

Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit: dëgjon me vëmendje prezantimin dhe komentet e bëra nga të tjerët rreth një teme, duke bërë pyetje, komente, sqarime dhe propozime. Kompetenca e të menduarit: Zgjidh një problem matematikor dhe arsyeton përzgjedhjen e teknikave përkatëse. Përzgjedh dhe demonstroi strategji të ndryshme për zgjidhjen e një problemi matematikor duke paraqitur rezultate të njëjta. Kompetenca e të nxënit: Shfrytëzon portofolin personal për identifikimin e përparësive dhe të mangësive në funksion të vetëvlerësimit të përparimit dhe të përmirësimit të suksesit. Ndërlidh temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake, duke i paraqitur në formë të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafike) sipas një radhitjeje logjike. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin: Zhvillon një projekt individual ose në grup për kryerjen e një aktiviteti mjedisor apo shoqëror me rëndësi për shkollën ose për komunitetin. Kompetenca personale: Vlerëson shkaqet e një situatë të mundshme konflikti midis moshatarëve ose anëtarëve të grupit dhe propozon alternativa për parandalimin dhe zgjidhjen, duke ndarë përvojat dhe mendimet në grup.	Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave matematikore Zgjidhja probleme: Përdor simbole dhe fakte për zgjidhjen probleme që lidhen me numra natyrorë, të plotë, dhjetorë dhe thyesorë. Përdor majet në figurat 2D ($D = \text{dimensionale}$) për zgjidhjen probleme. Përzgjedh dhe zbaton teknika të përshtatshme për zgjidhjen e problemeve. Arsyetimi dhe vërtetimi matematik: Klasifikon numrat. Prezanton të dhëna empirike për figurat 2D. Ndërton figura gjeometrike.. Të menduarit dhe komunikimi matematik: Demonstroi zbatimin e numrave natyrorë, të plotë, dhjetorë dhe thyesorë. Kryen matje për figurat 2D. Përdor simbolet gjeometrike për të përshkruar situata të ndryshme nga matematika dhe nga jeta e përditshme. Krijon paraqitje të koncepteve matematike (p.sh., me mjete konkrete, vizatime) dhe i zbaton në problema nga situata reale; e mendon matematikën si pjesë të kulturës njerëzore. Lidhja konceptuale: Bën lidhje ndërmjet koncepteve e procedurave matematikore. Integron njohuritë e shprehitë matematike me situata ose dukuritë e marra nga kontekste të tjera (jeta e përditshme, lëndët e tjera, sportet etj.). Modelimi matematik: Krijon modele që përmbajnë konceptet bazë matematikore. Përdorimi i teknologjisë në matematikë: Përdor makina llogaritëse për verifikimin dhe zgjidhjen e problemeve matematikore.
--	---

Nr.	Kapitulli	Temat mësimore	Situata e parashikuar e të nxënësve	Metodologjia dhe veprimtari të nxënësve	Vlerësimi	Burimet
56.	Mbledhja dhe zbritja (10 orë)	Diskutojmë së bashku	Mbledhja e shkronjave	Metoda	Vlerësim diagnostikues	Teksti i
57.		Mbledhja dhe zbritja e numrave treshifrorë – Zbulojmë		ndërvepruese,		matematikës për
58.		Mbledhja dhe zbritja e numrave treshifrorë – Eksplorojmë		bashkëvepruese,	• intervistë me një listë treguesish;	klasën VI;
59.		Mbledhja dhe zbritja e parave – Zbulojmë	Etiketat me shifrat 0-9	gjithëpërfshirëse;	• vetëvlerësim me listë kontrolli	teksti i mësuësit për klasën VI;
60.		Mbledhja dhe zbritja e parave – Eksplorojmë	Posta, muri i klasës, interneti, stafeta e vrapimit, interneti etj.	Puna në grup dhe		materiale nga interneti;
61.		Përdorimi i numrave negativë – Zbulojmë	Termometri, temperaturat në vende të ndryshme	puna individuale;	Vlerësim për të nxënë (vlerësim formues)	materiale nga enciklopedi;
62.		Përdorimi i numrave negativë – Eksplorojmë		Hetimi dhe zbulimi;	• vlerësimi i përgjigjeve me gojë;	tekst nga fusha të tjera;
63.		Mbledhja dhe zbritja – Përmbledhim	Nevojat dhe rezervat ujore, Votimet	Zbatime praktike brenda dhe jashtë klase	• vlerësimi i punës në grup;	slide/ materiale të krijuara nga mësuësit;
64.	Shumëzimi dhe pjesëtimi (15 orë)	Mbledhja dhe zbritja – Përforcojmë	Libri i mësuësit (veprimtari vlerësuese)	Metoda integruese	• vlerësim mes nxënësish;	
65.		Vetëvlerësim		Bashkëbisedim	• vlerësim i aktivitetit gjatë debateve në	
66.		Diskutojmë së bashku		Teknika që		
67.		Shumëzimi i numrave dy-, tre- dhe katërshifrorë – Zbulojmë				
68.		Shumëzimi i numrave dy-, tre- dhe katërshifrorë – Eksplorojmë				
69.		Pjesëtimi i numrave treshifrorë me numra dyshifrorë – Zbulojmë				
70.		Pjesëtimi i numrave treshifrorë me numra dyshifrorë – Eksplorojmë				
71.		Pjesëtimi me mbetje – Zbulojmë	Blerja e artikujve			
72.		Pjesëtimi me mbetje – Eksplorojmë				

73.	Përdorimi i shumëzimit dhe i pjesëtimit – Zbulojmë		zhvillojnë mendimin kritik dhe krijues	klasë;	modele të detyrave nga nxënësit;
74.	Përdorimi i shumëzimit dhe i pjesëtimit – Zbulojmë			• vlerësim i detyrave të shtëpisë;	
75.	Përdorimi i shumëzimit dhe i pjesëtimit – Eksplorojmë	<i>Loja me numra</i>	Prezantime në forma të ndryshme, përfshirë TIK	• vetëvlerësim;	makina llogaritëse;
76.	Shumëzimi dhe pjesëtimi – Përmbledhim	<i>Lista e blerjeve</i>		• intervistë me një listë treguesish;	etiketa numrash;
77.	Shumëzimi dhe pjesëtimi – Përforcojmë		Projekte kurrikulare	• vëzhgim me një listë të plotë treguesish,	etj.
78.	TEST			• portofol,	
79.	Projekti (4)			• prezantim me gojë ose me shkrim,	
80.	Festa e verës	Aktivitet shkollor	Konkurse	• projekt kurrikular	
81.	Diskutojmë së bashku	<i>Figura nga jeta reale</i>			
82.	Klasifikimi i shumëkëndësive – Zbulojmë	<i>Figura me letra</i>			
83.	Klasifikimi i shumëkëndësive – Eksplorojmë				
84.	Vetitë e trupave – Zbulojmë	<i>Trupa të krijuar nga nxënësit</i>		Vlerësimi i të nxënitorit (vlerësimi përmblendës)	
85.	Vetitë e trupave – Eksplorojmë				
86.	Hapja e trupave (3D) nëpërmjet figurave (2D) – Zbulojmë	<i>Trupa kartoni të krijuar nga nxënësit</i>		• test për një grup temash të caktuara;	
87.	Hapja e trupave (3D) nëpërmjet figurave (2D) – Eksplorojmë			• test në përfundim të një kohe të caktuar;	
88.	Ndërtimi i këndeve dhe këndet e një trekëndëshi – Zbulojmë			• Vlerësim i portofolit	
89.	Ndërtimi i këndeve dhe këndet e një trekëndëshi – Eksplorojmë	<i>Këndet në klasën tuaj (format trekëndore)</i>			
90.	Figurat dhe trupat gjeometrikë – Përmbledhim	<i>Këndi i lojërave</i>			
91.	Figurat dhe trupat gjeometrikë –	<i>Figurat dhe trupat në klasë</i>			

		Përforcime			
92.		Vetëvlerësim		<i>Libri i mësuësit (veprimtari vlerësues)</i>	
93.	Pozicioni dhe zhvendosja (11 orë)	Projekti (5)			
94.		Diskutojmë së bashku		<i>Motivi</i>	
95.		Leximi dhe vendosja e koordinatave – Zbulojmë		<i>Plani i klasës</i>	
96.		Leximi dhe vendosja e koordinatave – Eksplorojmë			
97.		Simetria dhe rrotullimi – Zbulojmë		<i>Motivi</i>	
98.		Simetria dhe rrotullimi – Eksplorojmë			
99.		Pozicioni dhe zhvendosja – Përmbledhim		<i>Logot</i>	
100.		Pozicioni dhe zhvendosja – Përforcime		<i>Skicimi i një posteri</i>	
101.		Projekti (6)			
102.		TEST PËRMBLEDHËS			
103.		VLERËSIMI I PORTOFOLIT			

PLANIFIKIMI TREMUJOR (PRILL – QERSHOR)

Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave kyçe

Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit: dëgjon me vëmendje prezantimin dhe komentet e bëra nga të tjerët rreth një teme, duke bërë pyetje, komente, sqarime dhe propozime.

Kompetenca e të menduarit: Zgjidh një problem matematikor dhe arsyeton përzgjedhjen e teknikave përkatëse. Përzgjedh dhe demonstroi strategji të ndryshme për zgjidhjen e një problemi matematikor duke paraqitur rezultate të njëjta.

Kompetenca e të nxënës: Shfrytëzon portofolin personal për identifikimin e përparësive dhe të mangësive në funksion të vetëvlerësimit, të përparimit dhe të përmirësimit të suksesit. Ndërlidh temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake, duke i paraqitur në formë të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafike) sipas një radhiqeje logjike.

Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin: Zhvillon një projekt individual ose në grup për kryerjen e një aktiviteti mjedisor apo shoqëror me rëndësi për shkollën ose për komunitetin.

Kompetenca personale: Vlerëson shkaqet e një situatë të mundshme konflikti midis moshatarëve ose anëtarëve të grupit dhe propozon alternativa për parandalimin dhe zgjidhjen, duke ndarë përvojat dhe mendimet në grup.

Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave matematikore

Zgjidhja probleme: Përdor matjet në figurat 2D ($D = \text{dimensionale}$) për zgjidhjen probleme. Kryen vërtetime dhe interpretime të tabelave dhe të diagrameve të gatshme. Përzgjedh dhe zbaton teknika të përshtatshme për zgjidhjen e problemeve.

Arsyetimi dhe vërtetimi matematik: Prezanton të dhëna empirike për figurat 2D. Ndërton figura gjeometrike. Sugjeron formë të ndryshme të paraqitjes së të dhënave.

Të menduarit dhe komunikimi matematik: Kryen matje për figurat 2D. Përdor simbolet gjeometrike për të përshkruar situata të ndryshme nga matematika dhe nga jeta e përditshme. Kryen paraqitje të koncepteve matematike (p.sh., me mjete konkrete, vizatime) dhe i zbaton në problema nga situata reale. Përdor terminologjinë matematikore (p.sh., modë, mesore, mesatare aritmetike etj.) për të përshkruar situata të ndryshme nga matematika dhe nga jeta e përditshme.

Lidhja konceptuale: Bën lidhje ndërmjet koncepteve e procedurave matematikore. Integron njohuritë e shprehurit matematike me situata ose dukuritë e marra nga kontekste të tjera (jeta e përditshme, lëndët e tjera, sportet etj.).

Modelimi matematik: Kryen modele që përmbajnë konceptet bazë matematikore. Përdor grafikët për përshkrimin dhe zgjidhjen e problemeve të ndryshme në matematikë, në fushat e tjera dhe në jetën e përditshme.

Përdorimi i teknologjisë në matematikë: Përdor teknologjinë për komunikuar dhe për të zbuluar informacion matematik.

Nr.	Kapitulli	Temat mësimore	Situata e parashikuar e të nxënit	Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve	Vlerësimi	Burimet
104.	Njësitë e gjatësisë, të masës dhe të vëllimit (9 orë)	Diskutojmë së bashku Zgjedhja dhe përdorimi i njësive të përshtatshme të matjes – Zbulojmë Zgjedhja dhe përdorimi i njësive të përshtatshme të matjes – Eksplorojmë Këmbimi i njësive të matjes – Zbulojmë Këmbimi i njësive të matjes – Eksplorojmë Përdorimi i mjeteve të shkallëzuara për matje të saktë – Zbulojmë Përdorimi i mjeteve të shkallëzuara për matje të saktë – Eksplorojmë Njësitë e gjatësisë, të masës dhe të vëllimit – Përmbledhim Njësitë e gjatësisë, të masës dhe të vëllimit – Përforcojmë Diskutojmë së bashku Këmbimi i njësive të kohës – Zbulojmë Këmbimi i njësive të kohës – Eksplorojmë Përdorimi i sistemit 24-orësh të kohës dhe tabelat e orareve – Zbulojmë Përdorimi i sistemit 24-orësh të kohës dhe tabelat e orareve – Eksplorojmë Llogaritja e intervaleve të kohës dhe koha zonale – Zbulojmë	<i>Inxhinieri, Mjekja, Kuzhinieri</i> <i>Gjatësi nga jeta reale (enciklopedi)</i> <i>Objekte nga jeta reale</i> <i>Matim njëri – tjetrin</i> <i>Mjete të shkallëzuara</i> <i>Makineria e pastave</i> <i>Ora me akrepa, ora digjitale</i> <i>Ditë shkolle, ditë pushimi, udhëtime etj.</i> <i>Udhëtimi me autobus</i> <i>Harta gjeografike sipas zonave</i>	Metoda ndërvepruese, bashkëvepruese, gjithëpërfshirëse; Puna në grup dhe puna individuale; Hetimi dhe zbulimi; Zbatime praktike brenda dhe jashtë klase Metoda integrale Bashkëbisedim Teknika që zhvillojnë mendimin	Vlerësim diagnostikues • intervistë me një listë treguesish; • vetëvlerësim me listë kontrolli; Vlerësim për të nxënë (Vlerësim formues) • vlerësimi i përgjigjeve me gojë; • vlerësimi i punës në grup; • vlerësim mes nxënësish; • vlerësim i aktivitetit gjatë debateve në klasë;	Teksti i matematikës për klasën VI; teksti i mësuesit për klasën VI; materiale nga interneti; materiale nga enciklopedi; tekst nga fusha të tjera; <i>slide/ materiale të krijuara nga mësuesit;</i> modele të detyrave
105.	Koha (10 orë)					
106.						
107.						
108.						
109.						
110.						
111.						
112.						
113.						
114.						
115.						
116.						
117.						
118.						

119.	Llogaritja e intervaleve të kohës dhe koha zonale – Eksplorojmë	<i>Ora në vende të ndryshme të botës</i>	kritik dhe krijues	• vlerësim i detyrave të shtëpisë;	nga nxënësit;
120.	Koha – Përmbledhim	<i>Udhëtimi në një ishull</i>	Prezantime në forma të ndryshme,	• vetëvlerësim;	makina llogaritëse;
121.	Koha – Përforcim		përfshirë TIK	• intervistë me një listë treguesish;	etiketa numrash;
122.	TEST		Projekte kurrikulare	• vëzhgim me një listë të plotë treguesish,	etj.
123.	Diskutojmë së bashku		Konkurse	• portofol,	
124.	Sipërfaqja dhe perimetri i figurave drejkëndore – Zbulojmë	<i>Në fermë</i>		• prezantim me gojë ose me shkrim,	
125.	Sipërfaqja dhe perimetri i figurave drejkëndore – Eksplorojmë			• projekt kurrikular	
126.	Vlerësimi i sipërfaqes së figurave të parregullta duke numëruar katrorët – Zbulojmë	<i>Pëllëmba e dorës, Harta e Shqipërisë</i>			
127.	Vlerësimi i sipërfaqes së figurave të parregullta duke numëruar katrorët – Eksplorojmë	<i>Motivi</i>		Vlerësimi i të nxënësve (vlerësimi përmblendës)	
128.	Llogaritja e sipërfaqes dhe e perimetrit të figurave të përbëra – Zbulojmë	<i>Sipërfaqja e shteteve</i>			
129.	Llogaritja e sipërfaqes dhe e perimetrit të figurave të përbëra – Eksplorojmë	<i>Kubet e sheqerit</i>		• test për një grup temash të caktuara;	
130.	Sipërfaqja dhe perimetri – Përmbledhim	<i>Dollapë në klasë</i>		• test në përfundim të një kohe të caktuar;	
131.	Sipërfaqja dhe perimetri – Përforcim	<i>Skicimi i pishinës</i>		• Vlerësim i portofolit	
132.	Përpunimi i të dhënave (9 orë)	Përpunimi i të dhënave – Përcaktoj pyetjen time <i>Projekt (1)</i>			
133.	Përpunimi i të dhënave (9 orë)	Përpunimi i të dhënave – Çfarë di unë deri tani			

134.		Përpunimi i të dhënave – Kryerja e një studimi Projekt (2)				
135.		Përpunimi i të dhënave – Paraqitja e të dhënave				
136.		Përpunimi i të dhënave – Interpretimi i të dhënave, planifikimi i një prezantimi (Projekt 3)				
137.		Probabiliteti – Zbulojmë				
138.		Probabiliteti – Eksplorojmë				
139.		TEST PËRMBLEDHËS				
140.		VLERËSIMI I PORTOFOLIT				

Fusha Matematikë		Lënda Matematikë		Shkalla III		Klasa VI	
Tema mësimore: Diskutojmë së bashku				Situata e të nxënit: Përdor numra shumë të mëdhenj për të zgjidhur situata problemore praktike.			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: • kupton çfarë përfaqëson secila shifër në të gjithë numrat deri në një milion; • krijon dhe arsyeton përafrimet dhe rrumbullakimet e numrave të mëdhenj; • zgjedh strategji të përshtatshme dhe efikase të veprimeve me mend ose me shkrim për të realizuar një veprim (mbledhje, zbritje, shumëzim ose pjesëtim); • përdor sistemin e matjeve në jetën e përditshme.				Fjalët kyçe: • Numër • Vendvlerë • Klasa • Rrumbullakim • Përafërsisht			
Burimet : libri i nxënësit; vizore dhe metër shirit; kuti me kuboidë të madhësive të ndryshme, kokrra bizeleje, fasuleje dhe qiqre; makinë llogaritëse		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare Numri. Matjet					
Metodologjia, teknikat e përdorura, veprimtaritë e nxënësve							
Organizimi i orës së mësimi							
Parashikimi i të nxënit: Diskutimi i njohurive paraprake Me anë të metodës “stuhi mendimi”, nxënësit pasqyrojnë njohuritë e marra mbi numrin natyror në klasat e mëparshme: • Sa shifra përdorim për të shkruar numrat? • A mund t'i shkruaj të gjithë numrat natyrorë? • Sa kohë më duhet për të numëruar deri në 1 000 000? • Çdo numër do kohë të njëjtë. • Si veprojmë për të lexuar numra shumë të mëdhenj? • Sa klasa njohim? Nxënësit përgjigjen dhe pas çdo përgjigjeje plotësojnë diagramin për numrin duke kërkuar ilustrime praktike.							
Ndërtimi i njohurive të reja: Kërko – Hulumto ➤ Pyes nxënësit se sa kokrra qiqre na duhen për të mbushur klasën. ➤ Pastaj marr një kuti të vogël dhe i pyes se sa kokrra më duhen për të mbushur kutinë. ➤ Sa kuti do të duhen për të mbushur 1m³? ➤ Sa m³ është klasa? Ndaj klasën në grupe dhe iu jap kohë nxënësve të zgjidhin problemën. Secili grup jep përgjigjen e tij duke bërë argumentimin përkatës. Pranoj çdo përgjigje të saktë. Bëj pyetjen: Vlerat që dolën janë plotësisht të sakta apo duhet t'i rrumbullakosim? Kërkoj nga nxënësit të rrumbullakosin numrat në dhjetëshen, qindëshen, mijëshen më të afërt.							
Përforsimi: 1. Çfarë tregon shifra 4 te numërorët. a) 200 341 _____ b) 453 029 _____ 2. Rrumbullakos në dhjetëshen, qindëshen, mijëshen më të afërt.							
Numri		Në dhjetëshen më të afërt		Në qindëshen më të afërt		Në mijëshen më të afërt	
409 573							
Diskutoj përgjigjet dhe nxis nxënësit të lexojnë saktë numrat.							

Vlerësimi: Bëj vlerësimin e nxënësve për punën në grup, për argumentimin e përgjigjeve dhe shkathhtësinë në kryerjen e veprimeve.

Detyrat e dhëna për punë të pavarur: Kërkoj nga nxënësit të zgjedhin 10 numra 5- dhe 6-shifrorë; t'i lexojnë dhe rrumbullakosin në dhjetëshen, qindëshen, mijëshen më të afërt.

Fusha Matematikë	Lënda Matematikë	Shkalla III	Klasa VI																																																																		
Tema mësimore: Sistemi numerik-Zbulojmë		Situata e të nxënësve: Gjen të përbashkëtat e sistemeve të numërimit që përdoren nga popuj të ndryshëm të botës.																																																																			
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: - njih origjinën historike të sistemit numerik dhe fillon të kuptojë si është zhvilluar ai; - di çfarë përfaqëson secila shifër në të gjithë numrat deri në 1 000 000; - përdor arsyetimin logjik për të kuptuar dhe zgjidhur - problemat me numra dhe gjëgjëza matematikore.		Fjalët kyçe: - Vendvlerë - Klasë - Shifër - Sistem numerik - Sistem dhjetor numerik																																																																			
Burimet: - Libri i nxënësit - Katrorë me shkrime të ndryshme	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare Historia																																																																				
Metodologjia e përdorur; veprimtaritë e nxënësve																																																																					
Organizimi i orës së mësimin																																																																					
Parashikimi i të nxënësve: Mendo – diskuto Nxënësit numërojnë në formë stafete deri në 100. Paraqes para tyre tabelat deri në 100 me shkrime nga Bengali, Kina dhe Arabia (kujdesem të saktësoj se arabët lexojnë nga e djathta në të majtë.) Kërkoj nga nxënësit të tregojnë cila është karakteristika e përbashkët që lidh shkrimin e të gjithë këtyre numrave. Theksoj se sistemi i numërimit indo-arabik u zhvillua nga matematikani persian Al-Khuarezmi, rreth vitit 825 pas Krishtit, bazuar në një sistem të mëparshëm të përpunuar nga matematikanët indianë. Ndërtimi i njohurive të reja: Hulumtim – shqyrtim i përbashkët Paraqes para klasës një tabelë që tregon evoluimin e shkrimit të numrave.																																																																					
<table><tr><td>European</td><td>0</td><td>1</td><td>2</td><td>3</td><td>4</td><td>5</td><td>6</td><td>7</td><td>8</td><td>9</td></tr><tr><td>Arabic-Indic</td><td>.</td><td>١</td><td>٢</td><td>٣</td><td>٤</td><td>٥</td><td>٦</td><td>٧</td><td>٨</td><td>٩</td></tr><tr><td>Persian / Urdu</td><td>.</td><td>١</td><td>٢</td><td>٣</td><td>٤</td><td>٥</td><td>٦</td><td>٧</td><td>٨</td><td>٩</td></tr><tr><td>Devanagari Hindi</td><td>०</td><td>१</td><td>२</td><td>३</td><td>४</td><td>५</td><td>६</td><td>७</td><td>८</td><td>९</td></tr><tr><td>Gupta (4th cent. AD)</td><td>—</td><td>=</td><td>≡</td><td>५</td><td>६</td><td>७</td><td>८</td><td>९</td><td>५</td><td>३</td></tr><tr><td>Brahmi (1st cent. AD)</td><td>—</td><td>=</td><td>≡</td><td>+</td><td>h</td><td>५</td><td>७</td><td>८</td><td>५</td><td>३</td></tr></table>				European	0	1	2	3	4	5	6	7	8	9	Arabic-Indic	.	١	٢	٣	٤	٥	٦	٧	٨	٩	Persian / Urdu	.	١	٢	٣	٤	٥	٦	٧	٨	٩	Devanagari Hindi	०	१	२	३	४	५	६	७	८	९	Gupta (4th cent. AD)	—	=	≡	५	६	७	८	९	५	३	Brahmi (1st cent. AD)	—	=	≡	+	h	५	७	८	५	३
European	0	1	2	3	4	5	6	7	8	9																																																											
Arabic-Indic	.	١	٢	٣	٤	٥	٦	٧	٨	٩																																																											
Persian / Urdu	.	١	٢	٣	٤	٥	٦	٧	٨	٩																																																											
Devanagari Hindi	०	१	२	३	४	५	६	७	८	९																																																											
Gupta (4th cent. AD)	—	=	≡	५	६	७	८	९	५	३																																																											
Brahmi (1st cent. AD)	—	=	≡	+	h	५	७	८	५	३																																																											
Kërkoj nga nxënësit të kryejnë mbledhje dhe zbritje duke përdorur simbolet e vendeve të ndryshme (punë dyshe). Përforcimi: Nxënësit tregojnë para klasës si i kanë kryer veprimet. Nxis nxënësit të përdorin sa më shumë simbole. Ftoj disa nxënës të vijnë përpara klasës dhe të shkruajnë një nga llogaritjet e tyre në dërrasë. Shokët me të cilët kanë punuar në çift duhet të shkruajnë përgjigjet në shkrimin e duhur në minitabelat e tyre. Nxënësit që kanë dalë përpara klasës, duhet të kontrollojnë përgjigjet. Këtë e përsëris disa herë duke përdorur shkrime të ndryshme. P.sh: Si shkruhet 24 = 13 + 11 me simbolet kineze, të Bengalit dhe ato arabe. Përsëris veprimin deri sa të plotësohet e gjithë tabela e librit.																																																																					

Vlerësimi: vlerësoj nxënësit për aktivizimin në orën e mësimit. Për mënyrën si kanë punuar në dyshe; për mënyrën si kanë argumentuar përgjigjet dhe si kanë përdorur tabelat për të marrë rezultatin e dëshiruar.

Detyrat e dhëna për punë të pavarur. Të gjejnë sisteme të tjera numërimi për të plotësuar rreshtin e fundit të tabelës së librit (maja, romak etj.)

Fusha Matematikë	Lënda Matematikë	Shkalla III	Klasa VI
Tema mësimore: Sistemi numerik-Eksplorojmë		Situata e të nxënit: Të krijojë një ide të qartë për kuptimin e vendvlerës në një sistem numërimi jo vetëm me bazë 10.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: - uneh origjinën historike të sistemit numerik dhe fillon të kuptojë si është zhvilluar ai; - di çfarë përfaqëson secila shifër në të gjithë numrat - deri në një milion; - përdor arsyetimin logjik për të kuptuar dhe zgjidhur - problemat me nmra dhe gjëgjëza matematikore.		Fjalët kyçe: - Sistem numerik - Vendvlerë - Sistem dhjetor - Bazë e një sistemi numerik	
Burimet: libri i nxënësit; katrorë me shkrime të ndryshme për t'i përdorur si ide; minitabela.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare Histori Gjuhë	
Metodologjia, teknikat e përdorura, veprimtaritë e nxënësve			
Organizimi i orës së mësimit.			
Parashikimi i të nxënit: Mendo – krijo dyshe – diskuto Nxënësit, të ndarë në çifte, shohin imazhet në librin e nxënësit. U kërkoj të diskutojnë se si mund të jetë zhvilluar një sistem numërimi nga “jashtëtokësorët”. Ata mund të mendojnë për një sistem me bazë 3 ose me bazë 4, ose me bazë 6 apo me bazë 8. Kjo do të thotë që jashtëtokësorët me tre gishta mund të numërojnë deri në gjashtë dhe atëherë filloni me “dhjetëshet”. Pranoj çdo përgjigje të tyre. Nxënësit duhet të zhvillojnë idetë e tyre krijuese. Duke krijuar një sistem të ri numërimi, i ndihmoj nxënësit të kuptojnë qartë strukturën e sistemit numerik. Kjo do të thotë se, nëse nxënësit do të krijojnë një sistem numërimi me bazë 3, ata do të përdorin vetëm tri simbole për 0,1 dhe 2. Nëse do të përdorin një sistem numërimi me bazë 4, do të përdorin katër simbole, e kështu me radhë, nëse do të përdorë një sistem numërimi me bazë 6 ose 8.			
Ndërtimi i njohurive të reja: Hulumtim – shqyrtim i përbashkët Bazuar në skemën e “Hyrjes”, nxënësit punojnë në çifte për të shpikur sistemin e tyre të numërimit dhe e plotësojnë këtë në librin e nxënësit. I nxis nxënësit të zhvillojnë modele si me fjalë, ashtu edhe me simbole, duke përdorur modele ekzistuese në gjuhët që mund të njohin.			
Përforcimi: Kërkojini njërit nxënës të secilit çift të bëjë pyetje për shokun/shoqen e vet duke përdorur këto simbole. E përsëris këtë kur nxënësit shkëmbejnë rolet. Zgjedh një nga çiftet që “t'i mësojë” pjesës tjetër të klasës sistemin e shpikur. Zgjedh një çift, i cili ka zhvilluar në mënyrë të qartë si fjalët, ashtu edhe simbolet.			
Vlerësimi: vlerësoj nxënësit për punën dyshe dhe për mënyrën e argumentimit të përgjigjes.			
Detyrat e dhëna për punë të pavarur: Material shtesë për sistemin e numërimit me bazë 2 dhe për përdorimin e tij.			

Fusha Matematikë	Lënda Matematikë	Shkalla III	Klasa VI
Tema mësimore: Vendvlera- Zbulojmë		Situata e të nxënësve: Të ketë një ide të qartë për kuptimin e vendvlerës, jo vetëm për numrat natyrorë por edhe për ata me presje.	
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: - kupton se çfarë përfaqëson secila shifër deri në një milion; - di se çfarë përfaqëson secila shifër në pozicionin e parë dhe të dytë pas presjes te numrat dhjetorë deri në dy shifra pas presjes; - përdor tabelat për të zgjidhur situatat problemore.		Fjalët kyçe: - Numër natyror - Numër dhjetor - Vendvlerë - Presje dhjetore	
Burimet: libri i nxënësit; letra me shifrat nga 0 në 9; minitabela.	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare Fizikë Kimi		
Metodologjia, teknikat e përdorura, veprimtaritë e nxënësve			
Organizimi i orës së mësimi			
Parashikimi i të nxënësve: Mendo – diskuto - stuhi mendimi Shtatë nxënës dalin përpara klasës. Secili prej tyre zgjedh një letër A4 me një shifër sipër. U kërkoj nxënësve të formojnë një vijë të drejtë përpara nxënësve të tjerë të klasës. Ata duhet të vendosen te kjo vijë një e nga një, për të formuar numra me shifra të ndryshme. Pyes pjesën tjetër të klasës: Cili numër është ky? (Ose mund t'i pyes nxënësit në mënyrë individuale.) Për shembull: Një nxënës me numrin 7 – klasa thotë “shtatë”. Dy nxënës me numrat 3 dhe 7 – klasa thotë “tridhjetë e shtatë”. Tre nxënës me numrat 5, 3 dhe 7 – klasa thotë “pesëqind e tridhjetë e shtatë”. Katër nxënës me numrat 6, 5, 3 dhe 7 – klasa thotë “gjashtë mijë e pesëqind e tridhjetë e shtatë”. E përsëris veprimin disa herë.			
Ndërtimi i njohurive të reja: Hulumtim – shqyrtim i përbashkët – pune dyshe U kërkoj nxënësve të punojnë në dyshe për të përfunduar veprimtarinë në librin e nxënësit. Ndërsa nxënësit punojnë, u kërkoj t'i thonë numrat me zë të lartë, në mënyrë që të kontrolloj se sa e kanë kuptuar mësimin. U bëj pyetje të tilla: Si e përcaktuat se cili ishte numri më i madh i mundshëm? A jeni të sigurt se nuk mund të gjeni një numër më të madh se ai? E kështu me radhë.			
Përforcimi: Për secilin rast, nxënësit shkruajnë numrin duke vendosur shifrat në katrorin e duhur. Lexojnë numrin me zë të lartë. 9 790 000 - popullsia në Bangkok (kryeqyteti i Tailandës) 39 775, 71 - perimetri i Tokës i dhënë në km. 1 665 671- rritja e popullsisë në javën e parë të muajit maj të vitit 2014 5 625 429 - numri i makinave që prodhohen mesatarisht në një muaj 6 227 678 - kompjuterat që shiten çdo javë 415 151 - numri i postimeve të bëra në Twitter për një minutë 1 340 000 000 - numri i popullsisë në Kinë. 9,58 rekordi botëror në vrapimin 100 m meshkuj (i dhënë në sekonda)			

Vlerësimi: Vlerësoj nxënësit për punën dyshë dhe përgjigjet e dhëna me gojë dhe me shkrim. Detyrat e dhëna për punë të pavarur. Të gjejnë fakte interesante dhe kuriozitete, ku të dhënat numerike t'i paraqesin në tabelë si modeli që punuan në klasë.
--

Metodologjia, teknikat e përdorura, veprimtaritë e nxënësve

Organizimi i orës së mësimit

Parashikimi i të nxënit: Mendo – diskuto- stuhi mendimi

Vizatoj gjashtë kuti në tabelë. Përdor letra të palosura, në të cilat kam shkruar shifrat nga 0-9.

Zgjedhim në mënyrë rastësore gjashtë shifra.

Kërkoj nga nxënësit të shkruajnë numrin më të madh dhe më të vogël.

Përsëris veprimin disa herë, duke ndalur në rastet kur përfshihet zero.

Në të njëjtën mënyrë veprojnë edhe me numrat me presje.

[illegible]


Ndërtimi i njothurive të reja: Hulumtim – punë në dyshje

Në këtë veprimtari, nxënësit punojnë në dyshë në librin e nxënësit.

Ftoj nxënësit t'i shpjegojnë njëri-tjetrit çfarë vunë re ("Kur shumëzuat me..."). I nxis nxënësit që të shpjegojnë

Nxierr përfundimet, të cilat kërkoj t'i paraqesin në formën e një diagrami.

7	1			7	1	1		7	6
---	---	--	--	---	---	---	--	---	---



Përforcimi:

Zgjedh një ose dy nxënës, të cilët shpjegojnë qartë. Zgjedh nxënës që shpjegojnë mirë idetë e tyre të punës në dyshe. U kërkoj të ndajnë shpjegimet e tyre me të gjithë klasën.

Ilustrojmë me sa më shumë shembuj (pa përdorur makinën llogaritëse, por duke u bazuar në përfundimet e arritura).

Vlerësimi: vlerësoj nxënësit për punën dyshe, nxjerrjen e përfundimeve të sakta dhe argumentimin e përgjigjeve.

Detyrat e dhëna për punë të pavarur: Secili nxënës duhet të përdorë letrat e palosura për të formuar 10 numra natyrorë dhe 10 numra me presje. Më pas t'i shumëzojë dhe pjesëtojë me 10, 100, 1000.

Fusha Matematikë	Lënda Matematikë	Shkalla III	Klasa VI
Tema mësimore: Vetitë e numrave- Zbulojmë		Situata e të nxënët: Të përdorë sitën e Eratostenit për të dalluar numrin e thjeshtë, që t’i përdorë kur zbërthen një numër të përbërë në faktorë të thjeshtë.	
Rezultatet e të nxënët të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: - njuh numrat e thjeshtë deri në 20 dhe gjen të gjithë - numrat e thjeshtë më të vegjël se 100; - gjen faktorët e numrave me dy shifra; - gjen disa shumëfisha të përbashkët, për shembull: për 4 dhe 5 .		Fjalët kyçe: - Numër i thjeshtë - Numër i përbërë - Shumëfisha - Faktorë	
Burimet :Libri i nxënësit, tabela.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare Histori Fizikë	
Metodologjia, teknikat e përdorura, veprimtaritë e nxënësve			
Organizimi i orës së mësimit			
Parashikimi i të nxënët: Mendo – diskuto Bëj lojën e ditëlindjes. Pyes nxënësit për ditën e lindjes dhe shkruaj në tabelë të gjitha datat. P.sh: 12, 5, 9, 24, 17, 2, 19, 15, 1 Kërkoj nga nxënësit të shkruajnë faktorët për secilin numër. Ndërtimi i njohurive të reja: Hulumtim – shqyrtim i përbashkët Faktorët e 12 janë: 1, 2, 3, 4, 6, 12. Faktorët e 5 janë: 1, 5 Faktorët e 9 janë: 1, 3, 9 Faktorët e 1 janë: 1 Numrat e thjeshtë 5, 17, 2, 19 numrat e përbërë 12, 9, 15 Theksoj se numri 1 nuk është i thjeshtë. U kërkoj nxënësve të punojnë në librin e nxënësit dhe u kujtoj se shumëfishat e një numri janë “numra që shfaqen në tabelën e shumëzimit të numrit të dhënë”; për shembull, shumëfishat e numrit 6 janë 12, 18, 24 e kështu me radhë.			

Zbërthej në faktorë të thjeshtë numrin 48: $48 = 6 \times 8$ $48 = 2 \times 3 \times 2 \times 2 \times 2 = 2 \times 2 \times 2 \times 2 \times 3$ Përforcimi: Kërkoj nga nxënësit të përkufizojnë numrat e thjeshtë të përbërë, si dhe faktorët e thjeshtë të një numri të përbërë.
Vlerësimi: vlerësoj nxënësit për punën në libër, përdorimin e fjalorit të saktë matematikor.
Detyrat e dhëna për punë të pavarur: Të mësojnë përmendësh numrat e thjeshtë deri në 20. Të zbërthejnë në faktorë të thjeshtë numrat 36, 54, 75, 100, 120, 288.

Fusha Matematikë	Lënda Matematikë	Shkalla III	Klasa VI
Tema mësimore: Vetitë e numrave – Eksplorojmë		Situata e të nxënit: Të përdorë simbolet matematike <,>=.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: - gjen faktorët e numrave dyshifrorë; - gjen disa shumëfisha të përbashkët, p.sh: për 4 dhe 5; - përdor me korrektesë shenjat <, > dhe =.		Fjalët kyçe: - Shumëfisha - Faktorë të thjeshtë - A është më i vogël... - A është më i madh...	
Burimet: libri i nxënësit; letra me shifrat nga 0 deri në 9; njëzet e katër kube të barabarta.	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare Fizike		
Metodologjia, teknikat e përdorura, veprimtaritë e nxënësve			
Organizimi i orës së mësimi			
Parashikimi i të nxënit: Mendo – diskuto Marr 24 kubet dhe u kërkoj nxënësve t'i vendosin në mënyra të ndryshme. Kërkoj të di nga nxënësit sa modele mund të formojnë dhe si do të ishte renditja. $24 = 1 \times 24 = 2 \times 12 = 3 \times 8 = 4 \times 6$ Bëj të njëjtën veprimtari me numra të ndryshëm. Diskutoni se cili nga numrat ka më tepër mundësi dhe cili ka mundësitë më të vogla. Ndërtimi i njohurive të reja: Hulumtim – shqyrtim i përbashkët Kërkoj nga nxënësit të plotësojnë veprimtaritë në librin e nxënësit. Verifikoj nëse ata i kuptojnë simbolet > (më e madhe se), < (më e vogël se) dhe shumëfish i përbashkët. Në qoftë se do t'u kërkohej të gjejnë një shumëfish të numrit 3, atëherë do të mjaftonte shumëzimi i numrit 3 me një numër tjetër. Kështu, 12 është katërfish i numrit 3, duke qenë se del nga shumëzimi i numrit 3 me numrin 4; 15 është pesëfish i numrit 3; 18 është gjashtëfish i numrit 3, e kështu me radhë, mund të gjeni një pafundësi shumëfishash. Vargu i shumëfishave të numrit 3 është: 3, 6, 9, 12, 15, 18, 21, 24, 27, 30, 33, 36 ... Vargu i shumëfishave të numrit 4 është: 4, 8, 12, 16, 20, 24, 28, 32, 36, 40, 44 ... Te këto dy vargje gjeni numra që janë njëkohësisht edhe të numrit 3, edhe të numrit 4. Numrat: 12, 16, 24 dhe 36 janë shumëfisha të numrit 3 dhe të numrit 4. Këta numra quhen shumëfisha të përbashkët të numrit 3 dhe 4. Në veçanti, numri 12 quhet shumëfishi më i vogël i përbashkët (sh. v. p) i numrit 3 dhe 4. Përforcimi: Nxënës të ndryshëm tregojnë tre ose katër nga këto përkufizime. Zgjedh një përkufizim për klasën. Shkruaj dhe shtoj në fjalorin e nxënësve. Përkufizimet mund t'i paraqesim në klasë, me qëllim që nxënësit t'u referohen vazhdimisht.			
Vlerësimi: vlerësoj nxënësit për punën e pavarur në libër dhe përdorimin e fjalorit të saktë matematik.			


Detyrat e dhëna për punë të pavarur: Gjeni shumëfishin më të vogël të përbashkët për secilin çift numrash. (këshillohet të shkruhet vargu i shumëfishave për secilin numër)

1. sh. v. p për numrat 4 dhe 5 është....
2. sh. v. p për numrat 3 dhe 5 është.....
3. sh. v. p për numrat 2 dhe 7 është.....
4. sh. v. p për numrat 8 dhe 6 është
5. sh. v. p për numrat 8 dhe 6 është
6. sh. v. p për numrat 9 dhe 18 është.....
7. sh. v. p për numrat 7 dhe 14 është.....
8. sh. v. p për numrat 8 dhe 12 është
9. sh. v. p për numrat 7 dhe 13 është.....
10. sh. v. p për numrat 9 dhe 17 është.....

Fusha Matematikë	Lënda Matematikë	Shkalla III	Klasa VI
Tema mësimore: Krahasoni i numrave – Zbulojmë		Situata e të nxënit: Të zbulojë më shumë mbi bashkësinë e numrave të plotë.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: - rendit dhe krahason numrat pozitivë deri në një milion dhe numrat negativë në një nivel të përshtatshëm; - përdor arsyetimin logjik për të kuptuar dhe zgjidhur problemat me numra dhe gjëgjëza matematikore; - përdor listat ose tabelat për të zgjidhur problemat në mënyrë sistematike.		Fjalët kyçe: - Numra pozitivë - Numra negativë - Renditje - Krahasim	
Burimet: libri i nxënësit; 10 letra format A4, secila me një nga shifrat 0-9; komplet zareshe – nga një zar për çdo nxënë.	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare. Gjeografi Histori Fizikë		
Metodologjia, teknikat e përdorura, veprimtaritë e nxënësve			
Organizimi i orës së mësimi			
Parashikimi i të nxënit: Mendo – diskuto – ndërvepro Ftoj gjashtë nxënës përpara klasës. Secili merr një letër me një shifër dhe vendoset në radhë përpara klasës. Kërkoj nga nxënësit e tjerë të klasës që t'i thonë shokut/shoqes të bankës numrin që kanë formuar nxënësit e rreshtuar para klasës. Kontrollon që të gjithë nxënësit ta thonë numrin me zë të lartë. Për shembull, në qoftë se gjashtë nxënësit kanë në duar shifrat 7, pastaj 2, pastaj 5, pastaj 3, pastaj 8, pastaj 1, atëherë numri i formuar do të jetë 725 381 (shtatëqind e njëzet e pesë mijë e treqind e tetëdhjetë e një). U kërkoj nxënësve që të diskutojnë me shokun/shoqen e bankës dhe të vendosin se cili është numri më i madh që mund të formohet me këto shifra (875 321, në rast se do të jenë shifrat e mësipërme). Nxënësit duhet të rivendosen në mënyrë të tillë që të formojnë pikërisht këtë numër. Pyes nxënësit se nga e dinë se ky është numri më i madh i mundshëm. (Vendos shifrën më të madhe në vendvlerën më të madhe të kolonës). E përsëris këtë për numrin më të vogël. Në qoftë se është e nevojshme, përsëris të gjithë veprimtarinë derisa ta kenë kuptuar qartë të gjithë. Kujdesem që gjatë zgjedhjes të përdoret shifra 0 (numri më i vogël nuk mund të fillojë me zero). Përdor boshtin numerik për të paraqitur numrat negativë. Ndërtimi i njohurive të reja: Hulumtim – shqyrtim i përbashkët I vë nxënësit në garë për të gjetur numrat më të mëdhenj dhe më të vegjël të mundshëm me shifrat që kanë dalë nga hedhja e zarit.			

Pasi nxënësit të kenë formuar numrat negativë, iu kujtoj nxënësve të tjerë të përdorin fjalët “negativi i trembëdhjetës” për -13 dhe jo “minus trembëdhjetë”. Gjithashtu i ndihmoj ata të përdorin sa më mirë boshtin numerik për të krahasuar numrat negativë. Përforsimi: Përdor një zar me numra për të formuar 5 numra negativë dhe i shkruaj në dërrasën e zezë. Kërkoj prej nxënësve t'i renditin këta numra nga më i vogli te më i madhi në minitabelat e tyre. Ata duhet të punojnë në dyshe për të diskutuar përfundimet me shokët/shoqet. Shkruaj numrat nga 0 në -20 në boshtin numerik. Një nga nxënësit duhet të shënojë në boshtin numerik numrat që ka gjetur. Pyes nxënësit se çfarë vërejnë në renditjen e numrave negativë (sa më larg zeros, aq më i vogël është numri – kjo është e kundërta e numrave pozitivë). Përdor shembuj praktikë si: temperaturat, lartësitë e maleve dhe thellësitë e deteve.
Vlerësimi: vlerësoj nxënësit për punën dyshe, përdorimin e fjalorit matematikor dhe si kanë argumentuar në nxjerrjen e përfundimeve.
Detyrat e dhëna për punë të pavarur: Nxënësit duhet të gjejnë materiale për lartësitë e maleve më të mëdha të kontinenteve dhe për thellësitë e humnerave oqeanike. Më pas, t'i paraqesin si numra me shenjë dhe t'i renditin nga më i vogli te më i madhi.

Fusha Matematikë	Lënda Matematikë	Shkalla III	Klasa VI										
Tema mësimore: Krahasimi i numrave- Eksplorojmë		Situata e të nxënit: Të zbulojë më shumë mbi krahasimin dhe renditjen e numrave të plotë.											
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: - rendit dhe krahason numrat pozitivë deri në - një milion dhe numrat negativë në një nivel të përshtatshëm; - përdor listat ose tabelat për të zgjidhur problemat në mënyrë sistematike.		Fjalët kyçe: - Numra pozitivë - Numra negativë - Renditje - Krahasim											
Burimet Libri i nxënësit, faqe 13	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare Gjeografi, Fizikë												
Metodologjia, teknikat e përdorura, veprimtaritë e nxënësve													
Organizimi i orës së mësimit													
Parashikimi i të nxënit: Mendo – diskuto – stuhi mendimi Shkruaj në tabelë informacionin e mëposhtëm: <table><tr><td>Omikan, Rusi</td><td>-68°C</td></tr><tr><td>Stacioni Vostok, Antarktidë</td><td>-89°C</td></tr><tr><td>Stacioni Ndërkombëtar, Minesota</td><td>-40°C</td></tr><tr><td>Uinepeg, Kanada</td><td>-62°C</td></tr><tr><td>Espo, Finlandë</td><td>-7°C</td></tr></table> Vizatoj një bosht numerik dhe iu kërkoj nxënësve të më thonë se në cilën anë të zeros janë numrat e dhënë; cili nga numrat do të ishte më pranë zeros dhe cili më larg. Ndërtimi i njohurive të reja: Hulumtim – shqyrtim i përbashkët Duke përdorur të njëjtën linjë arsyetimi, nxënësit renditin me përafërsi në bosht të gjithë numrat negativë. Nxënësit punojnë individualisht me veprimtarinë në librin e nxënësit. Do të ishte mirë t'i shqiptonin numrat me zë të lartë. Kjo i ndihmon të artikulojnë mendimin sa më qartë, ndërkohë që nxënësit e tjerë kontrollojnë drejtshqiptimin. Përforsimi: Pasi të kenë mbaruar detyrën në librin e nxënësit dhe të kenë diskutuar zgjidhjet, u kërkoj të tregojnë në mënyrë të përmblodhur çfarë kanë mësuar për numrat me shenjë.				Omikan, Rusi	-68°C	Stacioni Vostok, Antarktidë	-89°C	Stacioni Ndërkombëtar, Minesota	-40°C	Uinepeg, Kanada	-62°C	Espo, Finlandë	-7°C
Omikan, Rusi	-68°C												
Stacioni Vostok, Antarktidë	-89°C												
Stacioni Ndërkombëtar, Minesota	-40°C												
Uinepeg, Kanada	-62°C												
Espo, Finlandë	-7°C												



Çdo numër pozitiv është më i madh se zero.

Çdo numër negativ është më i vogël se zero.

Vlerësimi: vlerësoj nxënësit për punën e pavarur, argumentimin e përgjigjeve dhe përdorimin e saktë të fjalorit matematikor.

Detyrat e dhëna për punë të pavarur: Nxënësit duhet të hulumtojnë në internet për temperaturat më të ulëta dhe më të larta që janë regjistruar deri më sot. Vlerat e tyre duhet t'i renditë në boshtin numerik.

Fusha Matematikë	Lënda Matematikë	Shkalla III	Klasa VI
Tema mësimore: Përafrimi dhe rrumbullakimi - Zbulojmë		Situata e të nxënit: Të zbulojë më shumë për rrumbullakimin.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: • rrumbullakos të gjithë numrat në dhjetëshen, • qindëshen ose mijëshen më të afërt; • përdor listat ose tabelat për të zgjidhur problemat në mënyrë sistematike.		Fjalët kyçe: • Rrumbullakim • Përafërsisht • Rrumbullakim në dhjetëshen, qindëshen, mijëshen më të afërt	
Burimet: libri i nxënësit; pako letrash të mëdha me shifrat 0-9; pako letrash për nxënësit me shifrat 0-9	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare Histori Gjeografi Fizikë		
Metodologjia, teknikat e përdorura, veprimtaritë e nxënësve			
Organizimi i orës së mësimi			
Parashikimi i të nxënit: Mendo – bashkëvepro – diskuto Ftoj tre ose katër nxënës të dalin përpara klasës. Secili prej tyre duhet të tërheqë një nga shifrat 0-9 dhe të qëndrojnë së bashku në vijë të drejtë përballë klasës. Pjesa tjetër e klasës duhet të punojë në dyshe për të gjetur në sa mënyra mund të kombinohen këto shifra. Më pas sistemoj sërish tre (katër) nxënësit në mënyrë të tillë që të formojnë numra në rendin nga më i vogli te më i madhi. Çdo herë që ata formojnë një numër të ri, i tregoj klasës se si duhet ta rrumbullakosë në dhjetëshen, qindëshen dhe mijëshen. Përdor boshtin numerik për të treguar këtë. Për shembull: $473 \approx 470$ kur rrumbullakoset në dhjetëshen më të afërt; $473 \approx 500$ në qindëshen më të afërt; $3585 \approx 4000$ në mijëshen më të afërt. Argumentojmë se 3 është më pak se gjysma e dhjetës, 73 më shumë se gjysma e 50, dhe 585 më shumë se gjysma e 500. Në bosht ato ndodhen përkatësisht më afër 470, 500, 4000. Ndërtimi i njohurive të reja: Hulumtim – shqyrtim i përbashkët Përpara se nxënësit të punojnë me librin e nxënësit, pyes disa prej tyre: Cila është “rregulla” për të rrumbullakosur në dhjetëshen, qindëshen dhe mijëshen më të afërt? Po në rastet kur shifrat e fundit janë 5, 50, 500? Shqyrtojmë së bashku këto raste dhe kërkoj nga nxënësit të paraqesin para klasës argumentet e tyre. Më pas punohet libri i nxënësit.			

Përforcimi: Stuhi mendimi

3. Rrumbullakos në dhjetëshen, qindëshen, mijëshen më të afërt.

Numri	Dhjetëshe	Qindëshe	Mijëshe
1 285			
3 076			
8 150			
4 009			
9 897			
4 500			

Bëj pyetjen:

Nëse 140 është një numër i rrumbullakosur në dhjetëshen më të afërt, cili do të ishte numri më i vogël i mundshëm? Po më i madhi?

Të njëjtën pyetje shtroj për numrin 3400 dhe 7000 të rrumbullakosur përkatësisht në qindëshen dhe mijëshen më të afërt.

Vlerësimi: vlerësoj përgjigjet me gojë, punën e pavarur në libër dhe në fletore, mënyrën si argumentohen përgjigjet.

Detyrat e dhëna për punë të pavarur: Nxënësit duhet të rrumbullakosin në dhjetëshen, qindëshen, mijëshen më të afërt numrat 1 534, 5 089, 7 604, 25 150.

Fusha Matematikë	Lënda Matematikë	Shkalla III	Klasa VI
Tema mësimore: Përafrimi dhe rrumbullakimi – Eksplorojmë		Situata e të nxënësve: Të mësojë më shumë rreth përafrimit dhe rrumbullakimit të numrave të plotë dhe me presje (deri në dy shifra pas presjes)	
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: - rrumbullakos të gjithë numrat në dhjetëshen më të afërt; - përafron pozicionin e një numri katërshifror në një bosht numerik 0 - 10 000; - rrumbullakos një numër me dy shifra pas presjes dhjetore në dhjetëshen më të afërt ose në numrin e plotë më të afërt.		Fjalët kyçe: - Numër i plotë - Numër me presje - Rrumbullakim - Bosht numerik - Më afër me...	
Burimet: Libri i nxënësit, faqe 15 –17; një pako letrash me shifrat nga 1 – 20.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare Matjet Gjeografi Fizikë	
Metodologjia, teknikat e përdorura, veprimtaritë e nxënësve			
Organizimi i orës së mësimi			
Parashikimi i të nxënësve: Mendo – diskuto – bashkëvepro U kërkoj katër nxënësve të zgjedhin nga një shifër midis 0 dhe 9 dhe t'i përdorin për të ndërtuar numra katërshifrorë. Këtë numër, nxënësit duhet ta vendosin në një bosht numerik. Shtroj pyetjen: Cila mijëshe është në kufirin e poshtëm? Cila mijëshe është në kufirin e sipërm?			

P.sh: për numrin 5 378, kufiri i poshtëm është 5 000 dhe kufiri i sipërm është 6 000. Vendos një letër me numrin 5 000 në njërën anë të klasës dhe një letër me numrin 6000 në anën tjetër të saj. Më pas u kërkoj nxënësve të vendosin me kujdes numrin katërshifror në “boshtin numerik”. E përsëris këtë ushtrim aq herë sa të jetë e nevojshme.

Ndërtimi i njohurive të reja: Hulumtim – shqyrtim i përbashkët

Nxënësit duhet të plotësojnë veprimtarinë në librin e nxënësit. Për pjesën e parë të veprimtarisë pyesni secilin nxënësi: Cilat janë të gjitha kombinimet e mundshme me

katër shifra? Nga e dini nëse i keni gjetur të gjitha kombinimet e mundshme?

Numra me katër shifra gjithsej janë 24 (nëse nuk kemi shifrën 0). Këtë e gjejmë duke renditur me radhë të gjithë numrat, p.sh: me shifrat 4, 5, 7, 9 kemi 4 579, 4 597, 4 759, 4 795, 4 975, 4 957 etj.

Veprojmë në të njëjtën mënyrë me numrat 45,79 $\approx$ 45,8 45,79 $\approx$ 46

79,54 $\approx$ 79,5 79,54 $\approx$ 80

Përforcimi:

Nxënësit punojnë të pavarur.

Rrumbullakos në të plotën, të dhjetën më të afërt.

Numri	Rrumbullakos në të plotën	Rrumbullakos në të dhjetën
24,47		
78,62		
79,87		
60,54		

Nëse numri i rrumbullakosur në të plotën më të afërt është 79, cili do të ishte numri më i vogël dhe më i madh me një shifër pas presjes? Po me dy shifra pas presjes? (stuhia mendimi)

Vlerësimi: vlerësoj nxënësit për punën e pavarur dhe përgjigjet me argumentet përkatëse.

Detyrat e dhëna për punë të pavarur: Nxënësit duhet të rrumbullakosin numra me katër shifra, që përfaqësojnë fakte interesante të gjetura në internet.

Fusha Matematikë	Lënda Matematikë	Shkalla III	Klasa VI
Tema mësimore: Vargjet numerike – Zbulojmë		Situata e të nxënësve: Të njohë më mirë ndërtimin e vargjeve numerike.	
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: - njih dhe zgjeron vargun e numrave; - identifikon varësinë midis numrave dhe bën përkufizime të përgjithshme duke përdorur fjalët.		Fjalët kyçe: - Varg - Kufizë paraardhëse - Kufizë pasardhëse	
Burimet: Libri i nxënësit, faqe 18 –19		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare	
Metodologjia, teknikat e përdorura, veprimtaritë e nxënësve			
Organizimi i orës së mësimi			
Parashikimi i të nxënësve: Mendo – krijo dyshe – diskuto Shkruaj në dërrasën e zezë disa shifra të një vargu dhe pyes nxënësit: A mund të më thoni numrin pasues? Përdor vargjet e mëposhtme. Shkruaj dy numrat e parë, pastaj shtoj numrat e tjerë njëri pas tjetrit, derisa nxënësit të parashikojnë se cili është numri pasues dhe iu shpjegoj se cili është rregulli për këtë varg. 1; 3; 5; 7; 9; 3; 6; 9; 12; 15; 2; 4; 8; 16; 64; 1; 4; 9; 16; 25;			

Për të përshkruar vargun, nxënësit duhet të përdorin dy elemente: kufizën e parë dhe rregullën e zbuluar. P.sh: “fillon me një dhe shtojmë 2”. Ndërtimi i njohurive të reja: Hulumtim – shqyrtim i përbashkët (punë në grup) Nxënësit duhet të punojnë në librin e nxënësit. Ata do të përfitojnë duke punuar së bashku. Shikoj për shembuj të tjerë, siç mund të jenë vargjet e gjata, të cilat nxënësit do t'i trajtojnë më vonë. Kërkoj prej tyre të shpjegojnë metodën që kanë ndjekur. Kjo më ndihmon të verifikoj nëse janë në gjendje të ndajnë idetë e tyre me njëri-tjetrin. Përforcimi: (stuhi mendimi) Çfarë vargu do të përmbante numrin 75? Po numrin 49? Po numrin 24? Diskutojmë së bashku përgjigjet. P.sh: vargje që përmbajnë numrin 75 janë: vargu i shumëfishave të numrit 5, të numrit 25, të numrit 15, të numrit 3. Vlerësimi: vlerësoj nxënësit për punën në grup dhe përgjigjet argumentuese. Detyrat e dhëna për punë të pavarur: Material në internet për vargjet Fibonaçi.
--

Fusha Matematikë	Lënda Matematikë	Shkalla III	Klasa VI
Tema mësimore: Vargjet numerike-Gjejmë duke zbatuar		Situata e të nxënit: Të njohë më mirë mënyrën e ndërtimit të vargjeve numerike	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: kupton rregullat e përgjithshme mbi shumëmat, ndryshesat dhe shumëfishat e numrave tek dhe çift.		Fjalët kyçe: - Varg - Shumë - Ndryshesë - Rregull	
Burimet	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare		
Metodologjia, teknikat e përdorura, veprimtaritë e nxënësve			
Organizimi i orës së mësimi			
Veprimtaria e mëposhtme mund të realizohet në një nga korridoret e shkollës ose në oborrin e saj.			
Parashikimi i të nxënit: heto dhe zbul			
Ndërtoni një rreth me karrige, në mënyrë të tillë që të ketë një karrige më pak se numri i nxënësve. Një nxënës të qëndrojë në qendër të rrethit. Nxënësit e tjerë të ulen në karrige. Shpërndajuni nxënësve nga një copë letër, ku të shkruajnë një numër me dy shifra. Nxënësi që është në qendër të rrethit, përcakton një fakt për numrin që zgjedh.			
Për shembull: “Numri është i plotpjesëtueshëm me 5” ose “Numri është i plotpjesëtueshëm me 3” ose “Numri është një numër tek”. Të gjithë nxënësit që kanë një numër që e plotëson këtë fakt (për shembull, numri 15) kalojnë rrethin dhe ulen në karriget që janë bosh. Ndërkohë, nxënësi që është në qendër, ulët shpejt në një nga karriget bosh të rrethit. Tani, në qendër të rrethit mbetet një nxënës tjetër, i cili përcakton një fakt tjetër për nxënësit në rreth. Nxitini nxënësit të thonë fakte të përbashkëta për shumë numra. Si pasojë, shumë nxënës do të ndërrojnë vendet me njëri-tjetrin. Gjithashtu, nxitini nxënësit të thonë fakte që nuk janë të përbashkëta për shumë numra. Si pasojë, pak nxënës do të ndërrojnë vendet me njëri-tjetrin.			
Ndërtimi i njohurive të reja: Hulumtim – shqyrtim i përbashkët			
Nxënësit duhet të shkruajnë një numër me një shifër në një letër (mund të përdoret ana tjetër e letrës që kishit në lojën “Kalo rrethin”). Largoj karriget që nxënësit të kenë hapësirë lëvizjeje. Çdo 15 sekonda, deklaroni një nga pohimet e mëposhtme. Nxënësit duhet të përpiqen të krijojnë grupe me njëri-tjetrin. Kësaj radhe mund t’u duhet më tepër kohë për ta bërë këtë lojë.			
Krijoni grupe me nga 3 vetë, në mënyrë që shuma të jetë sa më afër 20.			
Krijoni grupe me nga 4 vetë, në mënyrë që shuma të mos e kalojë 35.			
Krijoni grupe me nga 5 vetë, në mënyrë që shuma të jetë çift.			

Krijoni grupe me nga 3 vetë, në mënyrë që shuma të jetë tek.
 Krijoni grupe me nga 2 vetë, në mënyrë që shuma të jetë çift.
 Krijoni grupe me nga 2 vetë, në mënyrë që shuma të jetë tek.
 Krijoni grupe me nga 2 vetë, në mënyrë që prodhimi të jetë çift.
 Krijoni grupe me nga 3 vetë, në mënyrë që prodhimi të jetë çift.
 Krijoni grupe me nga 2 vetë, në mënyrë që prodhimi të jetë tek.
 Krijoni grupe me nga 3 vetë, në mënyrë që prodhimi të jetë tek.

Përforcimi (kthehemi në klasë)

Kërkoj prej nxënësve të plotësojnë fjalitë në librin e nxënësve. Ata duhet t'i lexojnë individualisht fjalitë dhe të arsyetojnë përfundimet e tyre.

Vlerësimi: vlerësoj nxënësit për mënyrën si kanë bashkëvepruar me njëri-tjetrin dhe për punët individuale.

Detyrat e dhëna për punë të pavarur: Nxënësit duhet të plotësojnë vargun edhe me tri kufiza.

a) 2 ; 4 ; 6 ; 8 ; 10 ; _____ ; _____ : _____ .

b) 1 : 2 ; 3 ; 5 ; 8 ; _____ ; _____ : _____ .

Më pas duhet të tregojnë rregullën e formimit të vargut për secilin rast.

Fusha Matematikë	Lënda Matematikë	Shkalla III	Klasa VI												
Tema mësimore: Numri dhe vendvlera - Përmbledhim		Situata e të nxënit: Mëson më shumë për faktorët e thjeshtë të një numri duke punuar në praktikë.													
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: - gjen faktorë të numrave me dy shifra; - gjen disa shumëfisha të përbashkët, p.sh. për 4 dhe 5; - njeh numrat e thjeshtë deri në 20 dhe gjen të gjithë numrat e thjeshtë më të vegjël se 100.		Fjalët kyçe: - Kub - Kuboid - Shumëfisha - Numra të thjeshtë													
Burimet: Libri i nxënësit, faqe 21.	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare Matjet														
Metodologjia, teknikat e përdorura, veprimtaritë e nxënësve															
Organizimi i orës së mësimi															
Parashikimi i të nxënit: Mendo – puno në grupe – diskuto Për veprimtarinë e rubrikës “Përmbledhim”, nxënësit duhet të punojnë në grupe me nga katër vetë. I nxit ata që të përpiqen të interpretojnë dhe të fillojnë veprimtarinë pa ndihmën time. I organizoj nxënësit në grupe dhe u kërkoj të fillojnë veprimtarinë në librin e nxënësit.															
Ndërtimi i njohurive të reja: Hulumtim – shqyrtim i përbashkët Shkruaj pesë fakte për numrat që janë paraqitur më poshtë. Përdor të paktën një herë secilin nga kuptimet e mëposhtme:															
<table><tr><td>Milion</td><td>Faktor</td><td>Dhjetë mijë</td><td>Numër i thjeshtë</td></tr><tr><td>Një mijë</td><td>Shumëfish</td><td>Njëqind</td><td>Më i madh se</td></tr><tr><td>Njëshe</td><td>Më i vogël se</td><td></td><td>Afërsisht</td></tr></table>				Milion	Faktor	Dhjetë mijë	Numër i thjeshtë	Një mijë	Shumëfish	Njëqind	Më i madh se	Njëshe	Më i vogël se		Afërsisht
Milion	Faktor	Dhjetë mijë	Numër i thjeshtë												
Një mijë	Shumëfish	Njëqind	Më i madh se												
Njëshe	Më i vogël se		Afërsisht												
Nxënësit punojnë në mënyrë të pavarur në fletoret e klasës. Më pas diskutojmë dhe shqyrtojmë së bashku zgjidhjet e dhëna prej tyre.															
Përforcimi: Në fund të mësimi, grupet i komunikojnë njëri-tjetrit rezultatet e arritura. Nxënësit duhet të përpiqen të reflektojnë për atë çfarë kanë nxënë. Pyes me radhë disa nxënës: Çfarë ke mësuar nga ky mësim?															

Vlerësimi: vlerësoj nxënësit si bashkëvepruan në punën me grupe, për punën e pavarur dhe argumentimin e përgjigjeve.
Detyrat e dhëna për punë të pavarur. Nxënësit duhet të krijojnë 5 vargje numerike, të cilat përmbajnë numrat 9, -27, 125, 15, -22.

Fusha Matematikë	Lënda Matematikë	Shkalla III	Klasa VI
Tema mësimore: Numri dhe vendvlera – Përforcojmë		Situata e të nxënit: Zgjeron njohuritë për vendvlerën.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: - kupton se çfarë përfaqëson secila shifër në të gjithë numrat deri në një milion; - kupton se çfarë përfaqëson shifra e parë dhe e dytë pas presjes në numrat dhjetorë; - gjen faktorë dhe shumëfisha të përbashkët.		Fjalët kyçe: - Vendvlerë - Numër i plotë - Numër dhjetor - Faktorë - Shumëfisha	
Burimet : Libri i nxënësit, faqe 22		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare Matjet	
Metodologjia, teknikat e përdorura, veprimtaritë e nxënësve			
Organizimi i orës së mësimit			
Parashikimi i të nxënit: Mendo – stuhi mendimi Shkruaj në dërrasë një numër me katër ose pesë shifra. Mbuloj numrin në mënyrë që nxënësit të mos e shohin. I pyes nxënësit se cili është numri i fshehur. Më pas, pyetjet i bëj në mënyrë të tillë që të marr si përgjigje vetëm “jo” ose “po”. E përsëris këtë lojë disa herë. U kërkoj nxënësve të bëjnë pyetje të tilla, në mënyrë që të eliminojnë sa më shumë numra. Për shembull, pyetja “A është numër tek?”, përgjysmon menjëherë mundësitë. Përsërit lojën duke përfshirë numrat me një dhe dy shifra pas presjes dhjetore. Ndërtimi i njohurive të reja: Hulumtim – shqyrtim i përbashkët – punë grupi Për këtë lojë, klasa duhet të ndahet në grupe me nga katër veta. Secili grup përpiqet të gjejë numrin e fshehur. Grupet garojnë me njëri-tjetrin se kush do ta gjejë numrin e panjohur me sa më pak pyetje. Përforcimi: Nxënësit duhet të plotësojnë faqen në librin e nxënësit. Kjo do të thotë se ata duhet të shkruajnë një seri faktesh për numrin që kanë zgjedhur. I nxis nxënësit të zgjedhin numra, për të cilët mund të gjejnë fakte “interesante”. P.sh:135 - Numër tek - Numër treshifror - Ndërmjet 100 dhe 150 - Shumëfish i 5 - Shumëfish i 3 - Shumëfish i 9.....			
Vlerësimi: vlerësoj nxënësit për punën e pavarur dhe atë në grup.			
Detyrat e dhëna për punë të pavarur. Nxënësit duhet të paraqesin me poster, broshura ose mënyra të tjera një përmbledhje të njohurive të marra në këtë kapitull.			

Fusha Matematikë	Lënda Matematikë	Shkalla III	Klasa VI
Tema mësimore: Punë për portofol		Situata e të nxënit: Vetëvlerëson njohuritë e marra.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: • kupton se çfarë përfaqëson secila shifër në të gjithë numrat deri në një milion; • kupton se çfarë përfaqëson shifra e parë dhe e dytë pas presjes në numrat dhjetorë; • gjen faktorë dhe shumëfisha të përbashkët.		Fjalët kyçe: • Numër • Vendvlerë • Krahësim • Numër i thjeshtë	
Burimet	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare		
Metodologjia, teknikat e përdorura, veprimtaritë e nxënësve			
Organizimi i orës së mësimi			
Kontrolli i njohurive			
Qarkoni përgjigjet e sakta për pyetjet nga 1 deri në 6.			
1. Cili është numri më i madh që mund të ndërtoni me shifrat 7, 5, 8, 1, 7?			
a) 75 817			
b) 87 571			
c) 87 751			
d) 77 815			
2. Vlera e shifrës 7 tek numri 70 251 është:			
a) shtatë			
b) shtatëdhjetë			
c) shtatëdhjetë mijë			
d) dhjetë mijë			
3. Shumëzoj 562 me 100. Përgjigja është:			
a) 5 620			
b) 50 062			
c) 56 200			
d) 562 000			
4. Cilët nga këta numra janë të thjeshtë?			
a) 1			
b) 2			
c) 25			
d) 37			
5. Një shumëfish i përbashkët i 7 dhe 3 është:			
a) 73			
b) 42			
c) 7			
d) 3			
6. Kur 5 555 rrumbullakoset në qindëshen më të afërt është:			
a) 5 000			
b) 5 550			
c) 5 600			
d) 6 000			
7. Sa numra të ndryshëm me katër shifra mund të formoni duke përdorur 3, 4, 7, 9? Bëni një listë. Qarkoni numrin më të madh dhe më të vogël dhe shkruajini me fjalë.			
(Pyetjet nga 1 – 6 vlerësohen me 1 pikë.) Ushtrimi 7 ka katër pikë. (2 pikë ndërtimi i saktë i listës. 2 pikë qarkimi i numrit më të vogël dhe më të madh, dhe 2 pikë kur i shkruan saktë me fjalë.)			


Vlerësimi sipas tabelës:						
4	5	6	7	8	9	10
0-4	5	6	7	8	9	10

Detyrat e dhëna për punë të pavarur. –

Fusha Matematikë	Lënda Matematikë	Shkalla III	Klasa VI
Tema mësimore: Diskutojmë së bashku		Situata e të nxënësve: Të kuptojë më mirë lidhjen midis thyesave dhe përqindjes.	
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: • kupton përqindjen si pjesë në çdo qindëshe dhe shpreh thyesat si përqindje; • gjen përqindjen e figurave dhe të numrave natyrorë; • zgjidh problema me fjalë të thjeshta, të cilat përfshijnë përqindje; bën llogaritje me uljet e çmimeve.		Fjalët kyçe: • Thyesë • Përqindje • Krahësim	
Burimet: libri i nxënësit, gazeta dhe revista që paraqesin ulje të çmimeve	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare Matjet, Ekonomi		
Metodologjia, teknikat e përdorura, veprimtaritë e nxënësve			
Organizimi i orës së mësimi			
Parashikimi i të nxënësve: Mendo – krijo dyshe – diskuto Nxënësit punojnë në dyshe. Secili çift pajiset me një gazetë ose revistë. Nxënësit duhet të gjejnë sa më shumë shembuj të përqindjes në gazeta dhe revista. Më pas, secili çift duhet të diskutojë me nxënësit e tjerë një nga shembujt e gazetës. Përpiqem të diskutoj një numër të madh shembujsh, ku është përdorur shenja e përqindjes. Përqindja mund të gjendet në titujt kryesorë, në reklama apo artikuj të rinj. Secili nxënës jep shembullin e një përqindjeje, të cilën unë e shkruaj në dërrasë. Në këtë mënyrë do të kemi një numër të madh përqindjesh. Më pas u kërkoj nxënësve të flasin me shokun/shoqen e bankës për përqindjet që shohin në dërrasën e zezë. Për shembull: ata mund ta dinë se “50%” është e njëjtë me “gjysmën”, ndërsa kur gjejnë 10%, kanë pjesëtuar me 10. Ndërtimi i njohurive të reja: Hulumtim – shqyrtim i përbashkët (punë në grup) I kërkoj çdo çifti të zgjedhë tre shembuj nga përqindjet që kanë gjetur në gazeta ose revista. Pastaj, orientoj çiftet të përdorin shembujt e tyre për të shkruar një problemë me fjalë. Ata duhet të jenë në gjendje ta zgjidhin vetë këtë problemë. Për këtë u sugjeroj të punojnë në grupe me nga gjashtë vetë, me qëllim që të zgjidhin problemat e njëri-tjetrit. Në fund të mësimi, kërkoj prej secilit grup të zgjedhë problemën “më të mirë” të grupit. Secili grup duhet ta argumentojë zgjidhjen e bërë. Përforsimi: (punë e pavarur) Atletet kushtonin 12 000 lekë, u ulën me 10%. Sa kushtojnë tani? Bluzat shiten me 1/3 e çmimit. Sa kushtonte një bluzë, nëse tani dimë se mund ta blejmë me një çmim prej 2000 lekësh?			
Vlerësimi: vlerësoj nxënësit për punën në grup dhe atë të pavarur.			
Detyrat e dhëna për punë të pavarur: Secili nxënës duhet të marrë të dhëna nga revistat për të njehsuar vlerën e çmimeve të ndryshme.			

Fusha Matematikë	Lënda Matematikë	Shkalla III	Klasa VI
Tema mësimore: Thyesat e barabarta - Zbulojmë duke punuar		Situata e të nxënit: Thellon njohuritë për thyesat nëpërmjet veprimtarive praktike.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: - njuh barazimin e thyesave; - kthen thyesat në formën e tyre më të thjeshtë, për - shembull: $\frac{2}{4} = \frac{1}{2}$; - krahason thyesat me emërues të njëjtë ose thyesa me emërues shumëfish të njëri-tjetrit.		Fjalët kyçe: - Pjesë të barabarta - Emërues - Numërues - Thyesa të barabarta	
Burimet: Libri i nxënësit		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Fizikë	
Metodologjia, teknikat e përdorura, veprimtaritë e nxënësve			
Organizimi i orës së mësimi			
Parashikimi i të nxënit: Mendo – puno në grup – diskuto Pajis nxënësit me nga një katror të vogël prej letre. Nxënësit mund ta palosin këtë katror përgjysmë në mënyra të ndryshme. (Mund ta palosin fletën përgjysmë horizontalisht, vertikalisht dhe në mënyrë diagonale.) Më pas, pyes klasën: Nga e dini që fleta është palosur saktësisht në dy pjesë të barabarta? U kërkoj nxënësve t'i palosin fletët e tyre në katër pjesë, në mënyra të ndryshme palosjeje. Së fundi, kërkoj prej nxënësve të punojnë në grupe me nga gjashtë veta, për të treguar sa më shumë thyesa të ndryshme që përftohen nga palosja e katrorit të letrës. Ndërtimi i njohurive të reja: Hulumtim – shqyrtim i përbashkët Nxënësit punojnë në dyshe për të përfunduar ushtrimet në librin e nxënësit. U kërkoj të shkruajnë përgjigjet e tyre në kutitë bosh. Diskutoj me nxënësit kuptimin e thyesave të barabarta. $\frac{3}{4} = \frac{6}{8}$ $\frac{5}{6} = \frac{15}{18}$ (shumëzoj me të njëjtin numër dhe numëruesin dhe emëruesin) Thyesa të barabarta mund të përftohen edhe duke pjesëtuar me të njëjtin numër numëruesin dhe emëruesin. (Kjo mënyrë quhet thjeshtim i thyesave.) $\frac{8}{16} = \frac{1}{2}$ $\frac{6}{8} = \frac{3}{4}$ Përforcimi: Përforcoj njohuritë e nxënësve duke shtruar para tyre këto pyetje: Çfarë tregon numëruesi / emëruesi? Cilat thyesa janë të njëvlershme? Si mund të thjeshtoni një thyesë? Kërkoj nga nxënësit të ilustrojnë me shembuj.			
Vlerësimi: vlerësoj nxënësin/en për punën në grup dhe punën e pavarur.			
Detyrat e dhëna për punë të pavarur: shkruani 3 thyesa të barabarta me thyesat e dhëna $\frac{12}{16}$; $\frac{25}{75}$; $\frac{22}{33}$; $\frac{2}{5}$;			

Fusha Matematikë	Lënda Matematikë	Shkalla III	Klasa VI
Tema mësimore: Thyesat e barabarta – Eksplorojmë		Situata e të nxënës: Të thellojë njohuritë për krahasimin e thyesave.	
Rezultatet e të nxënës të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: - njuh thyesat e barabarta; - kthen thyesat në formën e tyre më të thjeshtë; - krahason thyesat me emërues të njëjtë ose thyesa me emërues shumëfish të njëri-tjetrit.		Fjalët kyçe: - Thyesë - Numërues - Emërues - Krahasoj - Rendis	

Burimet: libri i nxënësit, faqe 26–27	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare
Metodologjia, teknikat e përdorura, veprimtaritë e nxënësve	
Organizimi i orës së mësimit	
Parashikimi i të nxënit: Mendo – krijo dyshe - diskuto	
Nxënësit shohin tabelën në librin e nxënësit. I udhëzoj të punojnë në çifte. Shtroj pyetjen: Si është plotësuar rreshti i parë?	
Më pas u kërkoj nxënësve të diskutojnë me njëri-tjetrin.	
P.sh: = tre të pestat = =	
Ndërtimi i njohurive të reja: Hulumtim – shqyrtim i përbashkët	
Nxënësit duhet të punojnë në dyshe për të përfunduar tabelat në librin e nxënësit. Ata diskutojnë së bashku përgjigjet e tyre. Për t'i vënë çiftet në garë midis tyre, u jap shembuj më të vështirë për të plotësuar tri rreshtat e fundit të tabelës. Pas plotësimit të tabelës kontrolloj nëse nxënësit e kanë kuptuar njëvlershmërinë dhe formën e thjeshtuar të një thyese. Kjo është e domosdoshme për pjesën tjetër të veprimtarisë, të cilën do ta kryejnë të pavarur. Nxënësit punojnë në mënyrë të pavarur për të gjetur thyesa të barabarta dhe më pas i vendosin saktë në boshtin numerik.	
	
Nxënësit dallojnë rastet :	
1. Kur krahasojmë thyesat me emërues të njëjtë, thyesa më e madhe është ajo që ka numëruesin më të madh. 2. Kur krahasojmë thyesat me emërues të ndryshëm, por me numërues të njëjtë, thyesa më e madhe është ajo që ka emëruesin më të vogël. 3. Kur thyesat janë me emërues dhe numërues të ndryshëm, i kthejmë ato me emërues të njëjtë. Thyesa më e madhe është ajo që ka numëruesin më të madh.	
Ushtrim	
Krahaso thyesat:	
a) $\frac{2}{3} \bigcirc \frac{5}{3}$	b) $\frac{5}{7} \bigcirc \frac{5}{9}$
c) $\frac{5}{6} \bigcirc \frac{7}{9}$	d) $\frac{7}{11} \bigcirc \frac{19}{33}$
Nxënësit punojnë ushtrimin në fletoren e klasës. Njëri prej tyre zgjidh në tabelë dhe e argumenton përgjigjen duke u bazuar në përfundimet e arritura më parë.	
Përforsimi:	
Tetë nxënës dalin përpara klasës. Secilit prej tyre i jepet një letër ku janë shkruar thyesa. Nxënësve të tjerë u kërkohet të realizojnë renditjen e tetë nxënësve para klasës, si në një bosht numerik. Ata duhet të shpjegojnë arsyen e vendosjes së secilit nxënës.	
Vlerësimi: vlerësoj nxënësit për punën në çift, për punën e pavarur, si dhe për mënyrën si argumentojnë përgjigjet e tyre.	
Detyrat e dhëna për punë të pavarur: Nxënësit duhet të renditin në rendin rritës thyesat e mëposhtme:	
$\frac{7}{5}, \frac{3}{5}, \frac{1}{2}, \frac{9}{7}, \frac{3}{2}, \frac{5}{7}$	

Fusha Matematikë	Lënda Matematikë	Shkalla III	Klasa VI
Tema mësimore: Thyesat dhe numrat dhjetorë – Zbulojmë		Situata e të nxënët: Të bëjë lidhjen midis thyesave dhe numrave dhjetorë.	
Rezultatet e të nxënët të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: - njeh dhe përdor njëvlershmërinë midis numrave dhjetorë dhe thyesave; - kthen thyesat e çfarëdoshme në një numër dhjetor duke përdorur pjesëtimin; - numëron para dhe mbrapa në thyesa dhe numra dhjetorë, për shembull ; 0,1, dhe përsërit hapat për të gjithë numrat (edhe përtej zeros).		Fjalët kyçe: - Thyesë - Numër dhjetor - Kthim - Krahasim - Renditje	
Burimet: Libri i nxënësit, faqe 28; minitabela, makinë llogaritëse	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare Fizikë Gjeografi		
Metodologjia, teknikat e përdorura, veprimtaritë e nxënësve			
Organizimi i orës së mësimi			
Parashikimi i të nxënët: Mendo – diskuto Secili nxënës pajiset me nga një minitabelë dhe makinë llogaritëse. Në minitabelë duhet të shkruajnë një thyesë dhe numrin dhjetor përkatës. Për shembull, thyesa të thjeshta, si: $\frac{1}{2}= 0,5"$; $\frac{1}{4}= 0,25"$; $\frac{1}{10}= 0,1"$ Shkruaj në dërrasë thyesat e zgjedhura nga nxënësit dhe numrat dhjetorë përkatës. Kërkoj prej tyre që të pjesëtojnë në makinën llogaritëse 1 me 2. U shpjegoj nxënësve që $\frac{1}{2}$ do të thotë që 1 pjesëtohet me 2 dhe që përdorimi i pjesëtimit jep si përgjigje numrin dhjetor 0,5. Në këtë mënyrë mund të veproni për të gjetur numrin dhjetor përkatës për secilën thyesë. Nxënësit duhet të punojnë në dyshe dhe të gjejnë në krah të listës së thyesave, numrin dhjetor përkatës të njëvlershëm me të. Ndërtimi i njohurive të reja: Hulumtim – shqyrtim i përbashkët Nxënësit punojnë në dyshe për të përfunduar tabelat në librin e nxënësit dhe të gjejnë përgjigjet përkatëse. Organizoj një garë mes nxënësve më të mirë. Ata duhet të shohin thyesat me emërues 9 dhe 11. Shpjegoj përpara klasës se si shkruhen numrat dhjetorë periodikë. Por këtë nuk e bëj në fillim të mësimi. Pres derisa nxënësit të vënë re përfundimin kur arrijnë te thyesat me emërues 12. Për shembull $\frac{4}{12} = \frac{1}{3} == 0,333333$ ose $0,\bar{3}$ Përforcimi: Ftoj nxënësit të diskutojnë së bashku rreth njohurive që mësuuan.			
Vlerësimi: vlerësoj nxënësit për punën e pavarur dhe nxjerrjen e përfundimeve.			
Detyrat e dhëna për punë të pavarur: Nxënësit duhet të marrin 10 thyesa dhe t'i paraqesin si numër me presje.			

Fusha Matematikë	Lënda Matematikë	Shkalla III	Klasa VI
Tema mësimore: Thyesat dhe numrat dhjetorë – Eksplorojmë		Situata e të nxënët: Të mësojë më shumë për lidhjen midis thye- save dhe numrave me presje.	
Rezultatet e të nxënët të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: - njeh dhe përdor numrat dhjetorë me deri tri shifra pas presjes; - njeh dhe përdor njëvlershmërinë midis numrave dhjetorë dhe thyesave.		Fjalët kyçe: - Thyesë - Numër dhjetor i fundmë - Numër dhjetor periodik - Krahasoj - Rendis	
Burimet: Libri i nxënësit, faqe 29–31; letra të mëdha me shifrat 0 dhe 1	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare Fizikë Kimi		
Metodologjia, teknikat e përdorura, veprimtaritë e nxënësve			
Organizimi i orës së mësimit			
Parashikimi i të nxënët: Mendo – krijo dyshe – diskuto Vizatoj një bosht të gjatë nga njëri cep i tabelës në tjetrin, me numrin 0 në njërën anë dhe në anën tjetër vendos numrin 1 Ftoj nxënësit të shkruajnë një thyesë midis 0 dhe 1. Një nxënës qëndron midis 0 dhe1, një tjetër del përpara klasës dhe qëndron në vendin e duhur (midis nxënësit të parë dhe 1). E përsëris këtë veprim derisa në “boshtin numerik” të bëhen pesë nxënës. Këtë herë nxënësit duhet të vendosen midis numrit 0 dhe nxënësit të mëpar- shëm.			
Ndërtimi i njohurive të reja: Hulumtim – shqyrtim i përbashkët Nxënësit duhet të punojnë në dyshe për të përfunduar veprimtarinë në librin e nxënësit. Shikoj me vëmendje se çfarë kanë kuptuar nxënësit për thyesat dhe numrat dhjetorë të njëvlershëm, si dhe për termat “të dhjetat” dhe të “qindtat”. Bëj një listë me të gjitha përgjigjet. E shkruaj këtë listë në dërrasën e zezë.			
Përforcimi: Ushtrim: Përdorni letrat me shifrat 0-9. Tërhiqni në mënyrë rastësore tri prej këtyre letrave. Nga kombinimi i shifrave të gjetura do të krijohen gjashtë numra dhjetorë me dy shifra pas presjes. Shkruajini këta numra sipas rendit rritës. Ilustroj me një shembull: Tërheq letrat 2; 7; 1. Numrat dhjetorë sipas rendit rritës janë: 1,27; 1,72; 2,17; 2,71 ;7,12 ;7,21. E përsëris këtë veprim 5 herë. Për çdo rast ngre në dërrasë një nxënës për të zgjidhur ushtrimin.			
Vlerësimi: vlerësoj nxënësit për përgjigjet me shkrim dhe me gojë.			
Detyrat e dhëna për punë të pavarur: Nxënësit duhet të përdorin letrat me shifra 0-9, për të krijuar kombin- ime si modeli i ushtrimit të klasës dhe t’i renditin numrat në rendin rritës.			

Fusha Matematikë	Lënda Matematikë	Shkalla III	Klasa VI
Tema mësimore: Mbledhja me çiftim – Zbulojmë		Situata e të nxënës: Të mësojë më shumë rreth mbledhjes me çiftim të numrave me presje.	
Rezultatet e të nxënës të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: - çiftoj një numër dhjetor me një dhe dy shifra pas presjes për të bërë shumën 10 apo 1, për shembull: $7,8 + 2,2 = 10$ dhe $0,78 + 0,22 = 1$; - nga informacioni ekzistues, nxjerr një informacion të ri dhe kupton se nga një pjesë e informacionit rrjedh një informacion tjetër.		Fjalët kyçe: - Shumë - Çiftim - Numër me presje	

Burimet: libri i nxënësit, letra me shifra nga 0-9	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare Matjet
Metodologjia, teknikat e përdorura, veprimtaritë e nxënësve	
Organizimi i orës së mësimit Parashikimi i të nxënësve: Mendo – diskuto- stuhi mendimi. Bëj pyetjet: Sa i duhet 200 të bëhet 1 000? Sa i duhet 150 të bëhet 1 000? Sa i duhet 30 të bëhet 100? Sa i duhet 24 të bëhet 100? Sa i duhet 6 të bëhet 10? Sa i duhet 2,5 të bëhet 10? Sa i duhet 0,2 të bëhet 1? Mund të përdorim zerot e tepërta për të qartësuar situatën $10 = 10,0$; $1 = 1,0$ Ndërtimi i njohurive të reja: Hulumtim – shqyrtim i përbashkët Zgjedh letra me dy shifra dhe i shkruaj numrat në dërrasë. Duke punuar në dyshe, nxënësit duhet të shkruajnë tri shuma me përfundim 100, 10 dhe 1. Kjo veprimtari më ndihmon të shikoj nëse të gjithë nxënësit e kanë kuptuar procesin. Pyes një nxënës, i cili shpjegon dhe arsyeton shumë mirë për t'ia shpjeguar të gjithë klasës veprimtarinë kryesore. Shifrat 3; 8 Çiftim me 100 : $38 + 62$ Çiftim me 10 : $3,8 + 6,2$ Çiftim me 1 : $0,38 + 0,62$ Pasi sigurohem se nxënësit e kanë kuptuar veprimtarinë në librin e nxënësit, i vë ata të punojnë në dyshe për të plotësuar detyrën e librit. Përforcimi: Zhvilloj më tej idenë duke përdorur numra me tri shifra. P.sh: shifrat 2; 6; 7 Çiftim me 1 000 : $267 + 733$ Çiftim me 100 : $26,7 + 73,3$ Çiftim me 10 : $2,67 + 7,33$ E përsëris disa herë veprimtarinë, duke kërkuar nga nxënësit të argumentojnë përgjigjet e tyre.	
Vlerësimi: vlerësoj nxënësit për punën në dyshe dhe përgjigjet me gojë.	
Detyrat e dhëna për punë të pavarur: Nxënësit duhet të përdorin etiketat me shifra nga 0-9 për të ripunuar me numra të tjerë detyrën që bënë në klasë.	

Fusha Matematikë	Lënda Matematikë	Shkalla III	Klasa VI
Tema mësimore: Mbledhja me çiftim – Eksplorojmë		Situata e të nxënësve: Të mësojë më shumë rreth mënyrës si çiftohen numrat me presje për të përfutur 10; 1.	
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - çiftojnë një numër dhjetor me një shifër pas presjes për të arritur shumën 10, për shembull: $7,8 + 2,2$; Çiftojnë një numër dhjetor me dy shifra pas presjes dhjetore për të arritur shumën 1, për shembull: $0,78 + 0,22$; - shpjegojnë pse zgjedh një metodë të caktuar për të realizuar një veprim dhe argumenton që kjo metodë jep rezultat; - nga informacioni ekzistues, nxjerr një informacion të ri dhe kupton se nga një pjesë e informacionit rrjedh një informacion tjetër.		Fjalët kyçe: - Mbledhje - Çiftim - I çiftuari i...	

Burimet: libri i nxënësit	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare Matjet
Metodologjia, teknikat e përdorura, veprimtaritë e nxënësve	
Organizimi i orës së mësimit	
Parashikimi i të nxënësve: Mendo – punë në dyshe – stuhi mendimi Shkruaj numrin 10 në dërrasë. Secilit çift i lë dy minuta kohë që të shkruajë sa më shumë çifte numrash që e kanë shumën dhjetë. Numrat duhet të përfshijnë një shifër pas presjes dhjetore. Zgjedh një çift dhe marr një prej përgjigjeve të tyre. E shkruaj atë në dërrasën e zezë. Kërkoj prej nxënësve të shkruajnë çiftin korrespondues të numrave për shumën 100 dhe 1. E përsëris këtë disa herë. Ndërtimi i njohurive të reja: Hulumtim – shqyrtim i përbashkët Kjo veprimtari është e njëjtë me atë të mësimit “Zbulojmë”, por nxënësit punojnë në mënyrë të pavarur. Sërish mund të kontrolloj ndonjë nxënës për veprimtarinë e mëparshme, në mënyrë që të shikoj se si e ka kuptuar dhe ta ndihmoj nëse është e nevojshme. Nxënësit të përdorin përgjigjet e tyre në diagramin merimangë, në mënyrë që të plotësojnë edhe dy diagramet e tjera. Përfundimi: Si në veprimtarinë e mëparshme, kjo rubrikë mund të përdoret si veprimtari vlerësuese. Pyetet një nxënës për një çift numrash me shumë 100. Duke punuar në mënyrë të pavarur, nxënësit duhet të shkruajnë shumën korresponduese për 10 dhe për 1. Vlerësimi: vlerësoj nxënësit për punën e pavarur dhe për mënyrën si argumenton përgjigjet. Detyrat e dhëna për punë të pavarur: Nxënësit duhet të punojnë me numra të tjerë diagramin merimangë.	

Fusha Matematikë	Lënda Matematikë	Shkalla III	Klasa VI
Tema mësimore: Numrat e përzier dhe thyesat më të mëdha se një –Zbulojmë		Situata e të nxënësve: Të mësojë më shumë për thyesat më të mëdha se një.	
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - krahason thyesat me emërues të njëjtë dhe emërues shumëfish të njëri-tjetrit; - njeh barazinë e thyesave, për shembull kthen një thyesë më të madhe se 1 në një numër të përzier; - kthen thyesat në një formë më të thjeshtë.		Fjalët kyçe: - Thyesa më të mëdha se një - Numër i përzier - Krahasim - Thjeshtim	
Burimet: libri i nxënësit	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare		
Metodologjia, teknikat e përdorura, veprimtaritë e nxënësve			
Organizimi i orës së mësimit			
Parashikimi i të nxënësve: Mendo – stuhi mendimi– diskuto Diskutoj me nxënësit figurën me karriget. Një nxënës→ 1 çokollatë. (Një të plotë $\frac{6}{6}$) Dy nxënës → 2 çokollata. (Një të plotë $\frac{6}{6}$) Dy nxënës →3 çokollata. (Më shumë se një e plotë $1\frac{3}{6}=\frac{9}{6}$) A mund të thjeshtohet thyesa $\frac{9}{6}$? Një nxënës e kthen atë në formën e vet më të thjeshtë. Ndërtimi i njohurive të reja: Hulumtim – shqyrtim i përbashkët Shkruani numrin e përzier në formë thyese. Për zgjidhjen e këtij ushtrimi mund të ndiqni një nga tri rrugët që ilustrojnë shembujt e mëposhtëm. $3\frac{3}{4} =$  Ngjyrosni 3 të plotë dhe $\frac{3}{4}$ e rrethit të tretë, të cilat si një thyesë do të paraqiteshin $\frac{15}{4}$.			

Vendosni thyesën e dhënë në boshtin numerik (arrihet i njëjti rezultat; duke ndarë njësinë në katër pjesë marrim tri pjesë të plota dhe tek e katërta marrim tri pjesë nga katër, duke përfutur kështu gjithsej $\frac{15}{4}$).

$$\text{Ose } 3\frac{3}{4} = \frac{3 \times 4 + 3}{4} = \frac{15}{4}$$

Nëse është e nevojshme, marr edhe një shembull tjetër, duke kërkuar bashkëpunimin e nxënësve në zgjidhjen e ushtrimit.

Nëpërmjet metodës “shqyrtim i përbashkët”, zgjedh metodën më të përshtatshme duke listuar përparësitë dhe mangësitë e secilës metode.

Përforcimi: Ktheni numrat e përzier në thyesa:

$$2\frac{3}{5}; 4\frac{5}{6}; 12\frac{7}{8}; 3\frac{5}{9}; 5\frac{8}{13}.$$

Pesë nxënës paraqesin në tabelë numrat e përzier si thyesa jo të mirëfillta.

Vlerësimi: vlerësoj nxënësit për përgjigjet argumentuese dhe punën e pavarur.

Detyrat e dhëna për punë të pavarur: Nxënësit duhet të gjejnë 10 numra të përzier dhe t'i kthejnë ata në thyesa, duke përdorur një nga metodat e mësuara në mësim.

Fusha Matematikë	Lënda Matematikë	Shkalla III	Klasa VI
Tema mësimore: Numrat e përzier dhe thyesat më të mëdha se një - Eksplorojmë		Situata e të nxënit: Të thellojë njohuritë për thyesat më të mëdha se një.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: - kthen një thyesë të parregullt në numër të përzier; - logjikon dhe zgjidh problema me fjalë; - zgjidh problema me fjalë të thjeshta, duke përfshirë pjesëtimin dhe plotpjesëtimin.		Fjalët kyçe: - Thyesë e parregullt - Numër i përzier - Pjesa e plotë - Pjesa thyesore	
Burimet: libri i nxënësit; rrrathë të mëdhenj letre të prerë në katër pjesë për të paraqitur “picat”	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare Matjet		
Metodologjia, teknikat e përdorura, veprimtaritë e nxënësve			
Organizimi i orës së mësimi			
Parashikimi i të nxënit: Mendo – krijo dyshe – diskuto Pres katër rrrathë të mëdhenj, në mënyrë që të krijoj katër “pica”. Ul nxënësit në trajtë rrethore përreth “picave”. Largoj copën e picës në mënyrë që nxënësit të krijojnë një imazh më të qartë për thyesat: 1 person→ 4 pica 2 persona→ 2 pica 3 persona→ $1\frac{1}{3} = \frac{4}{3}$ pica 4 persona→ 1picë 5 persona→ $\frac{4}{5}$ pica. 6 persona→ $\frac{4}{6} = \frac{2}{3}$			
Ndërtimi i njohurive të reja: Hulumtim – shqyrtim i përbashkët Nxënësit punojnë ushtrimet në librin e nxënësit. I nxit ata të vizatojnë zgjidhjet përpara se të hedhin përgjigjet në tabelat e librit dhe u kërkoj shpjegime për vizatimet. Është e rëndësishme që dy problemat e para t'i paraqesin në mënyrë pamore. Pyetja e katërt në librin e nxënësit i nxit të ilustrojnë numrat e përzier.			
Përforcimi: Ftoj një nxënës të vijë dhe të paraqesë para klasës përgjigjen e tij për ushtrimin 5. Ai duhet të shpjegojë me kujdes punën e tij. Shtroj pyetjen përpara klasës: A mundet ndonjëri prej jush ta bëjë këtë ushtrim në një mënyrë tjetër?			
Vlerësimi: vlerësoj nxënësit për punën e pavarur në libër, argumentimin e përgjigjeve, si dhe për mënyrën e zgjidhjes së situatave problemore.			
Detyrat e dhëna për punë të pavarur: Nxënësit mund të shkruajnë “histori” të ndryshme me thyesa, nisur nga shembuj të ndryshëm.			

Fusha Matematikë	Lënda Matematikë	Shkalla III	Klasa VI
Tema mësimore: Raporti dhe përpjesëtimi – Zbulojmë		Situata e të nxënët: Të zbulojë më shumë mbi raportin dhe përpjesëtimin.	
Rezultatet e të nxënët të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: • zgjidh problema të thjeshta duke përfshirë raportin dhe përpjesëtimin; • thjeshton thyesat në formën e tyre më të thjeshtë; • zgjidh problema të thjeshta duke përfshirë raportin dhe përpjesëtimin; • përdor listat ose tabelat për të zgjidhur problemat në mënyrë sistematike.		Fjalët kyçe: • Raport • Përpjesëtim	
Burimet: libri i nxënësit; katrorë me ngjyra		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare Fizikë, Kimi	
Metodologjia, teknikat e përdorura, veprimtaritë e nxënësve			
Organizimi i orës së mësimët			
Parashikimi i të nxënët: Mendo – diskuto Ngjis tre katrorë blu dhe një të verdhë në dërrasën e zezë. Shpjegoj që kjo tregon një Raport 1:3. (Themi “një me tre”.) Shpjegoj se kjo do të thotë që për çdo pjesë të verdhë janë tri pjesë blu. Shkruaj në dërrasë raportin 1:4; 1:5 dhe 1:6. Ftoj nxënësit të vijnë përpara klasës dhe të ngjisin katrorë prej letre për të ilustruar këto raporte. Pastaj të tregojnë me zë të lartë raportet (“një me katër”, “një me pesë” dhe “një me gjashtë”). Ndërtimi i njohurive të reja: Hulumtim – shqyrtim i përbashkët - punë në dyshe Nxënësit punojnë në dyshe me librin e nxënësit. Secili çift pajiset me një pjesë të kubeve ose pullave, të cilat mund t’i përdorë si model për problemat. Nxënësit përdorin minitabelën për të parashtruar problemën. I nxis nxënësit të përdorin skica për të ilustruar idetë e tyre (nuk e paraqes menjëherë zgjidhjen duke përdorur thyesat). Raporti për ushtrimin 1(a) është 2 kuti boje A dhe 1 kuti boje B, sepse $2(1 : 4) + 1(1 : 7) = (2 : 8) + (1 : 7) = 3 : 15 = 1 : 5$ etj. Përforsimi: Zgjedh një nga çiftet të vijë përpara klasës dhe të paraqesë problemën që ka krijuar. Pastaj caktoj një nxënës që të japë zgjidhjen e saj. Nxënësi duhet të shpjegojë logjikën që ndjek për zgjidhjen e problemës. Çifti që ka shkruar problemën mund të zërë vendin e mësuesit dhe të ndihmojë nxënësin për të zgjidhur problemën.			
Vlerësimi: Vlerësoj nxënësit për punën në dyshe dhe për argumentimin e veprimeve të kryera për të arritur në rezultatin e duhur.			
Detyrat e dhëna për punë të pavarur: Nxënësit mund të gjejnë karakteristika të klasës ose të shkollës duke përdorur raporte. Për shembull, të shqyrtojnë sa gjuhë fliten në botë, llojet e mjeteve të transportit, mënyrat e ndryshme të shpenzimit të kohës së lirë etj.			

Fusha Matematikë	Lënda Matematikë	Shkalla III	Klasa VI
Tema mësimore: Raporti dhe përpjesëtimi— Eksplorojmë		Situata e të nxënësve: Thellon njohuritë që lidhen me raportin dhe përpjesëtimin.	
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: • zgjidh problema të thjeshta duke përfshirë raportin dhe përpjesëtimin; • thjeshton thyesat në formën e tyre më të thjeshtë; • zgjidh problema të thjeshta me fjalë, duke përfshirë raportin dhe përpjesëtimin; • përdor listat ose tabelat për të zgjidhur problemat në mënyrë sistematike.		Fjalët kyçe: • Raport • Përpjesëtim • Përqindje • Thyesë	

Burimet: libri i nxënësit, kube ose pulla me ngjyrë blu, të verdhë dhe të kuqe, katrorë letre me ngjyrë blu, të verdhë dhe të kuqe	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare. Fizikë Kimi Biologji Arte
Metodologjia, teknikat e përdorura, veprimtaritë e nxënësve	
Organizimi i orës së mësimit	
Parashikimi i të nxënit: Mendo – krijo dyshe – diskuto	
Nxënësit zgjidhin problemën që çifti tjetër shkroi në mësimin e mëparshëm. Shtroj pyetjen: Cilat janë gjërat më të rëndësishme që duhen mbajtur mend kur zgjidhet një problemë, e cila përfshin raportin dhe përpjesëtimin? Nxiti nxënësit të bëjnë vizatimet përkatëse.	
Ndërtimi i njohurive të reja: Hulumtim – shqyrtim i përbashkët	
Nxënësit punojnë në mënyrë të pavarur problemat në librin e nxënësit. Më pas i pyes: Si e vërtetoni që përgjigjet janë të sakta? Nxënësit duhet të argumentojnë pse përgjigjet e tyre janë të sakta.	
Përforcimi: Secili çift të shkruajë dy fjali: “Çfarë do të thotë raport?” dhe “Çfarë është një përpjesëtim?” Jap këtë shembull: 25% e banorëve të një fshati janë nxënës. Raporti nxënës – të rritur është 1:3. Raporti i studentëve ndaj banorëve të fshatit është .	
Sa është raporti midis vajzave dhe djemve në secilin rast?	
Kujtoni që me raport dy pjesë krahasohen me njëra-tjetrën.	
Shembull:	
Në një klasë me 25 nxënës 15 janë vajza. Në këtë rast themi se raporti i vajzave me djemtë është 15:10 ose 3:2.	
a) Klasa ka 12 nxënës, 4 prej të cilëve janë vajza.	
b) Klasa ka 24 nxënës, 6 prej të cilëve janë vajza.	
c) Klasa ka 15 nxënës, 3 prej të cilëve janë djem.	
d) Klasa ka 16 nxënës, 2 prej të cilëve janë djem.	
e) Klasa ka 20 nxënës, 15 prej të cilëve janë djem.	
f) Klasa ka 15 nxënës, 12 prej të cilëve janë vajza.	
Vlerësimi: Vlerësoj nxënësit për mënyrën si kanë argumentuar rrugën e zgjidhjes për të arritur në rezultatin e duhur.	
Detyrat e dhëna për punë të pavarur:	
Sa vajza dhe sa djem mund të jenë në një klasë, nëse dimë se raporti midis tyre është:	
a) 3 : 4 _____	
b) 5 : 3 _____	
a) 10 : 8 _____	
b) 50 : 75 _____	

Fusha Matematikë	Lënda Matematikë	Shkalla III	Klasa VI
Tema mësimore: Përqindja – Zbulojmë		Situata e të nxënit: Të zbulojë më shumë mbi lidhjen e përqindjes me thyesat.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:		Fjalët kyçe:	
Nxënësi/ja:		- Përqindje - Për një qindkemi.....	
- kupton përqindjet si pjesë në çdo qindëshe dhe shpreh thyesat si përqindje; - gjen përqindje të thjeshta të figurave dhe të numrave natyrorë; - zgjidh problema të thjeshta duke përfshirë përqindjet, për shembull: llogarit uljen e çmimeve.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare	
Burimet: libri i nxënësit		Fizikë Kimi Gjeografi	

Metodologjia, teknikat e përdorura, veprimtaritë e nxënësve
Organizimi i orës së mësimit Parashikimi i të nxënësve: Mendo – krijo dyshe – diskuto Shkruaj në dërrasë numrin 60. Kërkoj prej nxënësve të shkruajnë sa më shumë thyesa dhe përqindje lidhur me numrin 60. Marr përgjigjet e nxënësve, për secilin çift. Kur një çift nuk ka sugjerime, i nxit të përdorin fakte të tjera për të krijuar një fakt të ri. Pasi dërrasa të jetë plotësuar, pyes një nxënës: Cila është data e lindjes tënde? Bazuar në përgjigjet e nxënësve shtroj disa pyetje. Për shembull: për një nxënës me datën e lindjes 15, i kërkoj klasës të gjejë 15% të 60. $15\% \text{ e } 60 = x \cdot 60 = 9$ Çiftet mund ta përsëritin këtë veprimtari me ditët e tyre të lindjes. Ndërtimi i njohurive të reja: Hulumtim – shqyrtim i përbashkët Nxënësit plotësojnë në mënyrë të pavarur ushtrimet e librit. Ata duhet të shpjegojnë idetë e tyre dhe t'i përgjigjen pyetjes: Si e kuptoni që një numër i caktuar përbën 25% të 20 pikëve? Mund t'i pyes edhe për ndonjë numër tjetër pikësh që nuk është në tabelë. Për shembull: Pikët e mia janë 25. Sa për qind përbën kjo? Përforsimi: Të gjithë nxënësit vizatojnë një katror në minitabelat e tyre dhe e ndajnë atë në pjesë prej 25%; 33,3%; 80%. Përgjigjet duhet t'i japin në të njëjtën kohë. Vlerësimi: Vlerësoj nxënësit për punën e pavarur. Detyrat e dhëna për punë të pavarur: Nxënësit duhet të gjejnë raste të përdorimit të përqindjes në uljet e çmimeve nëpër dyqane të ndryshme.

Fusha Matematikë	Lënda Matematikë	Shkalla III	Klasa VI
Tema mësimore: Përqindja –Eksplorojmë		Situata e të nxënit: Të thellojë njohuritë për përqindjen.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: - kupton përqindjet si pjesë në çdo qindëshe dhe shpreh thyesat si përqindje; - gjen përqindje të thjeshta të figurave dhe të numrave natyrorë.		Fjalët kyçe: - Thyesë - Përqindje - Pjesë	
Burimet: libri i nxënësit	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare Fizikë Kimi Gjeografi		

Metodologjia, teknikat e përdorura, veprimtaritë e nxënësve
Organizimi i orës së mësimit Parashikimi i të nxënësve: Mendo – krijo dyshe – diskuto Shkruaj në dërrasë $\frac{1}{4}$, 25% dhe 50%. Pyes nxënësit: Cili prej tyre ndryshon nga të tjerët? Pse? Disa përgjigje të mundshme janë: “$\frac{1}{4}$, sepse është një thyesë, kurse 25% dhe 50% janë përqindje” ose “50% ndryshon nga të tjerët, sepse $\frac{1}{4}$ dhe 25% janë të barabartë”. Nxënësit të argumentojnë përgjigjet. Përsërit për: 10%; $\frac{1}{4}$ dhe 0,5 80%; 40% dhe $\frac{2}{5}$ Ndërtimi i njohurive të reja: Hulumtim – shqyrtim i përbashkët Nxënësit plotësojnë në mënyrë të pavarur ushtrimet në librin e nxënësit. Ata duhet të arsyetojnë mbi problemën. Për shembull, shtroj pyetjen: Si arrini në përfundimin që $\frac{3}{5}$ bëjnë 60%? Vendos nxënësit në garë të gjejnë shembuj që nuk janë në tabelë. P.sh: thyesa me emërues 8.

Përforcimi: Kërkoj nga nxënësit të zgjidhin problemat.

1. Një bluzë kushton 500 lekë, një palë çorape 100 lekë, një palë këpucë 6700 lekë, ndërsa një palë pantallona kushtojnë 4500 lekë. Një shitës ka ulur çmimet e artikujve të tij me 50%. Cilat janë çmimet e reja?

Bluza _____

Çorapet _____

Këpucët _____

Pantallona _____

2. Në qoftë se blini 5 palë çorape, ju përfitoni një ulje prej 10%. Një palë çorape kushtojnë 120 lekë. Sa është ulja e çmimit? _____

Sa kushtojnë 5 palë çorape? _____

Dy nxënës paraqesin në tabelë zgjidhjen e problemave. Nxënësit e tjerë të klasës korrigjojnë dhe plotësojnë.

Vlerësimi: Vlerësoj nxënësit për punën e pavarur, argumentimin e përgjigjeve dhe nxjerrjen e përfundimeve.

Detyrat e dhëna për punë të pavarur: Situata reale në treg bazuar në broshurat e uljeve të çmimeve.

Fusha Matematikë	Lënda Matematikë	Shkalla III	Klasa VI
Tema mësimore: Thyesat dhe numrat dhjetorë – Përmbledhim		Situata e të nxënit: Të thellojë njohuritë për lidhjen e numrave me presje dhe thyesave.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: • gjen përqindje të thjeshta të figurave dhe numrave natyrorë; • kupton përqindjen si pjesë të çdo qindësheje.		Fjalët kyçe: • Thyesë. • Përqindje • Numër dhjetor • I njëvlershëm me...	
Burimet :Libri i nxënësit.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare	
Metodologjia, teknikat e përdorura, veprimtaritë e nxënësve			
Organizimi i orës së mësimi			
Parashikimi i të nxënit: Mendo – punë në grup – diskuto			
Nxënësit të punojnë në grupe me nga katër veta. Nxiti nxënësit t'i interpretojnë vetë problemat. Shmang sa më shumë udhëheqjen e grupeve. Nxiti nxënësit të rilexojnë problemën në mënyrë që të kuptojnë se çfarë u duhet. Duhet t'u jap kohë të mjaftueshme për të planifikuar prezantimet e tyre. Është e rëndësishme që prezantimet të përgatiten sa mire.			
Ndërtimi i njohurive të reja: Hulumtim – shqyrtim i përbashkët			
Tri grupe nxënësish, njëri pas tjetrit, duhet të paraqisin zgjidhjen e problemës. Në fund të prezantimit, gjithë nxënësit të përfytyrojnë sikur janë tregtarë dhe të vendosin se cilat janë zgjidhjet më të mira për këtë problemë. Nxis nxënësit që të japin shpjegime sa më të qarta. Pyes: Pse mendoni se kjo është zgjidhja më e mirë?			
Përforcimi: Kërkoj nga nxënësit të zgjidhin problemën:Një palë pantallona kushtojnë 4600 lekë kurse një bluzë 600 lekë.Ju bletë një bluzë dhe një palë pantallona. Shitësi ju bëri 10% ulje për këtë blerje.			
a. Sa është vlera e bluzës dhe pantallonave në dyqan? _____			
b. Sa është zbritja që ju bëri shitësi? _____			
c. Sa paguat?_____			
Nxënësit punojnë të pavarur pres përgjigjet e tyre.			
Vlerësimi:Vlerësoj punën në grup dhe punën individuale.			
Detyrat e dhëna për punë të pavarur. Në jetën e përditshme, nxënësit mund të gjejnë të dhëna në revista, fletëpalosje, reklama, dyqane dhe t'i përfshijnë në problema me përqindje.			

Fusha Matematikë	Lënda Matematikë	Shkalla III	Klasa VI
Tema mësimore: Thyesat dhe numrat dhjetorë – Përforcojmë		Situata e të nxënët: Të thellojë njohuritë mbi marrëdhëniet e thyesës me numrin dhjetor.	
Rezultatet e të nxënët të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - njih dhe përdor barazimin midis numrave dhjetorë dhe thyesave; - kupton përqindjen si pjesë e çdo qindësheje dhe shpreh thyesat si numra dhjetorë; - nga informacioni ekzistues, nxjerr një informacion të ri dhe kupton se nga një pjesë e informacionit rrjedh një informacion tjetër; - parashtron, vlerëson dhe ripunon hipotezat, shpjegon dhe argumenton metodat, arsyeton strategjitë, rezultatet ose përfundimet.		Fjalët kyçe: - Thyesë - Numër dhjetor - Thyesë dhjetore	
Burimet: libri i nxënësit		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare ----	
Metodologjia, teknikat e përdorura, veprimtaritë e nxënësve			
Organizimi i orës së mësimët			
Parashikimi i të nxënët: Mendo 0,8 4/5 80% Nxënësit nxjerrin letrat A4 dhe i ndajnë në 28 drejtkëndësha për të formuar skeda. Secili çift nxënësish duhet t'i presë dhe të krijojë grupe me skeda për të luajtur një lojë kujtese. Nxënësit mund të përdorin shembuj nga libri ose të vendosin të krijojnë skedat e tyre. Ata duhet të përdorin katër përfaqësues (një thyesë, numrin dhjetor të njëvlershëm, përqindjen e njëvlershme dhe një diagram me kuti që tregon thyesën si një zonë të ngjyrosur). Ndërtimi i njohurive të reja: Hulumtim – shqyrtim i përbashkët Kërkoj nga nxënësit që të kthejnë këta numrat dhjetorë në thyesa të pathjeshtueshme dhe në përqindje: 0,5 ; 0,45 ; 0,05 Nxënësit paraqesin zgjidhjet e tri ushtrimeve në tabelë. Plotësojnë në mënyrë të pavarur veprimtarinë në librin e nxënësit. Ndihmoj nxënësit që mund të kenë vështirësi. Përforcimi: Secili prej nxënësve të shkruajë se çfarë ka mësuar nga ky kapitull duke përdorur këto fillime fjalish: “Unë kuptova që...” “Unë mësova se...” “Unë do të doja të mësoja më shumë për...” “Unë nuk jam i sigurt për...” Disa prej nxënësve mund të kenë nevojë t'i thonë me zë të lartë fjalitë përpara se t'i shkruajnë. Një alternativë tjetër është që mësuesi/ja t'i shkruajë fjalitë në dërrasë, në qoftë se kjo mënyrë i ndihmon ata në artikulimin e mendimit.			
Vlerësimi: Vlerësoj nxënësit për punën e pavarur dhe argumentimin e përgjigjeve.			
Detyrat e dhëna për punë të pavarur: Nxënësit duhet të marrin 10 numra dhjetorë me dy shifra pas presjes dhe t'i shkruajnë si thyesa dhe përqindje.			

Fusha Matematikë	Lënda Matematikë	Shkalla III	Klasa VI
Tema mësimore: Diskutojmë së bashku		Situata e të nxënit: Thellon njohuritë për mbledhjen dhe zbritjen e numrave natyrorë dhe dhjetorë.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: - përdor vendvlerën dhe faktet mbi numrat për të - mbledhur ose zbritur numrat me dy shifra; mbledh dhe zbret numrat me tri shifra shumëfisha të dhjetës, për shembull: $500 + 270$; $2,6 + 2,7$; $0,78 + 0,23$; - mbledh ose zbret numrat me një shifër pas presjes - dhjetore, për shembull: $5,6 + 2,9$; $13,5 - 2,1$; - mbledh ose zbret shumëfisha të afërt me 10, 100,1000 ose numra natyrorë që përafrohen me to, si: $3\ 127 + 4\ 998$; $5\ 678 - 1\ 996$.		Fjalët kyçe: - Mbledh - Vendvlerë - Përafron - Zbret	
Burimet: libri i nxënësit, faqe 45	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare Fizikë		
Metodologjia, teknikat e përdorura, veprimtaritë e nxënësve			
Organizimi i orës së mësimi			
Parashikimi i të nxënit: Mendo – krijo dyshe – diskuto Shkruaj $28 + 17$ në dërrasë. Ftoj nxënësit ta bëjnë këtë veprim me mend. Secili prej nxënësve duhet të flasë me një shok/shoqe dhe t'i shpjegojë strategjinë që ka përdorur. Për të ndihmuar nxënësit me terminologjinë e nevojshme, mund të shkruaj në dërrasë: “Përgjigjja është...” dhe “Unë e zgjidha me mënyrën...”. Pres përgjigjet nga klasa dhe kontrolloj nëse janë realizuar strategjitë e ndryshme. Përsëris këtë veprimtari me veprimet 4×14 dhe shtroj pyetjen: Cila është gjysma e numrit 78? Ndërtimi i njohurive të reja: Hulumtim – shqyrtim i përbashkët Nxënësit punojnë në grupe në secilën etiketë në librin e nxënësit. Një nxënës nga secili grup lexon pyetjen dhe të tjerët bëjnë llogaritjen. Më pas, nxënësit duhet të diskutojnë strategjitë që kanë përdorur. Nuk ka rëndësi rendi sipas të cilit bëjnë llogaritjet. Pas secilës llogaritje, grupet duhet të bien dakord se cila ishte metoda më efikase dhe më pas duhet ta mbajnë shënim. Përforcimi: Grupet duhet të ndajnë me të gjithë klasën metodën më të mirë që kanë përdorur për çdo llogaritje. Ata mund të kenë përdorur strategji të ndryshme. Është e rëndësishme që të merren në shqyrtim të gjitha strategjitë e ndjekura nga nxënësit. Përqendroj diskutimin mbi efikasitetin e strategjive. Për të treguar strategjitë e përdorura, krijoni një afishe për secilën llogaritje. Gjatë kapitullit do na duhet t'i drejtohem afishes herë pas here.			
Vlerësimi: Vlerësoj nxënësit për punën në grup.			
Detyrat e dhëna për punë të pavarur: ---			

Fusha Matematikë	Lënda Matematikë	Shkalla III	Klasa VI
Tema mësimore: Strategjitë e kryerjes me mend të mbledhjes dhe zbritjes – Zbulojmë		Situata e të nxënit: Përsërit njohuritë mbi vetitë e mbledhjes.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: - kujton faktet për mbledhjen dhe zbritjen e numrave deri në 20 dhe çiftin numrat me një shifër pas presjes dhjetore me shumë 1, për shembull: $0,4 + 0,6$; - gjen shpejt çifte me një shifër pas presjes dhjetore me shumë 10, për shembull: $7,8 + 2,2$;		Fjalët kyçe: - Mbledhor - Shumë - Përfundim - Veti - Çiftim	

• mbledh ose zbret numra të afërt me 10, 100 ose 1000; • shpjegon pse zgjodhi një metodë të caktuar për të realizuar një veprim dhe argumenton që kjo metodë jep rezultat.	
Burimet: libri i nxënësit	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare
Metodologjia, teknikat e përdorura, veprimtaritë e nxënësve	
Organizimi i orës së mësimit Parashikimi i të nxënësve: Mendo – krijo dyshe – diskuto Shkruaj numrin 50 në dërrasën e zezë. I jap secilit çift të nxënësve 2 minuta kohë për të shkruar sa më shumë pyetje, të cilat si përgjigje kanë 50. Ata mund të përdorin çfarëdolloj veprimi. Pas 2 minutash marr sugjerimet nga secili çift dhe i mbaj shënim. Shtroj pyetjen: Sa mundësi ka për të mbledhur dy numra natyrorë që ta kenë shumën 15? Iu jap përsëri çifteve 2 minuta kohë të përgjigjen. Këtë herë u drejtohem nxënësve me pyetjen e kundërt: Si e kuptoni që i keni dhënë të gjitha mundësitë? Ndërtimi i njohurive të reja: Hulumtim – shqyrtim i përbashkët Nxënësit punojnë në mënyrë të pavarur për të përfunduar veprimtarinë në librin e nxënësit. Disa prej tyre mund të kenë nevojë për ndihmë për të kuptuar numrat me presje dhjetore. Për këtë mund të përdorin boshtin numerik 0-1, të ndarë në dhjetë pjesë. Ndihmoj nxënësit të kujtojnë çiftimin e numrave për të dhënë shumën 1 ($0,1 + 0,9$; $0,2 + 0,8$ dhe kështu me radhë). Pasi nxënësit të plotësojnë fjalitë në libër, i nxit të diskutojnë për disa prej strategjive të tyre. Më pas mund të vazhdohet me pjesën e dytë të veprimtarisë. Evidentoj nxënësit që plotësuan me sukses pyetjen 5. Njëri prej tyre diskuton strategjinë e përdorur me pjesën tjetër të grupit. Kjo i ndihmon të gjithë nxënësit të kuptojnë strategjitë e mundshme. Theksoj se pyetja 5 mund të plotësohet duke përdorur veprimet me mend (për shembull: nga gjetja e çifteve të numrave, shuma e të cilëve është 10). Përforcimi: Rendis në dërrasë numrin e nxënësve për çdo klasë të shkollës sime. Për të gjetur numrin e përgjithshëm të nxënësve të shkollës, nxënësit duhet të punojnë në dyshe. Njëri nga nxënësi e secilit çift duhet të përdorë makinën llogaritëse, kurse tjetri ta llogarisë me mend. Këtë llogaritje e bëj vetë si fillim, me qëllim që të kem të qartë strategjitë e grupeve. Gjithashtu, diskutoj me nxënësit të arrijnë në përfundimin se mendja e njeriut është mbi makinën llogaritëse.	
Vlerësimi: Vlerësoj nxënësit për bashkëpunimin midis tyre dhe punën në grup.	
Detyrat e dhëna për punë të pavarur: –	

Fusha Matematikë	Lënda Matematikë	Shkalla III	Klasa VI
Tema mësimore: Strategjitë e kryerjes me mend të mbledhjes dhe zbritjes – Eksplorojmë		Situata e të nxënësve: Të thellojë njohuritë për metodat e kryerjes së mbledhjes dhe zbritjes	
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: • kujton faktet për mbledhjen dhe zbritjen e numrave deri në 20 dhe çiftojnë numrat me një shifër pas presjes dhjetore me shumë 1, për shembull: $0,4 + 0,6$; • përdor vendvlerën dhe faktet e numrave për të mbledhur dhe zbritur numrat me dy shifra; • shpjegon pse zgjodhi një metodë të caktuar për të realizuar një veprim dhe argumenton që kjo metodë jep rezultat.		Fjalët kyçe: • Mbledh • Zbres • Çiftoj • Vetë • Grupim • Vendvlerë	

Burimet: libri i nxënësit, etiketa me numrat 1-4 dhe +	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare
Metodologjia, teknikat e përdorura, veprimtaritë e nxënësve	
Organizimi i orës së mësimi Parashikimi i të nxënit: Mendo – krijë dyshe – diskuto Përgatis pesë letrat A4 me një nga shifrat 1, 2, 3, 4 dhe + në to. Ftoj pesë nxënës të vijnë përpara klasës dhe të marrin në mënyrë të rastësishme një nga letrat. Kjo do të krijojë mundësinë e mbledhjes së dy numrave me nga dy shifra ose të një numri me tri shifra me një numër me një shifër. Nxënësit duhet të punojnë në dyshe, të llogaritin me mend përgjigjet, t'i shkruajnë në minitabelë. Shtroj pyetjen: Cila është shuma më e madhe e mundshme? Ndërtimi i njohurive të reja: Hulumtim – shqyrtim i përbashkët Nxënësit punojnë në dyshe në librin e nxënësit. Pasi nxënësit të nisin punën, shtroj pyetjen: Si e dini që kjo është shuma më e madhe? Cila është shuma më e vogël? Nxitini nxënësit të shpjegojnë përgjigjet e tyre dhe strategjitë përkatëse. Përforcimi: Pas përfundimit të ushtrimit, gjej pesë kërkesa, që si përgjigje kanë numrin 112. U kërkoj nxënësve ta bëjnë me mend këtë verifikim dhe të diskutojnë strategjitë e tyre. Zgjedh një numër me një ose dy shifra pas presjes dhjetore. Nxënësit shkruajnë në minitabela pyetjet ku kërkojnë veprime që kanë si përfundim këtë numër. Për shembull: Përgjigjja është 3,5. Cila është pyetja?	
Vlerësimi: Vlerësoj punën në çift, si dhe argumentimin e përgjigjeve.	
Detyrat e dhëna për punë të pavarur: Për secilën përgjigje shkruani pesë pyetje të ndryshme. Ato duhet të përmbajnë numra dyshifrorë ose trashifrorë, duke kryer veprime si mbledhja apo zbritja. Përgjigjja është 250. a) _____ b) _____ c) _____ d) _____ e) _____ 2. Përgjigjja është 1001. a) _____ b) _____ c) _____ d) _____ e) _____	

Fusha Matematikë	Lënda Matematikë	Shkalla III	Klasa VI
Tema mësimore: Strategjitë e kryerjes me mend të shumëzimit dhe të pjesëtimit – Zbulojmë		Situata e të nxënit: Thellon njohuritë për strategjitë e kryerjes me mend të shumëzimit dhe të pjesëtimit.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - njuh dhe aplikon pjesëtimin me 2; 4; 5; 10; 25 dhe 100; - shumëzon çifte numrash shumëfisha të numrit 10; - shumëzon shumëfisha të afërt me numrin 10; - dyfishon shpejt çdo numër me dy shifra, për shembull: 78; 7,8; 0,78 dhe identifikon gjysmat korresponduese.		Fjalët kyçe: - Faktorë - Prodhim - Herës - Dyfishim - Përgjysmim	

Burimet: libri i nxënësit	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare Fizikë Kimi Gjeografi
Metodologjia, teknikat e përdorura, veprimtaritë e nxënësve	
Organizimi i orës së mësimit	
Parashikimi i të nxënës: Mendo – diskuto – ndërvepro Ftoj 24 nxënës të dalin përpara klasës (ose nëse është e mundur, kryej veprimtarinë jashtë shkollës). Ky grup rreshtohet në mënyrë të caktuar (për shembull: 8 rreshta me nga 3 vetë). E përsëris disa herë këtë veprim, derisa ata të kuptojnë që janë rreshtuar në të gjitha mundësitë. Ndërtimi i njohurive të reja: Hulumtim – shqyrtim i përbashkët Nxënësit punojnë në dyshe në veprimtarinë e parë në librin e nxënësit. Kërkoj prej nxënësve të diskutojnë përgjigjet për pyetjen 3. Ata duhet të shqyrtojnë mundësi të ndryshme për të shumëzuar numrat afër 10. Nxënësit t'i gjejnë vetë strategjitë e mundshme. Kjo i ndihmon të kuptojnë se strategjia më e shpejtë është të shumëzojnë fillimisht me 10 dhe pastaj të korrigjojnë përfundimin (për shembull: $15 \times 11 = 15 \times 10 + 15 \times 1 = 165;$ $15 \times 9 = 15 \times 10 - 15 \times 1 = 135).$ Për pyetjen 4, nxënësit duhet të punojnë në grup. Grupet mund t'i orientoj duke parë shumën e shifrave (për shembull: $3 \times 6 = 18$ dhe $1 + 8 = 9$, e cila është e pjesëtueshme me 3). Përforcimi: Secili grup do të shpjegojë rregullën e pjesëtimit që gjeti. Ndërkohë, nxënësit e tjerë shkruajnë rregullën. Vizatoj në dërrasën e zezë diagramin e Venit, me rrathë të etiketuar “Shumëfish i numrit 10”, “Shumëfish i numrit 100” dhe “Shumëfish i numrit 25”. Nxënësit vijnë përpara klasës një e nga një. Secili prej tyre zgjedh një nga letrat e përgatitura, mbi të cilat janë shënuar numra me dy dhe tri shifra. Pastaj i vendosin në vendin e duhur në diagramin e Venit. Çdo herë shtroj pyetjen: A është ky numër shumëfish i 10/100/25? Nxënësit shpjegojnë përgjigjet e tyre.	
Vlerësimi: Vlerësoj punën në dyshe dhe argumentimin e përgjigjeve. Detyrë shtëpie: Gjej numra që plotësojnë kushtin: Pjesëtohet me 2 dhe jep mbetje. Pjesëtohet me 2 dhe nuk jep mbetje. Pjesëtohet me 3 dhe jep mbetje. Pjesëtohet me 2 dhe nuk jep mbetje. Pjesëtohet me 4 dhe jep mbetje. Pjesëtohet me 4 dhe nuk jep mbetje. Pjesëtohet me 5 dhe jep mbetje. Pjesëtohet me 5 dhe nuk jep mbetje. Pjesëtohet me 6 dhe jep mbetje. Pjesëtohet me 6 dhe nuk jep mbetje. Pjesëtohet me 7 dhe jep mbetje. Pjesëtohet me 7 dhe nuk jep mbetje. Pjesëtohet me 8 dhe jep mbetje. Pjesëtohet me 8 dhe nuk jep mbetje. Pjesëtohet me 9 dhe jep mbetje. Pjesëtohet me 9 dhe nuk jep mbetje. Pjesëtohet me 10 dhe jep mbetje. Pjesëtohet me 10 dhe nuk jep mbetje.	

Fusha Matematikë	Lënda Matematikë	Shkalla III	Klasa VI
Tema mësimore: Strategjitë e kryerjes me mend të shumëzimit dhe të pjesëtimit		Situata e të nxënës: Thellon njohuritë për vetitë e shumëzimit dhe të pjesëtimit.	
Rezultatet e të nxënës të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - shumëzon çifte shumëfisha të numrit 10; - shumëzon shumëfisha të afërt me numrin 10; - përdor vendvlerën dhe faktet e shumëzimit për të shumëzuar/pjesëtuar me mend, për shembull: $0,8 \times 7$; $8:6$;		Fjalët kyçe: - Prodhim - Herës - Dyfishim - Përgjysmim - Përafrim - Rrumbullakim	

- shpjegon pse zgjedh një metodë të caktuar për të realizuar një veprim dhe argumenton që kjo metodë jep rezultat; - nxjerr një informacion të ri nga informacioni ekzistues dhe kupton se nga një pjesë e informacionit rrjedh një informacion tjetër.	
Burimet: libri i nxënësit	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare
Metodologjia, teknikat e përdorura, veprimtaritë e nxënësve	
Organizimi i orës së mësimi Parashikimi i të nxënit: Mendo – diskuto – stuhi mendimi Ky mësim zhvillohet menjëherë pas mësimi të mëparshëm. Ftoj nxënësit të diskutojnë me shokun e tyre për çështjet e mëposhtme: Çfarë strategjie përdorët për të gjetur 10×40 ose $20 \times 7,2$? Si mund të llogaritni me mend 31×30? Si mund të llogaritni me mend $0,3 \times 40$? Kërkoj argumentim për secilin diskutim. Ndërtimi i njohurive të reja: Hulumtim – veprimtari e pavarur Nxënësit punojnë në mënyrë të pavarur në librin e nxënësit. Ky është vazhdimi i veprimtarisë së mëparshme dhe mund ta përdor edhe si vlerësim për të nxënit. Nxënësit punojnë në çift ose në grupe të vogla për pyetjen 4. Ndhimjo nxënësit ndërkohë që ata punojnë për pyetjen 4. Shtroj pyetjen: Si e gjeni që ai është prodhimi më i madh/më i vogël? Përforcimi: Gjatë veprimtarisë kryesore zgjedh nxënësit ose grupet që do të shpjegojnë strategjitë e zgjidhjes së tyre për përgjigjen e pyetjes 4. Për përforcimin e të nxënit, i ftoj nxënësit ta prezantojnë këtë para klasës. Vlerësimi: Vlerësoj nxënësit për veprimtarinë e pavarur. Detyrat e dhëna për punë të pavarur: –	

Fusha Matematikë	Lënda Matematikë	Shkalla III	Klasa VI
Tema mësimore: Përdorimi i fakteve të njohura për të gjetur fakte të reja – Zbulojmë		Situata e të nxënit: Thellon njohuritë për vetitë e shumëzimit të dy numrave natyrorë dhe të një numri natyror me një numër dhjetor.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: - përdor vendvlerën dhe faktet e shumëzimit për të shumëzuar ose pjesëtuar me mend; - zgjedh strategji të përshtatshme dhe efikase të veprimeve me mend ose me shkrim për të realizuar një veprim (mbledhje, zbritje, shumëzim ose pjesëtim);		Fjalët kyçe: - Faktor natyror - Faktor numër dhjetor - Faktor që mbaron me zero - Prodhim	
shpjegon pse zgjedh një metodë të caktuar për të realizuar një veprim dhe argumenton që kjo metodë jep rezultat.			
Burimet: libri i nxënësit	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare		
Metodologjia, teknikat e përdorura, veprimtaritë e nxënësve			

Organizimi i orës së mësimit

Parashikimi i të nxënësve: Veprimtari e pavarur

Shkruaj në dërrasë tabelën e mëposhtme të shumëzimit.

x	7	2	4	3	8
5					
6					
3					
9					
10					

Tabela do të plotësohet në mënyrë të pavarur nga çdo nxënës. Më pas shtroj pyetjet: Nga cili rresht ose kolonë u nisët? Cili është rreshti ose kolona më e lehtë për t'u plotësuar? Si mund ta përdorni rreshtin e 3-të për të plotësuar shpejt rreshtin e 4-të? (duke dyfishuar). Qëllimi është t'u tregoj nxënësve si të përdorin fakte që i njohin për të përfutur informacion të ri.

Ndërtimi i njohurive të reja: Hulumtim – shqyrtim i përbashkët

Nxënësit punojnë në mënyrë të pavarur ushtrimin 2 dhe shkëmbejnë me njëri-tjetrin informacionin e përfutur.

Përfuturimi:

$$7 \times 13 = 91 \text{ sepse } 7 \times 10 = 70 \text{ dhe } 7 \times 3 = 21; 70 + 21 = 91$$

$$\text{Shkruaj saktë: } 7 \times 13 = 7 \times (10 + 3) = 7 \times 10 + 7 \times 3 = 70 + 21 = 91$$

$$6 \times 19 = 6 \times (20 - 1) = 6 \times 20 - 6 \times 1 = 120 - 6 = 114$$

Nxënësit punojnë në mënyrë të pavarur ushtrimet e shkruara në tabelë.

$$5 \times 13 = \quad \quad \quad 5 \times 19 =$$

$$6 \times 21 = \quad \quad \quad 29 \times 7 =$$

$$8 \times 42 = \quad \quad \quad 6 \times 99 =$$

Ushtrimet punohen në mënyrë të pavarur në fletoret e klasës. Më pas, nxënësit paraqesin zgjidhjet në tabelë duke argumentuar se si kanë arritur në përfuturimin e saktë.


Vlerësimi: Vlerësoj nxënësit për punën e pavarur, bashkëveprimin me shokët dhe argumentimin e përgjigjes.

Detyrat e dhëna për punë të pavarur: Nxënësit duhet të krijojnë tabela shumëzimi të ngjashme me ato që punuan në klasë.

Fusha Matematikë	Lënda Matematikë	Shkalla III	Klasa VI
Tema mësimore: Përdorimi i fakteve të njohura për të gjetur fakte të reja		Situata e të nxënësve: Thellon njohuritë për shumëzimin e një numri që mbaron me zero me një numër dhjetor.	
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - përdor vendvlerën dhe faktet e shumëzimit për të shumëzuar ose pjesëtuar me mend; - zgjedh strategji të përshtatshme dhe efikase të veprimeve me mend ose me shkrim për të realizuar një veprim (mbledhje, zbritje, shumëzim ose pjesëtim); - shpjegon pse zgjedh një metodë të caktuar për të realizuar një veprim dhe argumenton që kjo metodë jep rezultat.		Fjalët kyçe: - Veti - Prodhim. - Faktorë.	
Burimet: libri i nxënësve	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare Fizikë Kimi		
Metodologjia, teknikat e përdorura, veprimtaritë e nxënësve			

Organizimi i orës së mësimit**Parashikimi i të nxënit: Mendo – stuhi mendimi – diskuto**

Shkruaj në tabelë shumëzimin $5 \times 8 = 40$. Me anë të metodës stuhi mendimi, nxënësit nxjerrin përfundime bazuar në këtë shumëzim.



Për çdo barazim të dhënë nga nxënësit, kërkoj rrugën e arsytimit që kanë ndjekur.

Ndërtimi i njohurive të reja: Hulumtim – shqyrtim i përbashkët

Nxënësit plotësojnë në mënyrë të pavarur diagramin merimangë në librin e nxënësit. Ata duhet të përpiqen të llogaritin sa më shumë fakte.

Përforcimi:

Shkruaj sipër, në të majtë të dërrasës: $19 \times 20 = 380$.

Pyes secilin nxënëse me radhë:

Them një fakt të ri, bazuar në një fakt të mëparshëm. Kjo shërben për të krijuar një varg me fakte në të gjithë dërrasën e zezë.

Për shembull: $19 \times 20 = 380$, kështu që $1,9 \times 20 = 38$, ndaj

$1,9 \times 40 = 76$, e kështu me radhë.

Vlerësimi: Vlerësoj nxënësit për argumentimin e përgjigjeve dhe nxjerrjen e përfundimeve të tërthorta.

Detyrat e dhëna për punë të pavarur: Nxënësit duhet të shkruajnë sa më shumë fakte për $80 \times 9 =$

Fusha Matematikë	Lënda Matematikë	Shkalla III	Klasa VI
Tema mësimore: Dyfishi dhe gjysma – Zbulojmë		Situata e të nxënit: Krijon shkathtësi në përdorimin e dyfishit dhe gjysmës.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - dyfishon shpejt çdo numër me dy shifra, për shembull: 78; 7,8; 0,78; dhe gjithashtu gjen gjysmën përkatëse; - shpjegon pse zgjedh një metodë të caktuar për të realizuar një veprim dhe argumenton që kjo metodë jep rezultat.		Fjalët kyçe: - Dyfishoj - Përgjysmoj	

Burimet: libri i nxënësit	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare Kimi
Metodologjia, teknikat e përdorura, veprimtaritë e nxënësve	
Organizimi i orës së mësimit	
Parashikimi i të nxënësve: Mendo – krijo dyshe – diskuto	
Shkruaj numrat e mëposhtëm në dërrasë: 28; 32; 15; 39; 62; 50; 20; 78	
Lexoj me zë çdo numër dhe pyes nxënësit: A është e lehtë apo e vështirë të dyfishoni?	
Nxënësit duhet të arsyetojnë zgjedhjen e tyre. Ata mund të thonë se për numrin 20 është e lehtë, sepse ai është dyfishi i numrit 10; ndërsa për numrin 78 është e vështirë, sepse ai kalon numrin 100, kështu që mund ta ndajnë numrin 78 në dy pjesë: 70 dhe 8.	
Ndërtimi i njohurive të reja: Hulumtim – shqyrtim i përbashkët	
Nxënësit plotësojnë në mënyrë të pavarur veprimtarinë në librin e nxënësit. I nxit të diskutojnë strategjitë e tyre në çifte. Mbat shënime për nxënësit, të cilët janë të sigurt në shpalosjen e strategjive të tyre. Ata mund të ndihmojnë në përfundimin e të nxënësit. Ushtrimet 2 dhe 3 janë materiale shtesë, të cilat i ndihmojnë nxënësit të zhvillojnë metodat e mbledhjes dhe të zbritjes së numrave treshifrorë.	
Përfundimi: Përsërit secilën nga veprimtaritë në librin e nxënësit për të gjithë klasën duke përdorur minitabelat. Kështu mund të kuptoj se sa i kanë përvetësuar njohuritë. Hedh dy herë një zar për të formuar një numër me dy shifra. Ftoj nxënësit të shkruajnë përgjigjen e tyre në dërrasë. Pres 5 sekonda.	
Vlerësimi: Vlerësoj nxënësit për argumentimet e tyre në zgjedhjen e ushtrimeve.	
Detyrat e dhëna për punë të pavarur: Nxënësit duhet të dyfishojnë dhe përgjysmojnë numrat: 34, 56, 86, 74.	

Fusha Matematikë	Lënda Matematikë	Shkalla III	Klasa VI
Tema mësimore: Dyfishi dhe gjysma – Eksplorojmë		Situata e të nxënësve: Thellon njohuritë në kryerjen e veprimeve që kërkojnë shkathtësi.	
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: - dyfishon shpejt çdo numër me dy shifra; - zgjedh strategji të përshtatshme dhe efikase të veprimeve me mend ose me shkrim për të realizuar një veprim (mbledhje, zbritje, shumëzim ose pjesëtim); - shpjegon pse zgjedh një metodë të caktuar për të realizuar një veprim dhe argumenton që kjo metodë jep rezultat; - zgjidh problema të thjeshta me fjalë.		Fjalët kyçe: - Dyfishi - Gjysma	
Burimet: libri i nxënësit	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare		
Metodologjia, teknikat e përdorura, veprimtaritë e nxënësve			
Organizimi i orës së mësimit			
Parashikimi i të nxënësve: Mendo – veprimtari në dyshe Kërkoj prej nxënësve të shqyrtojnë zgjidhjen e problemave pa ndonjë pjesë hyrëse. Ata mund të përdorin strategjitë e veprimtarive të mëparshme. Pasi të plotësojnë pyetjet, zgjedh një çift dhe shkruaj pyetjen për ta në dërrasë. Ndërkohë, nxënësit e tjerë zgjidhin problemën në çifte. Pyes njërin prej çifteve të shpjegojë strategjinë e zgjidhjes dhe të kontrollojë përgjigjen. Më pas, nxënësit plotësojnë pjesën tjetër të veprimtarisë në librin e nxënësit.			

Ndërtimi i njohurive të reja: Hulumtim – shqyrtim i përbashkët Ftoj dy çifte të ndryshme të diskutojnë problemet që kanë hasur duke përdorur recetën e peshkut (ushtrimi 3). Përforcimi: Për të krijuar problema për shokët e tyre, nxënësit mund të përdorin receta gatimesh që përdor familja e tyre. Nxënës të krijojnë problema që përfshijnë dyfishin dhe gjysmën. Fillimisht nxënësit duhet të jenë të aftë t'i zgjidhin vetë këto problema.
Vlerësimi: Vlerësoj nxënësit për bashkëpunimin midis tyre dhe për argumentimin e përgjigjeve gjatë zgjidhjes së problemave.
Detyrat e dhëna për punë të pavarur: Nxënësit duhet të dyfishojnë recetën e kekut.

Fusha Matematikë		Lënda Matematikë	Shkalla III	Klasa VI
Tema mësimore: Strategjitë për kryerjen me mend për pjesëtimin të një numri dyshifror me një numër njëshifror			Situata e të nxënit: Thellon njohuritë për pjesëtimin	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: • pjesëton numrat me dy shifra me numrat me një shifër, duke përfshirë edhe rastet me mbetje; • shpjegon pse zgjedh një metodë të caktuar për të realizuar një veprim dhe argumenton që kjo metodë jep rezultat; • parashtron, vlerëson dhe ripunon hipotezat, shpjegon dhe argumenton metodat, arsyeton strategjitë, rezultatet ose përfundimet.			Fjalët kyçe: • Plotpjesëtim • Pjesëtim me mbetje	
Burimet: libri i nxënësit		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare Fizikë Kimi		
Metodologjia, teknikat e përdorura, veprimtaritë e nxënësve				
Organizimi i orës së mësimi				
Parashikimi i të nxënit: Mendo – krijo dyshe – diskuto Nxënësit formojnë tabelën e mëposhtme në minitabelat e tyre: Shkruaj numrin 36 në dërrasën e zezë. Kërkoj prej nxënësve të plotësojnë tabelën për numrin 36, me numrat nga 1 në 18, për shembull: Çdo çift duhet të plotësojë dy fjalë: 36 plotpjesëtohet me...” “Në qoftë se 36 pjesëtohet me....., mbetja është...”				
36 plotpjesëtohet me.....		36 pjesëtohet me mbetje me...		
1,2,3,4,6,9,12,18		5,7,8,10,11,13,14,15,16,17		
Marr përgjigje nga secili çift nxënësish. Shkruaj numrin në fjalitë korresponduese në dërrasë. Për shembull: në qoftë se një çift shkruan “36 plotpjesëtohet me 9”, atëherë $36 : 9 = 4$. Në qoftë se 36 pjesëtohet me 11, mbetja është 3; $36 : 11 = 3$ dhe mbetja 3. Ndërtimi i njohurive të reja: Hulumtim – shqyrtim i përbashkët Nxënësit punojnë në mënyrë të pavarur për plotësimin e librit të nxënësit. I nxit të diskutojnë me njëri-tjetrin për argumentimet që japin. Përforcimi: Mund t’iu kërkoj nxënësve të krijojnë tabela pjesëtimi për të gjithë numrat nga 1 deri në 50, si te veprimtaria e hyrjes.				
Vlerësimi				
Detyrat e dhëna për punë të pavarur: Nxënësit duhet të punojnë si tek ushtrimi që bënë në klasë, për numrat: 24, 75, 32.				

Fusha Matematikë	Lënda Matematikë	Shkalla III	Klasa VI
Tema mësimore: Strategjitë e kryerjes me mend për pjesëtimin e në numri dyshifror me një numër njëshifror – Eksplorojmë		Situata e të nxënësve: Përfundon njohuritë për pjesëtimin.	
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: • pjesëton numrat me dy shifra me numrat me një shifër, përfshirë rastet me mbetje; • shpjegon pse zgjedh një metodë të caktuar për të realizuar një veprim dhe argumenton pse kjo metodë jep rezultat; • parashtron, vlerëson dhe ripunon hipotezat, shpjegon dhe argumenton metodat, arsyeton strategjitë, rezultatet ose përfundimet.		Fjalët kyçe: • Plotpjesëtim • Pjesëtim • Mbetje	
Burimet: libri i nxënësit	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare Fizikë Kimi		
Metodologjia, teknikat e përdorura, veprimtaritë e nxënësve			
Organizimi i orës së mësimi			
Parashikimi i të nxënësve: Mendo – diskuto Pyes nxënësit: Çfarë karakteristikash ka “një udhëzues i mirë përsëritjeje”? Të ndarë në çifte ose grupe të vogla, nxënësit duhet të bëjnë një listë karakteristikash. Përdor shembuj të një udhëzuesi përsëritjeje për të ndihmuar nxënësit. Karakteristikat mund të përfshijnë: • fjalor të rëndësishëm me përkufizime; • shembuj për zgjidhje problemash; • shembuj për nxënësit që të verifikojnë përgjigjet; • e kështu me radhë. Rendis karakteristikat në dërrasën e zezë. Kjo u jep nxënësve një strukturë që ata mund ta përdorin në këtë veprimtari.			
Ndërtimi i njohurive të reja: Hulumtim – shqyrtim i përbashkët – punë në grup Nxënësit punojnë në grupe, mbajnë shënime dhe hartojnë një variant të parë për një udhëzues përsëritjeje.			
Përfundimi: Grupet shkëmbejnë udhëzuesit e përsëritjes që kanë hartuar. I nxis nxënësit të përdorin kriteret e renditura në hyrje. I kërkoj secilit grup të shkruajë dy arritje dhe një çështje që ka nevojë të zhvillohet më tej.			
Vlerësimi. Vlerësoj grupin më të mirë të nxënësve.			
Detyrat e dhëna për punë të pavarur: Nxënësit duhet të paraqesin udhëzuesin në formën e një posteri, ku të përfshihen të gjitha njohuritë e marra në këtë kapitull.			

Fusha Matematikë	Lënda Matematikë	Shkalla III	Klasa VI
Tema mësimore: Mbledhja dhe zbritja duke përafëruar numrat –Zbulojmë duke punuar		Situata e të nxënësve: Thellon njohuritë për vetitë e mbledhjes dhe zbritjes.	
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: • mbledh ose zbret një shumëfish të afërt me 10, 100 ose 1000, dhe më pas korrigjon përfundimin, për shembull: $3\,127 + 4\,998$; $5\,678 - 1\,996$; • mbledh ose zbret numra dhjetorë me 1 shifër pas presjes, shumëfisha të afërt me 1, për shembull $5,6 + 2,9$; $13,5 - 2,1$.		Fjalët kyçe: • Shumë • Ndryshesë • Përafrim	

Burimet: libri i nxënësit	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare Fizikë Kimi Gjeografi
Metodologjia, teknikat e përdorura, veprimtaritë e nxënësve	
Organizimi i orës së mësim	
Parashikimi i të nxënit: Mendo – krijo dyshe – diskuto Shkruaj në dërrasë $199 + 355 =$. Nxënësit duhet të punojnë në dyshe. I dëgjoj një nga një dhe shoh se cilët janë të aftë të përshkruajnë mirë strategjitë e tyre. E përsërit për: $3\,723 - 1\,998$ dhe $7,2 + 5,9$. Paraqes strategjitë në tabelë: $199 + 355 = (200 - 1) + 355 = 200 + 355 - 1 = 555 - 1 = 554$ $3\,723 - 1\,998 = 3\,723 - 2\,000 + 2 = 1\,723 + 2 = 1725$ $7,2 + 5,9 = (7 + 0,2) + (6 - 0,1) = (7+6) + (0,2 - 0,1) = 13 + 0,1 = 13,1$ Ndërtimi i njohurive të reja: Hulumtim – shqyrtim i përbashkët Nxënësit plotësojnë në mënyrë të pavarur ushtrimet në librin e nxënësit. Njëri nga nxënësit kryen llogaritjen, tjetri e kontrollon. Secili prej tyre përshkruan strategjinë përpara se ta shkruajë në tabelë. Strategjia më e mirë për disa shembuj mund të jetë numërimi. Gjithashtu, duhet të pranoj me mend edhe ndonjë metodë tjetër. Përforcimi: Një nxënës nga secili çift duhet të bëjë llogaritjen për shokun/shoqen. Llogaritja duhet të jetë e njëjtë me atë në librin e nxënësit. Kjo gjë përsëritet katër herë. Zgjedh dy shembuj që t'i realizojë e gjithë klasa. Për secilën llogaritje, nxënësit duhet t'i shpjegojnë me kujdes strategjitë e tyre.	
Vlerësimi: Vlerësoj nxënësit për mënyrën si plotësuan librin e nxënësit dhe argumentimin e përgjigjeve.	
Detyrat e dhëna për punë të pavarur: Nxënësit duhet të shkruajnë problema me fjalë që të përfshijnë shumëfisha të afërt, të cilat zgjidhen me anë të strategjive të mësuara në këtë mësim. Ata duhet të përdorin shembuj nga jeta e përditshme, p.sh. paratë ose pesha.	

Fusha Matematikë	Lënda Matematikë	Shkalla III	Klasa VI
Tema mësimore: Mbledhja dhe zbritja duke përafëruar numrat –Eksplorojmë		Situata e të nxënit: Thellon njohuritë për kuptimin e mbledhjes.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - shpjegon pse zgjedh një metodë të caktuar për të realizuar një veprim dhe argumenton që kjo metodë jep rezultat; - nga informacioni ekzistues, nxjerr një informacion të ri dhe kupton se nga një pjesë e informacionit rrjedh një informacion tjetër; - kupton dhe zgjidh problema me fjalë.		Fjalët kyçe: - Mbledhje - Zbritje - Përafrim	
Burimet: libri i nxënësit	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare Fizikë Kimi		
Metodologjia, teknikat e përdorura, veprimtaritë e nxënësve			
Organizimi i orës së mësim			
Parashikimi i të nxënit: Mendo – krijo dyshe – diskuto Shtroj pyetjen: Unë bleva një revistë sportive dhe një revistë me gjëgjëza. Sa shpenzova? U jap nxënësve kohë të bëjnë llogaritjet. U kërkoj të mbajnë përpara minitabelat që të shikoj përgjigjet. Zgjedh një nga nxënësit të përshkruajë strategjinë që ka përdorur. Nëse ndonjë nga nxënësit ka bërë gabim, i kërkoj të tregojë se si e ka bërë llogaritjen, me qëllim që të gjejë se ku ka gabuar. Shtroj një problemë:			

Unë shkoj në dyqan me 23,55 euro dhe blej një revistë, e cila kushton 2,5 euro. Sa euro më mbeten? Kujtoj rregullën e vendosjes së presjes nën presje kur kryejmë në shtyllë mbledhjet dhe zbritjet. Ndërtimi i njohurive të reja: Hulumentim – shqyrtim i përbashkët Nxënësit punojnë në dyshe dhe me radhë zgjidhin problemat me fjalë. Problemën duhet ta shkruajnë vetëm pasi të kenë bërë llogaritjen dhe të përshkruajnë strategjinë që kanë përdorur. Gjatë punës së nxënësve me këtë veprimtari, mbledh disa shembuj që mund t'i përdor në përforsimin e të nxënës. Përforsimi: Ftoj një nxënës përpara klasës, i cili zgjidh një nga problemat që ka hartuar ai vetë. Nxënësit duhet të punojnë në dyshe për ta zgjidhur problemën dhe të tregojnë se si e kanë zgjidhur. E përsëris këtë me disa nga problemat që kam parë. Vlerësimi: Vlerësoj nxënësit për argumentimin e rrugës së ndjekur për zgjidhjen e problemeve. Detyrat e dhëna për punë të pavarur: Nxënësit mund të vizitojnë dyqane dhe të hartojnë problema me fjalë, duke përdorur çmime reale.
--

Fusha Matematikë	Lënda Matematikë	Shkalla III	Klasa VI
Tema mësimore: Veprimet me mend – Përmbledhim		Situata e të nxënit: Thellon njohuritë për veprimet me numrat me presje.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - përdor vendvlerën dhe faktet e numrave për të mbledhur dhe zbritur numrat e mundshëm me dy shifra, mbledh dhe zbret shumëfishat me tri shifra të dhjetës dhe të çifteve me presje dhjetore, për shembull: $560 + 270$; $2,6 + 2,7$; $0,78 + 0,23$; - përdor vendvlerën dhe faktet e shumëfishimit për të shumëzuar ose pjesëtuar me mend, për shembull: $0,8 \times 7$; $4,8 : 6$.		Fjalët kyçe: - Llogarit - Përafron - Shumë - Prodhim	
Burimet: libri i nxënësit	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare		
Metodologjia, teknikat e përdorura, veprimtaritë e nxënësve			
Organizimi i orës së mësimit			
Parashikimi i të nxënit: Mendo – krijo dyshe – diskuto Kopjoj në dërrasë tabelën që gjendet tek ushtrimi 1 në librin e nxënësit. Ndaj klasën në grupe me nga katër ose pesë nxënës dhe organizoj me ta një lojë. Hedh zarin. Grupet duhet të zgjedhin se ku ta vendosin shifrën. Ata duhet të vendosin një shifër pas çdo hedhjeje të zarit. Me t’u vendosur shifra, ajo nuk mund të lëvizë më. Pas nëntë hedhjeve të zarit, grupet mbledhin shumën e përgjithshme. Fitues është grupi me përgjigjen më afër numrit 100. Pyes klasën: Çfarë strategjie zgjodhët? E përsëris lojën aq herë sa është e nevojshme.			
Ndërtimi i njohurive të reja: Hulumentim – shqyrtim i përbashkët – punë në grupe Nxënësit mund të luajnë me njëri-tjetrin në grupe me nga katër ose pesë nxënës, duke e hedhur zarin me radhë. Organizoj një nga lojërat me secilin nga grupet. Shënoj strategjitë që përdorin nxënësit si për vendin e shifrës, ashtu edhe për kryerjen e veprimeve			
Përforcimi: Në minitabelat e tyre, nxënësit kopjojnë tabelën e ushtrimit 2 në librin e nxënësit. Hedh zarin gjashtë herë. Shkruaj rezultatin për çdo herë. Kërkoj prej grupeve të zgjedhin se ku ta vendosim shifrën për të dhënë: (a) rezultatin më të mirë; (b) rezultatin më të keq.			
Vlerësimi: Vlerësoj nxënësit për punën në grup.			
Detyrat e dhëna për punë të pavarur. Nxënësit duhet të përsërisin detyrën e klasës në shtëpi.			

Fusha Matematikë	Lënda Matematikë	Shkalla III	Klasa VI
Tema mësimore: Veprimet me mend – Përforcojmë		Situata e të nxënit: Thellon njohuritë për veprimet me numra me presje.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: • zgjedh strategji të përshtatshme dhe efikase të veprimeve me mend ose me shkrim për të realizuar një veprim (mbledhje, zbritje, shumëzim ose pjesëtim); • vlerëson dhe përafron kur llogarit, për shembull: përdor rrumbullakimin dhe kontrollon rezultatin; • shpjegon pse zgjedh një metodë të caktuar për të realizuar një veprim dhe argumenton që kjo metodë jep rezultat.		Fjalët kyçe: • Numri sekret. • Si llogaritet... • Pse është e saktë?	
Burimet: libri i nxënësit	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare		
Metodologjia, teknikat e përdorura, veprimtaritë e nxënësve			
Organizimi i orës së mësimi			
Parashikimi i të nxënit: Mendo – diskuto Organizoj në klasë lojën me etiketa. I jap secilit nxënës nga një skedë. Në qoftë se janë më tepër nxënës se etiketa, disa prej tyre mund të luajnë në çift. Zgjedh një nxënës për të lexuar pyetjen në etiketën e tij, duke thënë: “Cili është ...?” Nxënësit t’i përgjigjen kësaj pyetjeje duke u ngritur në këmbë dhe duke thënë: “Unë jam... Cili është...?” Vazhdojmë kështu derisa etiketa t’i kthehet nxënësit të parë. Mat kohën që të shoh se sa shpejt mund ta plotësojnë nxënësit këtë tabelë. E përsëris lojën për të parë nëse nxënësit luajnë më shpejt herën e dytë. Ndërtimi i njohurive të reja: Hulumtim – shqyrtim i përbashkët U kërkoj nxënësve të krijojnë lojën e tyre. Ata mund ta bëjnë lojën me çiftet e tjera në klasë dhe të gjykojnë nëse ajo jep rezultat. Përforcimi: Zgjedh një nga kompletet e etiketave të krijuara nga nxënësit. Organizoj me këtë komplet një lojë me të gjithë nxënësit e klasës. Ftoj nxënësit të vlerësojnë sa efikase është kjo lojë për të provuar njohuritë dhe idetë e marra në këtë kapitull. Nxënësit mund të krijojnë komplete të ndryshme letrash, në mënyrë që të përqendrohen në çështje specifike, siç janë dyfishimi dhe gjysma.			
Vlerësimi: Vlerësoj nxënësit për punën në grup.			
Detyrat e dhëna për punë të pavarur: Nxënësit duhet të përgatitin një poster ose broshurë, ku të paraqesin njohuritë e marra në këtë kapitull.			

Emri _____ Mbiemri _____

Test përfundimtar për tremujorin e parë

Klasa e 6-të.

Grupi A

1. Çfarë tregon shifra 4 te numërorët e mëposhtëm?

a) 200 341 _____

b) 130,24 _____

(2 pikë)

2. Rendit nga më i vogli te më i madhi numrat e mëposhtëm.

a) 245; 32,2; 31,08; 437

(6 pikë)

b) -4 ; 0 ; 23 ; -15

3. Rrumbullakos në dhjetëshen, qindëshen, mijëshen më të afërt. (3 pikë)

Numri	Dhjetëshe	Qindëshe	Mijëshe
1 275			

4. Rrumbullakos në të plotën, të dhjetën më të afërt. (2 pikë)

Numri	Të plotën	Të dhjetën
24, 472		

5. Krahaso.

1 284 ___ 2 452 ; $0,7$ ___ $0,25$; -395 ___ -432 ; 45% ___ $0,35$

(4 pikë)

6. Kryej veprimet.

(4 pikë)

a) $24 \cdot 100 =$

b) $2,85 \cdot 1000 =$

c) $6000 : 100 =$

d) $493,45 : 100 =$

7. Plotëso vargun dhe me tri kufiza.

(6 pikë)

a) $2 ; 4 ; 6 ; 8 ; 10 ;$ _____ ; _____ : _____ .

b) $1 : 2 ; 3 ; 5 ; 8 ;$ _____ ; _____ : _____ .

8. Cili është numri më i madh që mund të ndërtoni me shifrat 3,0 ,9,7?

Po numri më i vogël?

(2 pikë)

9. Shkruaj të gjithë numrat e thjeshtë që ndodhen midis 40 dhe 50. (3 pikë)

10. Paraqit si prodhim numrash të thjeshtë.

(4 pikë)

a) $24 =$

b) $120 =$

11. Babai i Artës do të lyejë shtëpinë me bojë të gjelbër, duke përdorur bojë të verdhë dhe blu në raportin 2:3.

Nëse për dhomën e Artës ai përdori 6 kuti me bojë blu, sa kuti me bojë të verdhë ka përdorur?

(1 pikë)

Nëse për të lyer gjithë shtëpinë u deshën gjithsej 45 kuti me bojë, sa prej tyre kanë qenë me bojë të verdhë dhe sa me bojë blu?

(3 pikë)

12. Kryej veprimet.

(4 pikë)

a) $12,6 \cdot 5 =$

b) $57,23 \cdot 7 =$

c) $45,9 : 3 =$

d) $79 : 5 =$

13. Kryej veprimet duke përafruar.

(2 pikë)

a) $132 \cdot 99 =$

b) $456 + 102 =$

14. Në një dyqan veshjesh për fëmijë, një bluzë kushton 2000 lekë dhe një palë këpucë 2500 lekë. Me rastin e festave të fundvitit, shitësi bëri ulje 15% për bluzat dhe 10% për këpucët.

Nëse do të blej me ulje një bluzë dhe një palë këpucë, sa lekë duhet t'i jap unë shitësit?

(4 pikë)

4	5	6	7	8	9	10
0-12	13-19	20-26	27-32	33-38	39-44	45-50

Emri _____ Mbiemri _____

Test përfundimtar për tremujorin e parë

Klasa e 6^{të}.

Grupi B

1. Çfarë tregon shifra 3 te numërorët e mëposhtëm?

a) 200 341 _____

b) 130,24 _____ (2 pikë)

2. Rendit nga më i vogli te më i madhi numrin e mëposhtëm.

a) 145 ; 35,2 ; 31,08 ; 737 (6 pikë)

b) -5 ; 0 ; 43 ; -15

3. Rrumbullakos në dhjetëshen, qindëshen, mijëshen më të afërt. (3 pikë)

Numri	Dhjetëshe	Qindëshe	Mijëshe
1 378			

4. Rrumbullakos në të plotën, të dhjetën më të afërt. (2 pikë)

Numri	Të plotën	Të dhjetën
12,492		

5. Krahaso.

1 284 ___ 2 952 ; 0,8 ___ 0,75 ; -195 ___ -432; 75% ___ 0,85 (4 pikë)

6. Kryej veprimet. (4 pikë)

a) $74 \cdot 100 =$

b) $2,95 \cdot 1000 =$

c) $2000 : 100 =$

d) $493,95 : 100 =$

7. Plotëso vargun edhe me tri kufiza. (6 pikë)

a) 1 ; 3 ; 5 ; 7 ; 9 ; _____ ; _____ : _____ .

b) 1 : 3 ; 4 ; 7 ; 11 ; _____ ; _____ : _____ .

8. Cili është numri më i madh që mund të ndërtoni me shifrat 9,0 ,2,7?

Po numri më i vogël? (2 pikë)

9. Shkruaj të gjithë numrat e thjeshtë që ndodhen midis 50 dhe 60. (3 pikë)

10. Paraqit si prodhim numrash të thjeshtë. (4 pikë)

a) $32 =$

b) $150 =$

11. Babai i Artës do të lyejë shtëpinë me bojë të gjelbër, duke përdorur bojë të verdhë dhe blu në raportin 2:5.

Nëse për dhomën e Artës, ai përdori 10 kuti me bojë blu, sa kuti me bojë të verdhë ka përdorur? (1 pikë)

Nëse për të lyer të gjithë shtëpinë u deshën gjithsej 70 kuti me bojë, sa prej tyre kanë qenë me bojë të verdhë dhe sa me bojë blu? (3 pikë)

12. Kryej veprimet. (4 pikë)

a) $12,7 \cdot 5 =$

b) $57,23 \cdot 8 =$

c) $95,4 : 6 =$

d) $69 : 5 =$

13. Kryej veprimet duke përafruar. (2 pikë)

a) $132 \cdot 101 =$

b) $456 + 99 =$

14. Në një dyqan veshjesh për fëmijë, një bluzë kushton 3000 lekë dhe një palë këpucë 3500 lekë. Me rastin e festave të fundvitit, shitësi bëri ulje 15% për bluzat dhe 10% për këpucët.

Nëse do të blej me ulje një bluzë dhe një palë këpucë, sa lekë duhet t'i jap shitësit? (4 pikë)

4	5	6	7	8	9	10
0-12	13-19	20-26	27-32	33-38	39-44	45-50

Tremujori i dytë

Fusha: Matematikë		Lënda: Matematikë	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Mbledhja dhe zbritja (Diskutojmë së bashku)			Situata e të nxënët: Luajmë me germa. Mbledhim duke përdorur germa në vend të numrave.	
Rezultatet e të nxënët të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - mbledh një numër dyshifrorë me një numër tjetër dyshifror; - mbledh një numër trashifror me një numër tjetër trashifror; - mbledh një numër trashifror me një numër dyshifror.			Fjalët kyçe: rend, rigrupim, mbledhje, zbritje, numër dyshifror, numër trashifror.	
Burimet: teksti, fletorja e punës.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: gjuha dhe komunikimi, artet, sportet, teknologjia, shoqëria dhe mjedisi.		
Metodologjia, teknikat e përdorura, veprimtaritë e nxënësve				
Organizimi i orës së mësimit				
Parashikimi i të nxënët: Mendo – krijo dyshe – diskuto				
Nxënësit njihen me situatën e të nxënët, e cila paraqitet në libër. Ata shohin një mbledhje në shtyllë, e cila përfaqëson mbledhjen e një numri trashifror me një numër dyshifror. Barazimi shkruhet në tabelë. Nxënësit udhëzohen të punojnë në dyshe dhe të diskutojnë rreth vlerës që mund të ketë secila germë e përdorur në këtë barazim. Gjatë diskutimit në dyshe mësuesi i kujton nxënësit që secila germë përfaqëson një shifër të ndryshme, pra germa N, J dhe E janë shifra të ndryshme. Gjithashtu një shkronjë përfaqëson gjithmonë të njëjtën shifër, pavarësisht nga vendi ku ndodhet.				
Nxënësit lihen të diskutojnë në dyshe për rreth 5 minuta.				
Më pas shtrohen pyetjet:				
- Një dhe tri bëjnë pesë. Çfarë do të thotë kjo? - Si mendoni çfarë shifre mbart germa E? - Po germa I çfarë shifre mbart? - Si mund të arrijmë në gjetjen e shifrave që mbartin këto germa?				
Jepen disa përfundime nga dyshe të ndryshme nxënësish.				
Ndërtimi i njohurive të reja: Hulumtim – shqyrtim i përbashkët				
Mësuesi shkruan në tabelë një mbledhje: 868+27.				
Shtrohen pyetjet:				
- Çfarë metode mund të përdorim për kryerjen e këtij veprimi? - Cila është mënyra më e thjeshtë për ta kryer këtë veprim?				
Merren mendimet e nxënësve. Ata zhvillojnë në fletoren e tyre veprimin me anë të metodës së mbledhjes në shtyllë.				
Nxënësit udhëzohen që të argumentojnë se si e kanë kryer veprimin në shtyllë dhe se çfarë kanë pasur parasysh për kryerjen e mbledhjes së dhënë në shtyllë.				
Drejtohet pyetja:				
A mund të nxjerrim një përfundim rreth vëzhgimeve që kemi kryer?				
Pasi dëgjon nxënësit mësuesja shkruan në tabelë hapat për njehsimin e shumës së numrave 3-shifrorë me numra 2-shifrorë.				
Hapi i parë: Vendosim numrat në shtyllë sipas rendeve dhe mbledhim njëshet.				
Hapi i dytë: Mbledhim dhjetëshet.				
Hapi i tretë: Mbledhim qindëshet.				
Mësuesja pyet: Në cilin përfundim arrijmë kur mbledhim shifrat që tregojnë rendin e njësheve?				
Nxënësi përgjigjet: 8 njëshe + 7 njëshe = 15 njëshe. Meqenëse numri i njësheve është më shumë se 10, duhet të rigrupojmë 15 njëshe në 1 dhjetësh + 5 njëshe.				
Kështu veprojmë dhe me rendet e tjera.				

Mbledhja paraqitet e gjitha në tabelë.

Më pas nxënësit punojnë në mënyrë të pavarur dhe duke zbatuar metodën e mbledhjes dhe zbritjen në shtyllë ushtrimet:

- Kryej veprimet.

$$682+632= \quad 312+976= \quad 312+601= \quad 140+927= \quad 591+274=$$

$$135 - 52= \quad 126 - 33= \quad 157 - 81= \quad 149 - 67= \quad 780 - 60=$$

Ushtrimet diskutohen në tabelë. Theksohet zbritja në shtyllë, duke zbatuar të njëjtat rregulla si në mbledhjen në shtyllë.

Përforcimi: Rishikim në dyshe

Në këtë fazë nxënësit duhet të punojnë ushtrimin:

- Gjej shifrat që mungojnë.

$$_92+_ _ _ = 849 \quad 7_5+_2_ = 949 \quad _ _ 8+2_3=871 \quad 437+_ _ 3=550$$

Fillimisht nxënësit punojnë në mënyrë të pavarur dhe më pas shkëmbejnë fletoren me shokun/shoqen e bankës për të parë se si e kanë zgjidhur ushtrimin, dhe metodën që secili ka përdorur për zgjidhjen e ushtrimit.

Disa dyshe diskutojnë zgjidhjen në tabelë.

Vlerësimi: Gjatë kësaj ore mësimi, nxënësit vlerësohen për bashkëpunimin, përcaktimin e rendeve, zbatimin e hapave me rigrupim të rendeve, mbledhjen e numrave treshifrorë në shtyllë dhe zbritjen e tyre. Ata vlerësohen edhe për mendimet argumentuese në kryerjen e veprimeve.

Detyrë për punë të pavarur: Pjesa përkatëse në fletoren e punës jepet për t'u punuar në shtëpi.

Fusha: Matematikë		Lënda: Matematikë	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Mbledhja dhe zbritja e numrave treshifrorë (Zbulojmë)			Situata e të nxënit: Luajmë me numrat dhjetorë.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: mbledh një numër dyshifror me një numër tjetër dyshifror;mbledh një numër treshifror me një numër tjetër treshifror;mbledh një numër treshifror me një numër dyshifror;mbledh ose zbret numra me një ose dy shifra pas presjes dhjetore.			Fjalët kyçe: rend, rigrupim, mbledhje, zbritje, numër dyshifror, numër treshifror, numër dhjetor, presje.	
Burimet: teksti, fletorja e punës.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:gjuha dhe komunikimi, artet, sportet, teknologjia, shoqëria dhe mjedisi.		
Metodologjia, teknikat e përdorura, veprimtaritë e nxënësve				
Organizimi i orës së mësimi				
Parashikimi i të nxënit: Diskutimi i njohurive paraprake				
Së bashku me nxënësit bëhet një përsëritje e njohurive të marra në temën paraardhëse. Shtrohen pyetjet: ➤ Çfarë metode zgjidhëm për mbledhjen apo zbritjen e numrave me më shumë se dy shifra? ➤ Çfarë kishim parasysh gjatë mbledhjes në shtyllë? ➤ Cilat njohuri na ndihmuan për të arritur në përfundimin e kërkuar? Një nxënës jep në tabelë një shembull të mbledhjes së një numri treshifror me një numër dyshifror.				

Ndërtimi i njohurive të reja: Kërko – hulumto

Në vijim nxënësit udhëzohen të shohin shembullin në libër dhe të gjejnë shumën e dy numrave dhjetorë: $56,8 + 24,5$.

Ata studiojnë për 3 minuta shembullin dhe pastaj rendisin njohuritë që ndihmojnë për të gjetur këtë shumë. Pas kësaj, diskutohet së bashku mënyra e mbledhjes së dy numrave dhjetorë.

Shtrohen pyetjet:

- Cila metodë është më e lehtë për mbledhjen e numrave dhjetorë?
- Çfarë duhet të kemi parasysh kur i vendosim numrat dhjetorë në shtyllë për të kryer mbledhjen?
- Po përfundimi çfarë numri del? Ku e vendosim presjen në përfundim?

Mbledhja paraqitet edhe në tabelë, duke u zhvilluar me anë të metodës së mbledhjes në shtyllë.

Në të njëjtën formë diskutohet dhe zbritja e numrave dhjetorë: $125,8 - 11,4$

Përfundimi: Rishikim në dyshe

Nxënësit punojnë në mënyrë të pavarur ushtrimet e librit. Më pas disa prej tyre diskutohen në të gjithë klasën.

Gjatë zhvillimit të ushtrimeve në tabelë nxënësit pyeten nëse e kanë më të thjeshtë për t'i kryer veprimet me mend apo me shkrim. Në cilin rast ishte më e thjeshtë të kryeshin veprimet me mend?

Nxënësit udhëzohen të krijojnë vetë ushtrime me mbledhje dhe zbritje numrash dhjetorë dhe më pas t'i japin shokut/shoqes së bankës për ta kryer mbledhjen ose zbritjen me një nga metodat e mësuara. Një dyshe diskuton ushtrimin e tyre në tabelë.

Vlerësimi: Gjatë kësaj ore mësimi, nxënësit vlerësohen për bashkëpunimin, përcaktimin e rendeve, zbatimin e hapave me rigrupim të rendeve, mbledhjen e numrave treshifrorë në shtyllë dhe zbritjen e tyre, si dhe për mbledhjen e zbritjen e numrave dhjetorë në shtyllë. Ata vlerësohen edhe për mendimet argumentuese në kryerjen e veprimeve.

Detyrë për punë të pavarur. Pjesa përkatëse në fletoren e punës jepet për t'u punuar në shtëpi.

Fusha: Matematikë		Lënda: Matematikë		Shkalla: III		Klasa: VI	
Tema mësimore: Mbledhja dhe zbritja e numrave treshifrorë (Eksplorojmë)				Situata e të nxënit: Të zbulojmë më shumë mbi numrat dhe shifrat që i përbëjnë ato.			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: • mbledh një numër dyshifror me një numër tjetër dyshifror; • mbledh një numër treshifror me një numër tjetër treshifror; • mbledh një numër treshifror me një numër dyshifror; • mbledh ose zbret numra me një ose dy shifra pas presjes dhjetore.				Fjalët kyçe: rend, rigrupim, mbledhje, zbritje, numër dyshifror, numër treshifror, numër dhjetor, presje.			
Burimet: teksti, fletorja e punës.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: gjuha dhe komunikimi, artet, sportet, teknologjia, shoqëria dhe mjedisi.					
Metodologjia, teknikat e përdorura, veprimtaritë e nxënësve							

Organizimi i orës së mësimi

Parashikimi i të nxënës: Imagjinatë e drejtuar

Shtrohet situata: Gjeni numrat që mungojnë. $746,32 + \Delta 8\Delta, \Delta 5 = 13\Delta 6,9\Delta$.

Për t'i dhënë zgjidhje kësaj situatë nxënësit në fillim punojnë në dyshe. Mësuesja ndjek arsyetimin në çdo dyshe dhe nxit diskutimin e tyre nëpërmjet pyetjeve apo sugjerimeve të ndryshme, si p.sh.:

- Si vepruat për të gjetur shifrat e panjohura?
- Cilat shifra gjetët në fillim?
- Si ju ndihmojnë ato për të gjetur shifrat në vazhdim?

Dëgjohen përgjigje të ndryshme në disa nga dyshet e formuara. Veçohen përgjigjet e sakta.

Ndërtimi i njohurive të reja: Marrëdhënie pyetje-përgjigje

Nxënësit udhëzohen të studiojnë ushtrimin 1 dhe 2 në librin e nxënësit. Shohim që jepen shifrat 4, 5, 6, 7, 8 dhe 9. Klasën e ndajmë në grupe me nga 4-5 nxënës secili grup. Disa grupe duhet të krijojnë numra treshifrorë me shifrat e dhëna dhe të gjejnë shumën më të vogël të mundshme. Ndërsa disa grupe të tjera duhet të formojnë numra treshifrorë dhe të gjejnë shumën më të madhe të mundshme.

Gjatë punës së grupeve për zgjidhjen e ushtrimit, mund të shtrohen pyetjet:

- Çfarë duhet të kemi parasysh për formimin e numrave treshifrorë që pasi të mbledhen të japin shumën më të vogël?
- Po për numrat që pasi të mbledhen të japin shumën më të madhe?
- Nga do ta nisni punën?

Nxënësit gjatë punës së tyre u përgjigjen të gjitha pyetjeve të drejtuara nga mësuesi dhe më pas japin zgjidhjen e saktë. Përfundimi i çdo grupi e paraqet zgjidhjen në tabelë. Diskutohen ndryshimet midis metodës së zgjidhjes dhe përfundimit të të dyja kërkesave të dhëna.

Përfundimi: Puno, mendo, diskuto në dyshe

Nxënësit punojnë në mënyrë të pavarur ushtrimet 3 dhe 4 në librin e nxënësve. Më pas diskutohen disa raste nga këto ushtrime me të gjithë klasën.

Nxënësit udhëzohen të krijojnë vetë ushtrime me mbledhje dhe zbritje numrash dhjetorë që i përafrojnë një numri të caktuar. (Shifrat që duhet të përdoren u jepen paraprakisht.) Më pas ata ia japin numrin shokut/shoqes së bankës për të krijuar numrat që duhen dhe për të gjetur mbledhjen ose zbritjen që përafrojnë me numrin që ata vetë kanë caktuar. Një dyshe diskuton ushtrimin e tyre në tabelë.

Shembull: Jepen shifrat 1, 2, 8, 7, 6 dhe shuma e dy numrave dhjetorë me një shifër pas presjes që shumën e kanë sa më afër numrit 9.

Përfundimi: $7,8+1,2=9$

Vlerësimi: Gjatë kësaj ore mësimi, nxënësit vlerësohen për bashkëpunimin, mbledhjen dhe zbritjen e numrave dhjetorë në shtyllë, gjetjen e shifrave që mungojnë në mbledhjen apo zbritjen e numrave dhjetorë, si dhe krijimin e situatave të ndryshme problemore. Ata vlerësohen edhe për mendimet argumentuese në kryerjen e veprimeve.

Detyrat për punë të pavarur: Pjesa përkatëse në fletoren e punës jepet për t'u punuar në shtëpi.

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Mbledhja dhe zbritja e parave (Zbulojmë)		Situata e të nxënës: Mbledhim dhe zbresim paratë duke formuar numra me shifra nga 0 deri në 9. Shifrat shkruhen në etiketa.	
Rezultatet e të nxënës të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: ● mbledh ose zbret numra me numër të njëjtë ose të ndryshëm shifrash pas presjes dhjetore, duke përfshirë dhe shumat e parave.		Fjalët kyçe: mbledhje, zbritje, para.	

Burimet: teksti, fletorja e punës.	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: gjuha dhe komunikimi, artet, sportet, teknologjia, shoqëria dhe mjedisi.				
Metodologjia, teknikat e përdorura, veprimtaritë e nxënësve					
Organizimi i orës së mësimit					
Parashikimi i të nxënit: Diskutim mbi njohuritë paraprahe Kjo fazë nis me paraqitjen e temës së re në mënyrë që nxënësit të kujtojnë njohuritë e marra dhe t'i përdorin ato në këtë temë. Jepet veprimi në shtyllë: 53,72 + 14,68 68,40 Shtrohen pyetjet: ➤ Si kemi vepruar për të kryer mbledhjen? ➤ Si janë vendosur vendvlerat e njëjta? ➤ Po presja te mbledhorët dhe shuma si është vendosur? ➤ A ndikon në ndryshimin e rezultatit nëse këto numra do të tregonin euro? Dëgjohen përgjigjet e nxënësve.					
Ndërtimi i njohurive të reja: Puno, mendo, diskuto në dyshe Nxënësit udhëzohen të studiojnë ushtrimin në librin e nxënësve. Ndërkohë atyre u paraqiten etiketa me numra nga 0 deri në 9. Mësuesja vizaton në dërrasën e zezë tabelën:					
€ (Euro)	Dhjetëshe	Njëshe	,	Të dhjetat	Të qindtat
+			,		
			,		
			,		
Nxënësit dalin para klasës një e nga një dhe tërheqin një nga etiketat. Shifrën e tërhequr e vendosin në një nga kutitë bosh të vizatuara në tabelë, në mënyrë që të krijojnë numra dhjetorë dhe më pas të kryejnë mbledhjen e tyre. Ndërsa secili nxënës vendos shifrën e tij, shtrohet pyetja: Çfarë përfaqëson kjo shifër? Për shembull: “Një 6 te kolona e dhjetësheve përfaqëson 60 euro” ose “një 3 në kolonën e të qindtave përfaqëson 3 qindarka”. Pasi nxënësi i fundit vë shifrën e tij, nxënësve u kërkohet të përllogarisin rezultatit, duke përdorur metodën me shkrim. Ata shpjegojnë strategjinë e tyre, ndërsa bëjnë veprimet. Përsëritet kjo veprimtari për të krijuar një veprim zbritjeje.					
Përforcimi: Rishikim në dyshe Në këtë fazë nxënësit u përgjigjen pyetjeve: ➤ A është mënyra e mbledhjes së numrave dhjetorë njësoj si mbledhja e numrave natyrorë? ➤ A është mënyra e zbritjes së numrave dhjetorë njësoj si zbritja e numrave natyrorë? Nxënësit nxiten të argumentojnë përgjigjet e tyre. Më pas nxënësit punojnë në dyshe problemat e mëposhtme. 1. Andi përshkoi në këmbë 6,2 km ditën e hënë. Ai eci 1,5 km më pak ditën e martë se ditën e hënë. Sa km përshkoi Andi të dyja ditët së bashku?					

2. Xhami mbrojtës i një celulari kushton 1,58 €, ndërsa këllëfi i tij kushton 3,48 €. Sa euro duhen paguar për të blerë xhamin mbrojtës dhe këllëfin e celularit?

Problemat diskutohen në fund me të gjithë klasën.

Vlerësimi: Gjatë kësaj ore mësimi, nxënësit vlerësohen për bashkëpunimin, mbledhjen dhe zbritjen e parave, si dhe për zgjidhjen e situatave të ndryshme problemore. Ata vlerësohen edhe për mendimet argumentuese në kryerjen e veprimeve.

Detyrë për punë të pavarur: Pjesa përkatëse në fletoren e punës jepet për t'u punuar në shtëpi.

Fusha: Matematikë		Lënda: Matematikë	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Mbledhja dhe zbritja e parave (Eksplorojmë)			Situata e të nxënit: Në postë, në dyqan, në internet, në klasë.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: mbledh ose zbret numra me numër të njëjtë ose të ndryshëm shifrash pas presjes dhjetore, duke përfshirë dhe shumat e parave.			Fjalët kyçe: mbledhje, zbritje, para.	
Burimet: teksti, fletorja e punës.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: gjuha dhe komunikimi, artet, sportet, teknologjia, shoqëria dhe mjedisi.		
Metodologjia, teknikat e përdorura, veprimtaritë e nxënësve				
Organizimi i orës së mësimi				
Parashikimi i të nxënit: Përmbledhje e strukturuar				
Mësuesja u rikujton nxënësve hapat e zgjidhjes së problemave sipas skemës së mëposhtme.				
1. Lexoni me kujdes. - Çfarë kërkohet të gjejmë? - Çfarë informacioni jepet? - A ka informacion që nuk do ta përdorni gjatë zgjidhjes? (Problema nuk ka informacion të tepërt.)				
2. Planifikoni zgjidhjen. Cilën mënyrë do të zgjedhim për të planifikuar zgjidhjen? Hartojmë planin e zgjidhjes.				
3. Zgjidhni problemën. Si do ta zgjidhim problemën?				
4. Kontrolloni rezultatin. Si e kuptojmë që zgjidhja është e saktë?				
Më pas, ushtrimi 1 në librin e nxënësit diskutohet në tabelë, duke përdorur skemën e mësipërme.				
Ndërtimi i njohurive të reja: Rolet në grupet bashkëpunuese				
Nxënësit ndahen në grupe dhe secilit prej grupeve i caktohet një nga problemat 2, 3, 4, 5 në libër. Secilit nxënësi brenda grupit i caktohet një rol. Nxënësve u shpjegohen rolet një e nga një.				
Pyetësi paraqet detyrën grupit.				
Kontrolluesi merr masa që të gjithë anëtarët e grupit ta kuptojnë problemën dhe të përqendrohen në zgjidhjen e saj.				
Mbajtësi i kohës mban kohën e caktuar për zgjidhjen e problemës dhe siguron që secili anëtar i grupit të kryej detyrat në kohë.				

Nxitësi fton e nxit të tjerët të përgjigjen, i përgëzon ata për idetë e mira dhe u kërkon të thonë më shumë.
Raportuesi i paraqet idetë e grupit të vogël para gjithë klasës.
 Më pas aktivizohen disa grupe për të raportuar mbi zgjidhjen e problemës përkatëse.

Përforcimi: Shkëmbe një problemë

Nxënësit qëndrojnë të ndarë në grupe. Secilit grup i kërkohet të formulojë një problemë të ngjashme me problemën e parë dhe më pas t'ia kalojë për zgjidhje njërit prej grupeve të tjera.
 Grupeve u lihet pesë minuta për zgjidhjen e problemave dhe më pas aktivizohen disa grupe për të raportuar mbi zhvillimin e problemës.

Vlerësimi: Gjatë kësaj ore mësimi, nxënësit vlerësohen për përcaktimin e hapave të zgjidhjes së problemës, për argumentimin gjatë zgjidhjes së problemave, si dhe për kryerjen e detyrave të caktuara brenda grupit.

Detyrë për punë të pavarur: Pjesa përkatëse në fletoren e punës jepet për t'u punuar në shtëpi.

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Përdorimi i numrave negativë (Zbulojmë)		Situata e të nxënit: Luajmë në boshtin numerik. Matim temperaturën.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: gjen ndryshimin mes një numri të plotë pozitiv e negativ dhe mes dy numrave të plotë negativë në një kontekst si temperatura ose boshti numerik.		Fjalët kyçe: numër i plotë negativ, numër i plotë pozitiv, bosht numerik.	
Burimet: teksti, fletorja e punës.	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: gjuha dhe komunikimi, artet, sportet, teknologjia, shoqëria dhe mjedisi.		
Metodologjia, teknikat e përdorura, veprimtaritë e nxënësve			
Organizimi i orës së mësimi			
Parashikimi i të nxënit: Imagjinatë e drejtuar Shtrohet situata: “Na duhet të vendosim në boshtin numerik pikën A 2 njësi larg origjinës.” Nxënësit fillimisht punojnë në dyshe dhe paraqesin mënyrat e mundshme të vendndodhjes së pikës A në bosht. Pas pak minutash mësuesja aktivizon dy nxënës, të cilët kanë dhënë alternativa të ndryshme për ta paraqitur atë në tabelë. Pasi kanë përfunduar punën në tabelë mësuesja i drejtohet klasës. Cili nga shokët ka vepruar drejt? Dëgjoen përgjigjet dhe argumentet e nxënësve dhe në përfundim mësuesja thekson faktin se ekzistojnë dy vendndodhje për pikën tonë A me largesë 3 njësi nga 0: njëra në të djathtë dhe tjetra në të majtë të numrit 0. Pra në boshtin numerik në të dyja krahët e numrit 0 vendosen numra dhe secili prej tyre ka shenjën përkatëse: + ose -			
-2 0 +2			
Ndërtimi i njohurive të reja: Puno, mendo, diskuto në dyshe			
Në këtë fazë shtrohen pyetjet: - Nëse duam të vendosim një numër natyror në bosht, në cilin kah të zeros do ta vendosim? Ja një përgjigje e saktë që duhet të japin nxënësit: - Nëse duam të vendosim një numër natyror në bosht numërojmë në anë të djathtë të numrit 0 aq njësi sa tregon vlera e numrit. Më pas nxënësit i përgjigjen pyetjes: - Nëse duam të vendosim një numër me shenjë negative, në cilën anë të boshtit do ta vendosim? - Duke u orientuar nëpërmjet boshtit numerik ç'mund të thoni për numrat -3 dhe -9? - Cili prej tyre është më i madh? Pse?			

Më pas nxënësit diskutojnë ushtrimin 1 në librin e nxënësit. Pasi diskutohen përgjigjet e ushtrimit nxënësit punojnë në mënyrë të pavarur ushtrimet 2 dhe 3.

Përforcimi: Rishikim në dyshe

Pasi kanë plotësuar tabelën e ushtrimit 3 në fletore, nxënësve u kërkohet të punojnë në dyshe për të shkruar tri fakte nga tabela. Për shembull: “Në Londër është 43 gradë më ftohtë se në Omikan”. Faktet diskutohen në fund me të gjithë klasën.

Vlerësimi: Gjatë kësaj ore mësimi, nxënësit vlerësohen për vendosjen në boshtin numerik të numrave pozitivë dhe negativë, si dhe për krahasimin e numrave me shenjë, duke u bazuar nga vendndodhja në bosht.

Detyrë për punë të pavarur: Pjesa përkatëse në fletoren e punës jepet për t’u punuar në shtëpi.

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Përdorimi i numrave negativ (Eksplorojmë)		Situata e të nxënit: Luajmë me numrat.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimoreNxënësi/ja: - gjen shumën dhe ndryshesën e numrave me shenjë; - përcakton rregullin e mbledhjes dhe zbritjes së dy numrave me shenjë.		Fjalët kyçe: numër i plotë negativ, numër i plotë pozitiv, mbledhje, zbritje.	
Burimet: teksti, fletorja e punës.	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:gjuha dhe komunikimi, artet, sportet, teknologjia, shoqëria dhe mjedisi.		
Metodologjia, teknikat e përdorura, veprimtaritë e nxënësve			
Organizimi i orës së mësimi			
Parashikimi i të nxënit: Kërkim – hulumtim			
Mësuesja shkruan në tabelë disa numra dhe u kërkon nxënësve të shkruajnë të kundërtit e tyre. Duke theksuar që numrat e kundërt janë numra me largësi të njëjtë nga origjina e boshtit, po me shenjë të kundërt, p.sh.: -2 dhe +2. Pasi nxënësit kanë gjetur të kundërtat, mësuesja u kërkon që të gjejnë shumat për çdo çift të kundërtash. Nxënësit i gjejnë shumat, duke përdorur boshtin numerik. ➤ Çfarë tregon lëvizja djathtas në boshtin numerik? Po lëvizja majtas? ➤ Çfarë vini re? Si del rezultati i shumës së këtyre dy numrave? ➤ A mund të themi se shuma e të kundërtave është gjithmonë 0? Zhvillohet një diskutim me përgjigjet e nxënësve.			
Ndërtimi i njohurive të reja: Marrëdhëniet pyetje-përgjigje			
Në këtë fazë, nxënësit punojnë në dyshe ushtrimet e dhëna në libër dhe në përfundim duhet t’u përgjigjen pyetjeve: Si veprojmë për të mbledhur dy numra me të njëjtë shenjë? P.sh.: (-3) + (-5) = Si veprojmë për të gjetur shumën e dy numrave me shenjë të ndryshme? P.sh.: (-7) + (+6) = Po nëse duam të zbresim dy numra me shenjë si veprohet ? P.sh.: 5 – (-3) = Për t’iu përgjigjur pyetjeve mund të mbështeteni dhe te boshti numerik. Nxënësit diskutojnë përgjigjet e pyetjeve dhe më pas punojnë në dyshe ushtrimin: Kryeni veprimet duke përdorur boshtin numerik. 7+3= (-2) + (+2)= (-8)+(+4)= (-81)+(+8)= (-9)+(+11)= (+9)+(-2)= (+35)+(-10)= (-5)+(-1)= 0+(-5)= (-15)+(-7)=			

Përforsimi: Rishikim në dyshe

Edhe në këtë fazë nxënësit punojnë në dyshe. Ata krijojnë vetë ushtrime me mbledhje dhe zbritje të numrave me shenjë dhe më pas ia japin shokut/shoqes së bankës për të gjetur përfundimet. Gjithashtu ata i kërkojnë njëritjetrit të argumentojnë mënyrën se si e kryen veprimin. Aktivizohen disa dyshe për të diskutuar ushtrimet e tyre në tabelë.

Vlerësimi: Gjatë kësaj ore mësimit, nxënësit vlerësohen për gjetjen e shumës (ndryshesës) së numrave të kundërt, të numrave me shenjë të njëjtë dhe me shenjë të ndryshme, si dhe për interpretimin e këtyre veprimeve me ilustrime apo bosht numerik.

Detyrë për punë të pavarur: Pjesa përkatëse në fletoren e punës jepet për t'u punuar në shtëpi.

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Mbledhja dhe zbritja (Përmbledhim)		Situata e të nxënët: Problema nga jeta reale. Nevojat dhe rezervat ujore. Votimet.	
Rezultatet e të nxënët të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: mbledh ose zbret numra me numër të njëjtë ose të ndryshëm shifrash pas presjes dhjetore, duke përfshirë dhe paratë.		Fjalët kyçe: mbledhje, zbritje, numër dyshifror, treshifror.	
Burimet: teksti, fletorja e punës.	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: gjuha dhe komunikimi, artet, sportet, teknologjia, shoqëria dhe mjedisi.		
Metodologjia, teknikat e përdorura, veprimtaritë e nxënësve			
Organizimi i orës së mësimit			
Parashikimi i të nxënët: Lexim i drejtuar Nxënësit njihen me situatën e dhënë në librin e nxënësit. Në të paraqiten dy tabela, të cilat tregojnë nevojat për ujë dhe rezervat ujore në Lindjen e Mesme dhe të Afrikës Veriore. Nxënësit ftohen të lexojnë të dhënat e këtyre tabelave. Shtrohen pyetjet: ➤ Çfarë paraqesin figurat në këto tabela? ➤ Çfarë paraqet tabela e parë? Po tabela e dytë? ➤ Çfarë të dhënash të tjera mund të nxirrnë nga studimi i këtyre dy tabelave? Dëgjohen përgjigjet e nxënësve. Më pas nxënësit udhëzohen të plotësojnë fjalitë e dhëna në ushtrimin 1. Përgjigjet dhe veprimet që i shoqërojnë ato diskutohen me të gjithë klasën.			
Ndërtimi i njohurive të reja: Puno, mendo, diskuto në dyshe Nxënësit në këtë fazë do të punojnë në dyshe me shoku/shoqen e bankës. Nxënësit studiojnë dhe më pas plotësojnë tabelën e ushtrimit 2. Ndërsa nxënësit interpretojnë tabelën, mësuesi ose vetë nxënësit korrigjohen. Kjo jep mundësinë të vlerësohet thellësia e të kuptuarit të tyre. Më pas diskutohen bashkë me gjithë klasën fjalitë që duhen plotësuar në lidhje me ushtrimin 2. Nxënësit argumentojnë se si kanë mbërritur në përfundimin që kanë shënuar për çdo pikë të ushtrimit 2.			
Përforsimi: Shkëmbe një problemë Nxënësit qëndrojnë dhe punojnë në dyshe, sërish. Në fillim secili nga nxënësit krijon një situatë problemore si në ushtrimet 1 dhe 2. Më pas hartojnë disa pyetje në lidhje me këto situata. Pyetjeve duhet t`u përgjigjet shoku/shoqja e bankës. Në fund zgjidhen disa dyshe për të paraqitur para klasës situatat e tyre problemore dhe zgjidhjen e tyre.			

Vlerësimi: Gjatë kësaj ore mësimi, nxënësit vlerësohen për mbledhjen ose zbritjen e numrave me numër të njëjtë ose të ndryshëm shifrash pas presjes dhjetore, duke përfshirë dhe paratë.

Detyrë e dhëna për punë të pavarur: Pjesa përkatëse në fletoren e punës jepet për t'u punuar në shtëpi.

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Mbledhja dhe zbritja (Përforcojmë)		Situata e të nxënit:	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: mbledh ose zbret numra me numër të njëjtë ose të ndryshëm shifrash pas presjes dhjetore, duke përfshirë dhe paratë.		Fjalët kyçe: mbledhje, zbritje, numër dyshifror, numër treshifror.	
Burimet: teksti, fletorja e punës.	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: gjuha dhe komunikimi, artet, sportet, teknologjia, shoqëria dhe mjedisi.		
Metodologjia, teknikat e përdorura, veprimtaritë e nxënësve			
Organizimi i orës së mësimi			
Parashikimi i të nxënit: Diskutim i njohurive paraprake			
Bashkë me nxënësit, diskutohet për mbledhjen, zbritjen e numrave me dy ose tri shifra, si dhe për mbledhjen (zbritjen) e numrave dhjetorë dhe numrave me shenjë. Gjatë diskutimit shtrohen pyetjet e mëposhtme: ➤ Çfarë metode kemi përdorur për të mbledhur apo zbritur numrat? ➤ Cila ishte metoda më e thjeshtë për ju në njehsimin e shumës dhe ndryshesës? ➤ Si i mbledhim dy numra me shenjë të njëjtë? ➤ Si i mbledhim dy numra me shenjë të ndryshme? Çdo përgjigje nga nxënësit shoqërohet me një shembull, i cili shkruhet në tabelë.			
Ndërtimi i njohurive të reja: Kërkim – hulumtim			
Nxënësit udhëzohen të vëzhgojnë tabelën në librin e nxënësve. Klasa ndahet në 8 grupe me nga 4 ose 5 nxënës. Secilit grup i jepet një nga kërkesat e paraqitura në tabelën e mësimi. Grupet duhet të formojnë dhe të zgjidhin tri ushtrime sipas kushteve të kërkuara në tabelë. P.sh.: Grupi 1 duhet të formojë tri shuma që përfshijnë një shifër pas presjes. Shuma duhet të gjendet me shkrim. 23,8 + 12,9= 125,7+39,7 = 825,9+324,3=			
Secili grup paraqet punën e tij përpara klasës dhe diskuton zgjidhjet e ushtrimeve që ka krijuar.			
Përforcimi: Rishikim në dyshe			
Nxënësit punojnë në mënyrë të pavarur ushtrimet që jepen në tabelë nga mësuesi. Më pas ata shkëmbejnë fletoret për të parë dhe për të korrigjuar zgjidhjet e njëri-tjetrit. Disa ushtrime mund të jenë: - Vendosni në boshtin numerik numrat: -5; -3; 8; 4 - Kryeni veprimet. (-8) + (+3)= (-11) + (-6)= (+9) + (-11)= (-4) – (+6)= (-30) – (-5)= - Shuma e dy numrave është 214. Njëri prej tyre është 54. Sa është numri tjetër? - Familja e Andit udhëtoi me makinë për tri ditë. Ditën e parë ata udhëtuan 417 km, ditën e dytë 45,3 km dhe ditën e tretë udhëtuan 366,9 km. Sa rrugë përshkoi familja e Andit në të tri ditët së bashku?			

5. Era bleu një makinë llogaritëse për 15 €. Gleni e gjeti të njëjtin model makine llogaritëse për 9,79 €. Sa euro më shumë pagoi Era në blerjen e kësaj makine llogaritëse?
6. Gjeni shumën dhe ndryshesën.
- $15,4 - 8 =$ $3 - 2,54 =$ $1,34 + 4,1 =$ $133,01 - 5,6 =$ $6,8 + 237,29 =$

Vlerësimi: Gjatë kësaj ore nxënësit do të vlerësohen për mbledhjen ose zbritjen e numrave me numër të njëjtë ose të ndryshëm shifrash pas presjes dhjetore, duke përfshirë dhe paratë.

Detyrë për punë të pavarur: Pjesa përkatëse në fletoren e punës jepet për t'u punuar në shtëpi.

VETËVLERËSIM

1. Kryej veprimet.

$6,496 + 3,288 =$	$54,398 + 64,508 =$
$3,254 + 4,113 =$	$754 - 549 =$
$54,678 + 74,357 =$	$98,455 - 14,789 =$
$38,904 - 32,899$	$908 - 774 =$
$15,7 + 2,34 + 5,06 =$	$64,038 + 164,8 + 15,7 =$
$2,6 + 64,89 + 4,007 =$	$12,9 + 2,008 + 75,9 =$
$87,4 - 56,09 =$	$5,908 - 4,72 =$
$68,9 - 24,74 =$	$955,3 - 242,7 =$

2. Altini instaloi një lojë të re në kompjuter. Në ditën e parë të lojës, ai grumbulloi 59570 pikë, ndërsa ditën e dytë ai grumbulloi 61020 pikë. Sa pikë grumbulloi Altini në të dyja ditët së bashku?

3. Një anije kozmike udhëton me një shpejtësi prej 27358 km për orë, ndërsa një aeroplan konkord udhëton me një shpejtësi prej 2333 km për orë. Sa më shpejt se aeroplani udhëton anija kozmike?

4. Gjej numrat që mungojnë.

$$8 _ 2 _ 4 _ + 30 \ 0 _ 4 = 882 \ 288$$

$$93 \ 251 - 4 _ 6 _ = _ _ 4 _ 1$$

5. Të dielën temperatura më e ulët ishte -9°C . Të hënën temperatura më e ulët u rrit me 12°C . Sa ishte temperatura më e ulët të hënën?
6. Një nëndetëse zhytet në 45 metra nën nivelin e detit dhe më pas vazhdon të zhytet edhe 57 metra të tjera. Sa metra është zhytur gjithsej nëndetësja?

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Shumëzimi dhe pjesëtimi (Diskutojmë së bashku)		Situata e të nxënësve: Luajmë me numrat.	
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - shumëzon numra dy ose treshifrorë me numra dyshifrorë; - shumëzon dy numra shumëfisha të dhjetës.		Fjalët kyçe: rend, shumëzim, pjesëtim.	
Burimet: teksti, fletorja e punës.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: gjuha dhe komunikimi, artet, sportet, teknologjia, shoqëria dhe mjedisi.	
Metodologjia, teknikat e përdorura, veprimtaritë e nxënësve			
Organizimi i orës së mësimi			
Parashikimi i të nxënësve: Diskutim për njohuritë paraprake			
Nxënësit njihen me temën dhe rezultatet e të nxënësve për këtë temë. Më pas zhvillohet një veprimtari praktike, rikujtimi i shumëzimit të dy numrave të plotë. Jepet për t'u gjetur prodhimi i numrave $187 \cdot 32$. Gjatë njehsimit të këtij prodhimi shtrohen disa pyetje, të cilat ndihmojnë nxënësit në rikujtimin e mënyrës së shumëzimit të dy numrave të plotë. Disa nga këto pyetje mund të jenë: - Në çfarë mënyre mund ta kryejmë shumëzimin? - Pse zgjodhët këtë mënyrë? - Cila do të ishte mënyra më e thjeshtë për të kryer këtë shumëzim? - Cila do të ishte mënyra më e shpejtë për kryerjen e këtij shumëzimi? - Nëse do të kryejmë shumëzimin në shtyllë, nga cilat shifra do ta fillonim shumëzimin? - Si do ta vazhdonim shumëzimin më pas? Veprimet e përfunduara paraqiten dhe diskutohen me gjithë klasën.			
Ndërtimi i njohurive të reja: Diskutim për njohuritë paraprake			
Në këtë fazë, nxënësit vazhdojnë diskutimin për metodat e paraqitura në librin e nxënësve për shumëzimin e dy numrave. Klasa ndahet në tri grupe të mëdha. Secilit grup i caktohet një nga metodat që paraqiten në libër dhe u jepen tri ushtrime, të cilat do t'i zgjidhin me metodën që i takon grupit të tyre. Nxënësit jo vetëm do t'i zgjidhin ushtrimet sipas metodës që i takon grupit të tyre, por do të mbrojnë dhe tezën që kjo është metoda më e mirë për të shumëzuar dy numra. Grupeve u jepen shumëzimet e mëposhtme për t'i kryer sipas tri metodave të dhëna në librin e nxënësve. $324 \cdot 25$ $192 \cdot 53$ $250 \cdot 18$ Ushtrimet diskutohen me të gjithë klasën.			
Përforcimi: Rishikim në dyshe			
Në këtë fazë nxënësit duhet të punojnë ushtrimin: Kryej shumëzimet me metoda të ndryshme. $74 \cdot 38 =$ $442 \cdot 135 =$ $354 \cdot 279 =$ $49 \cdot 898 =$ $754 \cdot 12 =$ $12 \cdot 15 =$ $602 \cdot 72 =$			
Fillimisht nxënësit punojnë në mënyrë të pavarur dhe më pas shkëmbejnë fletoren me shokun/shoqen e bankës për të parë se si e kanë zgjidhur ushtrimin, si dhe metodën që secili ka përdorur për zgjidhjen e ushtrimit. Disa dyshe diskutojnë zgjidhjen në tabelë.			
Vlerësimi: Gjatë kësaj ore mësimi, nxënësit vlerësohen për shumëzimin e numrave dy ose treshifrorë me numra dyshifrorë, si dhe për shumëzimin e dy numrave shumëfisha të dhjetës.			
Detyrë për punë të pavarur: Pjesa përkatëse jepet në fletoren e punës për t'u punuar në shtëpi.			

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Shumëzimi i dy numrave dy, tre dhe katërshifrorë (Zbulojmë)		Situata e të nxënësve:	
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - shumëzon numra dy ose treshifrorë me numra dyshifrorë; - shumëzon dy numra shumëfisha të dhjetës.		Fjalët kyçe: rend, shumëzim, pjesëtim.	
Burimet: teksti, fletorja e punës.	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare. gjuha dhe komunikimi, artet, sportet teknologjia, shoqëria dhe mjedisi.		
Metodologjia, teknikat e përdorura, veprimtaritë e nxënësve			
Organizimi i orës së mësimi			
Parashikimi i të nxënësve: Diskutim për njohuritë paraprake			
Paraqitet tema së bashku me rezultatet përkatëse të të nxënësve. Më pas mësuesi zhvillon bashkë me nxënësit një veprimtari praktike për rikujtimin e shumëzimit të dy numrave të plotë. Nxënësit njehsojnë prodhimin e numrave $2187 \cdot 32$. Gjatë njehsimit të këtij prodhimi shtrohen disa pyetje, të cilat ndihmojnë nxënësit në rikujtimin e mënyrës së shumëzimit të dy numrave të plotë. Disa nga këto pyetje mund të jenë: - Në çfarë mënyre mund ta kryejmë shumëzimin? - Si do ta fillojmë shumëzimin, nga cilat shifra? - Po më pas si do ta vazhdonim shumëzimin? Veprimet e përfunduara paraqiten dhe diskutohen me gjithë klasën.			
Ndërtimi i njohurive të reja: Marrëdhënie pyetje-përgjigje			
Shtrohet një situatë tjetër: Na duhet të shumëzojmë një numër dhjetor me një numër të plotë dyshifror, p.sh.: $21,87 \cdot 32$. - Si mendoni se duhet të veprojmë për të njehsuar këtë prodhim? - A mund të bazohemi te njohuritë që kemi për njehsimin e prodhimit të dy numrave të plotë? - Si do t'i shfrytëzoni njohuritë e rikujtuara për të gjetur këtë prodhim? - Ku do të dallonin dy prodhimet nga njëri-tjetri? Nxënësit provojnë të kryejnë shumëzimin $21,87 \cdot 32$. Ata nxiten dhe nga pyetjet e mësipërme për të njehsuar këtë prodhim. Pasi diskutohet dhe jepet përfundimi i shumëzimit të mësipërm, bashkë me nxënësit jepet dhe mënyra e shumëzimit të një numri dhjetor me një numër dyshifror. Për të provuar veten nxënësit punojnë në mënyrë të pavarur ushtrimin 1 të libri të nxënësit. Në fund ushtrimi diskutohet me të gjithë klasën.			
Përforcimi: Rishikim në dyshe			
Nxënësit punojnë në dyshe me shokun/shoqen pranë, ushtrimin 2, 3 dhe 4 të libri të nxënësit. Ata duhet të argumentojnë zgjidhjen e ushtrimit si dhe t'i përgjigjen pyetjeve të këtyre ushtrimeve. Po kështu punohet dhe me ushtrimet 5, 6. Në fund zgjidhen disa dyshe për të diskutuar ushtrimet.			
Vlerësimi: Gjatë kësaj ore mësimi, nxënësit vlerësohen për shumëzimin e numrave dy ose treshifrorë me numra dyshifrorë, si dhe për shumëzimin e dy numrave shumëfisha të dhjetës.			
Detyrë për punë të pavarur: Pjesa përkatëse në fletoren e punës jepet për t'u punuar në shtëpi.			

Fusha: Matematikë		Lënda: Matematikë		Shkalla: III		Klasa: VI	
Tema mësimore: Shumëzimi i dy numrave dy, tre dhe katërshifrorë (Eksplorojmë)				Situata e të nxënit: Luajmë me prodhimin e numrave.			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - shumëzon numra dy ose treshifrorë me numra dyshifrorë; - shumëzon dy numra shumëfisha të dhjetës.				Fjalët kyçe: rend, shumëzim, pjesëtim.			
Burimet: teksti, fletorja e punës.			Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: gjuha dhe komunikimi, artet, sportet, teknologjia, shoqëria dhe mjedisi.				
Metodologjia, teknikat e përdorura, veprimtaritë e nxënësve							
Organizimi i orës së mësimi							
Parashikimi i të nxënit: Diskutim për njohuritë paraprake							
Paraqitet tema dhe rezultatet përkatëse të të nxënit. Më pas mësuesi jep në tabelë dy prodhime, si p.sh.: $45 \cdot 768$ dhe $54 \cdot 768$. Bashkë me nxënësit rikujtohet shumëzimi i dy numrave të plotë. Para njehsimit të këtij prodhimi shtrohen pyetje, të cilat ndihmojnë nxënësit në rikujtimin e mënyrës së shumëzimit të dy numrave të plotë. Disa nga këto pyetje mund të jenë: ➤ Në çfarë mënyre mund ta kryejmë shumëzimin? ➤ Si do ta fillojmë shumëzimin, nga cilat shifra? ➤ Po më pas si do ta vazhdonim shumëzimin? Më pas mësuesi shtron pyetjen: Cili prej prodhimeve është më i madh dhe pse? Dëgjohen përgjigjet e nxënësve dhe argumentet shënohen në tabelë. Më pas kryhen shumëzimet në tabelë për të parë saktësinë e argumenteve të dhëna nga nxënësit.							
Ndërtimi i njohurive të reja: Kërkim – hulumtim							
Klasa ndahet në grupe me nga katër veta. Grupet udhëzohen të kryejnë veprimtarinë në librin e nxënësit. Nxënësit orientohen se mund të provojnë përlllogaritje të ndryshme. Theksohet se nuk është e nevojshme të gjenden të gjitha prodhimet e mundshme. Ata duhet të përdorin njohuritë e marra për vendvlerën, që të përpiqen të vendosin se cila përlllogaritje ka më shumë gjasë të japë një prodhim më të madh. Pasi grupet përfundojnë punën disa prej tyre diskutojnë me të gjithë klasën zgjidhjen që i kanë dhënë ushtrimit. Për të përforcuar njohuritë e marra nxënësit punojnë në grupe ushtrimin e mëposhtëm. Përcaktoni se cili nga prodhimet e dhëna është më i madh dhe pse? Kryeni shumëzimet për të vërtetuar përgjigjen. $25 \cdot 548 =$ $52 \cdot 548 =$ $124 \cdot 38 =$ $124 \cdot 83 =$ $589 \cdot 91 =$ $985 \cdot 91 =$							
Përforcimi: Rishikim në dyshe							
Në këtë fazë, nxënësit duhet të krijojnë vetë ushtrime si ushtrimi i dhënë në libër. Më pas ushtrimin e kalojnë te shoku/shoqja e bankës për ta zgjidhur. Në fund diskutojnë me njëri-tjetrin zgjidhjen e dhënë. Disa dyshe përzgjidhen për ta diskutuar ushtrimin e tyre në tabelë, duke argumentuar zgjidhjen. Vlerësimi: Gjatë kësaj ore mësimi, nxënësit vlerësohen për shumëzimin e numrave dy ose treshifrorë me numra dyshifrorë, si dhe për shumëzimin e dy numrave shumëfisha të dhjetës.							
Detyrë për punë të pavarur: Pjesa përkatëse në fletoren e punës jepet për t'u punuar në shtëpi.							

Fusha: Matematikë		Lënda: Matematikë		Shkalla: III		Klasa: VI	
Tema mësimore: Pjesëtimi i numrave treshifrorë me numra dyshifrorë (Zbulojmë)				Situata e të nxënit: Luajmë me role, mësues, nxënës.			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: • pjesëton numra treshifrorë me numra njëshifrorë (përfshirë edhe atë me mbetje); • pjesëton numra treshifrorë me numra dyshifrorë (pa mbetje) duke përfshirë edhe paratë.				Fjalët kyçe: rend, shumëzim, pjesëtim			
Burimet: teksti, fletorja e punës.			Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: gjuha dhe komunikimi, artet, sportet, teknologjia, shoqëria dhe mjedisi.				
Metodologjia, teknikat e përdorura, veprimtaritë e nxënësve							
Organizimi i orës së mësimi							
Parashikimi i të nxënit: Imagjinatë e drejtuar Pasi nxënësit njihen me temën e re, mësuesja paraqet një situatë imagjinare, e cila do t'i ndihmojë nxënësit në trajtimin e njohurive të reja. Genti do të ndajë 2600 gr gështenja në 12 qese me të njëjtën gramaturë. Sa gramë gështenja do të ketë secila qese? Nxënësit lihen 5 minuta për të diskutuar me shokun/shoqen e bankës rreth zgjidhjes së problemës. Më pas problema diskutohen me të gjithë klasën në tabelë. Gjatë diskutimit të problemës shtrohen pyetjet: ➤ Çfarë veprimi kryet për të gjetur sa gramë do të ketë secila qese? ➤ Hasët ndonjë vështirësi në kryerjen e veprimit? ➤ Cilat janë hapat që ndoqët në kryerjen e pjesëtimit? Zgjidhja e problemës paraqitet në tabelë.							
Ndërtimi i njohurive të reja: Rrugëzgjidhje për të lexuarit në matematikë Nxënësit udhëzohen të shohin ushtrimin 1 dhe 2 në librin e nxënësit. Gjatë diskutimit të ushtrimeve shtrohen disa pyetje në mënyrë që të rikujtohet mënyra e pjesëtimit të dy numrave. - Çfarë njohurish kemi për të kryer këtë pjesëtim? - Cili do të ishte hapi parë i këtij pjesëtimi? - A ka ndonjë mënyrë tjetër për kryerjen e këtij pjesëtimi? Në fund, të dyja pjesëtimet zhvillohen në tabelë dhe nxënësit aktivizohen të shpjegojnë hapat e pjesëtimit. Nxënësit punojnë ushtrimin 3 në librin e nxënësit në mënyrë të pavarur nga njëri-tjetri dhe nën udhëheqjen e mësueses.							
Përforcimi: Shkëmbe një problemë Nxënësit punojnë në mënyrë të pavarur problemën: • Një shitës fruta-perimesh bleu 3 580 lulëlakra, të cilat i vendosi në 32 arka. Sa lulëlakra vendosi në çdo arkë? Pas përfundimit të zgjidhjes së problemës nxënësit e kontrollojnë zhvillimin e saj me shokun/shoqen pranë. Më pas secili nxënës duhet të krijojë vetë një problemë, e cila zgjidhet nëpërmjet pjesëtimit të dy numrave. Këtë problemë e zgjidh shoku/shoqja pranë. Disa problema diskutohen me të gjithë klasën. • Vlerësimi: Gjatë kësaj ore mësimi, nxënësit vlerësohen për pjesëtimin e numrave treshifrorë me numra njëshifrorë (përfshirë edhe ata me mbetje), si dhe për pjesëtimin e numrave treshifrorë me numra dyshifrorë (pa mbetje), duke përfshirë edhe paratë.							
Detyrë për punë të pavarur: Pjesa përkatëse në fletoren e punës jepet për t'u punuar në shtëpi.							

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Pjesëtimi i numrave treshifrorë me numra dyshifrorë (Eksplorojmë)		Situata e të nxënit:	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - pjesëton numra treshifrorë me numra njëshifrorë (përfshirë edhe atë me mbetje; - pjesëton numra treshifrorë me numra dyshifrorë (pa mbetje), duke përfshirë edhe paratë.		Fjalët kyçe: rend, shumëzim, pjesëtim.	
Burimet: teksti, fletorja e punës.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: gjuha dhe komunikimi, artet, sportet teknologjia, shoqëria dhe mjedisi.	
Metodologjia, teknikat e përdorura, veprimtaritë e nxënësve			
Organizimi i orës së mësimi			
Parashikimi i të nxënit: Diskutim për njohuritë paraprake Ora e mësimi do të fillojë me paraqitjen e temës mësimore dhe të rezultateve të të nxënit. Më pas zhvillohet një diskutim me të gjithë klasën për mënyrën se si kryhet pjesëtimi i dy numrave. Gjatë diskutimit shtrohen pyetjet e mëposhtme: ➤ Çfarë dimë ne për veprimin e pjesëtimit? ➤ Si kryhet një pjesëtim? ➤ Cilët janë elementet e një pjesëtimi? ➤ Si e vërtetojmë që e kemi kryer saktë një pjesëtim? Diskutimi shoqërohet me zhvillimin e një pjesëtimi në tabelë. Ndërtimi i njohurive të reja: Puno, mendo, diskuto në dyshe Nxënësit punojnë në dyshe për të zgjidhur ushtrimin 1 në librin e nxënësit. Ata duhet të krijojnë një pjesëtim me shifrat e dhëna, i cili ta ketë herësin 1331. Nxënësit mund t'i përdorin shifrat më shumë se një herë (përgjigjja është $5\,324 : 4 = 1\,331$). Më pas pyetet një dyshe: ➤ Si e gjetët përfundimin? Mësuesi sigurohet që ta kuptojnë zgjidhjen edhe ata nxënës që nuk e kishin zgjidhur problemën. Nxënësit vazhdojnë punojnë në dyshe, duke mbështetur njëri-tjetrin në zgjidhjen e problemave në librin e nxënësit. Provohen disa nga problemat e librit. Zgjidhen dy prej tyre për t'i përdorur në përfundimin e të nxënit. Dy dyshe paraqesin problemat e tyre para klasës. Në këtë pjesë të mesimit, ata mund të sillen si mësues. Në fillim, dyshet u kërkojnë nxënësve të tjerë të zgjidhin problemën. Pastaj mund të kontrollojnë nëse zgjidhjet janë të sakta Përfundimi: Shkëmbe një problemë Dyshet punojnë për të krijuar një problem të ngjashme me problemat 3 dhe 4 dhe ia paraqesin për ta zgjidhur njëres nga dyshet e tjera. Një dyshe e paraqet problemën e saj në tabelë.			
Vlerësimi: Gjatë kësaj ore mësimi, nxënësit vlerësohen për pjesëtimin e numrave treshifrorë me numra njëshifrorë (përfshirë edhe atë me mbetje), si dhe për pjesëtimin e numrave treshifrorë me numra dyshifrorë (pa mbetje), duke përfshirë edhe paratë.			
Detyrë për punë të pavarur: Pjesa përkatëse në fletoren e punës jepet për t'u punuar në shtëpi.			

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Pjesëtimi me mbetje (Zbulojmë)		Situata e të nxënit: Blerja artikujve.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: nxjerr përfundime për pjesëtimin ku herësi është numër i përzier ose numër dhjetor.		Fjalët kyçe: pjesëtim, herës, mbetje.	
Burimet: teksti, fletorja e punës.	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: gjuha dhe komunikimi, artet, sportet, teknologjia, shoqëria dhe mjedisi.		
Metodologjia, teknikat e përdorura, veprimtaritë e nxënësve			
Organizimi i orës së mësimi			
Parashikimi i të nxënit: Stuhi mendimesh			
Shkruhet në tabelë fjala Pjesëtim dhe u kërkohet nxënësve që në fletoret e tyre për 1 minutë të shkruajnë sa më shumë gjëra mbi pjesëtimin. Më pas dëgjohen përgjigjet e nxënësve, të cilat shënohen në tabelë.			
thyesa Pjesëtim pa mbetje (:)			
Ndërtimi i njohurive të reja: Diskutim i pyetjeve			
Një nxënës ftohet të ngrihet dhe të hedhë tri herë zarin kubik. Nxënësit udhëzohen që me dy shifrat e para që ranë nga hedhja e zarit të formojnë një numër dyshifror dhe këtë numër ta pjesëtojnë me shifrën e tretë që ra. (Veprimi përsëritet nëse pjesëtimi del pa mbetje.)			
Shembull: Bien shifrat 2, 5 dhe 2.			
Pjesëtimi që do të formojmë është 25 : 2.			
Kryhet pjesëtimi:			
25 : 2 = 12 (1) - 2 5 - 4 1			
Pasi pjesëtimi shkruhet në tabelë shtrohen pyetjet:			
- Çfarë nënkupton 12? Çfarë shpreh 12? - Po mbetja 1 çfarë do të thotë? - Si mund ta paraqesim ndryshe mbetjen 1?			
Dëgjohen përgjigjet e nxënësve, të cilat si përfundim duhet të shprehin përfundimin e pjesëtimin si numër të përzier.			
25 : 2 = 12 ¹/₂			
Më pas nxënësve u kërkohet që në fletoret e tyre të kthejnë numrin e përzier në numër dhjetor (në raste të veçanta mund të përdoret dhe makina llogaritëse).			
12 ¹/₂ = 12 + ¹/₂ = 12 + 0,5 = 12,5			
Paraqitet pjesëtimi në shtyllë, ku herësi paraqitet si numër dhjetor.			

Përforsimi: Shkëmbe një problemë Nxënësit do të punojnë në dyshe me shokun ose shokën pranë (bankat që kanë tre nxënës të punojnë në treshe). Dyshtet udhëzohen të punojnë ushtrimin 1 dhe 2 në libër e nxënësit. Ushtrimet e disa dysheve ndiqen në tabelë. Në fund mund të shtrohen pyetjet: - Nëse pjesëtojmë dy numra natyrorë si na del herësi? - Si e shprehim përfundimin e një pjesëtimi me mbetje? Nxënësit punojnë në mënyrë të pavarur ushtrimet 3, 4 dhe 5. • Vlerësimi: Gjatë kësaj ore mësimi, nxënësit vlerësohen për nxjerrjen e përfundimeve të një pjesëtimi me mbetje kur herësi është numër i përzier ose dhjetor. Detyrë për punë të pavarur: Pjesa përkatëse në fletoren e punës jepet për t'u punuar në shtëpi.

Fusha: Matematikë		Lënda: Matematikë		Shkalla: III		Klasa: VI	
Tema mësimore: Pjesëtimi me mbetje (Eksplorojmë)				Situata e të nxënësve: Blerja e artikujve.			
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: - shumëzon numra dy, tre ose katërshifrorë me numra njëshifrorë, duke përfshirë edhe paratë. - pjesëton numra trashifrorë me numra njëshifrorë, duke përfshirë edhe ata që dalin me mbetje; - pjesëton numra trashifrorë me numra dyshifrorë (pa mbetje), përfshirë edhe veprime me paratë.				Fjalët kyçe: pjesëtim, herës, mbetje.			
Burimet: teksti, fletorja e punës.			Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare. gjuha dhe komunikimi, artet, sportet, teknologjia, shoqëria dhe mjedisi.				
Metodologjia, teknikat e përdorura, veprimtaritë e nxënësve							
Organizimi i orës së mësimi							
Parashikimi i të nxënësve: Diskutim mbi njohuritë paraprake							
Bashkë me nxënësit bëhet një përsëritje të njohurive të marra mbi pjesëtimin. Gjatë diskutimit shtrohen pyetjet: - Cilat janë elementet përbërëse të pjesëtimin? - Sa lloje pjesëtimesh kemi? - Në sa forma e kemi shprehur përfundimin e një pjesëtimi me mbetje? - Si e kontrollojmë që një pjesëtim është kryer saktë? Dëgjohen përgjigjet e nxënësve.							
Më pas nxënësve u kërkohet që në dyshe me shokun pranë të shkruajnë një pjesëtim me mbetjen 2, si dhe ta shprehin përfundimin e tij në të dy format e mësuara.							
P.sh.: $17 : 5 = 3 \text{ (2)}$							
$17 : 5 = 3\frac{2}{5}$							
$17 : 5 = 3,4$							
Ndërtimi i njohurive							
Klasa ndahet në grupe me nga 4 ose 5 nxënës secili grup. Secili grup pajiset me fletë, në të cilat paraqiten produkte të njëjta, por me sasi të ndryshme dhe çmime të ndryshme.							

Nxënësve u kërkohet që për secilin produkt të vëzhgojnë dhe të shkruajnë në fletore se cili është produkti më me dobi për ta. Nxënësit nxiten që të diskutojnë brenda grupit rreth këtij ushtrimi dhe punojnë për rreth 5 minuta. Më pas dëgjohen përgjigjet e grupeve për produktet e zgjedhura, si dhe argumentimi se pse grupi ka zgjedhur këtë produkt. Për çdo produkt bëhet ballafaqimi midis grupeve dhe dëgjohen argumentet e ndryshme. Nëse grupet kanë kryer veprime ato paraqiten në tabelë. Përforcimi Nxënësit do të punojnë në mënyrë të pavarur ushtrimin 1 në librin e nxënësit. Pasi kanë bërë zgjidhjen, dëgjohen përgjigjet tyre dhe vihen në krahasim me pjesën tjetër të klasës. Nëse kemi përgjigje të ndryshme nxënësit nxiten që të gjejnë gabimin. Veprimet e nxënësve shënohen në tabela. • Vlerësimi: Gjatë kësaj ore mësimi, nxënësit vlerësohen për shumëzimin dhe pjesëtimin e numrave dy, treshifrorë me një numër njëshifror, si dhe për përdorimin e këtyre veprimeve në lidhje me paranë. Detyrë për punë të pavarur: Pjesa përkatëse në fletoren e punës jepet për t'u punuar në shtëpi.

Fusha: Matematikë		Lënda: Matematikë	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Përdorimi i vetive të shumëzimit dhe pjesëtimit (Zbulojmë)			Situata e të nxënit: Lojë me zare.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: di dhe të zbaton vetitë e shumëzimit (pa përdorur domosdoshmërisht termat: vetia ndërruese, shoqëruese ose e përdasisë).			Fjalët kyçe: shumëzim, veti, pjesëtim.	
Burimet: teksti, fletorja e punës.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare. gjuha dhe komunikimi, artet, sporte, teknologjia, shoqëria dhe mjedisi.		
Metodologjia, teknikat e përdorura, veprimtaritë e nxënësve				
Organizimi i orës së mësimin				
Parashikimi i të nxënit: Kërkim hulumtim Shkruhet në dërrasë “$a \cdot (b + c)$”. Hidhet një zar tri herë. Zëvendësojmë “a” me numrin e parë që na del. Zëvendësojmë “b” me numrin e dytë që na del. Zëvendësojmë “c” me numrin e tretë. Për shembull: na doli 3, 5 dhe një tjetër 3. Shkruajmë: “$3 \cdot (5 + 3)$”. Mësuesja i drejtohet klasës: <i>Kjo është njësoj me $3 \cdot 8$, që bëjnë 24.</i> Mësuesja i drejtohet klasës: <i>Këtë mund ta shkruani edhe si $(3 \cdot 5) + (3 \cdot 3) = 15 + 9 = 24$.</i> Shtrohet pyetja: <i>A është gjithmonë e vërtetë kjo? Apo është ndonjëherë e vërtetë?</i> Udhëzohen nxënësit ta provojnë vetinë me thyesa e numra negativë, për të “verifikuar” nëse formulimet janë gjithmonë të vërteta.				
Ndërtimi i njohurive: Puno, mendo, diskuto në dyshe Nxënësit punojnë në dyshe me veprimtaritë në librin e nxënësit. Ata mund t’i provojnë vetë formulimet me numra të ndryshëm: njëri nxënës provon me numra negativë, tjetri me numra thyesorë, në një dyshe tjetër mund të përdorin dhe numrat dhjetorë. Nxënësit nxiten të përdorin fjalorët matematikorë për të formuluar dhe mbështetur përkufizimet e tyre për vetitë e ndërrimit, të shoqërimit dhe të përdasisë. Përforcimi: Rishikim në dyshe Dyshet ndajnë me njëri-tjetrin përkufizimet që kanë gjetur. Si klasë, bihet dakord për një përkufizim të vetëm për secilën veti. Krijohet një afishe për t’u varur në klasë. Mund t’i referoheni kësaj afisheje për mësimet e ardhshme. Ndërsa punojnë nxënësve u shtrohen pyetje:				

- A janë të vërteta këto veti për numrat negativë?
- A janë të vërteta këto veti për thyesat?
- A janë të vërteta këto veti kur njëri faktor është zero?

Në fund bëhet një reflektim me klasën. Gjatë reflektimit shtrohen pyetjet:

- A është e vërtetë që $a \cdot (b + c) = a \cdot b + a \cdot c$?
- Si mund ta shkruajmë me simbole vetinë e ndërrimit për shumëzimin?

- **Vlerësimi:** Gjatë kësaj ore mësimi, nxënësit vlerësohen për zbatimin e vetive të shumëzimit (pa përdorur domosdoshmërisht termat: vetia ndërruese, shoqëruese ose e përdasisë).

Detyrë për punë të pavarur: Pjesa përkatëse në fletoren e punës jepet për t'u punuar në shtëpi.

Fusha: Matematikë		Lënda: Matematikë		Shkalla: III		Klasa: VI	
Tema mësimore: Përdorimi i vetive të shumëzimit dhe pjesëtimit (Zbulojmë)				Situata e të nxënit: Lojë me zare.			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: di dhe zbaton vetitë e shumëzimit (pa përdorur domosdoshmërisht termat: vetia ndërruese, shoqëruese ose e përdasisë).				Fjalët kyçe: shumëzim, veti, pjesëtim.			
Burimet: teksti, fletorja e punës.			Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: gjuha dhe komunikimi, artet, sportet, teknologjia, shoqëria dhe mjedisi.				
Metodologjia, teknikat e përdorura, veprimtaritë e nxënësve							
Organizimi i orës së mësimi							
Parashikimi i të nxënit: Stuhi mendimesh							
Shkruhet në tabelë fjalën Shumëzim dhe u kërkohet nxënësve që ne fletoret e tyre për 1 minutë të shkruajnë sa më shumë gjëra mbi shumëzimin. Më pas dëgjohen përgjigjet e nxënësve, të cilat shënohen në tabelë. <pre>graph TD; A([Shumëzim]) --> B(veti); A --> C(përdasim); A --> D("•");</pre>							
Ndërtimi i njohurive: Diskutim i pyetjeve							
Një nxënës ftohet të ngrihet dhe të hedhë tri herë zarin kubik. Nxënësit udhëzohen që me dy shifrat e para që ranë nga hedhja e zarit të formojnë një numër dyshifror dhe këtë numër ta shumëzojnë me shifrën e tretë që ra. Shembull: Bien shifrat 6, 5 dhe 2. Shumëzimi që do të formohet është $26 \cdot 5$. Nxënësve u kërkohet të kryejnë shumëzimin. Më pas u kërkohet të zbatojnë vetitë e shumëzimit për shumëzimin e dhënë. Vetitë që duhet të zbatohen shënohen në tabelë nga nxënësit. Vetia e ndërrimit: $a \cdot b = b \cdot a$ Vetia e shoqërimit (për këtë veti nxënësit e hedhin dhe një herë zarin): $a \cdot b \cdot c = (a \cdot b) \cdot c$ Vetia e përdasismit $a \cdot (b + c) = a \cdot b + a \cdot c$ Në fund bëhet një përmbledhje mbi vetitë e shumëzimit.							

Shtrohen pyetjet: ➤ Çfarë kuptoni me veti shoqërimi? ➤ Çfarë kuptoni me veti ndërrimi? ➤ Çfarë kuptoni me veti përdasimi?			
Përforcimi: Rishikim në dyshe			
Nxënësit punojnë në dyshe me shokun/shoqen pranë (bankat që kanë tre nxënës të punojnë në treshe). Dyshet udhëzohen të punojnë ushtrimin që do të paraqiten në tabelë. Ushtrimet e disa dysheve ndiqen në tabelë. Kryeni shumëzimet në mënyrën më të thjeshtë: $164 \cdot 39 = 415 \cdot 15 = 224 \cdot 92 = 862 \cdot 79 = 261 \cdot 79 = 667 \cdot 89 = 360 \cdot 11 = 631 \cdot 43 =$ $155 \cdot 51 = 165 \cdot 73 = 630 \cdot 35 = 927 \cdot 89 = 519 \cdot 30 = 527 \cdot 33 = 808 \cdot 54 = 625 \cdot 93 =$			
• Vlerësimi: Gjatë kësaj ore mësimi nxënësit do të vlerësohen për zbatimin e vetive të shumëzimit (pa përdorur domosdoshmërisht termat: vetia ndërruese, shoqëruese ose e përdasisë).			
Detyrë për punë të pavarur: Pjesa përkatëse në fletoren e punës jepet për t'u punuar në shtëpi.			
Fusha: Matematikë		Lënda: Matematikë	
Tema mësimore: Përdorimi i vetive të shumëzimit dhe pjesëtimit (Eksplorojmë)		Shkalla: III	
Rezultatet e të nxënës të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: • di dhe zbaton vetitë e shumëzimit (pa përdorur domosdoshmërisht termat: vetia ndërruese, shoqëruese ose e përdasisë).		Klasa: VI	
Burimet: teksti, fletorja e punës.		Situata e të nxënës: Lojë me shifrat.	
Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: gjuha dhe komunikimi, artet, sportet, teknologjia, shoqëria dhe mjedisi.		Fjalët kyçe: veti të shumëzimit dhe të pjesëtimit.	
Metodologjia, teknikat e përdorura, veprimtaritë e nxënësve			
Organizimi i orës së mësimi			
Parashikimi: Kërkim – hulumtim			
Nxënësit fillojnë menjëherë veprimtarinë e dhënë në ushtrimin 1 në librin e nxënësit. Ndërsa punojnë, u kërkohet që individualisht të shpjegojnë metodën e tyre. Pas 5 minutash zgjidhen tre nxënës që kanë zgjedhur metoda paksa të ndryshme. Secili shpjegon metodën e tij. Gjatë diskutimit të ushtrimit shtrohen pyetjet: ➤ Pse zgjodhe këtë metodë? ➤ Si të ka ndihmuar ndryshimi i vendit të numrave në kryerjen e shumëzimit? ➤ A ke përdorur ndonjë veti gjatë kryerjes së këtij shumëzimi? ➤ Në çfarë përfundimi ke arritur gjatë zgjidhjes së këtij ushtrimi?			
Ndërtimi i njohurive: Puno, mendo, diskuto në dyshe			
Nxënësit plotësojnë në mënyrë të pavarur ushtrimet 2-4c. Kur të plotësojnë ushtrimin 4d, u kërkohet ta verifikojnë pyetjen e tyre me një shok. Zgjidhen disa nga problemat me gjëgjëza për t'i përdorur në “Përforcimin e të nxënës”. Gjatë zhvillimit të gjëgjëzave, rikujtohet që shumëzimi me 2 quhet edhe “dyfishim”, ndërsa pjesëtimi me dy quhet “përgjysmim”. Ushtrimet diskutohen me të gjithë klasën.			
Përforcimi:			
Disa nga ushtrimet me gjëgjëza shkruhen nëpër fleta dhe u shpërndahen dysheve të nxënësve, sipas bankave. Pasi nxënësit i zgjidhin, ato diskutohen me të gjithë klasën. Më pas dyshet orientohen të krijojnë vetë gjëgjëza të ngjashme, të cilat më pas u jepen për t'u zgjidhur dysheve të tjera (nxënësit ndihmohen nga mësuesja për shpërndarjen e gjëgjëzave). Në fund zgjidhen tri ose katër nga problemat më të mira me gjëgjëza. Nxënësit që i përpiluan gjëgjëzat të shpjegojnë: <i>Pse jep rezultat kjo gjëgjëzë?</i>			
Nxënësit shpjegojnë se si i përpiluan problemat me gjëgjëzat numerike. Gjatë diskutimit shtrohen pyetjet: ➤ Pse zgjodhe të pjesëtosh në këtë hap? ➤ Pse zgjodhe atë shifër? ➤ Nga e di që gjëgjëza jep rezultat?			
• Vlerësimi: Gjatë kësaj ore mësimi, nxënësit vlerësohen për zbatimin e vetive të shumëzimit (pa përdorur domosdoshmërisht termat: vetia ndërruese, shoqëruese ose e përdasisë).			
Detyrë për punë të pavarur: Pjesa përkatëse në fletoren e punës jepet për t'u punuar në shtëpi.			

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Shumëzimi dhe pjesëtimi (Përmbledhim)		Situata e të nxënët: Lista e blerjeve.	
Rezultatet e të nxënët të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - mbledh ose zbret numra me shifra të njëjta ose të ndryshme pas presjes dhjetore, përfshirë edhe veprime me paratë; - nxjerr përfundime për pjesëtimin kur herësi del numër i përzier apo numër dhjetor; - shumëzon numra dy, tri ose katërshifrorë (duke përfshirë edhe veprime me para) me numra njëshifrorë; - pjesëton numra trashifrorë me numra njëshifrorë, duke përfshirë edhe ata që dalin me mbetje dhe pjesëton numra trashifrorë me numra dyshifrorë (pa mbetje), duke përfshirë edhe veprime me para.		Fjalët kyçe: veti të shumëzimit dhe të pjesëtimin.	
Burimet: teksti, fletorja e punës.	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: gjuha dhe komunikimi, artet, sportet, teknologjia, shoqëria dhe mjedisi.		
Metodologjia, teknikat e përdorura, veprimtaritë e nxënësve			
Organizimi i orës së mësimin			
Parashikimi: Imagjinatë e drejtuar Nxënësit në këtë fazë punojnë në grupe të vogla. Klasa ndahet në grupe me nga 4-5 nxënës secili grup. Nxënësve u paraqitet një situatë imagjinare, ata duhet të prodhojnë një pije me kos dhe fruta dhe duhet ta shesin. Nxënësit orientohen të shohin situatën e ilustruar në librin e nxënësit. Mbështetet secili grup, teksa merren me problemën. Grupeve u jepet kohë të mendojnë në fillim, që të vendosin strategjinë e tyre.			
Ndërtimi i njohurive: Puno, mendo, diskuto Grupet ndajnë zgjidhjet e tyre dhe mënyrën e të menduarit për pyetjet përfundimtare. Pyetet klasa dhe pas përgjigjeve arrihet në një përfundim. Cili grup pati arsyetimin më të mirë “të çmimit”?			
Shtrohen gjithashtu pyetjet: ☐ Nga e dije se cilën përllogaritje do të përdorje? ☐ Si e kuptove këtë? ☐ A është përgjigjja e arsyeshme?			
Më pas grupeve u jepet një nga problemat për t'i zgjidhur: - Shpejtësia e një avioni është 915 km për orë. Sa km do të bëjë avioni për 4 orë? - Në një karçof ka 0,72 mg hekur. Sa miligram hekur ka në 6 karçofë? - Sa sekonda ka në 3 minuta? 100 faqe letër janë 4,7 mm të trasha. Sa e trashë është 1 faqe letër? - Një pako me stilolapsa përmban 8 stilolapsa. Një kuti përmban 24 pako. Sa stilolapsa ka në 6 kuti?			
Përforcimi: Shkëmbe një problemë Nxënësit vazhdojnë qëndrojnë në grupe dhe në këtë fazë. Ashtu në grupe ata formojnë vetë një problemë të ngjashme me atë të dhënë nga mësuesja. Më pas ia japin një grupi tjetër për ta zgjidhur. Diskutohen disa nga problemat e krijuara nga grupet.			
Vlerësimi: Gjatë kësaj ore mësimi, nxënësit do të vlerësohen për zbatimin, mbledhjen, shumëzimin, pjesëtimin e numrave të ndryshëm.			
Detyrë për punë të pavarur: Pjesa përkatëse në fletoren e punës jepet për t'u punuar në shtëpi.			

Fusha Matematikë:	Lënda: Matematikë	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Shumëzimi dhe pjesëtimi (Përforcojmë)		Situata e të nxënit:	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - shumëzon numra dy, tre ose katërshifrorë (duke përfshirë edhe veprime me para) me numra njëshifrorë; - shumëzon numra dy ose treshifrorë me numra dyshifrorë; - nxjerr përfundime për pjesëtimin ku herësi del numër i përzier apo numër dhjetor.		Fjalët kyçe: veti të shumëzimit dhe të pjesëtimit.	
Burimet: teksti, fletorja e punës.	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: gjuha dhe komunikimi, artet, sportet, teknologjia, shoqëria dhe mjedisi.		
Metodologjia, teknikat e përdorura, veprimtaritë e nxënësve			
Organizimi i orës së mësimit			
Parashikimi: Diskutim mbi njohuritë paraprake Nxënësit diskutojnë në dyshe idetë e këtij kapitulli. Një listë të këtyre ideve shkruhet në dërrasë. Nxënësit pyeten: ☐ Cilat ide kuptoheshin më lehtë? ☐ Cilat ide ishin më të vështira? ☐ Sa metoda mësuat për kryerjen e shumëzimit? ☐ Cila ishin vetitë e shumëzimit? Çfarë është pjesëtimi? ☐ Në sa mënyra e kemi kryer pjesëtimin? ☐ Përforcohen çështjet ku nxënësit hasin më shumë vështirësi.			
Ndërtimi i njohurive: Puno, mendo, diskuto në dyshe Nxënësit udhëzohen të vëzhgojnë veprimtaritë në librin e nxënësit. Ata punojnë në dyshe për këto veprimtari dhe shprehin mendimin e tyre me shokun. Kjo i ndihmon të kontrollojnë mënyrën e të menduarit para se ta shkruajnë. Disa dyshe paraqesin përgjigjet e tyre për ushtrimet 1 dhe 2.			
Shtrohen pyetjet: ☐ Cili është hapi i parë në zgjidhjen e kësaj përllogaritjeje? ☐ Nga e dije që përgjigjja është e saktë? ☐ Cila është vlera e kësaj shifre? ☐ A ka mbetje?			
Përforcimi: Rishikim në dyshe Edhe në këtë fazë nxënësit punojnë në dyshe me shokun ose shoqen pranë. Ata duhet të zgjidhin problema, të cilat u jepen në fisha nga mësuesja. Ja disa shembuj problemash: - Një palë gërsërë kushtojnë 25 lekë. Sa do të kushtojnë 4 palë gërsërë? - Një pako çokollata M&M përmban 36 çokollata të vogla. Sa çokollata përmbajnë 5 pako M&M? - Një anije udhëtimi, lëviz me një shpejtësi prej 25 milje për orë. Sa orë do t'i duhet anijes për të kryer 100 milje? Disa prej problemave diskutohen me të gjithë klasën.			
Vlerësimi: Gjatë kësaj ore nxënësit do të vlerësohen për shumëzimin, pjesëtimin e numrave të ndryshëm, si dhe për zbatimin e vetive të mësuara.			
Detyrë për punë të pavarur: Pjesa përkatëse në fletoren e punës jepet për t'u punuar në shtëpi.			

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Test i ndërmjetëm tremujori II		Situata e të nxënit: test.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave matematikore sipas temës mësimore Nxënësi/ja: • zgjedh metodën që mund të përdor për të shumëzuar me efikasitet; • thonë se çfarë përfaqësojnë shifrat e një numri; • zgjedh metodën që mund të përdoret për të pjesëtuar me efikasitet; • përdor pjesëtimin për të zgjidhur problema që përfshijnë edhe paratë; • tregon se çfarë është një numër i përzier; • pjesëton në rastet kur herësi është thyesë ose numër dhjetor; • pjesëton me një numër njëshifror; • paraqet mbetjen e një pjesëtimi; • përdor ligjet e ndërrimit, të shoqërimit dhe të përdasisë për shumëzimin.		Fjalët kyçe: shumëzim, pjesëtim, veti të shumëzimit, thyesë, numër i përzier, numër dhjetor.	
Burimet: letër A4.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Testi zhvillohet në 45 minuta dhe vlerësimi bëhet sipas tabelës së pikëve.			

Test I ndërmjetëm
Tremujori i dytë (janar - mars)
Klasa VI

Emri:

Grupi A

Mbiemri:

Klasa: VI

1. Kryej veprimet.

(4 pikë)

$$324,9 - 8,25$$

$$124,9 + 9,25$$

$$(-5) + 22$$

$$(-12) - (-28)$$

2. Kryej veprimet duke përdorur vetinë e përdasimit.

(4 pikë)

$$12 \cdot 99$$

$$74 \cdot 101$$

$$25 \cdot 98$$

$$15 \cdot 210$$

3. Vazhdo me tri kufiza vargun.

(3 pikë)

2,2 ; 4,4; 8,8 ; ... ; ... ; ...

4. Brinja e një paralelogrami e ka gjatësinë 2,8 m. Perimetri i paralelogramit është 15 m. Sa është gjatësia e brinjës tjetër?

(4 pikë)

5. Pjesëto në shtyllë. Përfundimi të shprehet si numër dhjetor.

(3 pikë)

$$903 : 6$$

$$588 : 8$$

$$956 : 6$$

6. Cili është ai numër që shumëzohet me 0,3 dhe del 27?

(3 pikë)

7. 14 fëmijë do të ndajnë në mënyrë të barabartë 728 kopsa që kanë koleksionuar? Nga sa kopsa i takojnë secilit fëmijë?

(3 pikë)

8. Gjej perimetrin e katrorit me brinjë 6,5 cm.

(2 pikë)

9. Një shitës bleu 36 blloqe me 145 lekë secilin dhe i shiti ato me 259 lekë.

a. Sa kushtojnë të gjitha blloqet që bleu?

b. Sa lekë grumbullon shitësi, nëse i shet të gjitha blloqet?

c. Sa është fitimi i shitësit nëse i shet të gjitha blloqet?

(3 pikë)

Nota	4	5	6	7	8	9	10
Pikët	0 – 7	8 – 11	12 – 15	16 – 19	20 – 23	24 – 26	27 – 29

Test I ndërmjetëm
Tremujori i dytë (janar - mars)
Klasa VI

Emri:

Grupi B

Mbiemri:

Klasa: VI

1. Kryej veprimet: (4 pikë)
 $289,9 - 2,46$ $256,3 + 4,72$
 $(-8) + 34$ $(-21) - (-14)$

2. Kryej veprimet duke përdorur vetinë e përdasimit. (4 pikë)
 $11 \cdot 88$ $56 \cdot 110$
 $27 \cdot 98$ $24 \cdot 205$

3. Një shitës bleu 36 blloqe me 145 lekë secilin dhe i shiti ato me 259 lekë. (3 pikë)
 - a. Sa kushtojnë të gjithë blloqet që bleu?
 - b. Sa lekë grumbullon shitësi, nëse i shet të gjitha blloqet?
 - c. Sa është fitimi i shitësit nëse i shet të gjitha blloqet?

4. Vazhdo me tri kufiza vargun. (3 pikë)
 $1,2 ; 2,4 ; 4,8 ; \dots ; \dots ; \dots$

5. Brinja e një drejtkëndëshi e ka gjatësinë $3,4$ cm. Perimetri i drejtkëndëshit është $10,8$ cm. (4 pikë)
Sa është gjatësia e brinjës tjetër?

6. Pjesëto në shtyllë. Përfundimi të shprehet si numër dhjetor. (3 pikë)
 $73 : 4$ $135 : 6$ $259 : 8$

7. Cili është ai numër që shumëzohet me $1,5$ dhe del 45 . (3 pikë)

8. 12 fëmijë do të ndajnë në mënyrë të barabartë 408 kopsa që kanë koleksionuar. Nga sa kopsa i takojnë secilit fëmijë? (3 pikë)

9. Gjej perimetrin e katrorit me brinjë $3,8$ cm. (2 pikë)

Nota	4	5	6	7	8	9	10
Pikët	0 – 7	8 – 11	12 – 15	16 – 19	20 – 23	24 – 26	27 – 29

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Të njohim matematikanët (Projekt)		Situata e të nxënit: projekt.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave kyçe Nxënësit/ja: • kërkon informacione nga burime të ndryshme; • veçon ato informacione për të cilat projekti ka për qëllim; • realizon projektin duke përdorur informacionin e gjetur; • paraqet projektin duke përdorur një nga mjetet e teknologjisë informative.		Fjalët kyçe: matematika.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave matematikore sipas temës mësimore Nxënësi/ja: • njeh matematikanët; • zbulon rëndësinë dhe kontributin e disa matematikanëve në matematikën e sotme; • zbulon se si ngjarjet ndikojnë në zbulimet e matematikanëve.			
Burimet: letra formati me ngjyra, lapustila, tabak letre, gërrshërë etj.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: edukim figurativ.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Paraqitet projekti përpara klasës. Klasa ndahet në grupe me nga 6 ose 7 nxënës secili grup. Pas një diskutimi, secili grup zgjedh drejtuesin e tij, dhe më pas formon brenda tij dyshe ose treshe, të cilat do të merren me punë të ndryshme në lidhje me temën e projektit. Nxënësve u sqarohet se secili prej tyre do të ketë një portofol personal me detyrat e ngarkuara për të realizuar, si dhe rezultatet e arritura. Paraqitja e temës së projektit realizohet nga një përfaqësues i grupit. Paraqitet puna e grupeve në lidhje me temën “Të njohim matematikanët”. Secili grup paraqet para audiencës punën e zhvilluar, kërkimet e informacionit të përdorur, përzgjedhjen e këtij informacioni, burimet nga ku kanë marrë informacionin, dhe në fund projektin përfundimtar.			
Vlerësimi: Gjatë këtij projekti, nxënësit do të vlerësohen për bashkëveprimin në grup dhe për ndarjen e detyrave midis anëtarëve të grupit.			

Projekt 4

TEMA: TË NJOHIM MATEMATIKANËT

Burimet e nevojshme:

1. Qasja në internet dhe/ose materiale të tjera reference.
2. Materialet e nevojshme për të përfunduar projektin.
3. Lista e matematikanëve të kërkimit dhe forma “Më lejoni t’ju prezantoj”.
4. Drejtimet e projektit / Përshkrimi i fletës.

Përgatitja e mësuesit:

1. Bëni kopje të fletëve-udhëzime / Përshkruani formën “Më lejoni t’ju prezantoj”.
2. Shqyrtoni informacionin e mësipërm me të gjithë grupin dhe bini dakord për një mënyrë pune.

Shpjegimi i aktivitetit:

Ky aktivitet do të zgjasë rreth 1 orë mësimore. Mësuesi do të veprojë si një lehtësues dhe do të ndihmojë nxënësit në mënyrë individuale, si dhe grupet e vogla.

Udhëzime:

1. Hulumtim i plotë për të mësuar rreth një matematikani të famshëm Zgjidhni një nga format e projektit për paraqitjen e hulumtimit.
2. Çdo nxënës/e duhet të kryejë kërkimin e tij/saj dhe të plotësojë formularin “Më lejoni t’ju prezantoj”.
3. Plotësoni dhe paraqisni projektin.

PËRSHKRIM

I gjithë projekti në vijim duhet të përfshijë të gjithë informacionin e marr nga forma “Më lejoni t’ju prezantoj”.

- **Mobile:** Krijoni një celular të varur që tregon historinë e jetës së matematikanit. Çdo formë në celular duhet të përfaqësojë një pjesë të formularit të kërkimit “Më lejoni t’ju prezantoj”. Piktura ose shkrimi në çdo formë duhet të shpjegojë pjesë të rëndësishme të biografisë së matematikanit.
- **Raportimi me gojë:** Veshje si personi që keni zgjedhur. Tregoni “historinë tuaj” të jetës në një mënyrë krijuese, duke përdorur pamje dhe/ose veprime.
- **Kolazh:** Përdorni fotografi, fjalë, harta dhe simbole për të krijuar një kolazh të madh në një poster në lidhje me matematikanin. Përdoreni këtë për të dhënë një prezantim me gojë në klasë.
- **Prezantimi i PowerPoint:** Përdorni fotografi, fjalë, harta dhe simbole për të krijuar një prezantim në PowerPoint në lidhje me matematikanin. Përdoreni këtë për të dhënë një prezantim me gojë në klasë.

Vlerësimi

- _____ **20 pikë.** Plotësoni formularin “Më lejoni t’ju prezantoj”.
- _____ **20 pikë.** Prezantimi përfundimtar përfshin të gjitha hulumtimet.
- _____ **20 pikë.** Kreativiteti.
- _____ **20 pikë.** Përpyjekja individuale.
- _____ **20 pikë.** Cilësia e prezantimit përfundimtar.
- _____ **100 pikë.** (pikë gjithsej)

Nota përfundimtare _____

Lista e Matematikanëve të Famshëm:

Arkimedi	Sophie Germain	Blaise Pascal
Girolamo Cardano	James Gregory	Ptolemy
Bonaventura Cavalieri	Hypatia	Pitagora
Rene Descartes	Johannes Kepler	Srinivasa Ramanujan
Euklid	Joseph-Louis Lagrange	Simon Stevin
Leonhard Euler	Pierre Simon de La Place	Nicolo Tartaglia
Pierre de Fermat	Gottfried Leibniz	Tales
Leonardo Fibonacci	John Napier	John Vann
Galileo Galilei	Sir Isaac Newton	Francois Viete
Evariste Galois	Amalie Emmy Noether	John Wallis
Carl Gauss	Zgjidhe ti	Zgjidhe ti

Emri: _____

Data: _____

“ MË LEJONI T’JU PREZANTOJ ”

Merrni shënime në skicën e mëposhtme për të hulumtuar matematikanin tuaj.

A. Të dhënat mbi jetën:

1. Emri
2. Jetëgjatësia
3. Vendlindja
4. Moshë në vdekje

B. Tri ngjarje historike botërore që kanë ndodhur gjatë jetës së tij / saj

- 1.
- 2.
- 3.

C. Edukimi

D. Gjendja martesore dhe familjare

E. Puna

F. Tre Kontribute në Matematikë

- 1.
- 2.
- 3.

G. Dy ngjarje interesante nga jeta e tij/saj

- 1.
- 2.

H. Bibliografi

- 1.
- 2.
- 3.

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Figurat dhe trupat gjeometrikë (Diskutojmë së bashku)		Situata e të nxënit: Udhëtim imagjinar.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: - klasifikon shumëkëndëshat e ndryshëm dhe kupton nëse një figurë dypërmasore (2D) është ose jo shumëkëndësh; - identifikon dhe përshkruan vetitë e katërkëndëshave.		Fjalët kyçe: figura gjeometrike.	
Burimet: - libri i nxënësit; - skeda treguese; - përzgjedhje nga revistat dhe gazetatat që lexohen rregullisht në familje.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: gjuha dhe komunikimi, artet, sportet, teknologjia, shoqëria dhe mjedisi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Parashikimi: Imagjinatë e drejtuar Nxënësit shohin pamjen në <i>Librin e nxënësit</i> . Shtrohet situata imagjinare. Imagjinoni sikur po bëni një udhëtim në Apoloni. Aty shikoni pamjen e dhënë në figurën në libër. Gjatë parashtrimit të situatës imagjinare shtrohet pyetja: Nga se përbëhet ndërtesa që po vështroni? Nxënësit ndahen në grupe me nga 4 deri në 5 nxënës secili grup. Grupet udhëzohen të rendisin sa më shumë figura që të mundën. Grupet raportojnë pas 5 minutash. Krijohet një listë me të gjitha figurat në tabelë. Çdo grup duhet të shkruajë një skedë për secilën figurë. Tani grupet duhet t'i klasifikojnë figurat të paktën në tri mënyra të ndryshme (p.sh.: dypërmasore/tripërmasore, e rregullt/e parregullt , me numër të barabartë brinjësh, me numër të barabartë këndesh, me brinjë të drejta , me brinjë të lakuara).			
Ndërtimi i njohurive: Puno, mendo, diskuto Secili grup pajiset me disa gazeta e revista. Nxënësit duhet të presin sa më shumë imazhe që arrijnë të gjejnë. Pastaj duhet të përzgjedhin figurat, të cilat ngjasojnë me këto imazhe dhe të bëjnë një afishe, duke përdorur sa më shumë veti të figurave që arrijnë të kujtojnë. Grupet paraqesin afishet para klasës. Vetitë e figurave të përmendura renditen në tabelë.			
Përforcimi: Rishikim në dyshe Nxënësit në këtë fazë punojnë në dyshe me shokun ose shoqen pranë. Atyre u jepet për ta plotësuar, tabela e mëposhtme.			
Figura	Numri i brinjëve	Numri i kulmeve	Numri i këndeve
Katrori			
Drejtëkëndëshi			
Rombi			
Trekëndëshi			
Trapezi			
... ..			
Aktivizohen disa dyshe për plotësimin e tabelës dhe diskutimin e saj me të gjithë klasën.			
Vlerësimi: Gjatë kësaj ore mësimi, nxënësit vlerësohen për dallimin e figurave me dy e tri përmasa dhe marrëdhëniet mes tyre, p.sh.: prerja me plan e një kuboidi është drejtëkëndësh.			
Detyrë për punë të pavarur: Pjesa përkatëse në fletoren e punës jepet për t'u punuar në shtëpi.			

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Klasifikimi i shumëkëndëshave (Zbulojmë)		Situata e të nxënësve: Figura me letra.	
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - klasifikon shumëkëndëshat e ndryshëm dhe kupton nëse një figurë dypërmasore (2D) është ose jo shumëkëndësh. - identifikon dhe përshkruan vetitë e katërkëndëshave.		Fjalët kyçe: figura gjeometrike.	
Burimet: - Libri i nxënësit, fletore pune; - trekëndësh i madh barabrinjës; - katror i madh; - karton, gërrshërë.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: gjuha dhe komunikimi, artet, sportet, teknologjia, shoqëria dhe mjedisi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Parashikimi: Kërkim – hulumtim Paraqitet para klasës tema dhe rezultatet e të nxënësve. Më pas mësuesja fton dy nxënës para klasës, të cilët mbajnë në dorë secili nga një figurë gjeometrike. Njërit i kërkohet të mbajë trekëndëshin e madh barabrinjës dhe tjetrit të mbajë katrorin e madh. Dy nxënësit udhëzohen të afrohen me njëri-tjetrin dhe gradualisht t’i mbivendosin dy figurat. Gjatë fazës së afrimit nxënësit duhet të ndalojnë herë pas here. Sa herë ndalojnë, nxënësve u kërkohet të shkruajnë sa më shumë karakteristika që të mundën për figurat që shohin, kur ndodh mbivendosja. I jepet pak kohë që ta bëjnë këtë. Në fund, dyshet raportojnë për mbivendosje. Shtrohen pyetjet: □ Çfarë vutë re gjatë mbivendosjes së figurave? □ Çfarë keni shkruar për trekëndëshin? □ Po për katrorin? □ Në çfarë konkluzioni arritët pas mbivendosjes? Dëgjohen përgjigjet e nxënësve.			
Ndërtimi i njohurive: Lëviz rrotull, fol rrotull Nxënësit përdorin gërrshërët dhe kartonin për të bërë figurat që u duhen për të kryer veprimtaritë në librin e nxënësit. Nxënësit nxiten të përdorin fjalorin matematikor për t’i ndihmuar të klasifikojnë çdo figurë që nuk e dinë, për shembull: gjashtëkëndëshin, shtatëkëndëshin, tetëkëndëshin . Gjatë kësaj faze nxënësit ndihmohen nga mësuesja për përcaktimin e figurave gjeometrike. Rikujtohet se figurat gjeometrike emërohen sipas numrit të kulmeve ose të brinjëve. Nxënësit vizatojnë në një skedë treguese ose në fletoret e tyre, një nga figurat që përdorën për t’i mbivendosur në ushtrimin 1. Pastaj lëvizin nëpër lirshëm nëpër klasë. Kur mësuesi të thotë “Ndal”, nxënësit bëhen dyshe me atë që kanë pranë. Në dyshe ata duhet të gjejnë një veti të përbashkët dhe një dallim mes dy figurave që mbajnë në duar. Vazhdohet loja dhe nxiten nxënësit të përdorin një fjalor sa më të pasur.			
Përforcimi: Rishikim në dyshe Nxënësit edhe në këtë fazë punojnë në dyshe. Secilës dyshe i jepet për të vizatur një figurë gjeometrike. P.sh.: Ndërtoni një trekëndësh me dy brinjë të barabarta, ndërtoni një katërkëndësh, ndërtoni një pesëkëndësh, ndërtoni një romb etj. Shihet shumëllojshmëria e figurave të vizatuara nga nxënësit.			
Vlerësimi: Gjatë kësaj ore mësimi, nxënësit vlerësohen për dallimin e figurave me dy e tri përmasa dhe marrëdhëniet mes tyre, p.sh.: prerja me plan e një kuboidi është drejtkëndësh.			
Detyrë për punë të pavarur: Pjesa përkatëse në fletoren e punës jepet për t’u punuar në shtëpi.			

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Klasifikimi i shumëkëndëshave (Eksplorojmë)		Situata e të nxënësve: Vizatojmë figura.	
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - klasifikon shumëkëndëshat e ndryshëm dhe kupton nëse një figurë dypërmasore (2D) është ose jo shumëkëndësh. - identifikon dhe përshkruan vetitë e katërkëndëshave.		Fjalët kyçe: shumëkëndësja, elemente të shumëkëndëshit.	
Burimet: teksti, fletorja e punës.	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: gjuha dhe komunikimi, artet, sportet, teknologjia, shoqëria dhe mjedisi.		
Metodologjia, teknikat e përdorura, veprimtaritë e nxënësve			
Organizimi i orës së mësimit			
Parashikimi: Kërkim – hulumtim			
Në këtë fazë nxënësit punojnë me grupe. Secilit grup i jepet një litar me të cilin krijon figura gjeometrike. Nxënësve u kërkohet të krijojnë këto figura: një katror; një drejtkëndësh; një drejtkëndësh të ndryshëm nga i mëparshmi; një trekëndësh; një trekëndësh barabrinjës; një trekëndësh kënddrejtë; një trekëndësh dybrinjënjëshëm; një trekëndësh të çfarëdoshëm; një gjashtëkëndësh. Pas çdo veprimi, një nxënës nga secili grup skicon figurën që bënë në një tabak letre. Në fund të veprimtarisë, grupet nxjerrin disa përfundime. Për t'i ndihmuar nxënësit në nxjerrjen e përfundimeve shtrohen pyetjet: ☐ A janë figurat tuaja saktësisht njësoj? ☐ A kanë figurat tuaja të njëjtat përmasa? ☐ Si mund t'i argumentoni përfundimet tuaja? Ndërtimi i njohurive: Puno, mendo, diskuto në dyshe Nxënësit punojnë në dyshe për veprimtaritë në librin e nxënësit. Dyshet nxiten t'i diskutojnë përgjigjet, të vizatojnë dhe të emërtojnë trekëndësja e shumëkëndësja të ndryshëm (fillimisht më vete, para se t'i vizatojnë në seksionin e duhur të tabelave klasifikuese). U kujtohet nxënësve se një shumëkëndësh është një figurë e mbyllur me dy përmasa, me brinjë të drejta. Çdo figurë me brinjë të lakuara ose e pambyllur nuk është shumëkëndësh. Nëse është e nevojshme, kujtojuni nxënësve brinjët paralele dhe pingule. Ata duhet të jenë të qartë kur emërtojnë figurat në ushtrimin 2. Për shembull, ata mund të përdorin “trekëndësh barabrinjës” për një trekëndësh të rregullt ose “katror” për një katërkëndësh të rregullt. Një pesëkëndësh i rregullt duhet shkruar thjesht si “pesëkëndësh i rregullt”, në mënyrë që të theksohet se një “pesëkëndësh i rregullt” është një rast i veçantë i “pesëkëndëshit”.			

Përforcimi: Puno, mendo, diskuto

Vizatohet një tabelë e madhe në dërrasë, si kjo:

	Shumëkëndësh	Joshumëkëndësh
Ka vetëm kënde të ngushta		
Ka të paktën një kënd të gjerë		
Ka të paktën një kënd reflektiv		

Nxënësit vijjnë në dërrasë një e nga një dhe vizatojnë një figurë në një prej kutive në dërrasë. Kujtojmë bashkë me nxënësit kuptimin e termave: i ngushtë, i gjerë dhe reflektiv.

Vlerësimi: Gjatë kësaj ore mësimi, nxënësit vlerësohen për dallimin e figurave me dy e tri përmasa dhe marrëdhëniet mes tyre, p.sh.: prerja me plan e një kuboidi është drejtkëndësh.

Detaje për punë të pavarur: Pjesa përkatëse në fletoren e punës jepet për t'u punuar në shtëpi.

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Vetitë e trupave (Zbulojmë)		Situata e të nxënit: Trupa gjeometrikë të krijuar nga nxënësit.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: • përfytyron dhe përshkruan vetitë e trupave trepërmasorë; • dallon paraqitjet e figurave dypërmasore dhe trupave trepërmasorë.		Fjalët kyçe: trupa gjeometrikë.	
Burimet: teksti, fletorja e punës.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: gjuha dhe komunikimi, artet, sportet, teknologjia, shoqëria dhe mjedisi.	
Metodologjia, teknikat e përdorura, veprimtaritë e nxënësve			

Organizimi i orës së mësimit

Parashikimi: Diskutim mbi njohuritë paraprake

Klasa ndahet në grupe.

Fillimisht mësuesja u kërkon nxënësve që në mënyrë individuale të shkruajnë çdo fjalë apo shprehje që ka lidhje me termin trup gjeometrik.

Nxënësit lihen 3 minuta të shkruajnë individualisht dhe më pas diskutojnë në grup dhe hartojnë një listë të përbashkët.

Përfaqësuesi i grupit bën prezantimin e punës.

Trup gjeometrik:

kub;

kuboid;

faqe;

brinjë;

gjatësi;

gjerësi;

lartësi;

prizëm;

vëllim.

Ndërtimi i njohurive: Analiza e tipareve semantike

Mësuesja i orienton nxënësit të vëzhgojnë veprimtarinë në *Librin e nxënësit* për 2-3 min. Më pas, ata krijojnë trupat sipas kërkesës së veprimtarisë.

Mbyllen librat dhe pa i parë sërish trupat, mësuesja u shpërndan nxënësve nga një fletë ku ka vizatuar tabelën që do të plotësojnë gjatë punës.

Në fund grupet lexojnë përfundimet e nxjerra dhe plotësohet tabela e mëposhtme.

Trupi	Numri i brinjëve	Numri i kulmeve	Numri i faqeve
Kuboidi	12	8	6
Prizmi trekëndor	...	...	...
Piramida katërkëndore	...	...	...

Lexohen përfundimet nga disa nxënës.

Përforcimi: Rishikim në dyshe

Nxënësit plotësojnë në mënyrë individuale tabelën në *Librin e nxënësit*. Nxënësit krahasojnë dhe diskutojnë në dyshe plotësimin e detyrës.

Më pas diskutimet zgjerohen me klasën, duke arsyetuar rreth plotësimit të saj.

Vlerësimi: Gjatë kësaj ore mësimi, nxënësit vlerësohen për dallimin e figurave me dy e tri përmasa dhe marrëdhëniet mes tyre, p.sh.: prerja me plan e një kuboidi është drejtkëndësh.

Detyrë për punë të pavarur: Pjesa përkatëse në fletoren e punës jepet për t'u punuar në shtëpi.

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Vetitë e trupave (Eksplorojmë)		Situata e të nxënës: Trupa gjeometrikë të krijuar nga nxënësit.	
Rezultatet e të nxënës të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - përfytyron dhe përshkruan vetitë e trupave trepërmasorë; - dallon paraqitjet e figurave dypërmasore dhe të trupave trepërmasorë.			Fjalët kyçe: trupa gjeometrikë.
Burimet: teksti, fletorja e punës.	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: gjuha dhe komunikimi, artet, sportet, teknologjia, shoqëria dhe mjedisi.		
Metodologjia, teknikat e përdorura, veprimtaritë e nxënësve			
Organizimi i orës së mësimi			
Parashikimi: Kërkim i pyetjeve			
Klasa në këtë fazë punon e ndarë në grupe me nga 5-6 nxënës secili grup. Mësuesja u shpërndan nxënësve të vendosur në grupe trupa gjeometrikë: kub, kuboid, prizëm, piramidë etj. Secili nxënës në një tabelë të vizatuar në fletore bën përshkrimin e trupit dhe gjithashtu shkruan pyetje rreth trupit.			
Përshkrimi i trupit	Pyetje rreth trupit	Përgjigje	
Çdo nxënës pasi e ka plotësuar tabelën ua tregon shokëve të grupit. Gjatë leximit të pyetjeve nxënësit e tjerë të grupit mund t'u përgjigjen pyetjeve të bëra. Pas 10 minutash, nga një përfaqësues për secilin grup paraqet përshkrimin dhe pyetjet e bëra për trupin që kanë. Ndërtohet një tabelë me pyetjet e mbetura pa përgjigje dhe vendoset në një kënd të klasës nëse askush nuk jep përgjigje për momentin. Mësuesja do të shfrytëzojë pyetjet e nxënësve, por nëse nuk ka mundësi do t'u ofrojë vetë pyetje atyre.			
Ndërtimi i njohurive: Puno, mendo, diskuto			
Në këtë fazë një nxënës ftohet para klasës. Ai duhet të ndërtojë një trup gjeometrik me plastelinë dhe kunja. Nxënësit e tjerë i japin udhëzime për të bërë një kub, duke përdorur plastelinë dhe shkopinj modelimi, siç ilustron në <i>Librin e nxënësve</i> . Secili nxënës mund të japë vetëm një udhëzim; pastaj është radha e një nxënësi tjetër, i cili do të krijojë një trup tjetër gjeometrik.			
Udhëzimet bazë shkruhen në dërrasë, si model për ushtrimet në <i>Librin e nxënësve</i> , për shembull:			
- Ngjisni dy shkopinj pas një topi të vogël plasteline. Vendosini shkopinjtë në kënd të drejtë me njëri-tjetrin. Nxënësit punojnë në dyshe për veprimtarinë në <i>Librin e nxënësve</i>, për të nxitur diskutimin mes tyre shtrohet pyetja: - Çfarë vini re për marrëdhënien mes shkopinjeve, topave të plastelinës, numrit të kulmeve dhe faqeve të trupit?			
Përforcimi: Rishikim në dyshe			
Një dyshe përshkruan trupin me tri përmasa që krijoi vetë. Përshkrimi duhet të jetë i tillë, që trupi të kopjohet me saktësi. Ndërsa nxënësit përshkruajnë trupin, shtrohen pyetje dhe modelohen fraza, duke përdorur fjalorin e trupave për të dhënë shprehjen e duhur, për shembull:			
<i>Sa faqe ka ky trup?</i> <i>Ky trup ka pesë faqe.</i> <i>Ç'formë kanë faqet?</i> <i>Dy faqet janë secila trekëndësh barabrinjës. Ato kanë të njëjtën madhësi.</i>			
Vlerësimi: Gjatë kësaj ore mësimi, nxënësit vlerësohen për dallimin e figurave me dy e tri përmasa dhe marrëdhëniet mes tyre, p.sh.: prerja me plan e një kuboidi është drejtkëndësh.			
Detyrë për punë të pavarur: Pjesa përkatëse në fletoren e punës jepet për t'u punuar në shtëpi.			

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Hapja e trupave (3D) nëpërmjet figurave (2D) (Zbulojmë)		Situata e të nxënës: Trupa gjeometrikë të krijuar nga nxënësit.	
Rezultatet e të nxënës të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - përfytyron dhe përshkruan vetitë e trupave trepërmasorë; - dallon paraqitjet e figurave dypërmasore dhe trupave trepërmasorë.			Fjalët kyçe: trupa gjeometrikë, hapje e trupave gjeometrikë.
Burimet: teksti, fletorja e punës.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: gjuha dhe komunikimi, artet, sportet, teknologjia, shoqëria dhe mjedisi.	
Metodologjia, teknikat e përdorura, veprimtaritë e nxënësve			
Organizimi i orës së mësim.			
Parashikimi: Diskutim për njohuritë paraprake Mësuesja u paraqet nxënësve një kub dhe i fton ata të diskutojnë rreth njohurive që kanë për kubin. Diskutimi mund të nxitet me anë të pyetjeve: ➤ Sa brinjë dhe sa faqe ka kubi? ➤ A i shohim të gjitha brinjët e tij në një pozicion të caktuar? ➤ A kanë brinjët ndonjë lidhje ndërmjet tyre? Në këtë formë kjo veprimtari mund të përsëritet dhe për një trup tjetër, në mënyrë që të përsëriten njohuritë që ata kanë për trupat gjeometrikë.			
Ndërtimi i njohurive: Mbajtje e strukturuar e shënimeve Mësuesja u jep nxënësve të punojnë ushtrimet 1, 2, 3 të <i>Libri i nxënësit</i> . Për të zgjidhur këto ushtrime duhet të mbahen shënimet përkatëse. Nxënësit lihen për disa minuta të mendohen dhe më pas, diskutohet çdo hap i bërë për zgjidhjen e tyre. Nxënësit u përgjigjen kërkesave të çdo ushtrimi duke u bazuar në mbajtjen e shënimeve të bëra më parë. Më pas, nxënësve u kërkohet që informacionin e përfutur deri tani ta paraqesin në mënyrë të strukturuar. Një paraqitje mund të ishte:			
Hapja 12 brinjë 6 faqe ... Kuboidi ...			
Përforsimi: Rishikim në dyshe Nxënësit punojnë në dyshe për ushtrimin 4 në <i>Librin e nxënësit</i> për të nxitur diskutime mes tyre. Jepini secilës dyshe një kuti (ju mund t’u kërkonit nxënësve të sjellin kutitë e tyre nga shtëpia, për këtë veprimtari). Pasi nxënësit përfundojnë zgjidhjen e ushtrimit 4, merren raportime prej tyre. Shtrohen pyetjet: ➤ Çfarë vutë re në ndryshimin midis vëllimeve të maketit dhe kutisë origjinale? Shkruhen këto fjali në dërrasë dhe u kërkohet nxënësve t’i plotësojnë, duke parë modelet e tyre: - Unë dyfishoj përmasat e një kutie. Përmasa e re është ____ herë sa gjatësia origjinale. - Unë dyfishoj përmasat e një kutie. Sipërfaqja e re e një faqeje është ____ herë sa sipërfaqja origjinale e një faqeje. - Unë dyfishoj përmasat e një kutie. Vëllimi i ri është ____ herë sa vëllimi origjinal. Ndërsa vëllimi studiohet edhe në klasat më të larta, nxënësit kanë intuitë për ta kuptuar vëllimin, sidomos kur punojnë me modele me tri përmasa.			
Vlerësimi: Gjatë kësaj ore mësimi, nxënësit vlerësohen për dallimin e figurave me dy e tri përmasa dhe marrëdhëniet mes tyre, p.sh.: Prerja me plan e një kuboidi është drejtkëndësh.			
Detyrë për punë të pavarur: Pjesa përkatëse në fletoren e punës jepet për t’u punuar në shtëpi.			

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Hapja e trupave (3D) nëpërmjet figurave (2D) (Eksplorojmë)		Situata e të nxënës: Trupa gjeometrikë të krijuar nga nxënësit.	
Rezultatet e të nxënës të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: - përfytyron dhe përshkruan vetitë e trupave trepërmasorë; - dallon paraqitjet e figurave dypërmasore dhe trupave trepërmasorë.		Fjalët kyçe: trupa gjeometrikë, hapje e trupave gjeometrikë.	
Burimet: teksti, fletorja e punës.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: gjuha dhe komunikimi, artet, sportet, teknologjia, shoqëria dhe mjedisi.	
Metodologjia, teknikat e përdorura, veprimtaritë e nxënësve			
Organizimi i orës së mësim. Parashikimi: Imagjinatë e drejtuar Nxënësit njihen me temën dhe me rezultatet e të nxënës për këtë temë mësimore. Më pas nxënësit orientohen të vëzhgojnë situatën në libër. Imagjinoni sikur keni katër kuba të vendosur si në figurë. Shtrohen pyetjet: Kjo është e vetmja mënyrë se si mund t'i vendosim kubat? Cila do të ishte mënyra tjetër? Dëgjohen dhe diskutohen mënyrat e dhëna nga nxënësit. Më pas nxënësve u kërkohet të plotësojnë veprimtarinë në librin e nxënësve.			
Ndërtimi i njohurive: Puno, mendo, diskuto në dyshe Në këtë fazë nxënësit punojnë në dyshe me shokun ose shoqen pranë. Secilës dyshe i përcaktohet të ndërtojë një model me një sasi të caktuar kubesh, p.sh me 5 kube. Më pas dyshet për këtë model përcaktojnë dhe pamjen nga sipër, atë ballore dhe pamjen anësore. Dyshet që kanë të njëjtat sasi kubesh shkëmbejnë fletoret në mënyrë që të shohin nëse kanë krijuar të njëjtin model apo jo. Disa modele diskutohen me të gjithë klasën. Përforcimi: Rishikim në dyshe Nxënësit punojnë sërish në dyshe me shokun/shoqen pranë. Tashmë në tabelë do të shkruhen disa pyetje në lidhje me trupat. Nxënësit duhet t'i japin përgjigje secilës pyetje në mënyrë individuale fillimisht dhe më pas ta diskutojnë me shokun/shoqen pranë. Disa nga pyetjet mund të jenë: Ç'figurë gjeometrike është secila faqe e kubit? Çfarë figure është baza e konit? Sa faqe ka një prizëm i drejtë? Çfarë figure është baza e poshtme dhe e sipërme e një cilindri? Përgjigjet e nxënësve diskutohen me të gjithë klasën.			
Vlerësimi: Gjatë kësaj ore mësimi, nxënësit vlerësohen për dallimin e figurave me dy e tri përmasa dhe marrëdhëniet mes tyre, p.sh.: Prerja me plan e një kuboidi është drejtkëndësh.			
Detyrë për punë të pavarur: Pjesa përkatëse në fletoren e punës jepet për t'u punuar në shtëpi.			


Fusha: Matematikë		Lënda: Matematikë	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Ndërtimi i këndeve dhe këndet e një trekëndëshi (Zbulojmë)			Situata e të nxënit: Ndërtojmë trekëndësha brenda një rrethi.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: • vlerëson, njeh dhe vizaton kënde të ngushta e të gjera; • përdor raportorin për të matur këndet me sa më shumë përafërsi; • verifikon që shuma e këndeve të një trekëndëshi të jetë 180°.			Fjalët kyçe: kënde, trekëndësh.	
Burimet: teksti, fletorja e punës.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: gjuha dhe komunikimi, artet, sportet, teknologjia, shoqëria dhe mjedisi.		
Metodologjia, teknikat e përdorura, veprimtaritë e nxënësve				
Organizimi i orës së mësimi				
Parashikimi: Kërkim – hulumtim				
Nxënësit punojnë në grupe me nga 5-6 nxënës secili grup. Nxënësit udhëzohen të marrin një fletë dhe ta palosin në fillim një herë, më pas dy herë dhe më pas tre herë. Në çdo rast nxënësit shohin se çfarë këndesh formohen nga palosja e fletës. Gjatë zhvillimit të veprimtarisë shtrohen pyetjet: ➤ Çfarë ju formohet nga palosja e fletës? ➤ A janë të njëjta të gjitha figurat që formohen? ➤ ➤ A mund t'i matim këndet e formuara? ➤ Në përfundim të kësaj veprimtarie nxënësi tregon këndet e ndryshme të formuara nga palosjet e letrës. Mësuesja u bën të qartë nxënësve se secili nga këndet e formuara mund të matet. Nxënësit diskutojnë mbi njësinë matëse të këndit si dhe mjetin me të cilën matet masa e këndit.				
Ndërtimi i njohurive: Kërkim – hulumtim				
Mësuesja i orienton nxënësit të flasin brenda grupit për llojet e këndeve. Nxënësit bëjnë krahasimin e këndeve të formuara nga palosja e fletës me këndin e drejtë dhe përgjigjen pyetjeve të mëposhtme. ➤ Si quhet këndi që është më i madh se këndi i drejtë? – Kënd i gjerë. ➤ Si quhet këndi që është më i vogël se këndi i drejtë? – Këndi i ngushtë. Për të pasur një përgjigje më të plotë mësuesja u kërkon nxënësve të vizatojnë një kënd të gjerë dhe një kënd të ngushtë.				
Përforcimi: Rishikim në dyshe				
Nxënësit punojnë në mënyrë të pavarur veprimtarinë në <i>Librin e nxënësit</i>. Pasi ata kanë ndërtuar trekëndëshat dhe kanë përcaktuar këndet në to, e kalojnë librin te shoku/shoqja pranë për të parë zgjidhjen e gjithsecilit. Në fund veprimtaria diskutohet me të gjithë klasën.				
Vlerësimi: Gjatë kësaj ore mësimi, nxënësit vlerësohen për dallimin dhe vizatimin e këndeve të ngushta e të gjera; përdorimin e raportorit për të matur këndet me sa më shumë përafërsi.				
Detyrë për punë të pavarur: Pjesa përkatëse në fletoren e punës jepet për t'u punuar në shtëpi.				

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Ndërtimi i këndeve dhe këndet e një trekëndëshi (Eksplorojmë)		Situata e të nxënit: Këndet në klasë (format trekëndore).	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - vlerëson, njeh dhe vizaton kënde të ngushta e të gjera; përdor raportorin për të matur këndet me sa më shumë përafërsi. - verifikon që shuma e këndeve të një trekëndëshi të jetë 180°.		Fjalët kyçe: kënde, trekëndësh.	
Burimet: teksti, fletorja e punës.	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: gjuha dhe komunikimi, artet, sportet, teknologjia, shoqëria dhe mjedisi.		
Metodologjia, teknikat e përdorura, veprimtaritë e nxënësve			
Organizimi i orës së mësimit			
Parashikimi: Harta e konceptit			
Mësuesja pasi paraqet temën e mësimit dhe rezultatet e të nxënit, zhvillon me nxënësit një përsëritje për këndin. Përsëritje paraqitet me anë të një harte koncepti.			
<pre>graph TD; K[Këndi] --> KG[Këndi i gjerë]; K --> KN[K. i ngushtë]; K --> KI[Këndi i...]; K --> MM[Mjet matës]; K --> NM[Njësia matës];</pre>			
Mësuesja pyet nxënësit të ndryshëm ndërkohë që plotësohet në tabelë ky diagram.			
Ndërtimi i njohurive: Kërkim hulumtim			
Mësuesja i orienton nxënësit të punojnë veprimtarinë në librin e nxënësve. Nxënësit lëvizin lirshëm nëpër klasë në mënyrë që të gjejnë dhe të matin këndet në ambientin e klasës. Më pas disa prej këndeve të gjetura dhe të matura nga nxënësit paraqiten përpara klasës.			
Shtrohen pyetjet: ➤ Çfarë vini re? ➤ Si janë këndet e gjetura nga ju? ➤ A ka ndonjë kënd me madhësi të njëjtë me një kënd tjetër?			
Përforcimi: Rishikim në dyshe			
Nxënësit punojnë në dyshe me shokun ose shoqen pranë ushtrimin që jepet nga mësuesja. Jepet një fletë për secilën dyshe, ku paraqiten disa kënde. Dyshet e nxënësve duhet t'i matin dhe t'i emërtojnë ato.			


Ja një shembull ushtrimi:

Matni masën e këndeve dhe emërtojini ato.


1)



2)



3)




4)



5)



6)



Disa prej grupeve e diskutojnë ushtrimin e tyre me të gjithë klasën.

Vlerësimi: Gjatë kësaj ore mësimi, nxënësit do të vlerësohen për dallimin dhe vizatimin e këndeve të ngushta e të gjera; për përdorimin e raportorit për të matur këndet me sa më shumë përafërsi.

Detyrë për punë të pavarur: Pjesa përkatëse në fletoren e punës jepet për t'u punuar në shtëpi.

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Figurat dhe trupat gjeometrikë (Përmbledhim)		Situata e të nxënit: Këndi i lojërave.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - dallon figurat dypërmasore dhe trupat trepërmasorë, si dhe marrëdhëniet mes tyre, p.sh.: prerja me plan e një kuboidi është drejtkëndësh; - parashtron, vlerëson dhe ripunon hipotezat, shpjegon dhe argumenton metodat, arsyeton strategjitë, rezultatet ose përfundimet me gojë.		Fjalët kyçe: figura gjeometrike, skicim.	
Burimet: teksti, fletorja e punës.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: gjuha dhe komunikimi, artet, sportet, teknologjia, shoqëria dhe mjedisi.	
Metodologjia, teknikat e përdorura, veprimtaritë e nxënësve			

Organizimi i orës së mësimi**Parashikimi: Diskutim mbi njohuritë paraprahe**

Mësuesja ndan klasën në tri grupe të mëdha. Secili grup shkruan çfarë ka mësuar në lidhje me një nga figurat apo trupat gjeometrike, si: paralelogram, trekëndësh, drejtkëndësh, kub, kuboid, prizëm etj. Secili grup zgjedh një nga figurat dhe një nga trupat. Pasi nxënësit diskutojnë me njëri-tjetrin në grup, mësuesja aktivizon nga një nxënës për çdo grup për të paraqitur në një tabelë të gjitha përfundimet e nxjerra, të cilat diskutohen me të gjithë klasën.

Ndërtimi i njohurive: Rolet në grupe bashkëpunuese

Mësuesja i ndan nxënësit në grupe dhe secili punon veprimtarinë në *Librin e nxënësit*. Secilit nxënës brenda grupit i caktohet një rol. Nxënësve u shpjegohen rolet një e nga një.

Pyetësi paraqet detyrën grupit.

Kontrolluesi merr masa që të gjithë anëtarët e grupit ta kuptojnë problemën dhe të përqendrohen në zgjidhjen e saj.

Mbajtësi i kohës mban kohën e caktuar për zgjidhjen e problemës dhe siguron që secili anëtar i grupit të kryejë detyrat në kohë.

Nxënësi fton e nxit të tjerët të përgjigjen, i përgëzon për idetë e mira dhe u kërkon të thonë më shumë.

Raportuesi i paraqet idetë e grupit të vogël para gjithë klasës.

Më pas aktivizohen disa grupe për të raportuar mbi zgjidhjen e problemës përkatëse.


Punët e secilit grup paraqiten para klasës për t'u parë nga grupet e tjera.

Përforcimi: Rishikim në dyshe


Nxënësit punojnë në dyshe me shokun ose shoqen pranë ushtrimit që jepet nga mësuesja. Për secilën dyshe, jepet një fletë, ku paraqiten disa ushtrime.

Disa tipa ushtrimesh mund të jenë:


1. Emërtoni secilin prej trupave.




2. Plotëso për secilin trup gjeometrik.



faqe brinjë kulme



faqe brinjë kulme



faqe brinjë kulme

Ushtrimet diskutohen në fund me të gjithë klasën.

Vlerësimi: Gjatë kësaj ore mësimi, nxënësit vlerësohen për dallimin dhe vizatimin e trupave dy dhe trepërmasorë.

Detyrë për punë të pavarur: Pjesa përkatëse në fletoren e punës jepet për t'u punuar në shtëpi.








Fusha: Matematikë		Lënda: Matematikë		Shkalla: III		Klasa: VI	
Tema mësimore: Figurat dhe trupat gjeometrikë (Përforcojmë)				Situata e të nxënët: Trupat dhe figurat në klasë.			
Rezultatet e të nxënët të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - dallon figurat dypërmasore dhe trupat trepërmasorë, si dhe marrëdhëniet mes tyre, p.sh.: prerja me plan e një kuboidi është drejtkëndësh; - parashtron, vlerëson dhe ripunon hipotezat, shpjegon dhe argumenton metodat, arsyeton strategjitë, rezultatet ose përfundimet me gojë.				Fjalët kyçe: figura gjeometrike, trupa gjeometrikë, skicim.			
Burimet: teksti, fletorja e punës.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: gjuha dhe komunikimi, artet, sportet, teknologjia, shoqëria dhe mjedisi.					
Metodologjia, teknikat e përdorura, veprimtaritë e nxënësve							
Organizimi i orës së mësimët							
Parashikimi: Diskutim mbi njohuritë paraprake Bashkë me nxënësit zhvillohet një përsëritje rreth njohurive të marra gjatë këtij kapitulli. Gjatë diskutimit shtrohen pyetjet: ➤ Çfarë quajmë trup gjeometrik? ➤ Çfarë quajmë figurë gjeometrike? ➤ Ku ndryshon trupi nga figura? ➤ Cilët janë disa nga trupat gjeometrikë që njihni? ➤							
Ndërtimi i njohurive: Kërkim – hulumtim Nxënësit ndahen në grupe me nga 5-6 nxënës secili grup. Grupet udhëzohen të vëzhgojnë nëpër klasë dhe të gjejnë trupa dhe figura të ndryshme gjeometrike. Më pas secili grup duhet t'i paraqesë këto trupa ose figura me anë të një vizatimi dhe të shkruajë sa më shumë të dhëna mbi to. Në këtë formë plotësohet veprimtaria në <i>Librin e nxënësit</i> . Pasi përfundojnë punën nëpër grupe, nxënësit aktivizohen për të treguar figurat që kanë gjetur dhe për të paraqitur para klasës vetitë dhe elementet e tyre.							
Përforcimi: Rishikim në dyshe Në këtë fazë nxënësit punojnë në dyshe me shokun ose shoqen pranë. Secili nxënës duhet t'i tregojë disa karakteristika të një trupi ose figure shokut/shoqes së bankës, ndërsa shoku/shoqja duhet të gjejë për çfarë figure apo trupi gjeometrikë bëhet fjalë. Secili nga nxënësit shpjegon nga se e kuptoi figurën apo trupin e zgjedhur nga tjetri/a.							

Vlerësimi: Gjatë kësaj ore mësimi, nxënësit vlerësohen për dallimin dhe vizatimin e trupave dy dhe trepërmasorë.

Detyrë për punë të pavarur: Pjesa përkatëse në fletoren e punës jepet për t'u punuar në shtëpi.

VETËVLERËSIM

1. Emërto trupat e dhënë.



2. Sa kulme dhe brinjë kanë figurat?

Një trekëndësh ka ____ kulme dhe ____ brinjë.



Një tetëkëndësh ka ____ kulme dhe ____ brinjë.

Një pesëkëndësh ka ____ kulme dhe ____ brinjë.

Një katërkëndësh ka ____ kulme dhe ____ brinjë.

Një gjashtëkëndësh ka ____ kulme dhe ____ brinjë.

3. Emërto figurat më poshtë.



Fusha: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Të njohim matematikanët (Projekt)		Situata e të nxënit: Projekt	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave kyçe Nxënësi/ja: • kërkon informacione nga burime të ndryshme; • veçon ato informacione për të cilat projekti ka qëllim; • realizon projektin duke përdorur informacionin e gjetur; • paraqet projektin duke përdorur një nga mjetet e teknologjisë informative.		Fjalët kyçe: matematikë, kub, kuboid, trupa gjeometrikë.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave matematikore sipas temës mësimore Nxënësi/ja: 1. grumbullon të dhëna për projektin; 2. ndërton trupa të ndryshëm gjeometrikë.			
Burimet: letra formati me ngjyra, lapustila, tabak lere, gërshtë etj.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: edukim figurativ.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Klasa ndahet në 4 grupe me nga 7-8 nxënës secili grup. Çdo grup zgjedh një përfaqësues grupi. Grupet kanë për detyrë ndërtimin e një maketi qyteti me trupa gjeometrikë.

Në këtë orë ata ndërtojnë trupa të ndryshëm gjeometrikë, si: prizëm me bazë 3-këndore dhe 5-këndore, piramidë, kub, kuboid, cilindër, sferë etj.

Bëhet paraqitja nga përfaqësuesit e grupeve të maketeve përpara një jurie dhe vlerësimi i tyre.

Vlerësohen 3 maketet më të realizuara, pra 3 grupet që kanë punuar më mirë se grupet e tjera.

Vlerësimi: Gjatë këtij projekti, nxënësit vlerësohen për bashkëveprimin në grup dhe për ndarjen e detyrave midis anëtarëve të grupit.

PROJEKT 5**TEMA: NDËRTIMI I MAKETIT TË NJË QYTETI**

Ky projekt realizohet në zbatim të udhëzimit të dhënë nga drejtorja e shkollës dhe drejtorja arsimore e qytetit.

Punoi:

Projekt-menaxheri: Mësuesi i matematikës

Afati: Gjatë muajit shkurt

Burimet njerëzore: Nxënësit

Baza materiale: tabak letre, vizore, kompas, tela, plastelinë, kompas.

Vendi:

Klasa:

Qëllimi:

Nxjerrja në pah talentin në lëndën e matematikës.

Ndërtimi i trupave gjeometrikë dhe përdorimi i tyre në ndërtimin e maketit të një qyteti.

Objektivat:

1. Grumbullimi i të dhënave për projektin.
2. Ndërtimi i trupave të ndryshëm gjeometrikë.

FAZAT E REALIZMIT TË PROJEKTIT❖ **Ndërtimi i një maketi sipas dëshirës me trupa gjeometrikë**

(1 orë të lira)

PËRSHKRIMI I PROJEKTIT***Ndërtimi i maketit të një qyteti me trupa gjeometrikë***

Klasa ndahet në 4 grupe me nga 7-8 nxënës secili grup. Çdo grup zgjedh një përfaqësues. Grupet kanë për detyrë ndërtimin e maketit të një qyteti me trupa gjeometrikë.

Në këtë orë ata do të ndërtojnë trupa të ndryshëm gjeometrikë, si: prizmi me bazë 3-këndore dhe 5-këndore, piramidë, kub, kuboid, cilindër, sferë etj.


Paraqitja nga përfaqësuesit e grupeve të maketeve përpara një jurie dhe vlerësimi i tyre.

Vlerësohen 3 maketet më të realizuara, pra 3 grupet që kanë punuar më mirë se grupet e tjera.


PËRFUNDIME

Në përfundime trajtohen çështjet e mëposhtme:

- Si ishte angazhimi individual në projekt?
- Si u punua në grup gjatë projektit?
- A u arrit realizimi i objektivave të këtij projekti?
- Si u drejtua projekti nga menaxheri i projektit?
- Marrja e vlerësimit nga ana e nxënësve për gjithçka rreth projektit (vlerësime, vërejtje, sugjerime).

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Pozicioni dhe zhvendosja (Diskutojmë së bashku)		Situata e të nxënësve: Zbulojmë mbi motivet dhe mozaikët.	
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: • lexon dhe vendos koordinatat në të katër kuadratet. • parashikon ku do të ndodhet një shumëkëndësh pas një simetrie, zhvendosjeje ose rrotullimi 90° rreth njërit prej kulmeve të tij.		Fjalët kyçe: zhvendosje, rrotullim, fytyrë, shëmbëllim, rrjet koordinativ, koordinatë e pikës.	
Burimet: teksti, fletorja e punës, ngjitës, karton, gërsërë.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: gjuha dhe komunikimi, artet, sportet, teknologjia, shoqëria dhe mjedisi.	
Metodologjia, teknikat e përdorura, veprimtaritë e nxënësve			
Organizimi i orës së mësimit			
Parashikimi: Imagjinatë e drejtuar Nxënësit njihen me temën dhe me rezultatet e të nxënësve. Më pas, atyre u paraqitet një situatë imagjinare: një motiv i rregullt ose një mozaik i tillë. Nxënësit duhet të vështrojnë me kujdes figurën dhe të imagjinojnë sikur duhet ta zhvendosin apo ta rrotullojnë atë. Më pas nxënësit diskutojnë mbi situatën që imagjinojnë. Gjatë diskutimit shtrohen pyetjet: ➤ A ndryshon formë ky motiv gjatë rrotullimit? ➤ A ka shumë figura që përsëriten? ➤ A ka simetri në këtë motiv? Nëse po, çfarë lloj simetrie? ➤ Do të mund ta kopjonim këtë motiv, në fletore? Mësuesi nxit imagjinatën e nxënësve edhe me pyetje të tjera, në varësi të diskutimit.			
Ndërtimi i njohurive: Kërkim – hulumtim Paraqitet në një tabak të madh letre një figure, e cila ka drejtëz simetrie. Shtrohet pyetja: ➤ Çfarë vini re? Nxënësit diskutojnë rreth figurës që shohin. Atyre u kërkohet të mendojnë dhe të tregojnë figura që janë simetrike në ambientet rreth tyre, si: shtëpi, klasë, oborr etj. Më pas nxënësve u jepen disa ushtrime për t'i punuar në mënyrë të pavarur, të cilat kanë lidhje me simetrinë.			
1. Rretho figurat që kanë drejtëz simetrie.			
			

2. Vizato drejtëzat e simetrisë së figurave.



Përforcimi: Rishikim në dyshe

Në këtë fazë nxënësit punojnë në dyshe me shokun ose shoqen pranë. Secili nxënës në fletoren e tij ndërton simetrikën e një figure, si p.sh:



Në fund ushtrimi diskutohet nga e gjithë klasa.

Vlerësimi: Gjatë kësaj ore mësimi, nxënësit vlerësohen për leximin dhe vendosjen e koordinatave në të katër kuadratet, si dhe për parashikimin ku do të ndodhet një shumëkëndësh pas një simetrie, zhvendosjeje ose rrotullimi 90° rreth njërit prej kulmeve të tij.

Detyrë për punë të pavarur: Pjesa përkatëse në fletoren e punës jepet për t'u punuar në shtëpi.

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Leximi dhe vendosja e koordinatave (Zbulojmë)		Situata e të nxënit: Plani i klasës.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - lexon dhe vendos koordinatat në të katër kuadratet; - parashikon ku do të ndodhet një shumëkëndësh pas një simetrie, zhvendosjeje ose rrotullimi me 90° rreth njërit prej kulmeve të tij.		Fjalët kyçe: fytyrë, shëmbëllim, rrjet koordinativ, koordinatë e pikës.	
Burimet: teksti, fletorja e punës.	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: gjuha dhe komunikimi, artet, sportet, teknologjia, shoqëria dhe mjedisi.		
Metodologjia, teknikat e përdorura, veprimtaritë e nxënësve			
Organizimi i orës së mësimi			
Parashikimi: LINK			
Mësuesja shkruan në tabelë fjalët “Rrjeti koordinativ” dhe i orienton nxënësit që të mendojnë marrëdhënie apo fjalë të tjera që kanë lidhje me atë që është shkruar në tabelë. Nxënësit lihen tri minuta të mendojnë dhe më pas hedhin në fletore mendimet e tyre rreth fjalëve. Më tej, ata pyeten për ato që kanë shkruar. Në këtë fazë, mësuesja shkruan në tabelë gjithçka që nxënësit thonë pa u shoqëruar me komente. Pasi shkruhen mendimet, nxënësit nxiten të bëjnë pyetje dhe të diskutojnë idetë e tyre, duke qenë përherë të fokusuar mbi rrjetin koordinativ. Ndërtimi i njohurive: Imagjinatë e drejtuar Nxënësit ftohen të dëgjojnë, të përfytyrojnë dhe të mbajnë shënim të dhënave të koordinatave. Një ditë, ndërkohë që po përsëritnin mësimin e matematikës që kishin punuar në shkollë, Ana dhe Beni kryen ushtrimin e mëposhtëm. Në rrjetin koordinativ secili përcaktoi: pikën A me koordinatat (2;2), pikën B me koordinatat (5;2) dhe pikën C me koordinatat (3;5). Mirëpo kur mbaruan panë se figurat që kishin formuar ishin në drejtime të ndryshme. Figura e Anës me kulmin e sipërm në drejtimin lart dhe e Benit me kulmin e sipërm në drejtim nga e djathta. Secili prej tyre thoshte se e kishte kryer ushtrimin saktë. Provojeni dhe ju. Cili mendoni se e kishte kryer si duhet ndërtimin e trekëndëshit në rrjet? Nxënësve u jepet kohë për të punuar dhe për të dhënë mendimet e tyre, duke argumentuar zgjidhjen. Përforcimi: Rishikim në dyshe Në këtë fazë nxënësit punojnë në dyshe me shokun ose shoqen pranë. Secili nxënës punon situatën në <i>Librin e nxënësit</i>. Dyshet lihen të punohen për disa minuta. Më pas diskutohet me të gjithë klasën puna e njëres prej dysheve.			

Vlerësimi: Gjatë kësaj ore mësimi, nxënësit vlerësohen për leximin dhe vendosjen e koordinatave në të katër kuadratet dhe për parashikimin ku do të ndodhet një shumëkëndësh pas një simetrie, zhvendosjeje ose rrotullimi me 90° rreth njërit prej kulmeve të tij.

Detyrë për punë të pavarur: Pjesa përkatëse në fletoren e punës jepet për t'u punuar në shtëpi.

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Leximi dhe vendosja e koordinatave (Eksplorojmë)		Situata e të nxënit:	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - lexon dhe vendos koordinatat në të katër kuadratet; - klasifikon shumëkëndëshat e ndryshëm dhe kupton nëse një figurë me dy përmasa është ose jo shumëkëndësh; - identifikon dhe përshkruan vetitë e katërkëndëshave (duke përfshirë paralelogramet, rombet e trapezet) dhe klasifikon duke përdorur brinjë paralele, brinjë të barabarta, kënde të barabarta.		Fjalët kyçe: fytyrë, shëmbëllim, rrjet koordinativ, koordinatë e pikës.	
Burimet: teksti, fletorja e punës.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: gjuha dhe komunikimi, artet, sportet, teknologjia, shoqëria dhe mjedisi.	
Metodologjia, teknikat e përdorura, veprimtaritë e nxënësve			
Organizimi i orës së mësimit			
Parashikimi: Diskutim mbi njohuritë paraprake			
Bashkë me nxënësit zhvillohet një përsëritje për njohuritë që ata kanë mbi rrjetin koordinativ. Të gjitha njohuritë që përsëriten shënohen në mënyrë të përmblendhur në tabelë.			
Ndërtimi i njohurive: Puno, mendo, diskuto në dyshe			
Nxënësve u lexohen koordinatat e disa pikave. Atyre u kërkohet t'i hedhin ato në një rrjet koordinativ dhe më pas të shohin se çfarë figure formohet nga bashkimi i këtyre pikave. Më pas në dyshe me shokun/shoqen pranë ata nxjerrin sa më shumë veti rreth figurës së dhënë, përfshirë këtu emërtimin e saj. Po në dyshe nxënësit zhvillojnë veprimtarinë e dhënë në <i>Librin e nxënësit</i>. Një nga dyshet diskuton veprimtarinë e dhënë në <i>Librin e nxënësit</i>.			
Përforcimi: Rishikim në dyshe			
Në këtë fazë, nxënësit punojnë në mënyrë të pavarur duke marrë disa pika në rrjetin koordinativ, pika të cilat formojnë një figurë gjeometrike. Më pas i kërkojnë shokut/shoqes që kanë pranë të shkruajnë koordinatat e pikave dhe të emërtojnë figurën gjeometrike të formuar nga këto pika. Ata rendisin sa më shumë veti të kësaj figure gjeometrike. Disa dyshe paraqesin punën e tyre para klasës.			
Vlerësimi: Gjatë kësaj ore mësimi, nxënësit vlerësohen për leximin dhe vendosjen e koordinatave në të katër kuadratet, për klasifikimin e shumëkëndëshave të ndryshëm, për përshkrimin e vetive të katërkëndëshave (përfshirë paralelogramet, rombet e trapezet) dhe klasifikimin duke përdorur brinjë paralele, brinjë të barabarta, kënde të barabarta.			
Detyrë për punë të pavarur: Pjesa përkatëse në fletoren e punës jepet për t'u punuar në shtëpi.			

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Simetria dhe rrotullimi (Zbulojmë)		Situata e të nxënit: Motiv.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - parashikon ku do të ndodhet një shumëkëndësh pas një simetrie, zhvendosjeje ose rrotullimi 90° rreth njërit prej kulmeve të tij; - identifikon dhe përshkruan vetitë e katërkëndëshave.		Fjalët kyçe: fytyrë, shëmbëllim, rrjet koordinativ, koordinatë e pikës, simetri, rrotullim.	
Burimet: teksti, fletorja e punës.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: gjuha dhe komunikimi, artet, sportet, teknologjia, shoqëria dhe mjedisi.	
Metodologjia, teknikat e përdorura, veprimtaritë e nxënësve			
Organizimi i orës së mësimi			
Parashikimi: Lapsat në mes			
Nxënësit ndahen në grupe me nga 4-6 nxënës secili grup. Nxënësve u shpjegohet procedura që do të ndjekin në këtë fazë. Mësuesja i thotë secilit grup nga një dyshe numrash brenda dhjetëshes, p.sh.: (3;5). Nxënësit mendohen dhe zhvendosin sipas dëshirës të dyja koordinatat e pikës. Në momentin që nxënësit e mendojnë dyshen e numrave, vendosin lapsin mbi tavolinë. Edhe ata nxënës, të cilët nuk kanë asnjë mendim e vendosin lapsin mbi tavolinë dhe thonë “pas”. Kur nxënësit e të gjitha grupeve kanë vendosur lapsat mbi tavolinë, mësuesja zgjedh disa lapsa dhe ai/ajo që ka lapsin duhet të thotë dyshen e numrave dhe si e ka marrë atë. Ndërtimi i njohurive: Kërkim – hulumtim Nxënësit punojnë përsëri në grup. Atyre u jepet një motiv, ashtu si në <i>Librin e nxënësit</i>. Grupet duhet të shënojnë të gjitha simetritë, rrotullimet dhe zhvendosjet që vënë re. Më pas krahasohen punët e grupeve. Në tabelë shënohen të gjitha simetritë, rrotullimet dhe zhvendosjet e përcaktuara nga grupet. Përforcimi: Rishikim në dyshe Në këtë fazë nxënësit punojnë në dyshe me shokun/shoqen pranë. Ata duhet të ndërtojnë një motiv të thjeshtë ashtu si në veprimtarinë që u punua në grup. Në të duhet të ketë figura që janë simetrike ose përftohen nga një rrotullim apo zhvendosje. Ftohen disa dyshe për të paraqitur punën e tyre para gjithë klasës. Vlerësimi: Gjatë kësaj ore mësimi, nxënësit vlerësohen për parashikimin ku ndodhet një shumëkëndësh pas një simetrie, zhvendosjeje ose rrotullimi 90° rreth njërit prej kulmeve të tij, si dhe për identifikimin dhe përshkrimin e vetive të katërkëndëshave. Detyrë për punë të pavarur: Pjesa përkatëse në fletoren e punës jepet për t’u punuar në shtëpi.			

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Simetria dhe rrotullimi (Eksplorojmë)		Situata e të nxënit:	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - parashikon ku do të ndodhet një shumëkëndësh pas një simetrie, zhvendosjeje ose rrotullimi 90° rreth njërit prej kulmeve të tij; - identifikon dhe përshkruan vetitë e katërkëndëshave.		Fjalët kyçe: fytyrë, shëmbëllim, rrjet koordinativ, koordinatë e pikës, simetri, rrotullim.	
Burimet: teksti, fletorja e punës.	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: gjuha dhe komunikimi, artet, sportet, teknologjia, shoqëria dhe mjedisi.		
Metodologjia, teknikat e përdorura, veprimtaritë e nxënësve			
Organizimi i orës së mësimi			
Parashikimi: Dil rrotull, fol rrotull			
Përgatitet një “labirint” në dyshe/tokë me shkumës ose me kone të vogla. Përfshini kthesa 90° majtas dhe djathtas. Nxënësit qëndrojnë te hyrja e labirintit, atyre u lidhen sytë që të mos shohin. Nxënësit e tjerë duhet të flasin me radhë dhe udhëzojnë nxënësin nëpër labirint. Këto udhëzime mund të jenë, për shembull: <i>Bëj 4 hapa para.</i> <i>Kthehu 90° në drejtim kundërorar.</i> Mund të krijoni dy ose tri labirinte dhe ta shndërroni veprimtarinë në një konkurs. Për shembull: Fituesi mund të jetë skuadra që e nxjerr nxënësin më shpejt nga labirinti. Ndërtimi i njohurive: Puno, mendo, diskuto në dyshe Nxënësit plotësojnë në mënyrë të pavarur veprimtarinë në <i>Librin e nxënësve</i>. Nxënësit nxiten të përdorin forma që nuk janë thjesht katërkëndësha. Ata mund të vizatojnë forma me përmasa të përshtatshme, që përshtaten brenda planit. Përforcimi: Rishikim në dyshe Në këtë fazë, nxënësit punojnë në dyshe me shokun/shoqen pranë. Ata vizatojnë në fletoret e tyre një rrjet koordinativ. Një nxënës vizaton formën e tij fillestare në plan. Pastaj i kërkon shokut/shoqes pranë të japë koordinatat e figurës pas një zhvendosjeje të dhënë nga nxënësi i parë. Më pas u kërkohet dysheve të tregojnë punën para të gjithë klasës.			
Vlerësimi: Gjatë kësaj ore mësimi, nxënësit vlerësohen për parashikimin se ku do të ndodhet një shumëkëndësh pas një simetrie, zhvendosjeje ose rrotullimi 90° rreth njërit prej kulmeve të tij, si dhe për identifikimin dhe përshkrimin e vetive të katërkëndëshave. Detyrë për punë të pavarur: Pjesa përkatëse në fletoren e punës jepet për t’u punuar në shtëpi.			

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Pozicioni dhe zhvendosja (Përmbledhim)		Situata e të nxënësve: Logo.	
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - lexon dhe vendos koordinatat në të katra kuadratet; - parashikon ku do të ndodhet një shumëkëndësh pas një simetrie, zhvendosjeje ose rrotullimi 90° rreth njërit prej kulmeve të tij.		Fjalët kyçe: fytyrë, shëmbëllim, rrjet koordinativ, koordinatë e pikës, simetri, rrotullim.	
Burimet: teksti, fletorja e punës.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: gjuha dhe komunikimi, artet, sportet, teknologjia, shoqëria dhe mjedisi.	

Metodologjia, teknikat e përdorura, veprimtaritë e nxënësve

Organizimi i orës së mësimi

Parashikimi: Imagjinatë e drejtuar

Mësuesja paraqet para klasës një situatë imagjinare:

Ju jeni një kompani reklamash dhe duhet të krijoni një logo për disa dyqane. Logot duhet të jenë shumë tërheqëse dhe të sjellin klientë në dyqan. Mësuesja paraqet disa logo para klasës dhe u kërkon nxënësve që në dyshe me shokun/shoqen pranë të përcaktojnë elementet e logos “efikase”. Merren raportime nga dyshet. Bëhet një listë kriteresh për logo “efikase”. Shpjegohet se si duhet t’i përdorin këto kriterë për të vlerësuar logot në fund të mësimi.

Ndërtimi i njohurive: Puno, mendo, diskuto në dyshe

Nxënësit punojnë në grupe të vogla me veprimtarinë në *Librin e nxënësit*. Një strukturë e mundshme për veprimtarinë është:

Çdo anëtar i grupit vizaton një logo për shkollën. Anëtarët e grupit i shikojnë logot me radhë. Ata rendisin tiparet pozitive e negative dhe se çfarë do të ndryshonin. Grupi zgjedh logon “e parapëlqyer” dhe punon për ta përmirësuar.


Secili grup paraqet logon e tij. Pjesa tjetër e klasës vlerëson logon e çdo grupi. Pastaj klasa përdor kriteret e “Hyrjes” për të vendosur mbi logon më të mirë.

Përforsimi: Rishikim në dyshe

Nxënësit punojnë në dyshe me shokun/shoqen pranë një ushtrim të dhënë nga mësuesja. Një tip ushtrimi mund të jetë:

Paraqitni në rrjetin koordinativ pikat E, F, G, H:

E (-3,2)	G (4,-2)
F (-4,-2)	H (3,2)







- Cila figurë u formua?
- Sa është gjatësia e brinjës EH?
- Sa është gjatësia e brinjës FG?
- Çfarë mund të thoni tjetër për figurën e krijuar?

Ushtrimi diskutohet nga një dyshe me të gjithë klasën.

Vlerësimi: Gjatë kësaj ore mësimi, nxënësit vlerësohen për leximin dhe vendosjen koordinatave në të katra kuadratet, si dhe për parashikimin se ku do të ndodhet një shumëkëndësh pas një simetrie, zhvendosjeje ose rrotullimi 90° rreth njërit prej kulmeve të tij.


Detyrë për punë të pavarur: Pjesa përkatëse në fletoren e punës jepet për t’u punuar në shtëpi.

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Pozicioni dhe zhvendosja (Përforcojmë)		Situata e të nxënit: Skicimi i një posteri.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - lexon dhe vendos koordinatat në të katra kuadratet; - parashikon se ku do të ndodhet një shumëkëndësh pas një simetrie, zhvendosjeje ose rrotullimi 90° rreth njërit prej kulmeve të tij.		Fjalët kyçe: fytyrë, shëmbëllim, rrjet koordinativ, koordinatë e pikës, simetri, rrotullim.	
Burimet: teksti, fletorja e punës.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: gjuha dhe komunikimi, artet, sportet, teknologjia, shoqëria dhe mjedisi.	
Metodologjia, teknikat e përdorura, veprimtaritë e nxënësve			
Organizimi i orës së mësimit			
Parashikimi: Diskutim mbi njohuritë paraprake Në këtë fazë të mësimit diskutohet mbi të gjitha njohuritë e marra gjatë këtij kapitulli. Me termat, përkufizimet e marra nxënësit krijojnë një poster. Për të krijuar një poster me njohuri sa më të plota, nxënësit ndihmohen me pyetje të tilla, si: Çfarë kuptojmë me motiv? ➤ Cilët janë elementet e një rrjeti koordinativ? ➤ Çfarë është simetria? ➤ Çfarë është një bosht simetrie? ➤ A njihni ndonjë zhvendosje tjetër? ➤ Ndërtimi i njohurive: Puno, mendo, diskuto në dyshe Nxënësit punojnë në dyshe me shokun/shoqen pranë. Çdo dysheje i jepet një ose dy nga figurat, të cilat duhet t'i ndërtojnë simetrikën. Ja disa nga figurat:			
 			
 			
Më pas dyshet shpjegojnë se si i kanë përfutur figurat-shëmbëllim dhe se cilat nga njohuritë e mësipërme përdorën për të ndërtuar figurën simetrike. Disa dyshe e paraqesin punën e tyre para klasës.			

Përforcimi: Rishikim në dyshe

Nxënësit punojnë në dyshe me shokun/shoqen pranë një ushtrim të dhënë nga mësuesja. Një tip ushtrimi mund të jetë:

Përshkruani se si secila figurë ka kaluar në simetrikën e saj.



Aktivizohen disa dyshe për të paraqitur punën e tyre. Bëhet dallimi i simetrisë sipas boshteve dhe rrotullimit me kënd 90° .

Vlerësimi: Gjatë kësaj ore mësimi, nxënësit vlerësohen për leximin dhe vendosjen e koordinatave në të katër kuadratet, si dhe për parashikimin se ku do të ndodhet një shumëkëndësh pas një simetrie, zhvendosjeje ose rrotullimi 90° rreth njërit prej kulmeve të tij.

Detyrë për punë të pavarur: Pjesa përkatëse në fletoren e punës jepet për t'u punuar në shtëpi.

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Shndërrimet gjeometrike në jetën reale (Projekt)		Situata e të nxënës: Projekt	
Rezultatet e të nxënës të kompetencave kyçe Nxënësi/ja: • kërkon informacione nga burime të ndryshme; • veçon ato informacione për të cilat projekti ka qëllim; • realizon projektin duke përdorur informacione të gjetura; • paraqet projektin duke përdorur një nga mjetet e teknologjisë informative.		Fjalët kyçe: matematikë, shndërrime gjeometrike.	
Rezultatet e të nxënës të kompetencave matematikore sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: 1. grumbullon të dhëna për projektin; 2. paraqet me fotografi apo skicim shndërrimet gjeometrike në jetën reale.			
Burimet: letra formati me ngjyra, lapustila, tabak letre, gërshërë etj.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: edukim figurativ.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Klasa ndahet në 4 grupe me nga 7-8 nxënës secili grup. Çdo grup zgjedh një përfaqësues. Grupet kanë për detyrë të gjejnë, të studiojnë dhe më pas të paraqesin shndërrimet gjeometrike në jetën reale. Në këtë orë, ata paraqesin simetrinë, rrotullimin apo zhvendosjen në jetën reale, dhe si ndikojnë ato në jetën e përditshme. Më pas bëhet paraqitja nga përfaqësuesit e grupeve të punëve përpara një jurie, si dhe vlerësimi i tyre. Vlerësohet puna në grup dhe sjellja e shembujve më të goditur nga ana e nxënësve.			
Vlerësimi: Gjatë këtij projekti nxënësit vlerësohen për bashkëveprimin në grup dhe për ndarjen e detyrave midis anëtarëve të grupit.			

PROJEKT 6

TEMA: SHNDËRRIMET GJEOMETRIKE NË JETËN REALE

Ky projekt realizohet në zbatim të udhëzimit të dhënë nga drejtorja e shkollës dhe drejtorja arsimore e qytetit.

Punoi:

Projekt-menaxheri: Mësuesi i matematikës
Afati: Gjatë muajit prill.
Burimet njerëzore: Nxënësit
Baza materiale: tabak letre, vizore, kompas, tela, plastelinë, kompas etj.

Vendi: Klasa

QËLLIMI

Nxjerrja në pah e talentit në lëndën e matematikës.

Paraqitja e simetrisë në jetën reale.

Paraqitja e rrotullimit në jetën reale.

Objektivat:

1. Grumbullimi i të dhënave për projektin.
2. Paraqitja me fotografi ose skicim e shndërrimeve gjeometrike në jetën reale.

FAZAT E REALIZMIT TË PROJEKTIT

❖ Paraqitja e shndërrimeve gjeometrike në jetën reale

(1 orë)

PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Shndërrime gjeometrike në jetën reale

Klasa ndahet në 4 grupe me nga 7-8 nxënës secili grup. Çdo grup zgjedh një përfaqësues grupi. Grupet kanë për detyrë të gjejnë, të studiojnë dhe më pas të paraqesin shndërrimet gjeometrike në jetën reale.

Në këtë orë ata paraqesin simetrinë, rrotullimin apo zhvendosjen në jetën reale, dhe si ndikojnë ato në jetën e përditshme.

Më pas bëhet paraqitja e punëve nga përfaqësuesit e grupeve përpara një jurie dhe vlerësimi i tyre.

Vlerësohet puna në grup dhe sjellja e shembujve më të goditur nga ana e nxënësve.

PËRFUNDIME

Në konkluzione do të trajtohen çështjet si më poshtë:

- Si ishte angazhimi individual në projekt?
- Si u punua në grup gjatë projektit?
- A u arrit realizimi i objektivave të këtij projekt?
- Si u drejtua projekti nga menaxheri i projektit?
- Marrja e vlerësimit nga ana e nxënësve për gjithçka rreth projektit (vlerësime, vërejtje, sugjerime).

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: Test përfundimtar tremujori II		Situata e të nxënit: Test	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave matematikore sipas temës mësimore Nxënësi/ja: • zgjedh metodën që mund të përdoret për të shumëzuar me efikasitet; • thotë se çfarë përfaqësojnë shifrat e një numri; • zgjedh metodën që mund të përdoret për të pjesëtuar me efikasitet; • përdor pjesëtimin për të zgjidhur problema që përfshijnë edhe paratë; • tregon se çfarë është një numër i përzier; • pjesëton në rastet kur herësi është thyesë ose numër dhjetor; • pjesëton me një numër njëshifror; • paraqet mbetjen e një pjesëtimi; • përdor ligjet e ndërrimit, të shoqërimit dhe të përdasisë për shumëzimin; • identifikon dhe përshkruan vetitë e katërkëndëshave; • dallon paraqitjet e figurave dypërmasore dhe trupave trepërmasorë; • lexon dhe vendos koordinatat në të katra kuadratet; • parashikon ku do të ndodhet një shumëkëndësh pas një simetrie, zhvendosjeje ose rrotullimi 90° rreth njërit prej kulmeve të tij.		Fjalët kyçe: shumëzim, pjesëtim, veti të shumëzimit, thyesë, numër i përzier, numër dhjetor, kub, kuboid, figura 2D, figura 3D, simetri, rrotullim, rrjet koordinativ.	
Burimet: letër A4.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Testi zhvillohet në 45 minuta dhe vlerësimi bëhet sipas tabelës së pikëve.			

TEST PËRFUNDIMTAR
TREMUJORI I DYTË (JANAR- MARS)
KLASA VI

Emri:

Mbiemri:

Klasa: VI

Grupi A

- 1. Kryej veprimet e mëposhtme. (4 pikë)**

$$324,9 - 8,25$$

$$124,9 + 9,25$$

$$(-5) + 22$$

$$(-12) - (-28)$$

- 2. Kryej veprimet duke përdorur vetinë e përdasimit. (4 pikë)**

$$12 \cdot 99$$

$$74 \cdot 101$$

$$25 \cdot 98$$

$$15 \cdot 210$$

- 3. Vazhdo me tri kufiza vargun. (3 pikë)**

2,2 ; 4,4; 8,8 ; ... ; ... ; ...

- 4. Brinja më e shkurtër e një paralelogrami e ka gjatësinë 2,8 m. Perimetri i paralelogramit është 15 m. Sa është gjatësia e brinjës tjetër? (4 pikë)**

- 5. 14 fëmijë do të ndajnë në mënyrë të barabartë 728 kopsa që kanë koleksionuar. Nga sa kopsa i takojnë secilit fëmijë? (3 pikë)**

- 6. Lexo karakteristikat dhe shkruaj emrin e figurës. (4 pikë)**

- a. Brinjët përballë paralele, 4 brinjë të barabarta, ka kënde të drejta.
- b. Dy brinjë paralele, nuk ka brinjë të barabarta, nuk ka kënde të drejta.

- 7. Gjej perimetrin e katrorit me brinjë 6,5 cm. (2 pikë)**

- 8. Një shitës bleu 36 blloqe me 145 lekë secilin dhe i shiti ato me 259 lekë.**

- a. Sa kushtojnë të gjithë blloqet që bleu?
- b. Sa lekë grumbullon shitësi, nëse i shet të gjitha blloqet?
- c. Sa është fitimi i shitësit nëse i shet të gjitha blloqet? (3 pikë)
- d.

- 9. Ndërttoni një katror në rrjetin koordinativ. Përcaktoni koordinatat e kulmeve të tij. (3 pikë)**

Nota	4	5	6	7	8	9	10
Pikët	0 – 7	8 – 11	12 – 15	16 – 19	20 – 23	24 – 27	28 – 30

TEST PËRFUNDIMTAR
TREMUEJORI I DYTË (JANAR- MARS)
KLASA VI

Emri:

Mbiemri:

Klasa: VI

Grupi B

1. Kryej veprimet: (4 pikë)

$$289,9 - 2,46$$

$$256,3 + 4,72$$

$$(-8) + 34$$

$$(-21) - (-14)$$

2. Kryej veprimet duke përdorur vetinë e përdasimit: (4 pikë)

$$11 \cdot 88$$

$$56 \cdot 110$$

$$27 \cdot 98$$

$$24 \cdot 205$$

3. Një shitës bleu 36 blloqe me 145 lekë secilin dhe i shiti ato me 259 lekë.

a. Sa kushtojnë të gjitha blloqet që bleu?

b. Sa lekë grumbullon shitësi, nëse i shet të gjitha blloqet?

c. Sa është fitimi i shitësit nëse i shet të gjitha blloqet?

(3 pikë)

4. Vazhdo me tri kufiza vargun. (3 pikë)

1,2 ; 2,4; 4,8 ; ... ; ... ; ...

5. Brinja më e shkurtër e një drejtkëndëshi e ka gjatësinë 3,4 cm. Perimetri i drejtkëndëshit është 10,8 cm. Sa është gjatësia e brinjës tjetër? (4 pikë)

6. 12 fëmijë do të ndajnë në mënyrë të barabartë 408 kopsa që kanë koleksionuar. Nga sa kopsa i takojnë secilit fëmijë? (3 pikë)

7. Lexo karakteristikat dhe shkruaj emrin e figurës. (4 pikë)

a. 4 brinjë të barabarta, nuk ka kënde të drejta.


b. Brinjët dy e nga dy paralele, brinjët dy e nga dy të barabarta, nuk ka kënde të drejta.

8. Gjej perimetrin e katrorit me brinjë 3,8 cm. (2 pikë)

9. Ndërtoni një drejtkëndësh në rrjetin koordinativ. Përcaktoni koordinatat e kulmeve të tij. (3 pikë)

Nota	4	5	6	7	8	9	10
Pikët	0 – 7	8 – 11	12 – 15	16 – 19	20 – 23	24 – 27	28 – 30

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: 8. Njësitë e gjatësisë, të masës dhe të vëllimit. Diskutojmë së bashku.		Situata e të nxënësve: - A matët ndonjë gjë dje? - Matjet janë të sakta vetëm me një shkallë të caktuar saktësie.	
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave matematikore sipas temës mësimore Nxënësi/ja: • përzgjedh dhe përdor njësite standarde të matjes; • identifikon sisteme standarde të matjes së gjatësisë, të masës dhe të vëllimit.		Fjalët kyçe: - Njësitë e gjatësisë: km, m, cm, mm, milje - Njësitë e masës: ton, kv, kg, g, mg - Njësitë e vëllimit: l, cl, ml	
Burimet: • Libri i nxënësit, faqja 133 • Minitabela		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuha dhe komunikimi, Shkencat e natyrës, Artet, Shoqëria dhe mjedisi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve			
Organizimi i orës së mësimi:			
Parashikimi i të nxënësve: <i>Mendo – krijo dyshe – diskuto</i> Nxënësit/et ndahen në çifte dhe diskutojnë me njëri-tjetrin: <i>Kur ju është dashur të masni një objekt këtë javë?</i> Rendisin në tabelën e zezë, në tri kolona, të gjitha njësitë matëse që përmendin. Pastaj iu kërkohet nxënësve/eve të nxjerrin objekte nga çanta në tavolinë dhe të tregojnë njësitë e përshtatshme të matjes për to p.sh.: gjatësia e fletës (20 cm); masa e moltos (50 g); shishja e ujit (500 ml). Mësuesi/ja i nxit nxënësit/et me pyetjet ç'njësi matëse kanë përmendur në lëndë të ndryshme këtë javë, p.sh.: fizikë -masa (kg), vëllimi (ml), distanca (m); gjeografi - lartësia e malit (m), sasia e reshjeve (mm), gjatësia e lumit (km); art pamor - gjatësia e segmentit (mm). Ndërtimi i njohurive të reja: <i>Rolet në grupet bashkëpunuese</i> Diskutohet figura në fq. 133. Mësuesi/ja pyet: <i>Cilat profesione përdorin shpesh matjet? Çfarë lloj matjesh u duhet të përdorin?</i> Nxënësit/et ndahen në grupe me 4 veta. Secili grup të zgjedhë një profesion të caktuar dhe të luajnë një lojë me role të shkurtër duke i paraqitur këto profesione gjatë procesit të matjes që mund të kryejnë në punë, p.sh.: - Mjeku jep recetën: tableta (mg), shurupi (ml), ampulat (ml). - Mësuesi i fizikës: masa (kg), vëllimi i lëngjeve (ml), gjatësia (m). - Inxhinieri i ndërtimit: lexon skicat (mm), i zbaton në ndërtesë (m). - Kuzhinieri: mat përbërësit (g; kg; ml). Paraqesin lojën e tyre para klasës.			
Përforcimi: <i>Përmbledhje e strukturuar</i> Ndërkohë që grupet paraqesin lojën e tyre, një nxënës/e plotëson në dërrasë tabelën e ndarë në tri kolona me njësitë e përshtatshme të matjes së objekteve të përdorura gjatë lojës, duke i ndarë ato me vijë për çdo grup. Në fund shpallet fitues grupi që ka përdorur më shumë njësi të përshtatshme. Pyet pse disa njësi përdoren më shpesh se të tjerat.			
Vlerësimi: Nxënësit/et vlerësohen individualisht për shqiptimin e duhur të njësive të matjes dhe zgjedhjen e shkallës së saktësisë që i referohen.			
Detyrat dhe puna e pavarur: Çdo nxënës/e bën një listë me objekte që kanë matur ata apo prindërit e tyre gjatë javës ku kanë përdorur në mënyrë të përshtatshme njësitë e gjatësisë, masës, vëllimit.			
Detyrë shtesë: Të hulumtojnë në internet e libra dhe të grumbullojnë të dhëna për gjatësinë, masën e vëllimin e kafshëve të ndryshme si p.sh.: balena blu, geopardi; të dhëna nga gjeografia; receta të ndryshme gatimi ose mjekësore.			

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: 8A. Zgjedhja dhe përdorimi i njësive të përshtatshme të matjes. Zbulojmë.		Situata e të nxënësve: A përdorim në mënyrë të përshtatshme njësitë e matjes?	
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave matematikore sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - përzgjedh dhe përdor njësitë standarde të matjes; - identifikon sisteme standarde të matjes së gjatësisë, të masës dhe të vëllimit.		Fjalët kyçe: - Njësitë e gjatësisë: km, m, cm, mm, milje - Njësitë e masës: ton, kv, kg, g, mg - Njësitë e vëllimit: l, cl, ml	
Burimet: • libri i nxënësit, faqja 134-135 • libra të ndryshme • gërrshërë • fletë të mëdha • internet		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuha dhe komunikimi, Shkencat e natyrës, Shoqëria dhe mjedisi, TIK.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve			
Organizimi i orës së mësimi:			
Parashikimi i të nxënësve: <i>Diskutimi i njohurive paraprake</i> Nxënësit/et e ndarë në grupe diskutojnë listat e sjella mbi matjet e bëra nga prindërit e tyre gjatë javës, të dhënat nga interneti e librat. Bëjnë me to afishe, ku rendisin njësitë matëse të gjatësisë, masës, vëllimit. Përfaqësuesit e grupeve plotësojnë tabelën në dërrasë të ndarë në tri kolona me njësitë e marra nga afishat.			
Ndërtimi i njohurive të reja: <i>Hulumtim, shqyrtim i përbashkët</i> Nxënësit/et plotësojnë në mënyrë individuale tabelën e ushtrimit 1 në libër. Duke diskutuar në grup, shtojnë në shtyllën e fundit të tabelës numrin e objekteve që përdorin në mënyrë të përshtatshme njësinë përkatëse. Nga hulumtimi në internet e libra, të dhëna detyrë një orë më parë, nxënësit/et plotësojnë ushtrimin 2 në libër dhe bëjnë skeda të ndryshme duke zgjedhur në to të dhëna më interesante.			
		Receta e mjekut Receta e gatimit Skeda e gjeografisë • lumi më i gjatë në botë: <i>Nili</i> – 6671 km. • liqeni më i thellë në botë: <i>Bajkal</i> – 1629 m. • maja më e lartë në botë: <i>Everest</i> – 8848 m. • trashësia mesatare e akullit: <i>Antarktidë</i> – 2000 m. • vendi me më shumë rreshje në vit: <i>Kolumbia</i> – 3240 ml.	
Gjuha e tyre peshon sa një elefant, ndërsa zemra sa një makinë.			
Përforcimi: <i>Imaginatë e drejtuar</i> Përfaqësues të grupeve prezantojnë skedat. Nxënësit/et bëjnë krahasimet për skedat e ngjashme dhe shpallin cili ka gjetur kafshën më të madhe, më të shpejtë apo më të rëndë. Në skedat e tjera, cili ka gjetur malin më të lartë apo lumin më të gjatë etj. Mësuesi/ja vlerëson njohuritë e informacionet që përmbajnë skedat si dhe zgjedhjen e njësive të përshtatshme të matjes dhe imagjinatën e tyre për të formuar skeda interesante duke votuar atë më të veçantën.			
Vlerësimi: Mësuesi/ja vlerëson gjatë gjithë orës punën në grup si dhe kreativitetin dhe origjinalitetin në formimin e skedave dhe përzgjedhjen saktë të njësive të përshtatshme të matjes së gjatësisë, vëllimit dhe masës.			
Detyrat dhe puna e pavarur: • Ushtrimi 3 fq. 135 në libër			
Detyrë hulumtuese për dosje: • Të bëjnë skeda me të dhëna interesante të marra nga librat e Interneti, ku të përdorin njësitë e gjatësisë, masës, vëllimit në mënyrë të përshtatshme.			

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla: III	Klasa: VI																								
Tema mësimore: 8A. Zgjedhja dhe përdorimi i njësive të përshtatshme të matjes. Eksplorojmë.		Situata e të nxënit: A mund të vlerësoh gjatësinë, masën, vëllimin e një objekti duke përdorur njësinë e përshtatshme të matjes?																									
Rezultatet e të nxënit të kompetencave matematikore sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: • përzgjedh dhe përdor njësitë standarde të matjes. • identifikon sisteme standarde të matjes së gjatësisë, të masës dhe të vëllimit dhe i përdor ato në kryerjen e përlogaritjeve të thjeshta.		Fjalët kyçe: ... është më i shkurtër se është më i rëndë se ka vëllim të njëjtë me ...																									
Burimet: • Libri i nxënësit, faqja 136-137 • Minitabela		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuha dhe komunikimi, Shkencat e natyrës, Shoqëria dhe mjedisi, TIK.																									
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve																											
Organizimi i orës së mësimit:																											
Parashikimi i të nxënit: <i>Mendo – krijo dyshe – diskuto</i> Në grupe dyshe, nxënësit/et i kërkojnë njëri-tjetrit të shkruajnë emrin e një objekti apo të një matjeje që përputhet me të gjitha përshkrimet e mëposhtme: - Diçka që është 1,5 mm e gjatë - Diçka që peshon 2 kg - Një vend që është 15 km larg - Gjerësia e klasës - Vëllimi i një kënaçeje me pije të gazuar Pyeten: Për cilat njësi matëse ishte më e lehtë të gjendej një shembull? Për cilat ishte më e vështirë? Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin për zgjedhjen më të përshtatshme.																											
Objekti - maja e lapsit - një bidon mjaltë - Tiranë - Vorë - 5m - 330ml																											
Ndërtimi i njohurive të reja: <i>Hulumtim – Shqyrtim i përbashkët</i> Nxënësit/et punojnë individualisht ushtrimin 1. Mësuesi/ja pyet: - <i>Nga e dini që kjo është e saktë?</i> - <i>A mund të më tregoni gjatësinë e objektit në fjalë?</i> - <i>Mbetët të habitur nga gjatësia e objektit?</i>																											
<table><tr><td>Ndërtesa më e gjatë: Burja Khalifa</td><td>65 km në orë</td></tr><tr><td>Kafsha më e vogël: lakuriqi i natës</td><td>6 650 km</td></tr><tr><td>Kafsha më e shpejtë: gepardi</td><td>149 600 000 km</td></tr><tr><td>Lumi më i gjatë: Nili</td><td>830 m</td></tr><tr><td>Largesa e Tokës nga Dielli</td><td>3,4 kg</td></tr><tr><td>Njeriu më i gjatë: Robert Uadlou</td><td>3 cm</td></tr><tr><td>Pesha e balenës blu</td><td>5 ml</td></tr><tr><td>Pesha e një veze</td><td>1 litër</td></tr><tr><td>Pesha e një centimetri kub rërë</td><td>53 g</td></tr><tr><td>Pesha mesatare e një foshnje</td><td>190 tonë</td></tr><tr><td>Vëllimi i një kutie të madhe kartoni me lëng frutash</td><td>2,6 g</td></tr><tr><td>Vëllimi i një luge çaji</td><td>2,34 m</td></tr></table>				Ndërtesa më e gjatë: Burja Khalifa	65 km në orë	Kafsha më e vogël: lakuriqi i natës	6 650 km	Kafsha më e shpejtë: gepardi	149 600 000 km	Lumi më i gjatë: Nili	830 m	Largesa e Tokës nga Dielli	3,4 kg	Njeriu më i gjatë: Robert Uadlou	3 cm	Pesha e balenës blu	5 ml	Pesha e një veze	1 litër	Pesha e një centimetri kub rërë	53 g	Pesha mesatare e një foshnje	190 tonë	Vëllimi i një kutie të madhe kartoni me lëng frutash	2,6 g	Vëllimi i një luge çaji	2,34 m
Ndërtesa më e gjatë: Burja Khalifa	65 km në orë																										
Kafsha më e vogël: lakuriqi i natës	6 650 km																										
Kafsha më e shpejtë: gepardi	149 600 000 km																										
Lumi më i gjatë: Nili	830 m																										
Largesa e Tokës nga Dielli	3,4 kg																										
Njeriu më i gjatë: Robert Uadlou	3 cm																										
Pesha e balenës blu	5 ml																										
Pesha e një veze	1 litër																										
Pesha e një centimetri kub rërë	53 g																										
Pesha mesatare e një foshnje	190 tonë																										
Vëllimi i një kutie të madhe kartoni me lëng frutash	2,6 g																										
Vëllimi i një luge çaji	2,34 m																										
Në grupe dyshe punohet ushtrimin 2, ku nxënësit/et përdorin njohuritë e përbashkëta të hulumtuara nga librat e interneti për të bërë krahasime si: lumi Nil është më i gjatë se Amazona; masa e Tokës është më e madhe se e Hënës; vëllimi i 1 luge çaji është sa ½ e vëllimit të lugë së gjellës; 1 shishe <i>Amita</i> nxë afërsisht sa 3 kënaçe <i>coca-cola</i> .																											

Përforcimi: *Shkëmbe një problem*

Mësuesi/ja iu kërkon pesë nxënësve/eve që punuan më mirë të dalin në krye të klasës. Ata/ato mund të bëjnë pyetje që lindin nga krahasimet e tyre. Për shembull, një nxënës/e që shkroi: “Klasa është po aq e lartë sa gjatësia e Robert Uadlout”, mund të pyes “Çfarë lartësie ka klasa?” Udhëzohen nxënësit/et e tjerë të shkruajnë përgjigjet në minitabelat e tyre.

largësia Tokë-Diell	është rreth 20 mijë herë më e madhe se	gjatësia e lumit Nil
një kuti <i>Amita</i>	nxë sa 200	lugë çaji
...	...	...

Shpallin fitues nxënësin/en që drejton pyetjet më të përshtatshme për të krahasuar madhësitë e zgjedhura prej tij/saj me ato të tabelës së librit.

Vlerësimi: Mësuesi/ja vlerëson individualisht nxënësit/et për krahasimin e saktë të objekteve duke përdorur njësitë e përshtatshme të matjes së gjatësisë, vëllimit, masës dhe shprehjet krahasuese.

Detyrat dhe puna e pavarur: Nxënësit/et e ndarë në grupe bëjnë kërkime në internet për:

- ndërtesat e larta;
- peshën e secilit pjesëtar të grupit;
- sasinë e ujit që pi secili gjatë një dite.

Me të dhënat e grumbulluara bëjnë tabela për secilin rast dhe më pas përgatisin një diagram krahasues.

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: 8B. Këmbimi i njësive të matjes. Zbulojmë		Situata e të nxënīt: Shprehni gjatësinë e një stilo- lapsi, masën e një paracetamoli, vëllimin e një kutie me lëng frutash në njësinë më të përshtatshme, pastaj kthejeni në njësi të tjera.	
Rezultatet e të nxënīt të kompetencave matematikore sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: • kthen një njësi matëse në tjetrën duke lëvizur presjen dhjetore deri në tri shifra; • njeh dhe përdor numrat dhjetorë në kontekstin e matjeve.		Fjalët kyçe: - Njësi e përshtatshme - Këmbim i njësive - Zhvendos presjen	
Burimet: • libri i nxënësit, faqet 138-139 • një sërë instrumentesh matëse dhe objekte për t’u matur • makinë llogaritëse		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkur- rikulare: Gjuha dhe komunikimi, Shkencat e natyrës, Shoqëria dhe mjedisi, TIK.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve			
Organizimi i orës së mësimi:			
Parashikimi i të nxënīt: <i>Diskutimi i njohurive paraprake</i> Kërkohet nga nxënësit/et që të shprehin matjen e disa objekteve (p.sh.: ato që jepen te situata e të nxënīt) në njësinë më të përshtatshme dhe më pas t’i kthejnë në njësi të tjera. P.sh.: masa e një paracetamoli është 500 mg = 0,5 g = 0,0005 kg. Nxënësit/et kujtojnë njësitë bazë të matjes së: gjatësisë (m), vëllimin të lëngjeve (l), masës (kg), shumëfisha e nënfisha të tyre, kuptimin e fjalëve “kilo” që do të thotë 1000 p.sh.: 1 km = 1000 m, “mili” që do të thotë 1/1000 p.sh.: 1 mg = 1/1000 g = 0,001 g, “centi” që do të thotë 1/100 p.sh.: 1 cl = 1/100 l = 0,01 l. Pyeten se çfarë vënë re nga këmbimi i njësive. Priten të thonë se kur këmbejmë njësitë shumëzohet ose pjesëtohet me fuqi të 10, duke zhvendosur presjen dhjetore.			
Ndërtimi i njohurive të reja: <i>Mendo – grup dyshe – diskuto</i> Udhëzohen nxënësit/et me 3-4 shembuj për plotësimin e tabelave 1-3, p.sh.: gjatësia e majës së lapsit është 1 mm = 0,1 cm = 0,001 m; gjatësia e gomës së lapsit është 10 mm = 1 cm = 0,01 m; gjerësia e tavolinë së nxënësit është 50,7 cm = 507 mm = 0,507 m; vëllimi i një bidoni të madh uji është 50 l = 5000 cl = 50000 ml; masa e një moltoje është 0,05 kg = 50 g = 50000 mg. Më pas, nxënësit/et punojnë në mënyrë të pavarur tabelat 1-3 në			

libër, duke kontrolluar me shokun e bankës nëse përgjigjet e tyre përputhen. Nëse jo, kontrollojnë përgjigjet duke përdorur makinën llogaritëse. Diskutojnë dhe për objektet më të përshtatshme si konkretizim për secilën matje.
Përforcimi: <i>Imaginatë e drejtuar</i> Mësuesi/ja paraqet vizualisht objekte të përzgjedhura nga detyra kryesore. Citohet njësia e matjes nga e cila është më e vështirë të dallohet se për çfarë objekti bëhet fjalë dhe kërkon nga nxënësit/et t'i gjejnë ato, p.sh.: - ky objekt ka një vëllim 100 cl (një kuti e madhe <i>Amite</i>); - ky objekt ka gjatësi rreth 0,3 m dhe gjerësi rreth 0,2 m (fleta e formatit A4); - ky objekt e masën rreth 0,050 g (një vezë). Pastaj zhvillojnë të njëjtën veprimtari, por e nisin nga objektet, p.sh.: - gjeni vëllimin dhe gjatësinë e një kënaçe pijeje me gazë dhe shkruani njësitet matëse në mënyra të ndryshme, p.sh.: vëllimi = 330 ml = 33 cl = 0,33 l - gjatësia = 12 cm = 120 mm = 0,12 m. Nxënësit/et diskutojnë në grup dysh shembuj të ngjashëm.
Vlerësimi: Mësuesi/ja vlerëson individualisht nxënësit/et në kthimin e njësive të matjes duke zhvendosur presjen dhjetore dhe në gjetjen e objekteve si konkretizim për secilën matje.
Detyrat dhe puna e pavarur: Për tri objekte të ndryshme të gjejnë gjatësinë e përshtatshme të matjes së gjatësisë, vëllimit, masës dhe t'i kthejnë në njësi të tjera. Të paraqesin vizualisht 3 objekte me anë të njësive të matjes dhe orën e ardhshme të kërkojnë nga shokët të gjejnë objektin në fjalë.

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: 8B. Këmbimi i njësive të matjes. Eksplorojmë.		Situata e të nxënësve: Përfytyroni sikur po ndërtoni një kullë duke qëndruar në shpatullat e njëri-tjetrit. Sa e lartë do të jetë kulla?	
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave matematikore sipas temës mësimore Nxënësi/ja: • kthen një njësi matëse në tjetrën duke lëvizur presjen dhjetore deri në tri shifra; • njeh dhe përdor numrat dhjetorë në kontekstin e matjeve.		Fjalët kyçe: ... është po aq e rëndë sa ka të njëjtën lartësi/peshë sa është po aq e gjatë sa ...	
Burimet: • libri i nxënësit, faqet 140-141 • metër • makinë llogaritëse • vizore shirit (për matje largësish të mëdha) • peshore matëse		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuha dhe komunikimi, Shkencat e natyrës, TIK.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve			
Organizimi i orës së mësimi:			
Parashikimi i të nxënësve: <i>Rolet në grupe bashkëpunuese</i> Mësuesi/ja kërkon nga nxënësit/et të përfytyrojnë sikur po ndërtojnë një kullë duke qëndruar në shpatullat e njëri-tjetrit. Pyet: <i>Sa e gjatë do të jetë kulla?</i> Shkruan disa nga përgjigjet e tyre në tabelë. Llogaritjet fillestare realizohen në cm, duke u bazuar në një hamendësim për gjatësinë e nxënësit në cm, p.sh.: mendohet se shtatlartësia mesatare e nxënësve të klasës është afërsisht 145 cm, numri i nxënësve (30). Meqë nxënësit/et qëndrojnë në shpatullat e njëri-tjetrit, hiqet 25 cm (gjatësia e kokës), kështu që lartësia e kullës është afërsisht: $120 \times 30 = 3600$ cm. Lartësia e një kati është mesatarisht 270 cm, numri i kateve është $3600 \text{ cm} : 270 \text{ cm} \approx 13$ kate. Nxënësit/et të ndarë në çifte masin gjatësinë e njëri-tjetrit me anë të një metri. Rendisin të gjitha gjatësitë në tabelë. Katër prej nxënësve/eve u jepen makina llogaritëse dhe përlllogarisin shumën e të gjitha gjatësive të shënuara në tabelë. Bëhet kujdes që nxënësit/et të arrijnë në të njëjtën shumë. Më pas, shkruhet përlllogaritja e saktë dhe krahasohet me përgjigjet paraprake të nxënësve/eve. Iu kërkohet nxënësve/eve të gjejnë një objekt që ka të njëjtën lartësi me kullën e tyre. Gjithashtu, mund të masin këtë largësi me një vizore shirit, bëjnë kthimin në m dhe km.			

Kjo do të realizohet me lëvizjen e presjes dhjetore tri shifra majtas. Më pas, rrumbullakosen në m apo km më të afërt.

Ndërtimi i njohurive të reja: *Mendo – grup dyshe – diskuto*

Udhëzohen nxënësit/et që çdo problem në librin e tyre ta zbërthejnë në hapa ndërmjetës. Për shembull, për ushtrimin 1 mund të masin gjatësinë e tavolinës së punës (120 cm) dhe e ndajnë gjatësinë në dhjetëshe ($120 : 10 = 12$ pjesë me nga 10 cm). Më pas të gjejnë se sa kokrra stafidhe (rrushi) mund të vendosen në këtë gjatësi (10 cm = 100 mm, $100 \text{ mm} : 3 \text{ mm} \approx 33$ kokrra) dhe ta shumëzojnë me 12 për të gjetur përgjigjen ($33 \cdot 12 \approx 396$ kokrra). Për ushtrimin 4 jepet masa e monedhës me vlerë më të madhe (100 lekë), që është 6,8 g $\approx$ 7 g. Nxënësit/et punojnë individualisht ushtrimet 1-4 në libër. Diskutojnë rezultatet në grup dyshe.

Përforcimi: *Marrëdhëniet pyetje-përgjigje*

Nxënësit/et prezantojnë para klasës zgjidhjen e ushtrimeve 1-4, duke sqaruar qartë procesin dhe përllogaritjet e nevojshme. Iu kërkohet nxënësve/eve të vlerësojnë përgjigjet duke i pyetur: *A ka kuptim kjo përgjigje? Pse?*

Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit/et individualisht në aftësitë e tyre për të sqaruar qartë procesin e zgjidhjes së problemave dhe përllogaritjet e tyre, duke përdorur numrat dhjetorë në kontekstin e matjeve.

Detyrat dhe puna e pavarur:

- Ushtrimi 5 fq. 141 në libër.
- Të krijojnë vetë një problem ku të përdorin numra dhjetorë në kontekstin e matjeve.

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: 8C. Përdorimi i mjeteve të shkallëzuara për matje të sakta. Zbulojmë.		Situata e të nxënit: Sa herë më e madhe është gjatësia ime nga perimetri i kokës?	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave matematikore sipas temës mësimore Nxënësi/ja: • përzgjedh dhe përdor njësitet standarde të matjes; • interpreton leximet në masa të ndryshme; • vizaton segmente dhe mat në centimetrin më të afërt.		Fjalët kyçe: - Rrumbullakos - Në cm më të afërt	
Burimet: • libri i nxënësit, faqet 142 • metra apo mjete të tjera për të matur lartësinë dhe gjatësinë		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuha dhe komunikimi, Edukimi fizik, Sporte dhe Shëndeti, TIK.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve			
Organizimi i orës së mësim:			
Parashikimi i të nxënit: <i>Imaginatë e drejtuar</i> Pyeten nxënësit/et për ushtrimet e dhëna detyrë. Më pas, mësuesi/ja i drejton klasës këtë pyetje: <i>Përfytyroni sikur unë mas kokën time me një fije peri rreth e qark. Si e quajmë këtë matje?</i> (Perimetër) <i>Sa herë më e madhe është gjatësia ime nga perimetri i kokës?</i> Shkruhen të gjitha përgjigjet paraprake të nxënësve/eve në tabelën e zezë. Pasi të bëjnë matjet dhe llogaritjet përkatëse, nxënësit/et do të zbulojnë se cila nga përgjigjet është më e sakta.			
Ndërtimi i njohurive të reja: <i>Hulumtim, shqyrtim i përbashkët</i> Iu kërkohet nxënësve/eve të masin gjatësinë e shokut/shoqes së bankës, si dhe perimetrin e kokës. Udhëzohen nxënësit/et të masin të njëjtën pjesë të kokës (për shembull: zonën mbi vesh) dhe të kryejnë matjen në centimetrin më të afërt . Më pas, nxënësit/et të rendisin të gjitha matjet e kryera në dërrasën e zezë në një tabelë të madhe.			

Gjatësia	Perimetri i kokës	Gjatësia : perimetri i kokës
152 cm	48 cm	$152 \text{ cm} : 48 \text{ cm} \approx 3,16 \approx 3$

Më pas, secili prej nxënësve/eve plotëson tabelën e madhe në dërrasë me matjet e veta dhe njehson raportin mes gjatësisë dhe perimetrit të kokës.

Përforcimi: Përmbledhje e strukturuar

Nxënësit/et vëzhgojnë tabelën dhe argumentojnë rezultatet.

Pyeten: Çfarë zbuluat?

Përgjigjen: *Unë zbulova se gjatësia ime është afërsisht 3 herë sa perimetri i kokës sime.*

Në grupe dyshe, nxënësit/et bëjnë matje të objekteve të ndryshme ku rezultati të rrumbullakosen në cm më të afërt, p.sh.: gjatësia e fletore është 204 mm = 20,4 cm $\approx$ 20 cm; gjatësia e librit të matematikës është 27,4 cm $\approx$ 27 cm; gjerësia e librit të matematikës është 21,6 cm $\approx$ 22 cm; gjatësia e pëllëmbës është 12,5 cm $\approx$ 13 cm.

Mësuesi/ja pyet: *Kur rrumbullakosni në vlerën pasardhëse dhe kur në atë paraardhëse?*

Nxënësit/et japin shembuj për të argumentuar përgjigjen e tyre.

Vlerësimi: Mësuesi/ja bën vlerësim diagnostikues për përdorimin e mjeteve të shkallëzuara dhe matjen në cm më të afërt.

Detyrat dhe puna e pavarur: Nxënësit/et mund të përdorin tabelën e matjeve për të ndërtuar një diagram ku, në përgjigje të pyetjes, të dallojnë përputhshmërinë më të lartë.

- Nxënësit/et njoftohen të sjellin në klasë në orën e ardhshme mjete të shkallëzuara për matjen e gjatësisë, vëllimin e lëngjeve, masën e trupave.

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: 8C. Përdorimi i mjeteve të shkallëzuara për matje të sakta. Eksplorojmë.		Situata e të nxënësve: Nxënësit/et vendosin sende të ndryshme në tavolinë dhe masin gjatësinë, vëllimin, masën e tyre duke përdorur enët e shkallëzuara në njësinë e përshtatshme më të afërt.	
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave matematikore sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - përzgjedh dhe përdor njësitet standarde të matjes; - interpretin leximet në masa të ndryshme; - vizaton segmente dhe mat në centimetrimin më të afërt.		Fjalët kyçe: - Rrumbullakos - Në milimetrimin apo centimetrimin më të afërt - Në miligramin apo gramin më të afërt	
Burimet: - libri i nxënësit, faqet 143-145 - vizore të thjeshta ose vizore metrike - enë matëse - peshore matëse - një sërë objektesh për matje		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuha dhe komunikimi, Shkencat e natyrës, TIK.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve			
Organizimi i orës së mësimi:			
Parashikimi i të nxënësve: <i>Diskutimi i njohurive paraprake</i> Pyeten nxënësit/et: <i>Cilat janë njësitet bazë të matjes së gjatësisë, masës, vëllimit; shumëfishat e nënfishat e tyre? Çfarë mjeti përdoret për të matur secilën prej këtyre madhësive?</i> Nxënësit/et demonstrojnë mjetet që kanë sjellë për këtë qëllim (vizore e shkallëzuar, peshore, enë e shkallëzuar). Për secilën prej tyre tregojnë vlerën e një ndarjeje të madhe dhe të një ndarjeje të vogël.			
Ndërtimi i njohurive të reja: <i>Rolet në grupet bashkëpunuese</i> Mësuesi/ja ndan nxënësit/et në grupe 5-6 veta. Në një tavolinë, vendosen një sërë objektesh (libra të ndryshëm, fletore, gomë, laps, portofol) dhe disa vizore të thjeshta/vizore metrike për të matur gjatësinë; në një tavolinë tjetër, vendosen një sërë enësh dhe disa gotëza për të matur vëllimin (shishe me ujë, kënaçe me pije të gazuara,			

lëngje frutash); në një tavolinë të tretë, një sërë objektsh dhe peshorsh matëse për të gjetur **masën**. Iu kërkohet grupeve të nxënësve të sillen rreth tavolinave duke matur objektet me radhë, të mbajnë shënim objektin më të gjatë, më të rëndë dhe enën me vëllimin më të madh. Pyeten nxënësit/et: *Cilën njësi matëse do të përdorni si më të përshtatshme gjatë matjes?*

Pasi grupet të kenë matur të gjitha objektet, u kërkohen rezultatet e matjeve. Mësuesi/ja kontrollon disa nga matjet. Diskutohet rreth njësive matëse që janë përdorur. U kërkohet të shkruajnë vlerën e matjeve në njësi të ndryshme, për shembull:

në metrin më të afërt;

në litrin më të afërt;

në **kilogramin** më të afërt.

Përforcimi: *Rishikim në dyshe*

Mësuesi/ja pyet nxënësit/et për vlerën e një ndarjeje të madhe apo të vogël në secilën nga enët e shkallëzuara që tregohen në figurat e librit në ushtrimet 1-3 fq. 143-145. Më pas, nxënësit/et plotësojnë ushtrimet 1-4 (a, b, c) në punë të pavarur. Kontrollonë rezultatet duke këmbyer librin me shokun dhe vlerësojnë njëri-tjetrin.

Vlerësimi: Mësuesi/ja vlerëson individualisht për matjen e objekteve të ndryshme në njësinë e përshtatshme më të afërt me mjete të shkallëzuara.

Detyrat dhe puna e pavarur:

- Ushtrimi 1-4 (d) fq. 143-145.

- Gjeni objektin më të gjatë/më të gjerë në shtëpinë tuaj. Vlerat e matjeve sillini në klasë dhe i krahasoni me nxënësit/et e tjerë/tjera. Gjithashtu, mund të gjeni enën më të madhe apo objektin më të rëndë.

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: 8. Njësitë e gjatësisë, të masës dhe të vëllimit. Përmbledhim.		Situata e të nxënit: Në një pastiçeri, makineria e pastave prodhon brumin në formë drejtkëndëshi me përmasa 1 m me 75 cm. Si duhet ta prisni brumin që të prodhoni maksimumin e pastave?	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave matematikore sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - përzgjedh dhe përdor njësitë standarde të matjes; - interpreton leximet në masa të ndryshme; - vizaton segmente dhe mat në centimetrin më të afërt.		Fjalët kyçe: - Modelim - Riaplikim	
Burimet: - libri i nxënësit, faqet 146 - vizore - letër me katrorë - kompas		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuha dhe komunikimi, Shkencat e natyrës, TIK.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve

Organizimi i orës së mësimi:


Parashikimi i të nxënit: *Imagjinatë e drejtuar*

Pyeten nxënësit/et:



- Çfarë objektsh keni matur në shtëpi me anë të mjeteve të shkallëzuara?


- Cili është objekti më i gjatë, më i rëndë, me vëllim më të madh apo më të vogël?


Krahasojnë vlerat e matjeve me njëri-tjetrin. Mësuesi/ja njeh nxënësit/et me situatën e shtruar në libër. Kërkohen mendime alternative për zgjidhjen e situatës dhe merret ajo më e mira. Udhëzohen nxënësit/et të modelojnë një pjesë të pastës në fletë me kuti me përmasa 25 cm X 25cm.



Ndërtimi i njohurive të reja: <i>Puno në dyshe, mendo, diskuto</i> Nxënësit/et punojnë në punë të pavarur për modelimin e fletës. I sugjerohet të konsultohen me shokun, por edhe me grupet e tjera. Pasi të modelojnë në fletë një numër të njëjtë të “bazave” dhe “kulmeve”, i riaplikojnë modelin në brumin pastës me përmasa: 1 m X 75 cm. Nxënësit/et përlllogarisin: • numrin e pastave - 90 pasta. • numrin e kutive me krem - 9 kuti.	
Përforcimi: <i>Shkëmbe një problem</i> Çohen tre nxënës në dërrasë që prezantojnë përkatësisht: - modelin; - llogaritjen e numrit të pastave; - llogaritjet e kutive të kremit. Më pas, nxënësit/et krijojnë problema të ngjashme dhe ia japin shokut për t'i zgjidhur, p.sh.: Gjeni numrin e biskotave me dy shtresa ku peta poshtë ka diametër 2 cm dhe peta lartë 1 cm, të prera nga brumi me përmasa 4 cm x 5 cm. Mund të shtoni dhe krem çokollate në mes.	
Vlerësimi: Mësuesi/ja vlerëson individualisht nxënësit/et për dhënien e alternativës më të mirë, në zgjedhjen e modelit më të përshtatshëm dhe për përlllogaritjet e sakta.	
Detyrat dhe puna e pavarur: Nxënësit/et krijojnë një problemë të ngjashme me atë të librit.	



Fusha: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: 8. Njësitë e gjatësisë, të masës dhe të vëllimit. Përforcojmë.		Situata e të nxënës: Jepen vlerat e matjeve të gjatësisë, masës, vëllimit të tri objekteve në njësinë më të përshtatshme dhe kërkohet të shprehen ato në njësi të tjera.	
Rezultatet e të nxënës të kompetencave matematikore sipas temës mësimore Nxënësi/ja: • përzgjedh dhe përdor njësitë standarde të matjes; • interpreton leximet në masa të ndryshme; • vizaton segmente dhe mat në centimetrin më të afërt.		Fjalët kyçe: - Këmbe njësitë - Njësi të përshtatshme - Gjatësi, masë, vëllim	
Burimet: • libri i nxënësit, faqe 147 • minitabela • bojëra uji		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuha dhe komunikimi, Shkencat e natyrës, TIK, Artet.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve			
Organizimi i orës së mësim:			
Parashikimi i të nxënës: <i>Përmbledhje e strukturuar</i> Pyeten nxënësit/et cilat janë njësitë bazë të gjatësisë, masës, vëllimit të lëngjeve, shumëfishat e nënfishat e tyre. Shkruhen në tabelën e zezë vlerat e matjes së tri objekteve dhe tre nxënës i kthejnë ato në njësi të tjera, p.sh.: $56,8\text{ cm} = 0,568\text{ m} = 0,000568\text{ km} = 568\text{ mm}.$ $8,20\text{ l} = 820\text{ cl} = 8200\text{ ml}$ $3540\text{ mg} = 3,540\text{ g} = 0,003540\text{ kg}$			
Ndërtimi i njohurive të reja: <i>Puno në dyshe, mendo, diskuto</i> Nxënësit/et në punë të pavarur punojnë ushtrimin e librit. Mësuesi/ja mban shënim nxënësit/et që përdorin njësi matëse interesante. Mund të përgatisin letra apo domino me matjet që korrespondojnë p.sh.: $2,5\text{ m}; 2\frac{1}{2}\text{ m}; 2,5\text{ m}; 25\text{ cm};$ shkruhen nga njëra e dominosë, ndërsa në anën tjetër të dominosë vihet i njëjti shënim për të gjitha njësi të njëjta, p.sh.:			
			



Përforcimi: <i>Marrëdhëniet pyetje-përgjigje</i> Pyetën nxënësit/et se si i kanë plotësuar kutitë bosh dhe krahasojnë përgjigjet e tyre me klasën. Tregojnë para klasës dominotë e përgatitura.
Vlerësimi: Mësuesi/ja bën vlerësim diagnostikues për saktësinë në kthimin e njësive.
Detyrat dhe puna e pavarur: Nxënësit/et mund të përgatisin letra me dorë ose në kompjuter me një tabelë të ngjashme dhe në orën e ardhshme të shpallen letrat më interesante.

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: 9. Koha Diskutojmë së bashku.		Situata e të nxënësve: Sa herë gjatë ditës të duhet të shohësh patjetër orën?	
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave matematikore sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - njih dhe kupton njësitet matëse të kohës (sekonda, minuta, orë, ditë, javë, muaj, vite, dekada dhe shekuj); - lexon orën duke përdorur orën digjitale dhe atë me akrepa; - krahason kohën mes orëve digjitale/me akrepa; - përllogarit intervale të kohës duke përdorur orën digjitale dhe atë me akrepa.		Fjalët kyçe: - Njësi të kohës: sekonda, minuta, orë, ditë, javë, muaj, vite, dekada dhe shekuj - Ditë, natë - Vjen, ikën	
Burimet: - libri i nxënësit, faqja 149 - letra të mëdha të bardha - bojëra uji		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuha dhe komunikimi, Shkencat e natyrës, TIK, Art pamor.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve			
Organizimi i orës së mësimi:			
Parashikimi i të nxënësve: Rolet në grupe bashkëpunuese Mësuesi/ja ndan klasën në grupe me nga 4 vetë. Çdo grup shkruan në një letër të gjitha rastet e përditshme kur u duhet të përdorin orën. Skedat qarkullojnë nga njëri grup në tjetrin, në mënyrë që çdo grup të shtoj rastet e tij të përdorimit. Zgjidhet një nga skedat dhe prezantohet para klasës.			
Ndërtimi i njohurive të reja: Puno në dyshe, mendo, diskuto Nxënësit/et punojnë në grupe dyshe për një nga pyetjet e librit. Mësuesi/ja mban shënime rreth përdorimit të fjalorthit matematikor që përdorin, p.sh. pyetjes: Në çdo çast diku në botë është natë, apo jo? I përgjigjen: Po, sepse në çdo çast gjysma e botës është e ndriçuar, pra është ditë, gjysma tjetër është e pandriçuar, pra natë. Grupeve iu duhet edhe të llogarisin për t'u kthyer përgjigje pyetjeve, p.sh.: Sa orë do të fle gjatë jetës sime? Llogarisin: - në një natë fle 8 orë; - në 100 vjet ka $100 \times 365 = 36500$ netë - do të fle gjithsej: $36500 \times 8 = 292000$ orë.			
Përforcimi: Marrëdhëniet pyetje-përgjigje Përfaqësues të grupeve prezantojnë në dërrasë përgjigjen e pyetjeve të bëra në libër duke sqaruar veprimet e kryera. Nxënësit/et i drejtojnë shokut pyetje, zgjidhja e së cilës bëhet duke përdorur fjalorthin matematikorë për kohën.			
Vlerësimi: Mësuesi/ja bën vlerësim diagnostikues për përdorimin drejt të fjalorthit matematikorë për njësitet e kohës.			
Detyrat dhe puna e pavarur: - Nxënësit/et bëjnë skeda duke klasifikuar rastet e përdorimit të orës sipas qëllimit. - Të ndërtojnë orë me akrepa.			

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: 9A. Këmbimi i njësive të kohës. Zbulojmë.		Situata e të nxënit: - Më thoni sa është ora? - Keni orë me akrepa apo digjitale?	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave matematikore sipas temës mësimore Nxënësi/ja: • lexon orën duke përdorur orën digjitale dhe atë me akrepa; • krahason kohën mes orëve digjitale/me akrepa; • përllogarit intervale të kohës duke përdorur orën digjitale dhe me akrepa.		Fjalët kyçe: - Njësi të kohës (orë, minuta) - A.m (paradite); p.m (pasdite) - Mesdite; mesnatë - Ora me akrepa; ora digjitale.	
Burimet: • libri i nxënësit, faqja 150-151 • orë e madhe me akrepa për t'u dalluar nga e gjithë klasa. • nëse është e mundur, ora dore/muri me akrepa për përdorim individual		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuha dhe komunikimi, TIK, Art pamor.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve			
Organizimi i orës së mësimi:			
Parashikimi i të nxënit: <i>Marrëdhëniet pyetje-përgjigje</i> Mësuesi/ja iu kërkon nxënësve/eve të lexojnë pjesë të skedave të bëra gjatë javës për rastet e përdorimit të orës sipas qëllimit dhe kjo i jep mundësinë të kontrollojë e korrigjojë shqiptimin e fjalorthit matematikor në përdorimin e njësive të kohës. Pastaj pyet nxënësit/et: <i>Sa prej jush kanë ora dore me akrepa apo ora muri me akrepa në shtëpi?</i> Flet për ndryshimin mes orës me akrepa dhe asaj digjitale , përfshirë përdorimin e termave ndërkombëtarë a.m (00:00 - 12:00) dhe p.m (12:00 - 24:00). Përdor orën e madhe me akrepa në krye të klasës për t'i treguar nxënësve/eve një sërë orësh. Sa herë tregon një orë të re, u kërkon nxënësve/eve të shkruajnë të njëjtën orë, duke përdorur orën digjitale 24-orëshe . Mësuesi/ja iu kërkon nxënësve/eve të tregojnë orën e mëvonshme, duke lëvizur akrepat e orës sipas intervaleve të poshtëshënuara: 09:24 45 minuta me vonë (10:09) 2 ore e 15 minuta me vonë (12:24) 1 ore e 30 minuta me vonë (13:54) 5 ore e 20 minuta me vonë (19:14) Pas secilës vlerë ore, pyesni: <i>Si e llogaritet orën e re?</i> Nxënësit/et mund të përgjigjen në mënyra të ndryshme p.sh.: - duke rrotulluar akrepat me vlerën që tregon intervali kohor dhe më pas lexojnë vlerën e re ose në orën digjitale mbledh p.sh.: 09:24 + 00:45 10:09 në orën me akrepa mbledh: 9h 24' + 45' 10h 9'			
Ndërtimi i njohurive të reja: <i>Puno në dyshe, mendo, diskuto</i> Nxënësit punojnë në punë të pavarur ushtrimet e librit duke përdorur si ndihmë orën me akrepa që ata kanë ndërtuar. Lëvizin akrepat për të krijuar vlerat e orës që fillimisht i shkruajnë si ora digjitale p.sh.:     01:23 04:56 12:34 23:45			
Kujdes shmangien e akrepit të orës në varësi të vlerave të minutave.			
Përforcimi: <i>Shkëmbe një problem</i> Nxënësit/et prezantojnë në dërrasë variantet e mundshme të zgjidhjeve të ushtrimit 1, si shkruhet, si lexohet. Më pas, shokët e bankës i shkruajnë njëri-tjetrit vlerën e një ore në mënyra digjitale dhe kërkojnë ta paraqesin në orë me akrepa dhe ta shkruajnë dhe lexojnë në mënyrë korrekte në të dyja mënyrat p.sh.: Në orën me akrepa: - Një e dhjetë minuta Në orën digjitale: - Një e dhjetë - pesë pa çerek - katër e dyzetepesë			

Mund të kërkojnë dhe llogaritjen e intervalit kohor midis tyre p.sh.: 04:45 - 01:10 03:35
Vlerësimi: Mësuesi/ja vlerëson nxënësit/et për mënyrën e leximit dhe shkrimit të orës me akrepa dhe digjitale dhe llogaritjes së intervaleve kohore.
Detyrat dhe puna e pavarur: Nxënësit/et shkruajnë 5-6 raste të përdorimit të përditshëm të orës në dy mënyra, atë me akrepa dhe digjitale dhe tregojnë mënyrën se si lexohen ato.

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: 9A. Këmbimi i njësive të kohës. Eksplorojmë.		Situata e të nxënit: - A mund të radhisni njësitë e kohës që ju njihni? - Sa sekonda ka një orë mësimi?	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave matematikore sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - njuh dhe kupton njësitë për të matur kohën (sekonda, minuta, orë, ditë, javë, muaj, vite, dekada dhe shekuj); - kthen nga një njësi matëse në tjetrën; - përlllogarit intervale të kohës në ditë, muaj ose vite.		Fjalët kyçe: - Njësitë e kohës (sekonda, minuta, orë, ditë, javë, muaj, vite, dekada dhe shekuj) - Kthe njësitë e kohës - Radhit njësitë e kohës	
Burimet: Libri i nxënësit, faqja 152-153 - Letra me fjalët e njësive të kohës të shkruara mbi to: mijëvjeçar, shekull, dekadë, vit, muaj, javë, ditë, orë, minutë, sekondë. - Kuti me fisha ku në secilën fishë të jetë shkruar emri i nxënësit - Makina llogaritëse - Kalendar		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuha dhe komunikimi, TIK, Shoqëria dhe mjedisi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve			
Organizimi i orës së mësimi:			
Parashikimi i të nxënit: <i>Imagjinatë e drejtuar</i> Mësuesi/ja tërheq një fishë nga kutia me fisha në të cilat janë shkruar emrat e nxënësve/eve. Nxënësi/ja i zgjedhur tërheq një fishë nga kutia e fishave me njësitë e kohës e kështu veprohet me disa nxënës. Kërkon nga nxënësit/et të pozicionohen nga vlera më e vogël te më e madhja (sekondat në njërin krah dhe mijëvjeçari në krahun tjetër). Sa herë që nxënësit/et të tërheqin një letër, iu kërkohet të thonë një fakt në lidhje me atë njësi kohe, për shembull: Një mijëvjeçar përmban 10 shekuj ose 100 dekada ose 1000vite Një shekull përmban 100 vjet apo Një minutë përmban 60 sekonda .			
Ndërtimi i njohurive të reja: <i>Puno, mendo, në dyshe diskuto</i> Pasi nxënësit/et të kenë plotësuar tabelën në librin e nxënësit, mësuesi/ja kontrollon përgjigjet e tyre në mënyrë që ata të kenë informacionin e duhur para se të kalojnë te pyetjet e tjera. Punojnë individualisht ushtrimet e librit dhe kontrollojnë rezultatet me shokun e bankës për ushtrimet 2- 6. Nxënësit/et mund të përdorin makina llogaritëse për të kryer përlllogaritjet. Mësuesi/ja pyet herë pas here, p.sh.: - Si po e bëni përlllogaritjen? - Pse po shumëzoni me 24 apo me 60?			
Përforcimi: <i>Rishikim në dyshe</i> Mësuesi/ja tërheq një fishë nga kutia e emrave të nxënësve/eve. Ky i fundit po kështu tërheq emrin e një nx- ënësi/e tjetër dhe një fish me njësitë e kohës dhe i kërkon atij të thotë sa më shumë fakte në lidhje me atë njësi duke i drejtuar pyetje të tilla si: - Sa njësi më të vogla përfshihen në njësinë më të madhe? Mund të përsëritet kjo dhe me çifte të tjera nxënësish.			

Vlerësimi: Mësuesi/ja vlerëson gjatë gjithë orës në lidhje në kthimin e nxënësve të kohës në njësi më të vogla dhe përllogaritjen e intervaleve kohore.
Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimet 7-9 në libër, fq. 53. - Nxënësit/et mund t'u drejtojnë pyetje pjesëtarëve të familjeve rreth datave të rëndësishme në historikun e familjes së tyre.

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: 9B. Përdorimi i sistemit 24- orësh të kohës dhe tabelat e orareve. Zbulojmë.		Situata e të nxënësve: - A keni bërë ndonjë ekskurSION me klasën? - A mund të më tregoni kohën përgjatë itinerarit të udhëtimit?	
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave matematikore sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: • lexon dhe përdor sistemin 24-orësh.		Fjalët kyçe: - Njësitë e kohës - Vjen/arrin, ikën/niset - Sistemi 24-orësh, sistemi 12-orësh - <i>Sa kohë pas...?</i> - <i>Sa kohë ka ndërmjet...?</i>	
Burimet: • libri i nxënësve, faqja 154 • minitabela të bardha • kuti me fisha sipas emrit të nxënësve (nga ushtrimi i mëparshëm)		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuha dhe komunikimi, TIK, Shoqëria dhe mjedisi.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve

Organizimi i orës së mësimi:

Parashikimi i të nxënësve: *Mendo – krijo dyshe – diskuto*

Mësuesi/ja tërheq nga kutia e fishave me emrat e nxënësve/eve dy prej tyre dhe i kërkon çiftit të nxënësve/eve të shkruajnë në minitabela tri vlera ore që lidhen me një ngjarje të ditës së mëparshme. Mund të jetë çfarëdolloj ngjarje, për shembull: ora kur u zgjuan, ora kur dolën nga shtëpia për të shkuar në shkollë, ora kur mbaruan detyrat e shtëpisë, ora kur u kthyen në shtëpi pas shkollës, ora kur fjetën gjumë, kur hëngrën drekën. Kërkohe të shkruajnë një vlerë ore nga paraditja dhe një nga pasditja ose mbrëmja. Përdoren fihat për të përzgjedhur gjatë nxënës, të cilët rreshtohen në krye të klasës nga ngjarja më e hershme në atë më të vonshme. Nxënësit/et të llogarisin intervalin e kohës nga një ngjarje në tjetrën, p.sh.: *Sa zgjat intervali kohor që nga ora kur dolën nga shtëpia deri sa u kthyen ?* Iu kërkohe të flasin rreth idesë së një **orari**.

Ndërtimi i njohurive të reja: *Imagjinatë e drejtuar*

Nxënësit/et punojnë ushtrimet 1- 2 në libër. Nxënësit/et duhet të krijojnë orare për ushtrimet në librin e nxënësve. Nxiten të përdorin ora që nuk janë vetëm pjesë të “gjysmë” apo “çerek”, veçanërisht në orarin e ekskurSIONeve të shkollës apo në ditët e pushimit. Në listën e ngjarjeve, u kërkohe nxënësve/eve të përfshijnë fakte që kanë të bëjnë edhe me kohëzgjatjen e veprimtarisë, jo thjesht të citojnë ngjarjet, për shembull: *Fjeta për 8 orë e 35 minuta*. U drejtohen pyetje për të ndihmuar nxënësit/et që të vlerësojnë njohuritë e tyre rreth përllogaritjes së intervaleve të kohës, për shembull:

Sa kohë pas...?

Sa kohë ka ndërmjet...?

Nxiten nxënësit/et të përdorin fjalorthin e kohës. Theksohet përdorimi i sistemit 24-orësh duke thënë, për shembull: *pesë e shtatëmbëdhjetë për 05:17*.

Përforsimi: *Rishikim në dyshe*

Tre nxënës/e paraqesin para klasës minitabelat me oraret e tyre përkatëse të një dite shkolle, pushimi, udhëtimi. Nxënësit/et bëjnë pyetje në çift për sa i përket orareve individuale, p.sh.:

- *Cilin film ndoqe dje në televizor dhe sa kohë zgjati filmi?*

- *Sa orë studiove dje për matematikën?*

- *Sa kohë pasi hëngre darken flete gjumë?*

- *Sa kohë pushim ka ndërmjet dy orëve mësimore?*

Vlerësimi: Mësuesi/ja vlerëson nxënësit/et për leximin dhe përdorimin saktë të sistemit 24-orësh gjatë krijimit të orareve dhe përlogaritjen e intervaleve kohorë në to.

Detyrat dhe puna e pavarur: - Ushtrimi 3 fq. 154 në libër.

- Të sjellin në klasë orën tjetër letra të mëdha e lapsa me ngjyra.


Fusha: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: 9B. Përdorimi i sistemit 24-orësh të kohës dhe tabelat e orareve. Eksplorojmë.		Situata e të nxënit: Jeni menaxher i një kompanie autobusësh. Duhet të llogarisni rrugën e autobusëve që çojnë nxënësit në shkollë dhe i kthejnë përsëri në shtëpi.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave matematikore sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: • lexon dhe përdor sistemin 24-orësh.		Fjalët kyçe: - Vjen/arrin, ikën/niset - Sistemi 24-orësh, sistemi 12-orësh - Itinerari i autobusit	
Burimet: • libri i nxënësit, faqja 155 • letra të mëdha dhe stilolapsa		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuha dhe komunikimi, TIK, Shoqëria dhe mjedisi, Art pamor.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve

Organizimi i orës së mësimi:

Parashikimi i të nxënit: *Imagjinatë e drejtuar*

Mësuesi/ja punon me të gjithë klasën për të zgjidhur ushtrimin në librin e nxënësit. Mësuesi/ja vizaton në dërrasë një hartë-skicë, e cila nis (dhe mbaron) me “stacionin e autobusit” dhe që lidh bashkë gjashtë vende të mundshme që kanë nevojë për një ndalesë autobusi në zonën lokale. Merr sugjerimet e nxënësve/eve. Shkruan vlerat e orës në hartën-skicë. Pastaj, duke filluar nga stacioni i autobusit në orën **08:45**, shkruan orën në të cilën autobusi **arrin** dhe **niset** nga secila ndalesë. Pyet: *Sa kohë i duhet autobusit të shkojë nga ... në ...?*



Për shembull: *Sa kohë i duhet autobusit të shkojë në shkollë?*

$$\begin{array}{r}
 09:05 \\
 - 08:45 \\
 \hline
 00:20
 \end{array}$$

Në ç'orë niset nga shkolla?

$$\begin{array}{r}
 09:05 \\
 + 00:02 \\
 \hline
 09:07
 \end{array}$$

Ndërtimi i njohurive të reja: *Rolet në grupet bashkëpunuese*

Nxënësit/et në grupe 4 veta përpilojnë harta-skicë për itinerarin dhe orarin e autobusit të linjës në zonën lokale (duke përdorur letër dhe stilolapsa). Kur të jenë të sigurt se harta dhe orari janë të saktë, iu kërkohet t'ua përshkruajnë punën e tyre. Pas kësaj, nxënësit/et punojnë ushtrimin 2 të librit në punë të pavarur. Plotësojnë tabelën dhe përlogarisin intervale të ndryshme kohore.

Përforcimi: *Rishikim në dyshe*

Mësuesi/ja zgjedh një grup që të paraqesë itinerarin dhe orarin e tyre të autobusit përpara klasës. Iu kërkohet nxënësve/eve të tjerë të bëjnë pyetje dhe të vlerësojnë efikasitetin e itinerarit.

Vlerësimi: Nxënësit/et vlerësohen për leximin dhe përdorimin e sistemit 24-orësh në përcaktimin e saktë të një orari udhëtimesh.

Detyrat dhe puna e pavarur: Nxënësit/et bëjnë një hartë-skicë për itinerarin dhe orarin e autobusit të linjës ku banojnë me 5-6 ndalesa dhe përlogaritjet e intervaleve kohorë.

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: 9C. Llogaritja e intervaleve të kohës dhe koha zonale. Zbulojmë.		Situata e të nxënësve: A mund të telefonosh kushëritit tënd në Amerikë në mëngjes para se të ikësh në shkollë? Pse?	
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave matematikore sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: vlerëson se si ora është e ndryshme në zona të ndryshme kohe nëpër botë.		Fjalët kyçe: - Zonat ndërkombëtare të kohës - Sa kohë më herët? - Sa kohë më vonë? - Sa orë përpara? - Sa orë prapa?	
Burimet: - libri i nxënësit, faqja 156 - hartë e madhe e botës ku tregohen zonat e kohës fletore - kuti me fisha me emrat e nxënësve		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuha dhe komunikimi, TIK, Shoqëria dhe mjedisi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve			
Organizimi i orës së mësimi:			
Parashikimi i të nxënësve: <i>Marrëdhëniet pyetje-përgjigje</i> Mësuesi/ja paraqet në dërrasë një hartë që tregon orën zonale ndërkombëtare në mbarë botën si shkak i lindjes së diellit në orë të ndryshme në zona të ndryshme, për shkak të rrotullimit të Tokës rreth boshtit të saj nga perëndimi në lindje. Mësuesi/ja iu kërkon nxënësve/eve që, në çifte, të shkruajnë në fletoret e tyre të gjitha vendet e ndryshme në botë që kanë vizituar ose ku jetojnë pjesëtarët e familjes së tyre. Përzgjedh disa nxënës/e duke zgjedhur fishat në kuti. Iu kërkon çdo nxënësi/e të përzgjedhur të caktojë një vend nga lista e tij, të gjejnë vendin në hartën e botës dhe mundohen të gjejnë orën aktuale në atë vend duke përdorur zonat ndërkombëtare të kohës . Nxënësit/et të mbajnë një listë të të gjitha vendeve dhe orëve në tabelën e zezë.			
Ndërtimi i njohurive të reja: <i>Kërko-hulumto</i> Nxënësit/et punojnë në punë të pavarur me ushtrimin në libër. Mësuesi/ja udhëzon të shkruajnë një sërë faktesh që njohin në lidhje me orën zonale, si dhe të ndajnë me klasën faktet që iu duken interesante. Për shembull: - Ne jemi në zonën (+1), së bashku me ne është Kosova, Italia, Austria, Zvicra... - Greqia është një orë para nesh (zona +2). - Anglia është një orë pas nesh (zona 0). - Florida është 6 orë pas nesh se ndodhet në zonën (-5). - Australia ka tri orë zonale.			
Përforcimi: <i>Rishikim në dyshe</i> Nxënësit/et në dyshe rishikojnë faktet e njëri-tjetrit dhe kontrollojnë nëse janë të sakta. Përfaqësuesit e grupeve ndajnë me klasën disa nga faktet që iu duken interesante.			
Vlerësimi: Mësuesi/ja bën vlerësime individuale në dhënien e fakteve të drejta për përdorimin e hartës që tregon orën zonale ndërkombëtare.			
Detyrat dhe puna e pavarur: - Nxënësit/et sjellin pesë fakte konkrete në lidhje me orën zonale ku banojnë të afërmit e tyre në mbarë botën.			
Detyrë hulumtuese: - Të sillet e printuar në klasë një tabelë me emrat e shteteve të ndarë sipas orës zonale.			

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: 9C. Llogaritja e intervaleve të kohës dhe koha zonale. Eksplorojmë.		Situata e të nxënësve: Një shoqja juaj në Argentinë e feston Vitin e Ri para apo pas jush? Sa orë?	
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave matematikore sipas temës mësimore Nxënësi/ja: vlerëson se si ora është e ndryshme në zona të ndryshme kohe nëpër botë.		Fjalët kyçe: - Zonat ndërkombëtare të kohës - Sa kohë më herët? - Sa kohë më vonë? - Sa orë përpara? - Sa orë prapa?	

Burimet: - libri i nxënësit, faqja 157-158. - hartë e madhe e botës ku tregohen zonat e kohës fletore - kuti me fisha me emrat e nxënësve	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuha dhe komunikimi, TIK, Shoqëria dhe mjedisi.
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve	
Organizimi i orës së mësimi:	
Parashikimi i të nxënit: <i>Imagjinatë e drejtuar</i> Nxënësit/et kanë mbi tavolinë tabelën e nxjerrë nga interneti për orët zonale. Nxënësit/et drejtojnë pyetje dhe grumbullojnë fakte të ndryshme në lidhje me orët zonale duke u mbështetur te tabela, si p.sh.: - Në zonën (-12) ndodhen ishujt <i>Baker</i> dhe <i>Howland</i> (të dy të pabanuar). - Kur dielli lind në Zelandën e Re (+12) te ne bie mbrëmja.	
Ndërtimi i njohurive të reja: <i>Puno në dyshe, mendo, diskuto</i> Nxënësit/et punojnë ushtrimet 1- 6 në libër në punë të pavarur. Herë pas here diskutojnë me shokun rezultatet. Për të pasur fakte të sakta, iu drejtohen tabelës ku shtetet janë ndarë sipas orës zonale.	
Përforcimi: <i>Marrëdhëniet pyetje-përgjigje</i> Nxënësit/et paraqesin në dërrasë zgjidhjet e ushtrimeve 1-6/a,b. Pastaj nxënësit/et pyesin njëri-tjetrin: - Çfarë keni mësuar në dy mësimet e fundit? - Çfarë gjëje të re keni mësuar? - Çfarë ju ka bërë përshtypje? - Çfarë dinit që më parë?	
Vlerësimi: Mësuesi/ja vlerëson nxënësit/et në mënyrë individuale për përllogaritjet e sakta të intervaleve kohore e përdorimin saktë të shprehjeve: - <i>Sa orë përpara?</i> - <i>Sa orë prapa?</i>	
Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimin 6/c-e fq. 158.	

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: 9. Koha. Përmbledhim.		Situata e të nxënit: Të planifikojnë një orar udhëtimi për ekskursionin që do të bëjnë me klasën në ishull.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave matematikore sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - njuh dhe kupton njësitë për matjen e kohës; - lexon dhe përdor oraret ku përdoret sistemi 24-orësh; - përllogarit intervalet e kohës duke përdorur orën digjitale.		Fjalët kyçe: - Vjen/arrin, ikën/niset - Sistemi 24-orësh, sistemi 12-orësh - Batica - Ishull - Itinerar, orar udhëtimi	
Burimet: - libri i nxënësit, faqja 159 - letra të mëdha për të skicuar zgjidhjet e problemit.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuha dhe komunikimi, TIK, Shoqëria dhe mjedisi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve			
Organizimi i orës së mësimi:			
Parashikimi i të nxënit: <i>Diskutimi i njohurive paraprake</i> Mësuesi/ja diskuton me nxënësit/et se ç'janë baticat dhe pse s`duhet të nisen gjatë orëve të baticave. Po kështu duhen respektuar oraret përkatëse të nisjes, kthimit, qëndrimit në ishull, p.sh.: Në 5 korrik meqë 08:00 - 10:00 ka baticë nisja bëhet në 10:00 + 00:45 10:45 – koha në vajtë 10:45 + 04:00 14:45 – pushimi në ishull 14:45 Ndërkohë në orën 15:00 ka filluar batica, kështu që ky variant bie. 14:45 + 00:45 15:30 – koha në kthim			

Ndërtimi i njohurive të reja: <i>Rolet në grupet bashkëpunuese</i> Nxënësit/et të ndarë në grupe me nga 4 veta shqyrtojnë variantet e tabelës së librit si në shembullin e sqaruar më lart ku duhen pasur kujdes të gjitha kushtet e vëna në fillim. Më pas, diskutojnë ushtrimet në libër. Përforcimi: <i>Marrëdhëniet pyetje-përgjigje</i> Përfaqësues të grupeve paraqesin në dërrasë përllogaritjet për secilin nga variantet e tabelës. Duke u mbështetur në to, nxënësit/et drejtojnë pyetje (si në ushtrimet e librit) njëri-tjetrit dhe diskutojnë përgjigjet e mundshme. Vlerësimi: Mësuesi/ja vlerëson individualisht idenë e zgjidhjes së problemit të shtruar te situata e të nxënës dhe përllogaritjet përkatëse. Detyrat dhe puna e pavarur: Nxënësit/et mund të përgatisin një ekskursion të vërtetë me klasën dhe të krijojnë një problem me situata të ngjashme me librin (detyra të dorëzohet si detyrë krijuese për dosje).
--

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: 9. Koha. Përforcojmë.		Situata e të nxënës: A mund të shkruani pesë pyetje për të kontrolluar njohuritë e shokut ose shoqes suaj për ato që keni mësuar gjatë këtij kreu?	
Rezultatet e të nxënës të kompetencave matematikore sipas temës mësimore Nxënësi/ja: • njeh dhe kupton njësitë për matjen e kohës; • lexon orën në formën me akrepa dhe digjitale të saj duke përdorur sistemin 24-orësh; • krahason orën në formën e saj me akrepa dhe digjitale; • llogarit intervalet e kohës duke përdorur orën digjitale dhe me akrepa; • llogarit intervalet e kohës në ditë, muaj dhe vite; • kupton se si ndryshon ora në zona të ndryshme kohe nëpër botë.		Fjalët kyçe: - Njësitë e kohës - Lexon orarin 24-orësh, 12-orësh - Përllogarit intervale kohore	
Burimet: • libri i nxënësit, faqja 160-161.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuha dhe komunikimi, TIK, Shoqëria dhe mjedisi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve			
Organizimi i orës së mësimi: Parashikimi i të nxënës: <i>Përmbledhje e strukturuar</i> Mësuesi/ja kërkon nga nxënësit/ee të shkruajnë në fletore pesë pyetje për të kontrolluar njohuritë e shokut ose shoqes për ato që kanë mësuar gjatë këtij kreu p.sh.: - Cili është dallimi mes orës digjitale dhe me akrepa? - Si tregohet e lexohet ora me akrepa, kur ora digjitale tregon 14:25. - Sa ditë kanë 5 javë? - Unë shkoj në stërvitje në orën 3 p.m. Sa tregon ora digjitale në këtë rast?			
Ndërtimi i njohurive të reja: <i>Puno në dyshe, mendo, diskuto</i> Nxënësit/et punojnë ushtrimet në libër. Pyetjet e bëra nga secili nxënësi/e i jepen shokut të bankës për t'iu përgjigjur.			
Përforcimi: <i>Rishikim në dyshe</i> Grupe të ndryshme paraqesin para klasës disa nga pyetjet interesante së bashku me përgjigjet e tyre duke përfshirë matjen e kohës me orën me akrepa e digjitale, këmbimin e njësive, përdorimin e sistemit 24-orësh.			
Vlerësimi: Mësuesi/ja bën vlerësim diagnostikues për njohuritë e marra për matjen e kohës, këmbimin e njësive të kohës, përdorimin e sistemit 24-orësh dhe 12-orësh.			
Detyrat dhe puna e pavarur: Nxënësit/et të bëjnë pesë pyetje dhe të kthejnë pesë përgjigje në lidhje me njohuritë e marra mbi kohën.			

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: 10. Sipërfaqja dhe perimetri. Diskutojmë së bashku.		Situata e të nxënësve: A mund të gjenden figura të ndryshme me të njëjtën sipërfaqe?	
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave matematikore sipas temës mësimore Nxënësi/ja: mat dhe llogarit perimetrin dhe sipërfaqen e figurave drejtkëndore.		Fjalët kyçe: - Perimetri - Sipërfaqe - Gjatësia, lartësia, gjerësia, thellësia	
Burimet: - libri i nxënësit, faqja 163 - fletore - letër me katrorë		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuha dhe komunikimi, TIK, Art pamor.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve

Organizimi i orës së mësimi:

Parashikimi i të nxënësve: Diskutimi i njohurive paraprake

Nxënësit/et ndahen në çifte, flasin për pesë minuta dhe mendohen për pyetjen: *Çfarë dini për sipërfaqen dhe perimetrin?* Pas pesë minutash, mësuesi/ja merr përgjigjet e të gjitha çifteve të nxënësve, rendit fjalët kryesore në tabelën e zezë. Për shembull, përfshin:


gjatësia, gjerësia, lartësia, thellësia;

perimetër, perimetër i rrethit;

zonë, sipërfaqe e bazës, syprina, sipërfaqe anësore;

centimetër katror (cm^2), metër katror (m^2), milimetër katror (mm^2).

Më pas, mësuesi/ja kërkon t'i përgjigjen situatës së të nxënësve.




Pra, gjenden figura të ndryshme me të njëjtën sipërfaqe.

Ndërtimi i njohurive të reja: Rolet në grupet bashkëpunuese


Mësuesi/ja ndan nxënësit/et në grupe me katër ose pesë vetë. Kërkon nga secili grup të diskutojë një nga fjalitë në veprimtarinë e librit të nxënësit. Grupe të ndryshme mund të punojnë me të njëjtën fjalë. Nxiten nxënësit/et të përdorin shembuj (duke përdorur letër me katrorë dhe fletoret) për të parë nëse fjalitë janë gjithmonë të vërteta, ndonjëherë të vërteta apo asnjëherë të vërteta, p.sh.:

- ka shumë figura me të njëjtën sipërfaqe, p.sh.:



Përgjigjja: Po, gjithmonë e vërtetë.

- Çdo figurë me sipërfaqe $16n^2$ ka të njëjtën perimetër.



Përgjigjja: Kjo nuk është gjithmonë e vërtetë.

Përforcimi: *Rishikim në dyshe*

Përfaqësues të grupeve paraqesin variantet e tyre për të treguar vërtetësinë për çdo fjalë të librit, duke plotësuar dhe me variante nga grupe të tjera që kishin të njëjtën fjalë. Në prezantim përpqen të përdorin sa më shumë fjalë kyçe.

Vlerësimi: Mësuesi/ja bën vlerësim diagnostikues për njohuritë që kanë për sipërfaqet dhe perimetrin e figurave dhe përdorimin e fjalëve kyçe.

Detyrat dhe puna e pavarur: - Nxënësit/et hartojnë një fjalë të ngjashme me ato të librit dhe argumentojnë me figurë përgjigjen përkatëse.
- Nxënësit/et përpqen t'i përgjigjen pyetjes: *Kur dyfishoni përmaset e një kuboidi, çfarë ndodh me vëllimin?*

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: 10A. Sipërfaqja dhe perimetri i figurave drejtkëndore. Zbulojmë.		Situata e të nxënit: Një fermer ka 24 metra tel për gardh. Ai dëshiron që të rrethojë maksimumin e mundshëm të sipërfaqes së tokës për të kullotur dhitë e tij.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave matematikore sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: mat dhe llogarit perimetrin dhe sipërfaqen e figurave drejtkëndore.		Fjalët kyçe: - Sipërfaqe - Perimetër - Përmasa, gjatësia, gjerësia	
Burimet: - libri i nxënësit, faqja 164 - fletore - letër me katrorë		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuha dhe komunikimi, TIK, Art pamor.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve			
Organizimi i orës së mësimi:			
Parashikimi i të nxënit: <i>Imagjinatë e drejtuar</i> Për të realizuar situatën e të nxënit, mësuesi/ja drejton imagjinatën e nxënësve/eve me një shembull të ngjashëm. Nxënësit/et shfrytëzojnë hapësirën bosh të klasës (mund të realizohet edhe në oborrin e shkollës), kapen për dore dhe formojnë një drejtkëndësh. Nxënësit/et veprojnë në mënyrë të pavarur, duke formuar drejtkëndësha të tjerë, por pa lëshuar duart. Mësuesi/ja pyet: <i>Ç`mund të themi për perimetrin e këtyre drejtkëndësive?</i> (Perimetri ngelet i njëjtë pavarësisht nga drejtkëndëshi që mund të formojnë.)			
4 32 8 P = 24 njësi 6 36 6 P = 24 njësi 2 20 10 P = 24 njësi			
Ndërtimi i njohurive të reja: <i>Hulumtim, shqyrtim i përbashkët</i> Mësuesi/ja ndan klasën në grupe 4 veta. Nxënësit/ja punojnë në fletë me kuti katrore. Çdo nxënës në punë të pavarur bën figura drejtkëndore me perimetër 24 njësi. Numërojnë njësitë katrore për të llogaritur sipërfaqet. Vëmë re se kanë sipërfaqe të ndryshme në përgjithësi. Duke vëzhguar punën në grup si dhe duke shkëmbyer fletët me grupet e tjera gjejnë ndër figurat e bëra figurën me sipërfaqe më të madhe.			
4 32 8 2 2 2 2 2 20 2 6 36 6 3 1 6 4 21 3 2 20 10			

Të gjitha figurat e kanë perimetrin 24 njësi.

Përforcimi: *Marrëdhëniet pyetje-përgjigje*

Përfaqësues të grupeve të ndryshme paraqesin në dërrasë variantet të ndryshme të figurave drejtkëndore me perimetër 24 njësi. Mësuesi/ja pyet: *Cila është forma më e përshtatshme?*

Zgjedhin formën që i përgjigjet sipërfaqes më të madhe si gardhin më të përshtatshëm.

Vlerësimi: Mësuesi/ja bën vlerësim individual për vizatimin e figurave drejtkëndore me perimetër e sipërfaqe të dhënë dhe përdorimin e fjalorthit matematikor për sipërfaqen dhe perimetrin e figurave.

Detyrat dhe puna e pavarur: Nxënësit/et të krijojnë një situatë të ngjashme me atë të librit dhe të vizatojnë figura drejtkëndore me perimetër 20 njësi.


Fusha: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: 10A. Sipërfaqja dhe perimetri i figurave drejtkëndore. Eksplorojmë.		Situata e të nxënës: Perimetri i drejtkëndëshit është 48nj^2 . Cilat janë përmasat e mundshme të gjatësisë dhe gjerësisë?	
Rezultatet e të nxënës të kompetencave matematikore sipas temës mësimore Nxënësi/ja: mat dhe llogarit perimetrin dhe sipërfaqen e figurave drejtkëndore.		Fjalët kyçe: - Sipërfaqe - Perimetër - Përmasa, gjatësia, gjerësia	
Burimet: - libri i nxënësit, faqja 165-166 - fletore - letër me katrorë		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuha dhe komunikimi, TIK, Art pamor.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve

Organizimi i orës së mësimi:

Parashikimi i të nxënës: *Marrëdhëniet pyetje-përgjigje*

Mësuesi/ja bën në tabelë një drejtkëndësh kërkon nga nxënësit/et të thonë variantet e mundshme të përmasave të tij (1×48 , 2×24 , 3×16 , 4×12 , 6×8).



Nxënësit/et mund të përsërisin ushtrimin me një figurë tjetër.

Ndërtimi i njohurive të reja: *Puno në dyshe, mendo, diskuto*

Mësuesi/ja ndan klasën në grupe 4 veta. Çdo grup punon me një nga ushtrimet 1-5. Për çdo rast japin variante të ndryshme për përmasat, p.sh.:

$S = 36\text{nj}^2$ përmasat e mundshme (1×36 ; 2×18 ; 3×12 ; 4×9 ; 6×6)

Përmasat	Figura	Sipërfaqja (nj^2)	Perimetri (nj)
6×6		36	24
4×9		36	26
...	...	...	...

Përforcimi: *Rishikim në dyshe*


Nxënësit/et paraqesin në dërrasë 2-3 variante për çdo ushtrim. Diskutojnë midis tyre për saktësinë e përllogaritjeve të perimetrit dhe sipërfaqes. Mësuesi/ja kërkon të përdorin saktë fjalorthin matematikor në përdorimin e fjalëve kyçe. Përpiqen të nxjerrin formulën: Sipërfaqe = bazë x lartësi.

Vlerësimi: Mësuesi/ja vlerëson individualisht nxënësit/et në përcaktimin e përmasave të një figure drejtkëndore me sipërfaqe të dhënë dhe përdorimin e fjalorthit matematikor për fjalët kyç.

Detyrat dhe puna e pavarur: Nxënësit/et ndërtojnë dy figura drejtkëndore me sipërfaqe të dhënë dhe pasi përcaktojnë përmasat njehsojnë edhe perimetrin.

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: 10B. Vlerësimi i sipërfaqes së figurave të parregullta duke numëruar katrorët. Zbulojmë.		Situata e të nxënit: A mund të hamendësoni sipërfaqen e dorës sime në cm ² ? Po varësinë ndërmjet gjatësisë dhe sipërfaqes së dorës?	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave matematikore sipas temës mësimore Nxënësi/ja: llogarit sipërfaqen e një figure të parregullt duke numëruar katrorët.		Fjalët kyçe: - Sipërfaqe - Figurë e parregullt - Llogarit	
Burimet: - libri i nxënësit, faqja 167-169 fletore - fotokopje e shenjave të dorës në një letër me katrorë në cm - letër me katrorë		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuha dhe komunikimi, TIK, Art pamor.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve			
Organizimi i orës së mësimit:			
Parashikimi i të nxënit: <i>Imagjinatë e drejtuar</i> Mësuesi/ja pyet nxënësit/et: <i>A mund të hamendësoni sipërfaqen e dorës sime në cm²?</i> Nxënësit/et shkruajnë shifrën në fletore. Pastaj mësuesi/ja shpërndan disa fotokopje të vizatimit të dorës së tij. I kërkon secilit grup (me katër ose pesë vetë) të llogarisë sipërfaqen duke numëruar katrorët. Nxënësit/et japin idetë e tyre se si do ta përllogarisin. Pastaj bien dakord për përllogaritjen e sipërfaqes në këtë mënyrë: numrit të katrorëve të plotë i shtojmë gjysmën e numrit të katrorëve të paplotë.			
Ndërtimi i njohurive të reja: <i>Hulumtim, shqyrtim i përbashkët</i> Nxënësit/et përsërisin ushtrimin në libër, por tashmë me dorën e tyre. Matet gjatësia e dorës, përllogaritet sipërfaqja dhe plotësohet tabela. Në tabelë vendosin edhe matjet e bëra nga shokët e tjerë të grupit si dhe bashkëpunojnë dhe me nxënësit/et e grupeve të tjera. Kjo mundëson të shohin lidhjen e drejtpërdrejtë midis gjatësisë dhe sipërfaqes së dorës. Në këtë rast, sa më e gjatë të jetë dora, aq më e madhe është sipërfaqja. Në të njëjtën mënyrë përllogarisin sipërfaqen e hartës së Shqipërisë në cm ² dhe meqë 1 cm në hartë tregon 22 km në terren gjenden dhe përmasat reale. Bazuar në këtë u përgjigjen dhe pyetjeve të librit.			
Përforcimi: <i>Marrëdhëniet pyetje-përgjigje</i> Nxënësit/et pas përllogaritjes së sipërfaqes së hartës i bëjnë pyetje njëri-tjetrit. - Sa është largësia ndërmjet qyteteve Vlorë-Tiranë (në vijë ajrore)? - Sa është largësia ndërmjet pikës më perëndimore dhe asaj më lindore të vendit tonë? Nxënësit/et verifikojnë përgjigjet me përllogaritje të përbashkëta.			
Vlerësimi: Mësuesi/ja vlerëson individualisht nxënësit/et për idetë e dhëna për përllogaritjen e sipërfaqes së figurave të parregullta dhe gjetjen e varësisë ndërmjet madhësive.			
Detyrat dhe puna e pavarur: - Nxënësit/et vizatojnë pesë figura të ndryshme në fletoren me kuti dhe përllogarisin sipërfaqen e tyre në njësi katrore (nj ²). - Të dhënat e varësisë së gjatësisë dhe sipërfaqes i paraqesin në një diagram.			


Fusha: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: 10B. Vlerësimi i sipërfaqes së figurave të parregullta duke numëruar katrorët. Eksplorojmë.		Situata e të nxënësve: Përllogarit sipërfaqen e pjesëve të ngjyrosura në figurën e librit e krijoni me pjesë të saj motive të reja.	
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave matematikore sipas temës mësimore Nxënësi/ja: llogarit sipërfaqen e një figure të parregullt duke numëruar katrorët.		Fjalët kyçe: - Përllogarit sipërfaqen - Figura të parregullta - Krijoni motive të reja	

Burimet: - libri i nxënësit, faqja 170-171 - letër me katrorë - gërshërë	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuha dhe komunikimi, TIK, Art pamor.														
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve															
Organizimi i orës së mësim:															
Parashikimi i të nxënësve: <i>Puno në dyshe, mendo, diskuto</i>															
	Nxënësit/et në grupe dyshe punojnë në përlogaritjen e sipërfaqeve të pjesëve të ngjyrosura në figurën e librit. Më pas, në një kopjo të madhe të figurës të bërë në dërrasën e zezë nxënësit/et tregojnë përlogaritjet e bëra, p.sh.: <table><tr><td>Pjesa</td><td>blu</td><td>bojëqielli</td><td>e gjelbër</td><td>e verdhë</td><td>portokalli</td><td>lejla</td></tr><tr><td>Sipërfaqja (nj²)</td><td>4</td><td>1</td><td>2</td><td>2</td><td>3</td><td>4</td></tr></table> Mësuesi/ja kërkon nga nxënësit/et të japin disa ide për krijimin e një motivi me pjesë nga figura e bërë në dërrasë. 	Pjesa	blu	bojëqielli	e gjelbër	e verdhë	portokalli	lejla	Sipërfaqja (nj²)	4	1	2	2	3	4
Pjesa	blu	bojëqielli	e gjelbër	e verdhë	portokalli	lejla									
Sipërfaqja (nj²)	4	1	2	2	3	4									
Ndërtimi i njohurive të reja: <i>Imagjinatë e drejtuar</i>															
Nxënësit/et punojnë në punë të pavarur me ushtrimet 1-4 në libër. Përdorin imagjinatën në krijimin e motiveve të reja duke përdorur 3, 4, 5 pjesë nga figura e dhënë. Për secilin nga modelet e krijuara përlogarisin sipërfaqen duke numëruar katrorët.															
Përforcimi: <i>Rishikim në dyshe</i>															
Nxënësit/et shikojnë modelet e njëri-tjetrit dhe kontrollojnë përlogaritjet e bëra. Disa nga modelet më interesante paraqiten në dërrasë dhe tregohen përlogaritjet e sipërfaqes dhe perimetrit të këtyre modeleve.															
Vlerësimi: Mësuesi/ja vlerëson nxënësit/et individualisht për imagjinatën në ndërtimin e motiveve të reja dhe përlogaritjen e sipërfaqeve të modeleve duke numëruar katrorët.															
Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimi 5 fq. 171.															

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: 10C. Llogaritja e sipërfaqes dhe e perimetrit të figurave të përbëra. Zbulojmë.		Situata e të nxënësve: Të shprehin informacione të ndryshme me anë të vizatimeve të figurave të përbëra që mund të ndahen në drejtkëndësha.	
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave matematikore sipas temës mësimore Nxënësi/ja: llogarit perimetrit dhe sipërfaqen e figurave të përbëra që mund të ndahen në drejtkëndësha.		Fjalët kyçe: - Figura të përbëra - Ndahen në drejtkëndësha - Shpreh informacione	
Burimet: - libri i nxënësit, faqja 172-173 - letore - letra të mëdha me katrorë - lapsa me ngjyrë		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuha dhe komunikimi, TIK, Art pamor.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve			
Organizimi i orës së mësim:			
Parashikimi i të nxënësve: <i>Marrëdhëniet pyetje-përgjigje</i> Mësuesi/ja i pyet nxënësit/et për informacionin që paraqitet në figurën e librit. Meqë sipërfaqja e shtetit A është 18 milionë km ² dhe në figurë paraqitet me 9 kuti atëherë një kuti shpreh $18 : 9 = 2$ milionë km ² . Duke numëruar kutitë në figurë vërejmë se shteti C ka sipërfaqe më të madhe, ndërsa shteti B ka sipërfaqe më të vogël.			
Ndërtimi i njohurive të reja: <i>Imagjinatë e drejtuar</i> Nxënësit/et në mënyrë individuale përpiqen të vizatojnë një pamje të re të këtyre shteteve për të dhënë një tjetër informacion, për shembull shpërndarjen e popullsisë, në shtetet A, B dhe C përkatësisht me popullsi 40 milionë, 36 milionë dhe 24 milionë banorë. Një kuti shpreh 4 milionë banorë.			

Shteti A: $40 : 4 = 10$ kuti; Shteti B: $36 : 4 = 9$ kuti; Shteti C: $24 : 4 = 6$ kuti.

Nxënësit/et vizatojnë një figurë të ngjashme duke ruajtur formën dhe pozicionin relativ të shteteve me njëri-tjetrit, sa më afër origjinalit të jetë e mundur.





Përforsimi: *Rishikim në dyshe*

Nxënësit/et vëzhgojnë vizatimet e njëri-tjetrit. Krahajojnë cili ka ruajtur më mirë formën dhe pozicionin relativ të shteteve me njëri-tjetrit, sa më afër origjinalit të jetë e mundur.

Vlerësimi: Mësuesi/ja bën vlerësim diagnostikues për shprehjen e informacionit me anë të sipërfaqeve të figurave që ndahen në drejtkëndësja.

Detyrat dhe puna e pavarur: Nxënësit/et gjejnë informacione nga interneti dhe vizatojnë të dhënat reale me anë të figurave që ndahen në drejtkëndësja.

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: 10C. Llogaritja e sipërfaqes dhe e perimetrit të figurave të përbëra. Eksplorojmë.		Situata e të nxënësve: Skiconi hapjen e një kutie <i>Amite</i> me vëllim 36 cm ³ .	
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave matematikore sipas temës mësimore Nxënësi/ja: llogarit perimetrimin dhe sipërfaqen e figurave të përbëra që mund të ndahen në drejtkëndësja.		Fjalët kyçe: - Vëllim - Kuti - Hapje - Sipërfaqe	
Burimet: - libri i nxënësit, faqja 174-175 - fletore - letra me katrorë - lapsa me ngjyrë - kube		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuha dhe komunikimi, TIK, Art pamor	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve			
Organizimi i orës së mësimi:			
Parashikimi i të nxënësve: <i>Imagjinatë e drejtuar</i> Mësuesi/ja iu thotë nxënësve/eve të përfytyrojnë sikur duhet të paketojnë një lëng me vëllim 36 cm ³ . Pyet: <i>Sa kube me brinjë 1 cm mbushen me këtë lëng? Mendoni një kuti në formë kuboidi që ta nxërë të gjithë lëngun.</i> Lihen pesë minuta të mendojnë se sa zgjidhje të ndryshme mund të ekzistojnë. Paraqesin në dërrasë një nga variantet. Skicojnë kuboidin në tabelë, bëjnë hapjen e këtij kuboidi, llogarisin sipërfaqen dhe perimetrimin e tij. Kuti <i>Amite</i> me vëllim 36 cm ³ . Variantet e mundshme të përmasave: (1; 1; 36) , (2; 2; 9) , (3; 3; 4)			
			
		(1; 2; 18) , (2; 3; 6) , (1; 3; 12) Llogarisin: $S_p = S_a + 2B$ $= 10 * 6 + 2 (2 * 3)$ $= 72$ $P = 2 * 6 + 4 * 3 + 4 * 2$ $= 32$	

Ndërtimi i njohurive të reja: *Puno në dyshe, mendo, diskuto*

Nxënësit/et në grupe dyshe punojnë një nga ushtrimet 1-3 të librit. Nxënësit/et përdorin kubet për të modeluar pakot e mëdha (2 mundësi për secilin pako). Skicojnë hapjen dhe njehsojnë sipërfaqen dhe perimetrin e saj, p.sh.:

Hapja për 12 kube (brinja e kubit është 2 cm).

	Vendosja e kubeve	Përmasat e kutisë	Hapja	Perimetri	Sipërfaqja
modeli 1	1 x 2 x 6	2 x 4 x 12	hapja 1	68	160
modeli 2	2 x 2 x 3	4 x 4 x 6	hapja 2	60	128
...	...	...	...	...	...

Përforcimi: *Rishikim në dyshe*


Nxënësit/et në çifte krahasojnë përlllogaritjet e perimetrit dhe sipërfaqes si dhe skicat e modeleve për hapjen e kutisë përkatëse. Pastaj i krahasojnë këto edhe me grupet e tjera. Paraqitet në dërrasë skica më e mirë për secilin nga ushtrimet 1-3, si dhe përlllogaritjet përkatëse.

Vlerësimi: Mësuesi/ja vlerëson individualisht për zgjedhjen e skicës më të mirë dhe bërjen saktë të përlllogaritjeve të perimetrit e sipërfaqes së kutive.

Detyrat dhe puna e pavarur: Ushtrimi 4 fq. 175.

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: 10. Sipërfaqja dhe perimetri. Përmbledhim.		Situata e të nxënësve: Bëjnë planimetrinë e klasës duke matur dhe llogaritur përmasat e dyshemesë së klasës, të tavolinave e dollapëve që kanë formë drejtkëndore.	
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave matematikore sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - mat dhe llogarit perimetrin dhe sipërfaqen e figurave drejtkëndore; - vizaton dhe mat segmente në centimetrin më të afërt; - llogarit perimetrin dhe sipërfaqen e figurave të përbëra që mund të ndahen në drejtkëndësha.		Fjalët kyçe: - Përmasa, gjatësia, gjerësia - Sipërfaqe, perimetër - Figura drejtkëndore	
Burimet: - libri i nxënësit, faqja 176-178 - fletore - letra me katrorë - vizore e thjeshtë dhe vizore metrike - makina llogaritëse - gërshërë		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuha dhe komunikimi, TIK, Art pamor.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve			
Organizimi i orës së mësimi:			
Parashikimi i të nxënësve: <i>Marrëdhëniet pyetje-përgjigje</i> Mësuesi/ja kërkon nga nxënësit/et të hamendësojnë përmasat e klasës dhe tavolinave. Një nxënës/e mat klasën dhe tavolinat (në metrin më të afërt). Bëjnë dhe skica në fletë letre me kuti për fundet e dollapëve që jepen në libër.			
Ndërtimi i njohurive të reja: <i>Imagjinatë e drejtuar</i> Mësuesi/ja ndan klasën në grupe 4-5 veta. Nxënësit/et zgjidhin në punë të pavarur ushtrimet 1-2 në libër. Ata/ato vizatojnë në skicë tavolinat e nxënësve dhe mësuesit dhe vendosin fletët e letrës me sipërfaqe sa fundi i dollapëve në pozicionet më të përshtatshme duke ruajtur përmasat relative. Pastaj nxënësit/et vizatojnë modele të ndryshme për shtrimin me pllaka të dyshemesë së klasës. Ata/ato vizatojnë në fletë me kuti një pjesë të modelit si në figurën më poshtë.			

Llogarisin numrin e pllakave të secilës ngjyrë në këtë model dhe i shumëzojnë me 6 për të gjetur numrin e pllakave të secilës ngjyrë në gjithë dyshtemenë. Shumëzojnë numrin e pllakave me çmimin e një pllake dhe gjejnë kushtimin në lekë të pllakave të secilës ngjyrë. Grupe të ndryshme bëjnë skica e përlllogaritje të ndryshme. Zgjidhen skicat më të mira.



Përforcimi: *Përmbledhje e strukturuar*

Mësuesi/ja zgjedh dy skica të ndryshme për të paraqitur në dërrasë. Nxënësit/et shpjegojnë gjithë veprimtarinë e tyre në zgjidhjen e ushtrimeve 1-2, duke përdorur saktë në arsyetim fjalorthin matematikor për matjen e perimetrit dhe sipërfaqes.


Vlerësimi: Mësuesi/ja vlerëson individualisht nxënësit/et për skicimin sa më të mirë të planimetrisë së klasës e të modelit për shtrimin e dyshtemesë si dhe kryerjen saktë të përlllogaritjeve përkatëse.

Detyrat dhe puna e pavarur: - Nxënësit/et bëjnë një model tjetër të shtrimit të dyshtemesë së klasës dhe përlllogarisin kushtimin në këtë rast.
- Nxënësit/et bëjnë planimetrinë e dhomës së tyre.

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: 10. Sipërfaqja dhe perimetri. Përforcojmë.		Situata e të nxënit: Nxënësit/et bëjnë postera me vizatime të përshtatshme ku mund të ngjiten etiketa me fjalët kyçe të përdorura gjatë kapitullit.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave matematikore sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - mat dhe llogarit perimetrin dhe sipërfaqen e figurave drejtkëndore; - vizaton dhe mat segmente në centimetrin më të afërt; - llogarit perimetrin dhe sipërfaqen e figurave të përbëra që mund të ndahen në drejtkëndësha.		Fjalët kyçe: - Sipërfaqe, perimetër i figurave - Gjatësia, lartësia, gjerësia, thellësia - m²; cm² më të afërt - Figura drejtkëndore - Figura të përbëra që ndahen në drejtkëndësha	
Burimet: - libri nxënësit, faqja 179 - fletore - letra të mëdha (në madhësinë e tabelave shfletuese) - bojëra uji - revista nga të cilat nxënësit/et mund të përzgjedhin imazhe		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuha dhe komunikimi, TIK, Art pamor.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve			
Organizimi i orës së mësimi: Parashikimi i të nxënit: <i>Diskutimi i njohurive paraprahe</i> Çiftet e nxënësve/eve të identifikojnë të gjitha fjalët kyçe matematikore të këtij kapitulli. Pas pesë minutash, mësuesi/ja i rendit të gjitha fjalët në tabelën e zezë. Mësuesi/ja i nxit me shembuj të ndryshëm nxënësit/et, që të kujtojnë të gjitha fjalët kyçe të përdorura në librin e nxënësit.			

Ndërtimi i njohurive të reja: *Rolet në grupet bashkëpunuese*

Mësuesi/ja ndan klasën në grupe 4-5 veta. Nxënësit/et ndërtojnë postera me vizatime të përshtatshme ku të përdoren fjalët kyç të kapitullit duke u frymëzuar nga figura e librit fq. 179, p.sh.:



Nxënësit/et mund të vendosin në postera planimetritë e dhomës së tyre të dhëna detyre një ditë më parë.

Përforcimi: *Përmbledhje e strukturuar*

Përfaqësues të grupeve prezantojnë para klasës posterat përkatës. Nxënësit/et vlerësojnë posterin më të mirë me vizatime interesante dhe me përdorim sa më të gjerë të fjalorthit matematikor e përkufizimet përkatëse.

Vlerësimi: Mësuesi/ja bën vlerësim diagnostikues mbi përdorimin saktë të fjalorthit matematikor me fjalët kyç për sipërfaqen e perimetrit e figurave drejtkëndore.

Detyrat dhe puna e pavarur: Nxënësit/et mund të përdorin imazhe nga revistat apo të bëjnë fotografi për përkufizimet e fjalëve kyçe.

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: 11A.Përpunimi i të dhënave- Përcaktoj pyetjen time. <i>Projekt (1).</i>		Situata e të nxënës: Çfarë jemi interesuar të gjejmë?	
Rezultatet e të nxënës të kompetencave matematikore sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: • mëson se si të përdorë statistikën në jetën e përditshme.		Fjalët kyçe: - Specifikim i problemit, pyetje - Planifikim - Të dhëna, studim	
Burimet: • libri i nxënësit fq. 181- 182 • libra referencë • internet		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuha dhe komunikimi, TIK, Shoqëria dhe mjedisi.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve

Organizimi i orës së mësim:

Parashikimi i të nxënës: *Përmbledhje e strukturuar*

Mësuesi/ja njih nxënësit/et me konceptin “Përpunim i të dhënave”, i cili ka të bëjë me marrjen e vendimit se çfarë të dhënash duhet të trajtojnë. Mësuesi/ja orienton nxënësit/et për të zgjedhur pyetje për të cilat janë vërtet të interesuar të gjejnë përgjigje. Pyetjet të jenë të qarta, të shkurtra dhe nga të cilat pritet një përgjigje e qartë.

Pyetjet të jenë nga e përditshmja, p.sh.:

- Sa orë mesatarisht mëson në ditë?
- Sa orë mesatarisht rri në internet?
- Sa është shtatlartësia juaj?

Nga interneti e libra referencë, p.sh.:

- Cili është lumi më i gjatë në Shqipëri?
- Cili vend në Evropë ka më shumë reshje mesatarisht në vit?

Ndërtimi i njohurive të reja: *Rolet në grupet bashkëpunuese*

Mësuesi/ja ndan klasën në grupe 5-6 veta. Secili pjesëtar i grupit rendit idetë e tij në fq. 182. Përgjegjësi i grupit orienton pjesëtarët në bërjen e pyetjeve ku të dhënat merren nga e përditshmja apo librat referencë e interneti. Të dhënat që do të shqyrtohen mund të jenë sasiore – me numër (diskret, i vazhdueshëm) ose cilësore – veti. Pasi i diskutojnë në grup pyetjet, zgjidhen ato më interesante dhe të shumëllojshme.

Përforcimi: *Imaginatë e drejtuar*

Çdo grup zgjedh vetëm 3 nga pyetjet më interesante të bëra. Pyetjet të jenë të shumëllojshme, pra të dhënat të jenë:


- 1) sasiore (diskret) (notat e marra në një provim);
- 2) sasiore (i vazhdueshëm) (shtatlartësia);

3) cilësore (ngjyra që iu pëlqen më shumë); Secili grup të përzgjedh një pyetje për të cilën janë të interesuar të kryejnë punë kërkimore. Pyetje të tilla i drejtojnë grupet të zgjedhin fusha të caktuara, p.sh.: 1) Grupi i Gjeografisë; 2) Grupi i Historisë; 3) Grupi i astronomisë etj. Për këto pyetje, nxënësit/et grumbullojnë të dhëna për të plotësuar tabelën në orën e ardhshme.
Vlerësimi: Mësuesi/ja bën vlerësim diagnostikues për mënyrën e qartë të bërjes së pyetjeve.
Detyrat dhe puna e pavarur: - Nxënësit/et paraqesin në dosjen e tyre të projektit 3 pyetjet e zgjedhura. - Nxënësit/et zgjedhin pyetjen që iu intereson më shumë dhe e shkruajnë atë në fund të fq. 182.

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: 11A. Përpunimi i të dhënave – Çfarë di unë deri tani.		Situata e të nxënit: Kërkojnë të gjitha të dhënat e mundshme rreth pyetjeve që kanë parashtruar duke përdorur internetin e librat referencë.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave matematikore sipas temës mësimore Nxënësi/ja: • mëson se si të përdorë statistikat në jetën e përditshme. • zgjidh një problemë duke paraqitur, përmbledhur dhe interpretuar të dhënat në tabela, grafike, skema dhe diagrame.		Fjalët kyçe: - Të dhënat - Studim - Pyetësor	
Burimet: • libri i nxënësit, fq. 183 • libra referencë • internet		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuha dhe komunikimi, TIK, Shoqëria dhe mjedisi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve			
Organizimi i orës së mësimi:			
Parashikimi i të nxënit: <i>Marrëdhënie pyetje-përgjigje</i> Mësuesi/ja iu kërkon nxënësve/eve të prezantojnë para klasës pyetjet e zgjedhura, për përgjigjet e të cilave janë vërtet të interesuar. Një nga pyetjet e kanë zgjedhur nga një fushë e caktuar që përfaqëson grupin ku ata bëjnë pjesë në projekt, p.sh.: Grupi i gjeografisë, grupi... (zgjedhja me dëshirën e nxënësve). Ata kanë grumbulluar të dhëna parësore apo dytësore për pyetjet e zgjedhura.			
Ndërtimi i njohurive të reja: <i>Rolet në grupet bashkëpunuese</i> Nxënësit/et punojnë në punë të pavarur plotësimin e tabelës në libër, fq. 183. Për pyetjet e zgjedhura plotësojnë tabela me të dhënat e grumbulluara dhe citojnë burimin nga janë marrë, p.sh.: tabela me notat e marra në një provim matematike, burimi i të dhënave - regjistri.			
Përforsimi: <i>Hulumtim, shqyrtim i përbashkët</i> Nxënësit/et e një grupi pasi lexojnë pyetjet e njëri-tjetrit zgjedhin 3 pyetjet më interesante dhe vlerësojnë seriozitetin e burimit nga janë marrë të dhënat. Ata/ato kërkojnë që për pyetjet e zgjedhura, të hulumtohet për të dhënat nga disa burime në mënyrë që informacioni të jetë sa më i saktë.			
Vlerësimi: Mësuesi/ja bën vlerësim diagnostikues për zgjedhjen e pyetjes dhe grumbullimin e të dhënave për pyetjet e zgjedhura.			
Detyrat dhe puna e pavarur: Për pyetjet e zgjedhura, të hulumtohet dhe nga burime të tjera për të siguruar të dhëna të sakta.			

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: 11A. Përpunimi i të dhënave – Kryerja e një studimi. <i>Projekt 2.</i>		Situata e të nxënit: Cili është ushqimi që të pëlqen më shumë?	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave matematikore sipas temës mësimore Nxënësi/ja: • mëson se si të përdorë statistikën në jetën e përditshme; • zgjidh një problemë duke paraqitur, përmbledhur dhe interpretuar të dhënat në tabela, grafike, skema dhe diagrame; • gjen mesataren dhe mesoren në një varg të dhënash; • gjen modën e vargut të të dhënave në situata të përshtatshme.		Fjalët kyçe: - Të dhëna - Tabelë e dendurive - Të dhëna parësore, dytësore	
Burimet: • libri i nxënësit, fq. 184-185 • libra referencë • internet		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuha dhe komunikimi, TIK, Shoqëria dhe mjedisi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve			
Organizimi i orës së mësim:			
Parashikimi i të nxënit: <i>Kërko-hulumto</i> Mësuesi/ja kërkon që përfaqësues të grupeve të prezantojnë para klasës pyetjet më interesante nga fusha të ndryshme, që kanë zgjuar interesin e nxënësve/eve për të grumbulluar të dhëna për to, pra rreth së cilave kanë bërë një punë kërkimore.			
Ndërtimi i njohurive të reja: <i>Rolet në grupet bashkëpunuese</i> Nxënësit/et punojnë në punë të pavarur ushtrimin e librit fq. 184-185. Më pas, diskutojnë në grup për pyetjet që iu drejtohen njerëzve, tregojnë grupin e njerëzve që iu drejtohet pyetja, numrin e njerëzve të pyetur dhe shpjegojnë arsyen pse kanë zgjedhur këtë grup njerëzish. Diskutohet pyetja e shtruar të situatës së të nxënit: <i>Cili është ushqimi që të pëlqen më shumë?</i> (nëse ndonjë grup ka paraqitur interes për të), p.sh.: Grupi - Njerëz të ndryshëm Numri i njerëzve të pyetur - 30 Arsyeja - të gjithë kanë një ushqim të preferuar.			
Përforsimi: <i>Diskutimi i njohurive paraprahe</i> Të dhënat e grumbulluara që në orën e mëparshme i paraqesin në tabelën e dendurive. Llogarisin mesoren, modën, mesataren aritmetike dhe amplitudën.			
Vlerësimi: Mësuesi/ja bën vlerësim diagnostikues për mënyrën e qartë të zgjedhjes së pyetjes, të grupmoshës dhe arsyes.			
Detyrat dhe puna e pavarur: Të dhënat e grumbulluara nga pyetjet që kanë zgjedhur t'i hedhin në tabelat e dendurive.			

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: 11A. Përpunimi i të dhënave – Paraqitja e të dhënave		Situata e të nxënit: Paraqitja e të dhënave me tabelë, diagrame e grafike të ndryshme.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave matematikore sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - mëson se si të përdorë statistikën në jetën e përditshme; - zgjidh një problemë duke paraqitur, përmbledhur dhe interpretuar të dhënat në tabelë, grafike, skema dhe diagrame; - gjetja e mesatares dhe mesores në një varg të dhënash; - gjetja e modës së vargut të të dhënave në situata të përshtatshme.		Fjalët kyçe: - Tabela dendurish - Zgjedhjet më shumë/më pak të zakonshme - Tabela krahasimore - Grafik me pika, drejtëz, piktogram, me shtylla, diagram	

Burimet: - libri i nxënësit, fq. 184-185 - libra referencë - internet	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuha dhe komunikimi, TIK, Shoqëria dhe mjedisi.																
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve																	
Organizimi i orës së mësimi:																	
Parashikimi i të nxënit: <i>Kërko - hulumto</i> Nxënësit/et kanë zgjedhur pyetjet e kanë hulumtuar për të grumbulluar të dhëna me të cilat kanë plotësuar tabelat të ndryshme. P.sh.: rezultatet në atletikë mund të paraqiten në mënyrë efikase si një listë historike e rekordeve botërore sipas viteve përkatëse. Ndryshimet në klimë mund të paraqiten në një tabelë krahasimore. Ndonjëherë është e përshtatshme të pasqyrohen të dhënat në një grafik si për shembull grafik me pika, grafik drejtëz, piktogram apo diagram me shtylla, diagrami i Veni. Mësuesi/ja nxit nxënësit/et të argumentojnë se pse kanë zgjedhur pasqyrimin e të dhënave në një mënyrë të caktuar.																	
Ndërtimi i njohurive të reja: <i>Rolet në grupet bashkëpunuese</i> Përfaqësuesit e grupeve i caktojnë secilit pjesëtar të grupit paraqitjen e të dhënave të grumbulluar nga intervistat apo hulumtimi i bërë në orën e kaluar, në një nga mënyrat (tabelë – grafikë – diagram), p.sh.: Notat e marra në një provim matematike. Ndërtojnë tabelën e dendurive, bëhet grafiku me shtylla dhe gjendet moda, mesorja, mesatarja aritmetike dhe amplituda.																	
<table><tr><td>notat</td><td>4</td><td>5</td><td>6</td><td>7</td><td>8</td><td>9</td><td>10</td></tr><tr><td>denduria</td><td>2</td><td>4</td><td>7</td><td>4</td><td>5</td><td>3</td><td>2</td></tr></table>		notat	4	5	6	7	8	9	10	denduria	2	4	7	4	5	3	2
notat	4	5	6	7	8	9	10										
denduria	2	4	7	4	5	3	2										
																	
Mesorja - 7 Moda - 6 Mesatarja aritmetike $\approx 6,9$ Amplituda - 6																	
Përforcimi: <i>Imaginatë e drejtuar</i> Nxënësit/et paraqesin para klasës disa nga mënyrat e paraqitjes së të dhënave dhe argumentojnë pse kanë zgjedhur pasqyrimin e të dhënave pikërisht në këtë mënyrë.																	
Vlerësimi: Mësuesi/ja bën vlerësim diagnostikues mbi mënyrën e zgjedhjes së pyetjes, saktësinë e të dhënave të grumbulluara dhe paraqitjen e tyre me tabelë, grafik e gjetjen e mesatareve.																	
Detyrat dhe puna e pavarur: Për një nga pyetjet e zgjedhura, nxënësit/et paraqesin të dhënat në tabelë, bëjnë grafikë të përshtatshëm për pyetjen.																	

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: 11A. Përpunimi i të dhënave – Interpretimi i të dhënave, planifikimi i një prezantimi (Projekt 3).		Situata e të nxënësve: Të interpretojnë vargun e të dhënave.	
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave matematikore sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - mëson se si të përdorë statistikën në jetën e përditshme; - zgjidh një problemë duke paraqitur, përmbledhur dhe interpretuar të dhënat në tabelë, grafikë, skema dhe diagrame; - gjen mesataren dhe mesoren në një varg të dhënash; - gjen modën e vargut të të dhënave në situata të përshtatshme.		Fjalët kyçe: - Varg të dhënash - Moda, mesorja, mesatarja aritmetike, amplituda - Tabela, grafik	
Burimet: - libri i nxënësit, fq. 187-188 - libra referencë - internet		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuha dhe komunikimi, TIK, Shoqëria dhe mjedisi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve			
Organizimi i orës së mësimi:			
Parashikimi i të nxënësve: Diskutimi i njohurive paraprake Nxënësit/et diskutojnë në grup të gjitha fazat e projektit nëse kanë nevojë për ndonjë përmirësim para se ta prezantojnë. Shohin nëse pyetjet e bëra janë formuluar në mënyrën më të mirë të mundshme, a janë marrë të dhënat nga burime të besueshme, a janë paraqitur në tabelë të përshtatshme, a janë ndërtuar grafikët saktë, a janë gjetur mirë moda, mesorja, mesatarja aritmetike, amplituda.			
Ndërtimi i njohurive të reja: Rolet në grupet bashkëpunuese Grupet prezantojnë projektin duke filluar me radhë nga pyetjet, të dhënat, tabelat, grafikët, mesoret e shpërndarjen statistikore. Për këtë mund të përdorin prezantimin me videoprojektor.			
Përforcimi: Imagjinatë e drejtuar Mësuesi/ja dhe nxënësit/et vlerësojnë grupin që ka zgjedhur pyetjet më të mira, burimet e të dhënave më të besueshme, kanë ndërtuar tabelat e grafikët më të përshtatshëm e kanë llogaritur saktë mesoren, modën, mesataren aritmetike, amplitudën. Gjithashtu vlerësohen grupet që gjatë prezantimit përdorin saktë fjalorthin matematikor me fjalët kyçe që i përkasin kapitullit të “Përpunimit të të dhënave” si: të dhënat, studim, pyetësor, etiketim; grafik, grafik-drejtëz, piktogram, diagram me shtylla apo rrethor; tabelë, tabelë frekuence; diagrami i Venit; më shumë/më pak e njohur; më shumë/më pak e zakonshme; mesatare, mesore, modë, renditje.			
Vlerësimi: Mësuesi/ja vlerëson punën në grup për organizimin saktë të projektit në gjithë fazat e tij dhe përdorimin e fjalorthit matematikor për kapitullin “Përpunim i të dhënave”.			
Detyrat dhe puna e pavarur: -			

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla: III	Klasa: VI
Tema mësimore: 11B. Probabiliteti Zbulojmë.		Situata e të nxënit: Gara me kuaj. Cili kalë do të zgjidhet si fitues? Pse?	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave matematikore sipas temës mësimore Nxënësi/ja: përdor gjuhën që lidhet me probabilitetin për të diskutuar ngjarje, për të vlerësuar mundësitë dhe riskun, duke përfshirë ngjarjet që kanë mundësi të barabarta të ndodhin.		Fjalët kyçe: - E mundur, e pamundur - Ka gjasa, më shumë/më pak të ngjarë - Ngjarje, probabilitet, rezultat	
Burimet: - libri i nxënësit, faqja 189 - zare - gurë		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuha dhe komunikimi, TIK, Art pamor.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve			
Organizimi i orës së mësimi:			
Parashikimi i të nxënit: <i>Marrëdhëniet pyetje-përgjigje</i> Mësuesi/ja pyet nxënësit/et ç`kuptojnë me fjalën “probabilitet”. - Kur themi: “ <i>Sa është probabiliteti i ndodhjes së ngjarjes A</i> ”, cilat përgjigje pres? Nxënësit/et përgjigjen: <i>Ngjarja A është e mundur të ndodhë, ka më shumë gjasa, ka më pak gjasa, është e sigurt, është e pamundur.</i>			
Ndërtimi i njohurive të reja: <i>Rolet në grupet bashkëpunuese</i> Mësuesi/ja ndan klasën në grupe me nga 12 veta. Secili nga nxënësit zgjedh të vendosi gurin me ngjyrë në një nga numrat 1-12. Një lojtar hedh dy zare njëri pas tjetrit. Më pas, lëviz një kuti përpara kalin, numri i të cilit del nga shuma e zareve. Për shembull, nëse në zare kanë rënë 6 dhe 4, kali 10 (shuma e të dyja zareve) bën një lëvizje përpara. Kali që arrin i pari në postin fitues, fiton lojën. Lihen nxënësit/et të luajnë tre ose katër herë derisa të kuptojnë dhe të identifikojnë kuajt që kanë më shumë/më pak gjasa për të fituar. Kur loja të jetë bërë disi e qartë, lihen grupet të plotësojnë faqen në librin e nxënësit. Pyeten nxënësit/et: <i>Mendoni se loja është e “drejtë” apo “e padrejtë”?</i> <i>Mendoni se rezultatet janë të njëanshme?</i>			
Përforcimi: <i>Përmbledhje e strukturuar</i> Mësuesi/ja shkruan tabelën e mëposhtme në dërrasën e zezë. Iu kërkohet nxënësve/eve të plotësojnë tabelën (Tri rreshtat e parë janë plotësuar si shembull). Përdoret tabela për t’iu kujtuar nxënësve/eve se probabiliteti i një ngjarjeje është raporti i numrit të mundësive që ajo ngjarje të ndodhë me numrin total të përfundimeve të mundshme. Mësuesi/ja iu shpjegon nxënësve/eve se rezultatet kanë mundësi të barabarta për të ndodhur dhe se shuma e probabiliteteve të të gjitha përfundimeve të mundshme është 1.			
Shuma e pikëve në të dy zaret	Mënyrat e mundshme	Numri i mundësive	
1	E pamundur	0	
2	(1,1)	1	
3	(1,2) , (2,1)	2	
4			
5			
6			
7			
8			
9			
10			
11			
12			